



*Xhemal Ahmeti*

*Odiseu*

*nuk kthehet*

*më!*

*Heliodori, Volteri dhe Leibniz. Nga  
Gilgameshi, Homeri, Dante  
e deri tek Imre Kertesz. Gentileshi,  
Austin, Shelley dhe Emma Bovary.  
Schileri, Camus, Barthes Eco dhe ...*

*Exilvox*

Xhemal Ahmeti ka lindur më 1969. Që nga viti 1991 jeton në Zvicër. Përveç këtij libri ai ka botuar ndër të tjera në gjermanisht, shqip e frëngjisht edhe veprat «*Shqiptarët në postmodernë*», «*Seleksion*», «*Kulturofsera në apori*», «*Paranoja*» (roman), «*Etnokracitë e Evropës Juglindore*» e të tjera.

Libri: „*Odiseu nuk kthehet më*“, është përmbledhje esesh që trajtojnë tema dhe probleme fushash të ndryshme të dijës nga: letërsia, kulturologjia, filozofia, historia, artet. Në libër trajtohen vepra letrare, duke filluar nga antika, mesjeta, (pas)moderna, monumente letrare të llojit si saga e Gilgameshit, epet e Homerit, veprat e Dantes, Shilerit e deri tek ato të autorëve të sotëm e të djeshëm si Camus, Eco, Neruda, Baricco, Palamas, Yalom, Kundera, Quinn, Coelho etj. Një pjesë të veçantë në libër zënë vend edhe debatet aktuale intelektuale. Duke u krahasuar analizohen dhe kritikohen paradigma si ato të Sloterdijk, Eagleton, Žižek, Han, Arendt, Habermas, Herni-Levy, Sedlaček...

*Xhemal AHMETI*

# *Odiseu*

*nuk kthehet më*

*Exilvox*  
2019

## LËNDA

Pjesa e parë

### TEMA

HELIODORI, VOLTERI DHE LEIBNIZ

*Esenca e udhëtimeve imagjinare*

NGA GILGAMESHI, HOMERI, DANTE

E DERI TEK IMRE KERTÉSZ

*Personazhët në gijotinë – ose programimi fatal i qenies*

GENTILLESHI, LA FAYETTE, BEHN,

AUSTIN, SHELLEY DHE EMMA

*Historia e një dashurie në gijotinë*

SHILERI, BREHTI, FLEMINGU

DHE TASLIMA NASRIN

*Arti si mjet i luftës ndërgjinore*

ALBERT CAMUS

*Arti olimpik brenda një filozofie të dështuar*

PABLO NERUDA

*Liriku gjenial dhe agitatori banal*

ECO, MANFREDI, BARICCO

*Trashëgimtarët e Dantes*

PALAMAS, KAVAFIS, RITSOS

VASILIKOS DHE ELYTIS

*Odiseu nuk kthehet më!*

RUDOLF BLÜMNER  
& XHINGIS AITMATOV

*Xhamilja ose puropoetika*

LEROUX, KAY, WEBER, STILGOE,  
YESTON DHE FANTOMI I OPERAS

*Një histori e shëmtisë, artit dhe dashurisë*

Pjesa e dytë

**LIBRA**

IRVIN DAVID YALOM

*«When Nietzsche Wept»\**

PETER ACROYD\*.

*Testamenti i fundit i Oscar Wilde, 1983*

ROLAND BARTHES

*Vita Nova ose ligjërata e fundit*

UMBERTO ECO

*«Flaka misterioze e mbretëreshës Loana»*

MILAN KUNDERA

*Injoranca ose legjenda e kasapit islandez*

DANIEL QUINN

*Ismael ose Gorilla akuzon qytetërimin njerëzor*

PAOLO COELHO

*Shamani i «pabesisë», 2015*

MICHEL HOUELLEBECQ

*Profet apo maniak?*

Pjesa e tretë

**DISKURSE**

BERNARD-HENRI LEVY

*Romani që paralajmëroi terrorin*

HABERMAS, BENDIT, KONRAD, MAK

*Ave Europa? Eurodebat*

DAWKINS, HITCHENS, HARRIS KUNDËR

COLLINS, McGRATH DHE SPAEMANN

*Parada e neoteistëve*

BERNARD-HENRI LÉVY

*Sartre - Ekzistenca dhe esenca e shekullit që shkoi?*

EAGELTON, RIFKIN, JUDT, HAN

*Postmoderna si epokë e CashKulturës*

TOMÁŠ SEDLÁČEK

TOMÁŠ SEDLACEKÁ

*Moralet dhe biznesi në simbiozë*

PETER SLOTERDIJK

*Filozofia e imagjinimit kundër realitetit*

SLAVOJ ŽIŽEK

*Religjioni megjithatë opium?*

HANNAH ARENDT

ose enigma e një kampanje

*Epilog: ESE PËR EPISTEMOCIDIN*

Pjesa e parë  
TEMA



## HELIODORI, VOLTERI DHE LEIBNIZ

### *Esenca e udhëtimeve imagjinare*

Me Heliodorin dhe Volterin gjeografisë së imagjinatës për të kuptuar esencën e udhëtimit në art.

Ajo kishte vendosur të jetojë e privuar nga dashuria. Priftëresha Kariklea nateditë i shtrihej pranë këmbëve të mermerta Artemisias, perëndeshës së fëmijëve dhe grave që t'i shpëtojë të fundit nga tmerret e botës. Një ditë mori bekimin e saj, duke u «mallkuar» me dy provime; me një dramë dhe një mrekulli: Kariklea dashurohet dhe detyrohet të ikë botës.

Në konstruktin e Erosit perëndesha ia shfaq Karikleas Teagjenin thesalez, i cili me bukurinë e tij edhe meshkujt i rrëzon për toke e lere më gra e perëndi. Nën trupin e thesalezit, priftëresha mirëpo mund të shtrihet e shkrië vetëm mijëra kilometra larg tempullit të Delfit. Nis shtegtimi ujërave të Mesdheut. Moti i keq i detyron të ndalen në ishullin Zakynthos. Aty robërohen nga një bandë piratësh të pamëshirshëm që me çdo kusht duan të bëjnë ca seanca erogjimanstike me të bukurën e Delfit. Skllavërohen dhe ndahen nga hordhi piratësh në konkurrencë. Pas një kohe Artemisia i bën sërish bashkë, ngase piratët i sjellin që të dytë në Nidelta të Egjipti për t'i shitur. Gruaja e

perandorit të Memphis-it Arsakeja sapo shoh Teagjenin e bukur i këputen gjunjët nga epshi dhe donë ta eliminojë Kariklean. Edhenjëherë hyn në aksion Artemisia dhe i flet në vesh burrit të Arsake-s Oroondates-it. Ky urdhëron që dy të dashuruarit t'i shkojnë në pallat. Pa sukses. Hordhi etiopianësh i zënë rob dhe i dërgojnë tek mbreti i tyre Hydaspes. Ky gjithë sa plas nga lumturia se më në fund i gjeti «kurbanët» për zotërat e tij kanibalë. Sërish Artemisia përvesh krahët. Mbreti zbulon Kariklea të jetë e bija e tij. Që nga ky çast e deri në fund të jetës Kariklea dhe Teagjeni nuk lënë luadh, shtrat e çarçaf të kryeqytetit Meroë të Etiopisë pa e ndukë e shkoq gjatë betejave të tyre epushore. Dhe Lukiani gjuhëhelmtë i Samosatës do të shtonte: Artemisia sigurisht se shkrihej me vetveten duke parë dy titanoidët e zhytur në seks.

## UDHËTIMI SI UTOPI OSE GËNJESHTËR

Përshkrimi është substanca e romanit «*Aithiopikà*» të Heliodorit nga Emesa (289-360). Të kësaj kategorie homeriadash janë pothuaj të gjitha veprat, romanet, epet deri në shfaqjen e legjendave, reportazheve të rrejshme të tregtarit dallmat Marco Pollo gjatë shekullit 13, të cilat çuditërisht nga historia e letërsisë merren në indeks poashtu si vepra adekuate artistike, çka s'janë. Stabilizimi vjen me ciklin pesëvëllimësh të romaneve parodike dhe utopike të François Rebelais «*Gargantua dhe Pantagruel*» (1532 – 1564) mbi botën e perversuar. Rebelais, respektivisht kapitulli i tij utopik «*L'abbaye de Thélème*» që huazohet si brum nga «*Utopia*» (1516) e Thomas Morus-it shkakton një llavë zhanrore në të cilën udhëtimet nuk kanë më synimin standard; shpëtimin e një fatumi interpersonal nëpërmjet dashurisë (Odiseu, Kariklea dhe Teagjeni me

qindra trashëguesit e tyre letrarisë universale), por udhëtojnë kërkueshëm drejt në bote të re, utopike. Andreas shkruan «Christianopolisin» (1619), Cmpanaella «Civitas Solis»in (1623) dhe Bacon-i «Nova Atlantis»in, sa për t'i përmendur të mbijetuarit.

Dy figura e thyejnë këtë modë: Gottfried Wilhelm Leibniz dhe Docteur Ralph, alias François-Marie Arouet alias edhe njëherë Voltair-i!

## GJITHA TË KËQIJAT E KËSAJ BOTE

Filozofi optimist Panglos (shqip = llapëmadhi) që ligjëronte «metafiziko-teologo-kosmolo-nigologjinë» i pati fajet. Një ditë gjersa baronesha e re Kunegunde shëtitej kaçubave të pallatit të metadorit të Westfalen-it Hans Jost Kurt dëgjoi ca psherëtima intensive. Magjistri Panglos kishte mbërthyer nga mbrapa gruan e tij dhe i provonte ca hipoteza të fizikës eksperimentale. Baronesha e bukur dhe e re, po si Artemisia që ndiqte paraeksplodueshëm muskujt e thesazetit bodybilder mbi trupin e priftëreshës së saj, edhe kjo si ndryshe përpos të nxehet e nxihet për një mashkull. Vrapas niset drejt pallatit dhe në portë ja Kandidi! Oh Kandidi! Shkaku u bë Panglos-i e veprimin bëri Kandidi. Të nesërmen të dytë, Kandidi dhe Kunegunde fshihen pas një muri spanjoll. Puthjet trembin bylbylat. Ajo lëshon fustanin për dhe ky ulet në gjunjë dhe, dhe aty pranë kalon Baroni, i cili bëhet shkaktari që përzë Kandidin nga pallati dhe e detyron atë botës. Asaj bote poaq të tmerrshme siç e pamë tek Heliodori 14 shekuj më herët. Në ikje e sipër Kandidi bie në dorë të ushtrisë primitive bullgare dhe kupton se diçka nuk shkon me teorinë e Panglos-it që thoshte të jetojmë «në botën më të mirë të mundshme». Të njëjtët, bullgarët kanibalë pra, sulmojnë Westfalinë dhe

vrasin e djegin gjithçka që ua kap syri. Ikë kontinentit mu në mes të tërmetit fatal të Lisbonës. Këtu, në kulmin e tragjedisë gëzohet ta gjej Kunegunden e përdhunuar qindra herë nga bullgarët, marinarët, skllavopronarët, tregtarët çifutë dhe piratët dhëmbëpalarë. Sërish ikë, udhëton për ta shpëtuar jetën. Tash me një shoqërues Cacambo-n mbërrin në Paraguai ku takon të vëllamin e Kunegundes, të shndërruar në jezuit. Pas gëzimit të bashkimit të dytë ia fusin njëri tjetrit shpatat në bark dhe njëri vdes. Jo Kandidi por jezuiti që s'mundej të parafytyroj skenën ku një qytetar i zakonitë ia heq teshat nga trupi një baroneshe edhe pse të përdhunuar nga dreqi e i biri. Në El Dorado mbush Kandidi thasët me diamantë e ar. Në Surinam takon enjë filozof tjetër Martinin që është e kundërta e optimistit Panglos, një pesimist që vetëm Shopenhaueri që lindë sapo vdes Volteri (1788) mund të jetë dhe askush tjetër. Nga Parisi në Kostandinopojë dhe dramës së udhëtimit i vjen fundi: Aty Kandidi takon Kunegunden e tij, tashmë aq të shëmtuar saqë vetëm si kuzhinierë vlen. Aty takon edhe Panglosin e konsideruar të vdekur. E shëmtuara, i pasuri, dy filozofët njëri pesimist e tjetri optimist vendosin të jetojnë sipas motos së pesimistit Martin: «Le të punojmë pa u menduar, është e vetmja mënyrë për ta bërë jetën të durueshme» dhe Kandidi që njeh rrëfimin rreth Odiseut dhe Penelopës ia kthen: «Sa bukur e the ... mirëpo kopshtin duhet patjetër ta kultivojmë». Cilin kopsht?

## NDËRMJET FIKTIVES, FAKTIVES DHE KIÇIT

E qartë: Kandidi i Volterit është një vepër kundër optimizmit të filozofit gjerman Gottfried Wilhelm Leibniz, i cili besonte se përkundër të gjithave humaniteti të jetojë në «botën më të mirë të mundshme». Volteri

udhëton botës për t'i dëshmuar gjermanit që përtallshëm e çemëron në Llapëmadh (greqishte = Panglos) se Zoti dhe Njeriu veprojnë me pamëshirë; se bota është ferri vetë dhe se ajo nuk ndryshon me optimizëm të verbër por vetëm me përndritje, me luftë që si armë ka dashurinë infektive, ngase vetëm kjo e fundit do ta ndryshojë botën nga gjendja siç është. Vërtetë?

Teoria polemiste e Volterit mirëpo ne na intereson më pak se sa modeli se si letërsia, arti përdor ecjen, udhëtimin si proces ndërmjet nisjes dhe finales së shpjegimit të botës. Nga njëra anë kemi letërsinë me përmbajtje të rëndë filozofike e artistike (Heliiodori, Volteri, Sternes), në mes atë të kiçit (Pollo, Karl May, Jule Vernes) dhe në anën tjetër atë faktiken, respektivisht reportazhin. Brenda këtyre tri kategorive cili është kontributi i prozës shqipe.

## EKSKURS: UDHA SHQIPTARE RRETH VETES

Udhëtimet e shkrimtarëve shqiptarë janë kryesisht historikorrigjuese, rekurrente. Shumica e shkrimtarëve shqiptarë nuk udhëtojnë botëve (i)reale, utopive, sferave të pëртејјёsisё e këndeјјёsisё për ta krijuar një botë për vete, por postohen në një skenë «reale», historikisht të rrëfyer, dhe nga aty reimagjinojnë botën në stilin e Karl May-t. Këtë edhe e bëjnë mrekullueshëm ashtu siç bëjnë dy a tre autorë që përpunojnë kohën dje dhe sot, fenomenet brenda kulturës së tyre, por nuk udhëtojnë dhe kjo ka një arsye konkrete: mungon materiali, kapitali i njohjes, gjeografia, historia, njohuritë mbi kulturat, epokat, historitë, qytetërimet, mitologjitë, paradigmat filozofike, realitetet aktuale vendeve, shoqërive, pra mungon gjithçka nga ajo me çka disponojnë trashëgimtarët e Volterit. Maksimumin

që kemi në letërsinë shqiptare është shqiptarizimi i Romeos dhe Xhulietës në Hanife dhe Ilir, që donë të thotë imitim i zbehtë i atyre skenave tashmë një miliard herë të konsumuara brenda opusit re-kreativ human. Ata pak autorë që kanë pasur «fatin» realisht të udhëtojnë, e kanë bërë udhëtimin vetëm fizikisht ngase në çdo paragraf u shkëlqen trasta që e kanë marrë nga shtëpia.

## UDHËTIMI I FLETOREVE TË ZEZA

Si tek Heliodori ashtu edhe tek *comedia erudita* e Volterit (që përdorëm si shembuj përgjithësues) shohim se në letërsi Bota barazohet kushtimisht më Udhëtimin! S'ka letërsi universale pa lëvizje. Përkundër këtij fakti, se përmbajtja, materiali, pjesa më e madhe, absolute e veprave letrare është udhëtimi (qoftë i bazuar në skena reale apo plotësisht të imagjinuara) ky segment është më i pahulumtuari siç argumentoi njëri nga studiuesit më të spikatur të drejtimit Peter Brenner me studimin e tij «Parastudim mbi historinë e një zhanri» (1990), pas të cilit katedrat anglosaksonike e deformuan edhe më tepër temën me teoritë e tyre farekoti të «*travel writing*»-ut, që më shumë na mëson për gjeopolitikën e globit se sa për esencën e udhëtimit në art.

Aktualisht vazhdon të mbizotërojë ky model proze që udhëtimin botëve, kulturave, mendësive, realiteteve e ekspozon si vuajtje, ferr, tmerr, si zonë barbarësh, si teatro nga lloji i atyre që Augustini dhe Pontifexi Maximum Scipio Nasica donin t'i djegin bashkë me aktorë. Leibniz donte ta ndryshojë këtë gjendje, mirëpo nuk ia doli, ngase as ai nuk diti t'i japë përgjigje pyetjes së Volterit: pse njeriu si qenie në mesin e kopshtit disahektarësh me lule të

Kostandinopojës automatikisht me sy kap atë grumbull plehu sa një shuplakë në një cep të tij?

Ka letërsi të madhe ku udhëtimi është emancipim, njohje, hapje, pasurim (jo me diamantë si Kandidi), bukuri? Me siguri se po, dika diku, mirëpo edhe në këtë shekull njeriu mbetet magnet i negativitetit që e konsideron si energji jete, prandaj ky model letërsie vazhdon ta mbajë tregun dhe mendjen e mondanitetit. Duhet edhe njëherë që poezia të triumfojë mbi zhanret tjera që bota të të rimbushet me frymë për një udhëtim më të bukur se ky mbizotëruesi!

## NGA GILGAMESHI, HOMERI, DANTE E DERI TEK IMRE KERTÉSZ

*Personazhët në gijotinë – ose programimi fatal i  
genies*

Në fund ata të gjithë vdesin: të vetëhelmuar, të vetëvrrarë, të djegur ose të varrosur për së gjalli. Ky është fati i shumicës absolute të personazheve që popullojnë kryeveprat e letërsisë universale. Dhe natyrisht se, specia humane e rritur dhe keqskalitur me këtë frymë ku dhuna, hakmarrja, lufta, vdekja janë stacionet e pakapërcyeshme të jetës, do të rrekej pas gjermimit të çfarëdo koncepti metafizik që do t'i hynte në punë sadopak për ta kamufluar kuptimin e ashtuqenies, asaj gjendjeje të shëmtuar që duket të jetë baza edhe e videolujës «mortal combat» të programuesit Ed Boon (1992) dhe çdo horroriteti tjetër të imagjinatës së demonëve.

E gjeti humaniteti arsyen se pse artet historikisht fabrikuan më shumë tragjedi nga shpirti i tyre se sa të bukurën që e kanë si devizë në ballë? Është ky shkaku se pse *Nietzsche* thoshte «tragjedia të ketë lindur nga fryma e muzikës» dhe arteve të tjera në përgjithësi, prandaj edhe aversioni ndaj sofoklinjëve dhe nënshtrimi i tij demonstrativ para gishtave pluhurplotë të këmbëve të



*Abura Masda-s së Zaratustrës?* Ky do të jetë me siguri thelbi edhe i vendimit të *Faustit* për t'iu bashkuar djallit dhe domosdo konstatimi i Schopenhauer-it «*jeta të jetë vuajtja dhe asgjë më shumë*», do të ketë rezultuar nga ky motiv pesimist.

Para se të bastisim veprat bazë, epet monumentale që hapin bibliotekën, mësonjëtoen e edukimit human me artet, konkretisht nëpërmjet letërsisë edhe një pyetje esenciale: Po shkrimtari postmodern? Sillet edhe ky lartë poshtë hapësirës së tij absurde në «pritje të godosë» ose ndonjë muze inteligjente apo ka gjetur më në fund çelësin për t'u çliruar nga roli i tij i gjetinuesit profesional, që në fund i çon personazhet si «cjapin tek kasapi»?

## MITOLOGJIA DHE EPIKA

Në kryesagën «*Enūma eliš*», gjenezisin akadik, krijuesi i kozmosit *Marduk*, duhej fillimisht ta fryjë me katër erërat mëmëperëndeshën *Tiamat* si një balonë deri sa pëlciti (zhbërje) si kusht për ta sajuar gjithësinë; tokën, shiun, oqeanet, plehrat dhe natyrisht ta ndërtojë Babilonin. Pas shuarjes së *Enkidu-së*, tirani i Urukut «*Gilgamesh*» u frikua e tmerrua aq i goditur nga vdekja, sa që la anash skllavë e konkubina dhe nis rrugën për ta sfiduar vdekjen, po atë që aq shumë e kishte shkaktuar.

Në të njëjtën formë raportojnë edhe epet tjera konstituuese letrare: «*Kumarb*» i hetitëve, «*Tengri*»-të e mongolëve, «*Rostami*» i persëve e deri tek «*Kalevala*» e mjekut finlandez Elias Lönnrot, gjitha këto që aq herë e ndërtuan universin pas përmbysjes së madhe (më vonë rrëfimi i njohur si «varka e Noës») ose pas betejës përfundimtare shfarosëse «*Ragnarök*» (Apokalipsi në

mitologjinë islandeze) e kanë një bazë të përbashkët: fondamenti i gjitha këtyre konstruksioneve mitologjike që shpjegojnë në mënyrën e vetë krijimin e kozmosit është ndarja nga kaosi ose *horror vacui* nëpërmjet përmbysjes totale të së qenës. Po çka pastaj, pas renditjes së natyrës e botës, universit?

Përgjigja vjen veç pas «europeizimit» të tyre. Përvetësimi, akumulimi dhe asimilimi i kësaj tradite bashkë me perënditë, mitet dhe bishat në favor të «*Iliadës*» dhe «*Odisesë*» jonike e më vonë greko-romake hapin një kapitull të ri: zbresin në tokë barbaritë, terrorin dhe masakrat qiellore (ultra-imagjinare) duke i humanizuar ato. Prej këtu, nga këto monumente letrare, nis edhe ndikimi konkret i edukimit të mendësisë humane.

## TRAGJIKËT

Parisi për lau Helenën dhe Agamemnoni u hakmor duke zhdukur Trojën. Akili shfarosës ia preu kokën Parisit falë intrigës perfide të Odiseut (Iliada) që duke mos e përballuar ndarjen nga e dashura e tij Penelopë kthehet, zhdukë çdo mashkull afër saj (Odiseja) për tu vlarë në fund si qen edhe vetë nga vetë i biri i tij (*Telegonia*). Për çka gjithë kjo? Për të shpëtuar nderin e grekëve që iu përdhunua nga Helena që iku e shtyrë nga erosi? Apo për të gjetur ndonjë kuptim më të arsyeshëm duhet ta hapim kutinë e *Pandorës* dhe ta cofim gjithë njerëzimin me sëmundje dhe epidemitë?

Edhe traku *Orfe* morri rrugën Hadit duke kërkuar një përgjigje rreth vdekjes së pakuptimtë të *Euridikës* së tij dhe vetëdënoi dashurinë me burg të përjetshëm në ferr. E tebasja, bija e Edipit *Antigona* me multindarjet e saj nga dashuria (Haimon), familja (vrasja e vëllezërve), ligjet në

favor të traditës (varrosja e të vëllait) pse u vetëhelmua në atë gropën e dajës së saj Kreonit? Ku iku pas vdekjes?

## POLITIKA

*Virgjili* me të papërfunduarën e tij «*Eneidën*» besoi ta ketë gjetur recetën, shpjegimin se pse sakrifica e Eneut për t'u ndarë nga princesha fonikase Dido – edhe kjo vetëvritet, e si ndryshe – ka madje përmasa hyjnore, ngase gjithçka shkon në favor të misionit sakralo-politik për perandorin, Augustin, për Atdheun pra.

*Ovidi* e ka mësuar sistemin e transferimit të mitologjisë nga hapësira në hapësirë, nga kultura nga kulturë. Edhe ky «*metamorfozat*» i nis në favor të atdheut, mirëpo përfundon i dëbuar nga perandori, nga po i njëjti atdhe. Ovidi në hyrje të metamorfozave rirrefen «*Genesisin*», lindjen e kozmosit edhe njëherë, por jo aq dallueshëm nga gjitha lartë. Gabimin e bën kur ua heq ndarjeve dhe tragjedive të tij aspektin religjio-politik, kur i çliron rrëfimet e huazuara; e para nga hyjnizimi dhe e dyta nga atdheu, perandori. Augusti kap si pretekst gjoja seancat seksuale të Ovidit me mbesën e tij Julia dhe e hedh në kufij të perandorisë diku brigjeve të detit të zi.

## RELIGJIONET

Më shumë se nga frika ndaj të panjohurave duket sikur religjionet abrahamite të jenë shfaqje brenda kësaj gare, konkurrence se kush do ta gjej shpjegimin më të popullarizueshëm e të kapshëm për përtejesisinë. Nëse e gjithë jeta është një dramë shumëkatëshe, vuajtjesh,

vrasjesh, mbijetimesh, atëherë vdekja implikueshëm del si akti i çlirimit absolut. Në këtë stad mungon mirëpo një sferë transcendentale, një ekstrabotë jo si *Walhalla* nordike ku konservohen heronjtë e vdekur mbi tokë, por një ku vazhdon jeta dhe atë pa gjitha këto tmerre terrestre që duhet t'i përjetojë njeriu. Parajsa? Po. Po për këtë duhet një Perëndi që dallon nga tjerët dhe që s'ka konkurrencë nga lloj lloj perëndeshash e perëndish si Ianana, Ishtarja, Zeusi antiprometeian, Amori, Athina, Erosi, Dyonisi alkoolik e Apoloni, Jupiteri me kompani. Një që sundon vetë mbi gjithçka dhe që garanton se vdekja është vetëm porta, pragun e së cilës duhet ta kalojnë Siegfridi dhe Kriemhildi («*Niebelungen*»- Epi gjermanik) për të jetuar njëjtë si Adami dhe Eva para se ta hanin mollën e gjarprit. Bibla është rrëfimi më «racional» në konglomeratin e epeve letrare irracionale. Ajo edhe pse për nga ngjashmëritë, forma dhe kontinuiteti çohet mbi bazën e master-rrëfimeve të mbledhura nga gjithandej rajonit e thjeshtëzon, kanalizon dhe banalizon problemin mijëvjeçar konform nivelit të trurit human – së paku të masave dhe i ofron një përgjigje të kapshme. Irracionale por efikase.

## RACIONALIZIMI

*Dante Alighieri* niset udhëtimit rrathëve të nëntokës për t'iu hakmarrë politikës dhe Papës që e dëbuan nga Florenca si zyrtar të korruptuar e të dënuar me vdekje. Ekzilit shkroi «*Komedinë*» johyjnore (ngase Boccaccio ia ngjet prapashtesën e jo Dante) duke ekspozuar shpjegimet religjioze si kopje të realitetit frymor e imagjinar mbi tokë: në ferr gjendet çdokush që nuk jeton dot në kraharor të Beatrice Portinarit i lumtur, me dashuri, por i dëbuar në purgator ku takon gjithë atë masë të rrezikuar që papërballueshëm presin t'iu

qesh disi fati. Në Parajsë, po, aty jetohet nëse jo Virgjili të heq për dore por Beatricja – dashuria, e bukura!

Dante nis ta suspensojë me këste pushtetin e religjioneve në arte, por jo po me atë efektivitet si më vonë Shekspiri, Goethe, Shileri e deri tek Tolstoi, Kafka, Hesse, Kamy, Markezi, Kadare, Kundera.

Që nga epoka e quajtur «*Sturm & Drang*», natyrisht e iniciuar nga iluminizmi e deri në postmodernë zgjat ky desakralizim i arteve nga dozat religjioze.

Dakord, kjo, desakralizimi, por ç'u bë me shpjegimin e jetës dhe kuptimin e vdekjes në opusin universal të autorëve të përmendur e që përbëjnë edukimin human me art në modernë e deri sot?

## ART PËR ART DHE MËTEJ?

Si do të dukej rrëfimi i *Romeo-s dhe Julia-s* (1954 -96) poqëse e parafytyrojmë në mënyrë kontrafaktike dhe falsifikojmë dramën duke i paraqitur familjet e armiqësuarat të të dyve si në harmoni dhe këta dy jo si të vetëvrarë, por si të plakur që dikur vdesin zakonshëm si gjitha qeniet tjera josheksipriane. Me këtë version do t'ia hiqnim dheun nga ndërkëmbet vdekjes. E pa vdekjen ç'ndarje monotone që do të kemi o njeri! Ndarje pa vdekjen aty? Tjetra: a ka në esencë ndonjë dallim kjo formë rrëfimi nga ato të treshes së tragjikëve antikë si Sofokliu, Euripidi, Eskili? Jo.

E vetmja perëndeshë shpëtimi, që *Werther-it* (1774) i qëndronte para si lugat për ta shpëtuar dashurinë e tij dhe vetë Lotte-n ishte po Vdekja. Ajo që i doli në ndihmë po aq intrigshëm dhe e padrejtë, duke ia suspenduar madje edhe të drejtën e ndarjes ceremoniale e me nder nga kjo botë – si vetëvrasës as prifti nuk donte ta shoqëroj në varr e lere më tjerët. E fatin dhe fatalizmin ku *mors omnia*

*vincit* është deviza, klasiku e pranon si një lloj ligji: «Brenda çdo ndarjeje të madhe gjendjet një substancë e çmendurisë» (*Goethe*: Maksimat, 2006: V. 14). Vetëm a?

«Çka s'mund të mbahet bashkë më së miri të zgjidhen», besonte *Freidrich Schiller*. Në ç formë të zgjidhen, kur erosi dhe patosi janë shtyllat e dramës, unaza kryesore përbashkuese e lidhjes si në «*Kabale ose dashuria*» (1784) e ku ndarja domsdoshmërisht të finalizohet me vdekjen e Ferdinandit dhe Luizës? Çka kur ndërmjet tyre «kabale»-ja (intriga) drejton ujërat e fatit vetëm drejt një udhe: të shuarjes definitive të personazheve, njerëzve?

Me këto shembuj ilustruam një tezë: Edhe pas ç'hyjnëzimit të arteve, largimin e tyre nga religjionet dhe sagat me bisha horrori, artet rihuqin misionin e proklamuar të tyre dhe në vend të së bukurës vazhduan të ekspozojnë krimin aq brutal e masiv saqë edhe sot e kësaj dite humaniteti nuk çlirohet dot nga kjo epidemi mentale, nga kjo mostër krimpjellëse e zgjidhjes së problemeve.

Janë të paafta shkencat dhe sidomos artet për të zgjedhur një model tjetër shprehjeje e ligjërimi për humanitetin, nga frika në mos gjithçka degradon në skena si ato në filmat kiç e qesharak të hindi-industrisë së filmit Bollywood ku *Happy – End*-i është i garantuar?

## MBIJETIMI I PERSONAZHËVE

Përkundrazi. Filozofia që me Epikurin, Seneca-n e plotë të tjerë sjell një version të mundshëm që mund të bëhej substanca edhe arteve për t'u çliruar nga masakrimi permanent i personazheve nëpër luftëra, intriga, fatkeqësi e që me orientimin e tyre më shumë u asistojnë religjioneve – jeta është tragjedi e përhershme, të ikim pra qëkëndej!

«Deri sa jam këtu, vdekja nuk është, kur ajo vjen s'kam çka merrem me të», kështu maksima epikuriane. Për të ardhur deri tek *modus vivendi* konstruktiv mirëpo arteve iu duhej një ndarje, që nuk bëhej aspak me urdhrin karteziian të «shkundjes, harresës totale të së mësuarës për ta nisur jetën nga zeroja», por që kushtëzonte paraprakisht trajtimin e asaj që me mijëra vite ishte *hardwer*-i i njeriut, pra atij formimi që na përcolli deri në këtë pikë.

Pikërisht këtë mundësi e shfrytëzuan shkrimtarët që e mbijetuan holokaustin. *Imre Kertész*, nobelisti hungarez me «*Romanin e një të pafatit*» të tij përbën një shembull konkret. György Köves, 15-vjeçari (ai vetë personazh) që kalon rrotave kërcënuese të mizërisë së Auschwitz-it dhe mbijeton duke ateruar një shoqëri pa asnjë fije senzibiliteti gati sa shuan veten nga depresioni; dëshiron sërish botën në krematoritë e krimit dhe në fund kupton; se jeta, kjo këtu, është parajsja që duhet shfrytëzuar maksimalisht. Ndarja e tij nuk duhet të ndodhë duke ekzekutuar veten si personazh i radhës, porse me art të shqitet nga optika e zymtë që ia pamundëson ta jetojë jetën në të vetmen parajsë të mundshme e faktike – në këtë botë, «më të mirën të mundshmen», në këtë jetë këtu, në tokë.

## PËRNDRYSHE

Ç' kuptim ka bukuria magjepsëse e Antigonës, Julias kur jeta ato në fund i vret? Natyrisht se letërsia nuk ka ku i ikë përshkrimin shpesh tragjik të realitetit, mirëpo pikërisht këtu qëndron dhe çelësi i artit të suksesshëm: tragjedinë, dramën, realitetin therës ta vë në funksion të triumfit të bukurisë! E në këtë drejtim dështimet janë historike, kolosale saqë edhe sot pjesa dërmuese e prodhimit letrar servon vetëm tragjedi, kiç dhe banalitet për mendësinë

humane – si gjithmonë! Kështu jo vetëm personazhet por edhe lexuesit dhe vetë autorët më shumë vdesin se sa mbijetojnë!

Ashtu siç thoshte poeti anglez Alfred Tennyson që në një varg e jep zgjidhjen: «Më le të fluturoj, i thotë zogu s'ëmës, më le të fluturoj tej», jo ndarja e dhimbshme duhet të jetë koka e artit por liria, ajo e bukura që duhet të shpërthejë si triumfatore mbi çdo dramë reale e ireale



## GENTILLESHI, LA FAYETTE, BEHN, AUSTIN, SHELLEY DHE EMMA

*Historia e një dashurie në gijotinë*

Ajo shkaktoi shembjen e Trojës. Ajo nuk i rezistoi demonit-gjarpër, bloi me dhëmbë mollën e ndaluar dhe tradhtoi specien e arsyes me vulën e mëkatarit të përjetshëm. Ajo për shekuj ishte fuçia ku konservoheshin të ligat, ishte shtabi mobil i djallit nga ku shkapërдахeshin dhembjet në kurriz, në kokë e mushkëri e veçanërisht në trurin e inkuizicionit – këtij përbindëshi gjigant që nuk rigjallërohej dot pa mitin e shtrigës. Asaj iu hoq koka në gijotinë sapo kërkoi të drejtat e njëjta për femrën si për mashkullin.

Femra, prej antike e deri në mesjetën e vonshme, nuk ishte sinonimi i tij, por vetë ai: Luciferi! Paradoks? Pse djalli, mashkull në të gjitha gjuhët e mundshme, të shfaqet si femër? Ndoshta se ndryshe nuk konstruktohej si shtrigë? Jo vetëm. Kabineteve të meshkujve, atyre arkitektëve të mendësive nëpër epoka, u duhej një fajtorgardian, një xanxar, një genie kolosale për nga enigmat, u duhej një rezervat sa universi i gjerë, i thellë dhe i durueshëm për ta funksionalizuar në depo të gjitha të këqijave të kësaj bote;

natyrisht për ato që i bënin vetë – dhe femrën e konsideronin më të përshtatshmin subjekt për këtë.

Dhe ja dikur, sikur sferat u mbushën plot muzikë edhe për gjininë e shkelur. Kontinenti sikur u hap për këngët e reja orfike femërore kundër trogloditëve shpellarë të **Herodotit, Strabonit dhe Hannos**. Shekulli 17 është epoka kur humaniteti u përball me sinjalet e para, rezistencën faktike të “qenies naive, të thyeshme, labile e të falur nga perënditë vetëm si fabrikë riprodhimi e vegjetimi”. Ajo merr në dorë pikërisht atë që më së paku e priste zylyfgjati impotent me parukë në kokë: ajo kap Brushën. Artin! Artemisia Gentilleshi (1593-1653), femra seksualisht e dhunuar nga mësuesi i saj, piktori Agostino Tassi trand botën me pikturat e saja edhe më baroke, edhe më mjeshtërore, më madhështore se ato të idolit të saj **Caravaggio**. Mikja personale e **Galileo Galileit** bëhet piktorja më e njohur globalisht – saqë edhe vetë kisha, mbretërit bashkë me kolonitë e tyre të gurta primitive-patriarkale porosisin piktura tek ajo. Femra dinë pra të bëjë art, madje edhe më mirë se mashkulli. Shoku kulturor, shpifjet dhe aversioni ndaj piktores është histori voluminoze në vete.

## KONTEKSTI

Sapo shuhet Gentilleshi, një femër tjetër përllan sallonet universale letrare. Aristokratja dhe shkrimtarja franceze **Marie-Madeleine de La Fayette** (1634-1693) vjen me romanin anonim “Princesha nga Kleva” (1678) – vepra konsiderohet si romani më i mirë francez i shekullit 17. Gjersa veprat paraprake (si “Princesha nga Montpensier”) shtjellojnë rëniet, ngjitjet olimpike erosit dhe kafazimet që rezultojnë seancat e intrigat jashtëmartesore, “Princesha nga Kleva” është rrëfim kryekëput psikologjik që aludon në

transparencë dhe barazi në nivelin e komunikimit ose përkthyer konkretisht: nëse je i/e dashuruar në një tjetër thuaje, çlirohu dhe jeto. Romani për herë të parë shfaq letrarisht perspektivën e femrës si e sheh ajo botën, jetën, temat sociale dhe si: natyrisht – me një inteligjencë emocionale shumë më të mprehur se kolegët e saj “burra”. Dhe assesi vetëm kaq.

Po në të njëjtën kohë, nga Londra, më thershëm, më drejtpërdrejt, akuzueshëm, pa pardon, rrokullisen e shpojnë eterin intelektual të kohës pjesët teatrale të shkrimtares, spiunes dhe feministes **Aphra Behn** (1640 – 1689). Porsa vihet në skenë pjesa “The forced Marriage” (1670), shoqëria aristokrate e sidomos ajo monarke ngacmohet e reagon vrazhdë ngase i shkulet me dhunë dhe ortekshëm njëra nga shtyllat e sistemit tradicional mbi të cilën ndërtonte gjithë diplomacinë. Përveç kësaj, opinioni shtanget kur sheh se edhe gratë mund të jenë aktore të suksesshme në skenë. E mesazhi “martesa për shkak të pasurisë është një formë e prostitucionit” krijon brigada grash në revoltë e burrash që ndihen të tradhtuar, të denoncuar, pa maska.

**Marie Gauze** (1748 -1793), alias **Olimp de Gouges** në vitin 1785 i dorëzon drejtorisë së “Comédie française” pjesën teatrale “Zamore dhe Mirza”. Katër vite me radhë shkrimtarja dhe revolucionarja bëhet banore sporadike e “Bastille”-s, difamohet, ndiqet, bëhet shenjë sulmi e gjithë efebëve orestianë të Parisit ngaqë nëpërmjet dashurisë, femrës, feministes kërkon shporrjen e skllavërimit kolonive franceze. Më 1789-n i vihet vepra në skenë dhe hap, inicion debatin e relacionit skllavërim-etikë dhe të drejta të njeriut që as sot e kësaj dite nuk ka përfunduar.

**Jane Austin** (1775-1817), britanikja nga dera e priftërinjve, boton me firmën “by a Lady” romanet epokale, realiste, stilistikisht të paarritshme deri në fillim të shekullit

20 si “Sense and Sensibility” (1811), “Pride and Prejudice” (1813), “Emma” (1816), “Persuasion” (1817), vepra, të cilat në epiqendër botëkonstituojnë himnin e idealeve të lirisë së femrës, përshkruajnë gjendjen fatale e njëkohësisht shpresën festive të njerëzores drejt harmonizimit jo vetëm të gjinive, por të gjitha pluripoleve të acaruara ndër veti. Romanet e Austin janë korpusi më komplet letrar mbi interaksionet njerëzore, kategoritë sociale, efektet dhe afektet e shekullit 19 e më vonë. Kësaj ia del Austin, ngase arrin më mirë se çdo autor/autore tjetër (e sidomos më mirë se kritikët e saj të ashpër më vonë Charlotte Brontë dhe Mark Twain) ta ekspozojë jo vetëm operimin konkret, rezultatin e sjelljes së njeriut, por shpalos mrekullueshëm paraprakisht gropat shpirtërore, kauzale, frymore që e detyrojnë atë të sillet siç vepron: ajo studion ndjenjat, paragjykimet, mënyrën e komunikimit, perceptimet, krenarinë, konceptet, mendësinë para se të nisë vizatimin e karaktereve, roleve të socialitetit.

Këtij aksioni të paprogramuar i bashkëngjitet edhe **Marie Godwin – Shelley** (1797-1851). Nëna e gjinisë fantastike në letërsi (“Frankeshtajni ose Prometeu modern” 1818) bënë copë tabutë që koha nuk i gëlltiste dot. Te “Matilda” (1819, të censuruar pastaj deri më 1915-n) përshkruan incestin aq të përhapur të etërve me bijat; në “Valperga” (1823) rrëfen nëpërmjet historisë reale historike të Castruccio Castraccon-it botën e lezbikeve. Në asistencë Shelley-t i vjen edhe **Charlotte Brontë** me romanin autobiografik të saj “Jane Eyre” (1847), në të cilin apeli është i qartë: njeriu (femra) duhet të bëjë çmos për ta siguruar mëvetësinë, lirinë e tij, pavarësisht çmimit. Dy shkrimtaret e fundit (e sidomos Shelley) ia flakin koleges së saj Marie de la Fayette tezën se qenka më mirë “të ruash shpirtin e pastër sesa të provosh kënaqësitë e kësaj bote”,

pra më mirë të mos tradhtosh e të rrish afër koftorit dhe si skllave e burrit sesa të kërkosh lirinë siç e kanë partnerët meshkuj. Këtë e kupton drejtë **Madame Bovary** dhe e provon!

## GUSTAVE FLAUBERT DHE EMMA

Charles Bovary martohet me zor me vejushën Dubuc, tek e cila prindit e tij supozojnë kapital të madh. Natyrisht pa dashuri dhe konform kohës. Kur i ati i ish-murgeshës Emma Bovary, zoti Rouaults thyen këmbën dhe trajtohet nga Charles, dashurohet ky i fundit, mjeku me bijën e bujkut. E shoqja e Charles-it vdes e tmerruar nga skenat dramatike që i nxit vetë. Hapet rruga dhe dy të dashuruarit martohen. Dhe ja që nga nata e parë: “pas martesës Charles u bë një njeri krejt tjetër” (I, IV) konstaton nusja Bovary. Që këtej Emma-s fillon t’i plasë parasysh pasqyra romantike që e ka ndërtuar me dromcat e përpira nga literatura që e lexonte ilegalisht në manastirin ku shërbente si murgeshë. Disa herë ndërrojnë shtëpi e shoqëri. Charles vjen duke u bërë i mërziqshëm, pa sens ose siç thotë Emma për bisedat e tij, të jenë “plate comme un trottoir de rue” (I, VII). Përkundër faktit se Charles punon ditë-natë për t’ia përmbushur kërkesat zonjës së tij, Emma shpejt frustrohet, sëmuret, vegjeton, e konsideron jetën dramë dhe fatin të padrejtë. Nga kjo gjendje pasive ajo sheh vetëm një shpëtim: çlirimin, ikjen, shpërthimin nga kthetrat stupide, të ngurta, primitive të konventave të rrejshme morale të kohës. Si kompensim improvizon jetën luksoze, si konsumuese pa para te grykësi kapitalist Lhereux. Nis

eskapadat orgjike, seksuale fillimisht me kapitalistin shpirtakull Rodolphe Boulanger dhe pastaj me pseudopoetin, burokratin Léon Dupuis. As me njërin as me tjetrin nuk nis dot atë jetë që e ëndërron, pasi që të dy janë shfrytëzues ordinerë të dashurisë, ndjenjave dhe dinjitetit të zonjës Bovary. Si shpërblim ajo, e harxhuar, pa rrugëdalje në aspektin financiar vetëhelmohe dhe vdes.

## INTERPRETIMI

Jo si në romanet paraprake, të përkthyer në shumicën e gjuhëve të Oksidentit plak, që përbëjnë spiralen e ndërtimit të dinjitetit të gruas edhe si figurë letrare, në art, në profesion, në dashuri, jo duke sipërfaqësuar shkeljet brutale të femrës si bijë, grua, jo ashtu, ndryshe, **Gustave Flaubert** (1821-1880) i bie me shpatë në mes këtij metarrëfimi duke e dënuar me helmim Emma Bovary-në si viktimë të pasioneve të saja që në thelb kanë tradhtinë ndaj burrit që punon natë e ditë për t'ia plotësuar dëshirat e jetës. E tradhtia nuk lejon fabrikimin e lirisë, përkundrazi ajo multiplikon tradhtinë (e Leon-it dhe Rodolph-it) e të tjerëve jo vetëm ndaj burrit, vetes por edhe ndaj fëmijës, Bertas.

Flaubert nga kritika e kohës e deri sot konsiderohet si klasiku, themeluesi i realizmit në letërsi. Për shkak të neutralitetit të autorit në rrëfim e sipër dhe gjuhës gati pseudoshkencore? A mjafton vetëm qëndrimi indiferent dhe imagjinar i autorit, si dhe “fabula” e huazuar nga një ngjarje e vërtetë e raportuar në gazetën “Journal de Rouen” (1848) mbi vetëvrasjen e Dephine Delamare për ta shpallur romanin “Madame Bovary” romanin e parë realist? Sidomos kur kemi parasysh romanet historike të autoreve

të mëhershme; kur kemi parasysh pjesët teatrale që vënë dukuritë ahumane zhveshur në skenë; kur kemi parasysh se – këtë e dokumentojnë të gjitha studimet historiko-antropologjike të kohës – jo gruaja ishte faktor destruksioni moral (e skllavëruar skajshëm), por vizitori i pufëve, Leonët, Rodolph-ët, Casanova-t “heroikë”.

Pse Flaubert nuk e çliron Emma-n nga konvencionet dhe ta lërë të triumfojë e të mos vdesë ose të vdesë kur i vjen dita, pasi ta ketë çliruar veten? Pse çlirimi erotik, seksual i femrës të jetë apriori orgji, pornografi, amoral e perversiteti i mashkullit jo vetëm seksualisht, por në çdo sferë të mos përbëjë kryetëmën? Pse gruaja të hiqet zvarrë, të përgjaket kapitujve të imagjinatës e realitetit me këtë barrë morale e mashkulli jo? Për më tepër kur shablloni i burrit viktimë dhe gruas së përdalë nuk është realist aspak, por më shumë një protokoll gazete i letrarizuar paçka për të kritikuar jetën e sëmurë borgjeze të kohës, por pse me femrën si burim të shthurjes, po si ajo Medea e Ovidit që sapo sheh Jasonin e kap epshi aq tërbueshëm saqë ia përdhos, amokon arsyen, lojalitetin, të atin, atdheun e gjithçka të shtrenjtë për njeriun në këtë tokë.

## ARTI I GIJOTINËS

Në fakt, që me sjelljen e shkrimtares Olymp de Gouges në gijotinë, për shkak të manifestit të saj (“Manifesti i të drejtave të femrës” (1791), dy vjet pas shpalljes së “Kartës së të drejtave të njeriut dhe qytetarit” më 26 gusht 1789, asaj karte pra që piktori Jacques- François Le Barbier i vuri dy gra anash (njëra simbolizon Francën e tjetra drejtësinë, ligjin dhe barazinë) imponohet si cezurë dhe dëshmi se asnjë e drejtë njerëzore ende nuk vlente edhe për femrën. Kësaj vije do t’i ketë ecur pas edhe Flaubert-i kur viktimizon

aq tragjikisht Madame Bovary-në në kritikën e tij drejtuar shoqërisë, e sa për realist nuk është aspak. Megjithatë romani i tij është në listën e klasikëve të letërsisë botërore e jo ai “Kujtimet e zonjës Valmont” ku kritikon ashpër qasjen e shoqërisë ndaj nënave të pamartuara dhe fëmijëve të tyre “bastardë” apo ndonjë roman i Aphra Behn-it ose Austin-it që realizimin e Flaubertit e spostojnë për ca shekuj para tyre.

Kjo formë perceptimi i gruas në letërsi vazhdon edhe sot.

Pra asgjë nuk është histori; keqpërdorimi i artit si mjet tradhtie kundër femrës vazhdon edhe sot. Ende vazhdon të jetë bestseller rrëfimi kot fare, romani doracak pseudoshamanist “Pabesia” (2014, lexuar gjermanisht) i **Paolo Coelho**-s, ai që atë e portretion po si Helenën, Bovarinë apo Olimpen e shtrirë në gijotinë. Linda gazetare (karikaturë e shëmtuar e Emma-s), 31 vjeçe në Gjenevën e shek. 21 patjetër të prostituohet natë e ditë para se të shpëtohet nga një guru-idiot e të braktisë jetën “destruktive” të orgjive. Sugjerimi historik siç po shihet se gruaja mbetet shtriga kundër çdo morali vazhdon. Fatkeqësisht jo vetëm në arte, por edhe në politikë. Ose siç tha kryeinjoranti i konservativëve francezë, **Nicolas Sarkozy**, për romanin e Madeleine de la Fayette, “Princesha nga Kleve”, kur atë e lexuan gjashtë orë me zë akademikët francezë në shenjë proteste kundër politikës ndaj arsimit: “Romane të tilla lexojnë vetëm sadistët dhe imbicilët” (23.02.2007). Flaubert, në kontekst me femrën, atëherë e sot ishte unus ex multis – Gijotina vazhdon të presë koka Bovary-sh, edhe në art po ashtu, aty ku s’duhej aspak! (2016)



## SHILERI, BREHTI, FLEMINGU DHE TASLIMA NASRIN

*Arti si mjet i luftës ndërgjinore*

Taslima Nasrin me librat e saj: „Sham“ dhe „Kënga e një nate të zymtë - “ fitoi dënimin me vdekje nga fundamentalistët islamë.

Në brendinë e kësaj së keqeje ajo gjeti një të mirë: u bë e popullarizuar dhe e pasur. Edhe pse librat e saja nuk kanë ndonjë vlerë artistike, kjo nuk pengon që librat e saj të ribotohen pandërprerë. I vetmi hall i saj tani, është që sa më shpejtë të ikë nga roli i pionit që shfrytëzohet për thellim të luftës tradicionale në mes orientit dhe oksidentit e anasjelltas. Së fundi artsisti nuk duhet t'i shërbejë një aventure të tillë.

*Një shoqëri letrare e Bernës hapi mbrëmjen diskutuese rreth librave të shkrimtares së përndjekur nga Bangladeshi Taslima Nasrin. Për njëri nga librat e sa: „Kënga e një nate të zymtë-gratë në mes religjionit dhe emancipimit“. Në këtë shoqëri letraro-filozofike, shpesh-herë diskutohen tema e vepra të karakterit kontestues, ku ftohen krijues të zhanreve të ndryshme. Sigurisht, gjatë përshëndetjes, emri im me tonacion musliman u*

*bëri përshtypje mysafirëve të mbrëmjes: «Jam shumë kureshtar për të dëgjuar mendimin tuaj mbi librin»- më përshtëpëriti në vesh Dr. M.W., teologe nga Baseli. Ajo është e njohur si autore e një varg librash mbi diskriminimin e gruas në botën e tretë, e veçanarisht në vendet islamike. Një feministe e ekzagjeruar! Keni lexuar romanin e Taslimës „Sham“? Pasi i thashë që e kam lexuar: „Si mendoni...?“. Mirë, po pa vlera aq të dukshme letrare, i mungon arti, më duket si vepër e thatë, e prirur nga një urrjetje tash më e marrë nëpër duar miliona herë! Besoj se shpirtin e saj e pushtoi tërbimi dhe urrjetja. Edhe unë po të kisha bërë aq shumë për një krijues siç ka bërë ajo për Nasrinin do të isha tërbuar, gjë shumë e natyrshme. Mirëpo, as unë nuk pata ndonjë faj, vetëm se shpreha mendimin tim. Pas diskutimit të saj, kryetari i shoqërisë K. G. për fat të keq shqiptoi edhe një herë rëndë emrin tim. Zonja W. e hapi fletoren e saj.*

## TRASHËGIMA NGA KULTURAT E PËRMBYSURA

Në shumicën e kulturave të lashta gruaja ka qenë sinonim i dashurisë, shumimit dhe ka gëzuar respektin si shtyllë e organizmit dhe zhvillimit të familjes dhe shoqërisë. Në mbretërinë e parë Assiro-babilonase të Akadit, nën sundimin e së cilës gjendeshin Siria, Babilonia dhe Elami, përkundër ashpërsisë dhe moralit pothuaj të egër të mbretit Sargon, gratë kishin të drejtën e votimit gjatë marrjes së ndonjë vendimi të rëndësishëm mbi ardhmërinë e pushtetit të tyre. Kështu vepruan edhe Mikenët, Lidët, Kretasit, etj. P.sh. Mbreti Hamurabi (1947-1905 p.e.s.) në ligjet e tij të famshme, në mënyrë të theksuar kërkon respekt sa më të lartë ndaj gjinisë femërore.

Në Epin e Gilgameshit hyji i diellit është Aja, një femër, Ishtareja hyjnesha e dashurisë është poashtu femër. Pozita e femrës vjen e keqësohet tek pas lulëzimit të

Antikës. Grekërit dhe romakët, edhe pse metodën e shpalljes së hyjnive dhe zotërave të tyre e morrën nga kulturat që vetë i përmbysën dhe faruan, në esencë ata nuk tregonin gjithaq respekt ndaj saj. Për këtë na dëshmon arti dhe letërsia e krijuar atë kohë.

Të gjithë ata, që njohin „Iliadën“ dhe „Odisenë“ e Homerit dhe që kanë studiuar epokën para tij, shpejtë do të konstatojnë se aty janë të akumuluarat të gjitha vlerat e kulturave që përmendëm më lartë, mirëpo të përshtatura dhe aktualizuara për kohën kur ka jetuar vetë Homeri. Homeri, Euripidi, Sofokliu, Eskili etj. njihen si themelues të artit tragjik. Në këtë periudhë ndër perlat e vlerat e larta, që edhe sot i shërbejnë përparimit mendor human, lindi edhe kulti i Helenës. Dihet që, ajo lëshoi burrin e saj Agamemnonin për t'u martuar me mbretin e Trojës. Pas ikjes së Helenës në Trojë, filloi lufta në mes këtyre dy mbretërive – kështu saga- përleshje, e cila përfundoi me përmbysjen e Trojës, djegien e një civilizimi dhe tradite aq të lashtë.

Shkaktare: Helena.

Një femër!

Përse u tragjedizua kaq shumë tradhëtia e një gruaje, kur para saj kishin ndodhur mijëra tradhëtira në mes klaneve për të marrë pushtetin, pjesmarrës të të cilave ishin kryekëput meshkuj.

Sa e sa kultura ishin zhdukur deri atëherë nga luftërat në mes popujve të ndryshëm. Për shkak të përmbysjes së Trojës? Trojanët nuk arritën të pushtojnë mendimin njerzor për të bindur atë për krimin grek. Grekërit bënë veprat me të cilat edukohet sot (sigurisht dhe nesër) bota krijuese.

Vetëm Helena ishte fajtores për krimin ndaj qytetërimit trojan?

Sigurisht: Jo!

## KULTI I FEMRËS DHE RELIGJIONET

Sidomos shpjegimet religjioze në raport me prejardhjen e njeriut përlulën edhe më shumë dinjitetin e femrës në shoqëri. Vetë versioni biblik se Evën e ka krijuar zoti nga një brinj i Adamit dhe se mëkatin e parë e bëri ajo duke ngrënë mollën e ndaluar flet për shumçka. Pse pikërisht Eva doli nga Adami e jo anasjelltas. Sa dijmë ne sot në shekullin njëzet e një është femra ajo që lind e jo mashkulli. Përse Eva bëri gabimin duke marrë të hajë mollën e ndaluar e jo Adami. Kush është dëshmitar i kësaj ndodhie? Zoti?. Ndërkaq, Islami përkundër përparësisë që ka për zanafillën kur predikon prejardhjen e njeriut prej balte (për të dyja gjinitë në mënyrë të barabartë) femrën e konsideron si pronë të pakontestueshme të mashkullit. Ai ka të drejtë të vendosë për fatin e jo vetëm të një gruaje, por për shtatë a tetë...syresh?! Kërkesat e Islamit ndaj gruas janë shumë të ashpra dhe deri në maksimum të pabarabarta në relacion me gjininë e kundërt. Hovi më masiv kundër dinjitetit të gruas u zhvillua gjatë ardhjes në fuqi të Inkuizicionit. Papa Lucius III, themelues i doktrinës inkuzicionare —e cila i legalizua në të gjitha kishat katolike të botës— ndërtoi përballë pothuaj, të çdo kisha nga një kapellë për djegie dhe ekzekutim të shtrigave dhe njerzve dajllëzorë , të cilat shërbyen për disa shekuj me

radhë për likuidim dhe terror ndaj më se një milion njerëzish.

## EPOKA E DJEGIES SË SHTRIGAVE

Në fillim të shekullit katërmëdhjetë Anglia pushtoi Francën dhe detyroi ikjen e familjes mbretërore të Karl VI. Francezët iu nënshtruan poshtërisht këtij pushtimi dhe nuk mendonin më në ndonjë rezistencë eventuale. Një vajzë e re kërkon nga ca ish-komandantë që t`i japin ushtarë për të çliruar Orleansin (seli e mbretit). Me sharrje, nënçmim në baza gjinore dhe të moshës (Johana i kishte shtatëmbëdhjet vjetë) e përzunë nga sheshi. Për Anglezët, kërkesat e saja nuk paraqitnin ndonjë rrezik. Ajo ishte ende një fëmij. Mirëpo Johana arriti të grupojë njerëz dhe pas një sulmi të organizuar mirë, mundi anglezët çliroi Orleansin dhe solli mbretin Karli VII në fron. Trimëritë e Johanës përshkuan tërë vendin dhe ajo u shpall heroinë. Inkuizicioni që ishte pjesa më e dukshme e pushtetit të atëhershëm anglez nuk mund të durronte një gjë të tillë. Johana ishte intelegjente, me një kulturë jashtëzakonisht të formuar sa që dijte në mënyrë të mrekullueshme se si funksionon inkuizicioni. Kështu që, i ikte çdo prite të organizuar nga anglezët. Kur anglezët panë se kapja e saj ishte e pamundur u futën në bisedime me Karlin e VII (ende të ri në moshë) dhe mashtruan atë në mënyrë dhelprake për të dorëzuar Johanën. Së fundi ajo ishte vetëm një femër!! Dhe kështu ndodhi ajo u dorëzua vetëm se ishte një femër. Me 30 maj 1431, pasi që i famshmi teolog Dr. Nikolas Midi ia lexon

grykimin, Johana digjet në turmë të drunjve si shtrigë. Ky ishte falenderimi i mbretit francez për ndihmën që Johana i bëri atij për t'u kthyer në fron. Politika e djegies së shtrigave do të vazhdojë pastaj deri në fund të shekullit shtatëmbëdhjetë, mu në mes të Evropës së kulturuar.

## MËKATET E GJENIVE

Figura e Johanës u bë objekt frymëzimi për shumë emra të njohur të letërsisë botërore. Ajo shërbeu si simbol i konsolidimit të femrës në jetën shoqërore dhe si viktimë e padrejtësisë gjinore. Me kultin e Johanës u morrën: Uiliam Shekspiri, F. Shilleri, P.I. Çajkovski, Bertolt Brehti, Viktor Flemingu etj. Mbi kultin e Johanës u shkruajtën më se djetë mijë libra shkencorë dhe letrarë. Poqëse parashtrijmë mënyrën se si autorët trajtuan historinë e Johanës do të ndeshemi me dy mëkate të mëdha ndaj pozitës së femrës. Fatkeqësisht autorë të këtyre mëkateve janë pikërisht dy mendjet më të mëdha të kohës, në të cilën ata jetuan. Dy emra dhe njerëz gjenial që ka historia e letërsisë së përbotshme: Shekspiri dhe Shilleri. Është e qartë shkalla e ndikimit të tyre në zhvillimin e vetëdijes mondane. Prej këtu rezulton gjithashtu edhe madhësia e gabimit të këtyre dy gjenive: Shekspiri në veprën e tij „Henriku VI“ paraqet Johanën si një shtrigë të keqe, e cila kishte për qëllim përmbysjen dhe poshtërimin e qytetërimit anglez, e jo si një heroinë franceze që kishte për pasion çlirimin e atdheut të saj. Sipas studiusve të paanshëm të Shekspirin rrjedh ky konkluzion: Shekspiri, dramën „Heinriku VI“ e ka bërë për t'iu imponuar klasës së lartë borgjeze si nacionalist me qëllime të caktuara. Paraqitja e një heroine franceze (atëbotë anglezet kanë urrejtur deri në marrëzi francezët) me karakter të dobët dhe ekstravagant i ka mundësuar atij

respektin kulminant në shoqërinë e atëhershme. Sado i madh e gjenial të jetë Shekspiri në këtë punkt të historisë së tij del si një profiter klasik, i cili përdor fjalën artistike për qëllime të ngushta komoditeti. Ndërsa Shileri, përkundër fotografive dhe kronologjive që ka pasur në disponim gjatë bërjes së pjesës teatrale „Virgjëresha nga Orleansi“, ai i jep asaj tiparet e një mashkulli me fytyrë të gabuar, pra femre. Në supozimet e disa prej monografëve të Johanës konstatohet në këtë mënyrë gabimi i Shilerit: ai nuk ka mundur të durrojë se si një femër ngritet mbi gjithë atë histori të famshme franceze, të përbërë nga meshkuj! Sado absurd të duket konkluzioni, në një studim më të afërt të veprës së tij në fjalë, krijohet bindja e plotë e vërtetësisë rreth përfundimit të autorëve: se ai nuk ka pranuar aq ëmbël të jap energjinë e vetë artistike për heroizmin e pakontestueshëm të një femre. Shekspiri i kohës së trazirave të mëdha religjioze dhe Shileri i ndikuar nga bota antike nuk bënë kurrgjë tjetër përveç se dëshmuar qëndrimin e filozofive, prej të cilave mblidhinin dijen dhe formimin kulturor të tyre. Viktimë përsëri mbeti femra!

## NËNAT E MASKILISTËVE

Ajo që deri tani mbetet e pashqyrtuar është pyetja se ç`kontributi dha femra për përmirësimin e pozitës së saj në shoqëri. Antika, inkuizicioni, islami, disa nga krijuesit botëror, etj kanë kontribuar dukshëm në misterizimin e figurës së femrës. Cilat ishin përkjekjet e gjinisë femërore për të ndryshuar këtë gjendje. Ku mbeti mbrojtja e saj? Deri në vitin 1900, vitin e trazirave të organizuara nga zonja Pankhurst në Londër, për të drejtën e femrës në zgjedhje dhe pjesmarrje në pushtet, pothuaj nuk u bë asgjë masive në këtë drejtim! Në vitet e gjashtëdhjeta paraqiten organizatat

e para feministe, me programet e tyre për ndryshimin e pozitës së femrës në shoqëri. Ata, si çdo ekstrem tjetër kaluan në fanatizëm inkuizionar kundër ekzistencës së mashkullit. Kjo mënyrë e të vepruarit ruhet deri në ditët e sotme. Koha, të cilën ne jemi duke jetuar paraqet një fotografi të mjerueshme sa i përket rolit të femrës: prostitucioni, ketu në perendim është bërë një ndër bizneset më të praktikuara të moralit njerzor. Pra, kemi të bëjmë me dy armiq të përбетuar të feminizmit. Sipas z. Taslima Nasrin me mashkullin islam dhe sipas feminizmit perendimor me mashkullin sundimtar dhe patron të gjinisë femërore!

## NË SHËRBIM TË LUFTËS NË MES OKSIDENTIT DHE ORIENTIT

Përmbledhja me kolumna „Kënga e një nate të zymtë-gratë në mes religjionit dhe emancipimit“ që ka për autore Taslima Nasrinin, nuk është i ngritur në bazë të kulturës historiko-shkencore në lidhje me pozitën e femrës në shoqëri. As që përbëhet nga një materie serioze për ndryshim të ndonjë psikologjie të caktuar. Çdo kapitull i saj ndërtohet me shembuj nga jeta e përditshme, raste diskriminuese ndaj femrës në Bangladesh. Probleme të tilla ka edhe në vendin tim, me një traditë qytetërimi mijëvjeçar. Edhe ne shqiptarët si gjithë popujt e tjerë jemi të ballafaquar me probleme të këtij karakteri. Jam më se i bindur se çdonjeri këtu ka fakte të bollshme për të bërë libra voluminoze për shkëljen e të drejtave dhe lirive individuale të femrës në Evropë. Mjafton të vizitohet një orë: San Paoilin në Hamburg, Posterdamin apo Bundesgasen në Bern dhe të bindemi me realitetin. Ky është një problem



me përmasa universale. Nuk ka të bëjë vetëm me një shtet apo kontinent të caktuar, por është planetar.

Taslina Nasrin i është nisur një përpjekjeje shumë të qëlluar: ndryshim të koncepteve islame ndaj gjinisë femërore. Kjo është ajo vlerë që duhet patjetër respektuar. Asaj duhet t'i jepen sugjerime dhe kurajo për të bërë këtë në mënyrë pak më të shëndoshë, sepse për të kundërshtuar një ideologji, religjion a fe, e cila sundon më se njëmijë e treqind vjet nevojitet një revolucion mendor, një strategji të bazuar në fakte bindëse si hiistorike ashtu edhe aktuale.

Nga përvoja dimë se me një urrejtje të ashpër fanatike (feministe) përveç se nuk mund të ndryshojmë kurrëgjë konkrete, tërbojmë edhe më shumë ekstremin tjetër. Më qartë: feminizmi duhet të jetë shumë më i butë, dhe si parim të parë të ketë emancipimin e vetvetes, pra femrës. Femra duhet të zvogëlojë pjesmarrjen e saj (tash masive) në bizensin e prostitucionit dhe nënshtrimin. Vetëm në këtë mënyrë do të vijë në shprehje logjika e shëndoshë dhe mirëkuptimi në mes dy kundërshtarëve tash më të mërzitshëm. Tasrinin nuk duhet ta mbivlerësojmë dhe mashtrojmë duke i thënë se ka vlera shumë të larta artistike dhe filozofike, vetë për arsye të interesit të dikujt për të shfrytëzuar atë si pion në luftën e oksidentit kundër orientit dhe anasjelltas. Asaj duhet thënë se është viktimë e përndjekur nga fanatizmi islam dhe viktimë që përdoret në mënyrat më të ulëta nga feminizmi i ekzagjeruar evropian. Eliminimin e këtij keqkuptimi historik në mes të dy gjinive duhet kërkuar tek ligjet e natyrës. Ajo ka paracaktuar rolin, aftësitë, dhe varrësinë reciproke në mes mashkullit dhe femrës. Sipas kësaj logjike, ata duhet në mënyrë të barabartë të vendosin mbi organizimin dhe përjetimin e jetës së tyre. Mendimi mondan i gjinisë mashkullore: femra, për shkak të karakterit të saj të butë e të thyeshëm duhet të jetë nën

patronatin e mashkullit është ekstremisht i gabuar. Ashtu siç është i gabuar mendimi feminist mbi gjininë e kundërt: meshkujt janë produkt yni natyror, prandaj edhe jeta e tyre duhet të varret nga ne!

## SHQIPTARI ME EMËR ARAB

*Në fund të diskutimit dr. W. kërkoi që t'a shoqëroja në kafenenë e shoqërisë. «A nuk jeni ju arab». Jo. «Më ka irrituar emri juaj me origjinë arabe. Më falni», ajo tërë kohën kishte menduar se jam ndonjë bashkëvendës i Taslima Nasrinit. Kësaj i ka ndihmuar edhe ngjyra ime esmere, apo ku t'a dijs. Edhe pse pranonte arsyetimet e mia në lidhje me zanafillën e humbjes së respektit ndaj gjinisë femërore...«Nuk patët të drejtë me gjykimet rreth feminizmit sot, ai është moderuar, avansuar... Taslima Nasrin ka thënë atë që ndodhë në vendin e saj». «Dakord, ajo ka përshkruar pozitën e vështirë të femrës në Bangladesh dhe emancipimin e saj në baza islame. Dhe kjo vlen shumë. Mirëpo unë nuk jam dakord me mënyrën se si ajo do që të luftojë kundër fanatizmit dhe skllavërisë», pasi ia thashë këto fjalë, edhe njëherë më kundërshtoi: «Ju nuk mund t'a merrni me mend se çfarë skllavërie zhvillohet atje». Po, po e di se çfarë skllavërie zhvillohet atje, sidomos pas leximit të veprave të Tasrinit. Madje edhe ajo si simbol kundër skllavërisë, në shtëpinë e saj ka një skllave me emrin Lili. Keni lexuar „esenë“ e saj „një dhomë vetëm për mua“, aty tregon qartë për hasmërinë e saj kundër skllavërisë dhe raportin me Lilin dhjetëvjeçare! Dr. W. qeshi dhunshëm: «Sa e vlefshme do të ishte sikur ju të mbronit botën e femrës nga diskriminimi». Një gjë të tillë edhe jam duke e bërë. Gjatë tërë kohës përderisa kam diskutuar parasyshtë më ka qëndruar ajo fizionomia e thyer e Lilit të vogël*

*duke pastruar brekët e zonjës mjeke. Ky ishte kulmi, ka gjasa të kem gabuar. Zonja W. më tha duke ikur: «po të kisha forcë do të ju digjsha si Johanën anglezët!». Duke u kthyer në shtëpi, përpigësja të kuptoj përse z. W. më tha ashtu: si duket është e frymëzuar më shumë nga metodat e inkuizicionit se sa nga lufta e Johanës. Dhashtë Zoti mos të ketë fuqi ajo të marrë ndonjë pushtet. Do të na djeg të gjithë meshkujve në turma drunjsh!  
(1999)*

## ALBERT CAMUS

*Arti olimpik brenda një filozofie të dështuar*

Kërkoi kuptimin e jetës dhe botës. Gjeti njeriun. U përball me absurdin si drejtues ekzistence. Preferoi revoltën. Beri njërin nga shkrimtarët më të mëdhenj francez të shekullit 20 dhe kryeveprën letrare të ekzistencializmit (I Huaji).

Rrëpirës, me një monolit në shpinë, mezi luan këmbët Sizifi. Sapo mbërrin majën kap ngarendshëm teposhtën, donë të mbërrije para shkëmbit në rrafsh, i duhet një copë kohë për të dihatur sadopak. Kjo është jeta, e përhershme, e njëjtë e Sizifit pikërrënë. Perënditë e kanë dënuar të jetojë ashtu, të bëjë një ekzistencë absurde, monotone, plot vuajtje, të përhershme. Ai paguan, vuan për shkak të revoltës, intrigave, shamatave, talljes ndaj perëndive e në veçanti se lidhi këmbeduar perëndinë e vdekjes Thanatin para portës së Hadit.

Kjo metaforë mitologjike, antike, është baza dhe uzina mbi të cilën shkrimtari dhe intelektuali francez Albert Camus ndërton botën e tij krijuese, respektivisht filozofinë e tij të ekzistencializmit, jo atë të majtën, sartrianen, as atë të djathtën heideggerianen, por atë absurden, camusianen.

Përkundër tezës së popullarizuar që thotë se filozofia e Camus nis tek eseja e tij «Miti i Sizifit» [1942] dhe kulmon tek «Njeriu i revoltuar» [1951] e vërtetë është se që nga vepra e tij e parë me ese letrare «Dritë dhe hije» [1937] e deri te romani i botuar postmortem «Njeriu i parë» [1994] Albert Camus iu përmbahet rigorozshëm linjave që ia dikton metafora, legjenda e Sizifit. Krejt e shkruara dhe e menduara, në mbarë veprën e tij, është amplifikim eufonik, del estetizim etiologjik i fatalitetit të qenies së paradënuar me lojën absurde, të cilën zotërat e bëjnë me njeriun këndeje e pëртеjvarrit.

## FATALITETI I EKZILIT

Në këtë 7 nëntor shkrimtari algjero-francez do të festonte 100 vjetorin e lindjes së tij. Hibridi (nga nëna spanjoll, nga i ati francez) Albert Camus lind në vreshtarinë e kolonizatorëve francezë në fshatin Mondovi të Annabasë algjeriane, ku i ati i punonte si magazinier i verës. Në moshën njëvjeçare humb të atin, i cili kthehet rëndë i lënduar nga beteja e Marnës (Lufta e parë botërore). Qysh si fëmijë Camus përballet me mjerimin, në stadion e tij më të egër: bashkë me të vëllain dhe të ëmën, që të dy gjysmë të hendikepuar, lufton për të ekzistuar herë si punëtor fabrike, herë si pastrues e më së shumti duke u vërdallur rrugëve të baltërta, epidemike të lagjes Belcourt të Algjerit. I huaj që ndihet i atyshëm më shumë se vendësit, i urryer si pinjoll pushtuesish, urryes i përzjarrtë i kolonizatorëve, i huaj për të dyja palët. Deri në moshën e tij 17 vjeçare [1930] kjo është jeta e Albertit, jeta e tij në një botë të huaj. Dhe pikërisht këtu nis e zhvillohet romani i tij i parë «I huaji» në Algjerinë e viteve të 30-ta.

## I HUAJI [1942]

Meursault rri shtangur, pa lotë, ka fiksuar sytë në këpucët e priftit që dërdëllit diçka mbi kufomën e nënës së tij. Përderisa të tjerë lotojnë ceremonialisht rreth varrit, Meursault mezi pret të ikë.

Fqinji i tij, makroja Raymond Sintès ka brenga tjera, as që i intereson se mikut të tij i ka vdekur e ëma. As Meursault-it duket të mos interesojë zija: kur i pari i kërkon t'i ndërmjetësojë për ta përvetësuar një arabe të bukur, një ish «mikeshë» të Meursault-së, ai pranon pa hezitar. Komploti del i suksesshëm. Kryeprotagonisti i Camus-së e di që Sintès e keqtrajton, përdhunon dhe detyron në prostitucion araben, mirëpo Meursault është i ftohtë, edhe kur përjeton parasyve ndonjë ekzekutim nuk ndalet as për të shikuar e lere më për të ndihmuar, kështu se indiferent, indolent deri në asht. Edhe kur turma e familjarëve të arabes e kërcënojnë atë dhe Raymond Sintès me thika, pas rrahjes, po ashtu, ftohtë fshin do pika gjaku nga hunda dhe ecë si statujë mobile sikur mos të kishte ndodhur asgjë. Të nesërmen njëri nga arabët e zë vetëm rrugës, ia drejton thikën, ndërsa ky Meursault, konform emrit që ka [Disa nga kritikët mendojnë se emri i kryepersonazhit të Camus-së është kombinim i fjalëve «vdis idiot!»] gjuan me revole mbi të. Dënohet me vdekje. Në qeli përjeton finalen: «aty përjeton përkëdheljen e ngrohtë të indiferencës së botës»!

Romani «I hujai» jo vetëm nga Sartre konsiderohet si i tillë, por është kryevepra e ekzistencializmit në letërsinë botërore.

## DASHURITË DHE DIVORCET

Disa muaj të vitit 1930 Albert Camus i kalon detyrueshëm shtrirë në shtrat një spitali francez. Tuberkulozi ia shemb ëndrrën që të nis me studimet e filozofisë në Universitetin e Algjerit. Tok me shërimin e prek edhe dashuria e tij e parë, e sëmura Simone Hié, ajo e varura nga morfiumi, drogat tjera dhe hiperseksualiteti, e cila së shpejti do t'i bëhet drama dhe muza e poetit të absurdit. Po si Sizifi përpiqet Camus ta shpëtojë zanën (kështu e thirr Hié A.C. nderi në momentin e fundit) e tij nga prapësitë e narkodemoneve. Mu në shkallën, klimaksin peripetik, më tragjik të dramës së kësaj dashurie, në atë pikë kur njerëzit rëndom dorëzojnë njëri tjetrin, Camus vepron si çdo bohem: marton më 16 qershor 1934 Hié-në, atë grua të cilën deri në vdekje, edhe kur ajo të do ta ketë tradhtuar ose do të bëj jetën e kufomës mobile (të Camus-së) do ta përkrah financiarisht e miqësisht dashurinë e tij të parë.

Një qenie me një habitus, fat si Albert Camus, në një kohë të tillë, ku mbaron? Në komunizëm se ku tjetër! Në vitin 1935 bëhet anëtar i PK të Algjerisë. Dallohet si njëri nga agjitorët më efektiv të komunizmit dhe antikolonializmit. Pas diplomimit të filozofisë me Plotin-in dhe Augustin-in Camus, për të shpëtuar martesën udhëton me Hié gjurmëve të Kafkës në Pragë. Në kthim e sipër, në Salzburg merr vesh për aferën seksuale të gruas së tij me mjekun e saj. Pas kthimit në Algjer Camus ndahet jo

vetëm prej saj. Ai divorcohet edhe nga komunizmi. Përrjashtohet me urdhër të Stalinit, sepse nuk pranon të ndalë propagandën e tij kundër kolonializmit. Ikë në Paris në fillim të vitit 1940 kur gjermanët kishin përparë pjesë të mëdha të vendit të të parëve të të atit.

### MITI I SIZIFIT [1942]

Ashtu siç e përshkruan në veprën «I huaji» njeriun, njëjtë e koncepton edhe ekzistencën reale të tij: absurde! Njeriu është i paradënuar të jetojë duke pranuar të jetë në një botë ku të gjitha speciet të njëjtin fat kanë [analogia entis]: të vuajnë pa vradë vetën. Këtë e sugjeron Camus në pjesën e parë dhe të dytë të studimit të tij. Pra *vetënjohjen* si parakusht për të pranuar botën dhe fatin ashtu siç është, pa u çmendur, pa kërkuar humnerën, po si Sizifi i cili bën jetë monotone me shkëmbin e tij në shpinë dhe megjithatë ia ftohë Thanatit [vdekjes] saherë që ia zë syri në horizont. Ky qenka kuptimi i jetës? Jo thotë Camus, sepse jeta ashtu si vdekja nuk kanë asnjë kuptim. E dyta duket më e «dinjitetshme» sepse është i vetmi fatalitet i paradhënë, i vendosur e të cilit nuk ke nga i ikë.

Jashtë këtij stadi të zhgjakësuar s'ka ku?

Po.

Revolta e brendshme, e çdonjërit, cila nuk është shpëtim nga absurditeti por është luftë, e vetmja gjë e kuptimtë për të cilën ia vlen të mos vdiset, sepse njëkohësisht kjo revoltë aktive, ekzistenca nënkupton solidaritet ndaj tjerëve. Si duket kjo letrarisht?

### MURTAJA [1947]



«Ndodhitë e çuditshme të cilave iu kushtohet kjo kronikë, kanë ndodhur në Oran të vitit 194...», kështu e hap qëllimisht rrëfimin «Murtaja» shkrimtari tashmë i vendosur në Francë. Le vitin hapur në shenjë alarmi: kjo që ndodhë këtu, ka ndodhur edhe më herët, do të ndodhë edhe nesër.

Romani metafizik është ndërtuar si dramë.

*Akti i parë:* Ekspozeja – Dr. Rieux gjen stahorin, korrierin e murtajës në Oran.

*Akti i dytë:* Intensifikimi – Epidemia përhapet gjithandej. Rugëve, korridoreve, shitoreve gjithandej kufoma njerëzish, kadavra minjsh, qensh, macesh. Të infektuarit presin vdekjen, të painfektuarit presin murtajën.

*Akti i tretë:* Kulmi – Murtaja ka asgjësuar, djegur, përheshtur qytetin Oran.

*Akti i katërt:* Momenti retardesk – Murtaja, pas ngopjes përgatit plaçkat për diku tjetër.

*Akti i pestë:* Katastrofa – kthimi në normalitet. Në absurd!

Nga shtatë personazhet kryesorë tre kanë mbijetuar, tre kanë vdekur dhe njëri është çmendur. Dr. Bernhard Rieux [që del në fund të jetë «autori»], mjeku, ateisti dhe praktikuesi më i denjë i dashurisë ndaj tjerëve mbijeton. Mbijeton po ashtu edhe nëpunësi Grand që i është fiksuar ta shkruajë një roman. Cottard që gjatë murtajës përpiqet ta vrasë veten përfundon në klinikat psikiatrike. I gjallë mbetet edhe gazetari emigrant Rambert. Politikani Tarrou vdes. Mbijeton edhe Paneloux, prifti jezuit që murtajën e pranon si dhe propagandon si dënim të Zotit ndaj mondanitetit përjetësisht keqbërës.

Pavarësisht religjionit, besimit, filozofisë, në luftë, në krizë (Romani shkruhet gjatë LDB) të gjithë bëjnë lojën

absurde të ekzistencës. Murtaja del si parabolë e Rezistencës së Njerëzve gjatë katastrofave [luftës, epidemive...], ndërsa mesazhi i romanit i qartë: Absurdi nuk mundet, ai mbijetohet nëpërmjet solidaritetit të njerëzve kundër vdekjes [së hershme] dhe tiranive.

Kjo qenka revolta? Solidariteti?

Katër vite më vonë me një ese tjetër sqaron Camus edhe më kategorik filozofinë e tij, një ese që jo vetëm Sartre-n e përdhos por nxit polemika epokale rreth filozofive, ideologjive, doktrinave dhe religjioneve.

### NJERIU NË REVOLTË [1951]

Historia nuk ka asnjë kuptim. Ajo ecë si një rrotë, sjell përsëritshëm të njëjtat sëmundje, shtyp mbi trurin, vetëdijen dhe zymtëson saherë që aktualizohet të sotmen. Religjionet janë kryeabsurdi i paradhënë. Që nga mesi i shekulli 18 e këndeje, që të gjitha ideologjitë dhe filozofitë janë konstruksione tragjike, janë utopi çnjerëzore. Sepse akëcila nga to synon monopolin absolut mbi fatin dhe formën e jetës së njeriut. Të gjitha nuk kishin e s'do të kenë kurrë tjetër causa finalis përveç absurdit, terrorit, diktaturave dhe vrasjes së legjitimuar nga shteti. Camus fut e përzien trutë e revolucionit francez, atij rus, marksizmit, fashizmit, Hegelit, Marksit, Sade-s, Nietzsches, Rimbaudes, Miltonit, Bakuninit, Brahamit në një kazan dhe i bërtet Njeriut t'i përmbahet vetëm një parimi, i cili nuk ka nevojë fare për asnjë asistencë ideologjike, por, dhe me fjalët e vetë Camus-ë:

*«"Toka e premtuar" nuk ekziston. Është e pamundur të jetosh për të nesërmen pa e përjetuar të sotmen. Bota si e tillë nuk ka asnjë kuptim. Kuptimin botës dhe jetës ia krijon njeriu aktiv kur vihet në shërbim të Tjetrit, kur lufton për të lirinë e*

*të skllavëruarit e të diskriminuarit. Vetëm Arti dhe Revolta janë të përjetshme. Ia vlen të duhet planeti, ia vlen të veprohet në mënyrë inteligjente, të qartë dhe të veprohet aktivisht».*

Camus nuk besonte në atë se e Keqja, Vrasjet, Tiranitë do të zhduken ndonjëherë. Gjithçka që njeriu mund të bëjë është të japë gjithçka prej vetes për të reduktuar dëmin e tyre, kështu sa për ta bërë jetën të durueshme [Kujto Nietzsche me artin e tij si mjet për të bërë realitetin të durueshëm].

Pas botimit të përmbledhjes me ese «Njeriu në revoltë» Jean Paul Sartre [që sapo kishte aderuar në Partinë komuniste] e akuzoi të ketë tradhtuar idealet komuniste. Divizioni i filozofëve nisi kampanjën për dekonstruksionin e teorisë së Absurdit. Polemika do të vazhdojë intensivisht edhe pas shuarjes [aksidentit me Gallimard-ët] së Camus-ë më 4 janar të vitit 1960.

## FILOZOFIA

Është vendim personal se a donë ta perceptosh botën si një gjëmadhë pa kuptim, të paradhënë apo donë t'i besosh ndonjë teorie si ajo e Pierre-Simon Laplace që thoshte se i gjithë universi është nën kontrollin e një demoni matematicien që gjithçka kalkulon dhe deri në përimitësi dirigjon edhe jetën e humanitetit, çka del jashtë orbitës individuale është raporti supra- dhe interhuman, konkretisht: janë kolektivët njerëzore të paradetyruara të pranojnë fatin e Sizifit ashtu siç është [në njërin nga interpretimet e shumta], apo guxojnë ato të vënë sërish po si Sizifi në aksion vullnetin e tyre të lirë, duke e lënë shkëmbin të rrokulliset ku të dojë, duke u shtrirë për të marrë frymë e pse jo edhe duke ia krisur ndonjë kënge?

Nëse për këtë perënditë e mbysin Sizifin, atëherë Camus s'ka çka thotë, sepse akti i vetëvrasjes është i përjashtuar, revolta ka marrë kuptimin e duhur: lirinë dhe vullnetin e njeriut në ndryshim, në sabotim të së përsëritshmes!

Këtu banon kontradikta kryesore e ekzistencializmit absurd të Camus-së. Me të drejtë [jo ideologjike, sepse sa u përket ideologjive Camus ka të drejtë, asnjëra prej atyre që trajton nuk ka shpëtuar e virgjër nga krimi] Jean Paul Sartre këmbëngulte duke shpallur tezat e ish mikut të tij të paqëndrueshme duke evidentuar kundërtënit: nga njëra anë i kërkohet njeriut aktivizmi kundër së keqes, tiranive, pritjet prej tij revolta e në anën tjetër i thuhet vegjeto se nuk ke çka bën kundër sistemit, fatit të njeriut që prodhon vetë njeriu se kështu qenka e thënë. Tjetri problem kardinal i teorisë është i ashtuquajtur i «problemi induktiv» i Humes-it, Russell-it dhe tjerëve deri sot, i cili filozofikisht ende ka mbetur ashtu dhe i cili argumenton për ndryshueshmërinë permanente e që demanton tezën se e ardhmja mund të dignostifikohet saktësisht duke u shërbyer me të kaluarën, pra si ngjitje-zbritje me gurin në shpinë drejt një shkëmbi.

## ARTI

Nëpërmjet kërkimit filozofik të kuptimit të botës dhe jetës Camus nuk na sjell zgjidhje relevante. Na i përsërit kontradiktat dhe problemet e pazgjidhura ose që nuk kanë zgjidhje. E vërtetë. Kjo do të jetë edhe arsyeja pse nga akademitë e botës as që trajtohet si filozof i ekzistencializmit absurd, por më shumë lexohet si ndër ekzistencialistët e parë që nëpërmjet artit hedh hipoteza shumë të rëndësishme rreth shumicës së doktrinave njerëzore. Po ashtu siç bënte në të njëjtën kohë edhe Samuel Beckett, jo vetëm nëpërmjet idesë filozofike në art

por edhe nëpërmjet vetë stilit, formës dhe gjuhës, për të dëshmuar absurdin e botëkuptimeve të shumta rreth botës, historisë dhe kulturës.

Nga një mit Albert Camus bën projektin e tij jetësor në kërkim të kuptimit të jetës dhe botës në relacion me njeriun, me ekzistencën e tij. Duke hulumtuar për të vërtetuar idenë e tij rreth të së vërtetës ekzistenciale absurde ai bën vepra arti si «Kaligula», «I huaji», «Rrethimi» dhe «Murtaja», kështu duke u bërë shkrimtari më i madh francez i shekullit 20 dhe njëri nga liderët e letërsisë botërore atëherë, sot e përgjithmonë.

Ndoshta ky edhe ka qenë synimi i gjeniut të lindur në Algjeri e jo të vrasë kohë për t'ia dekonstruktuar formulën induktive Humes-it dhe të tjerëve? Sido që të jetë mirë që është se pa të nuk do të kuptonim dot se sa absurd bëhemi kur besojmë në gjithçka që na të diellin! (2013)

6

## PABLO NERUDA

### *Liriku gjenial dhe agjitoratori banal*

Sot ai konsiderohet si njëri nga lirikët me ndikimin më të madh të shekullit njëzet. Me 12 korrik u bënë njëqind vjet nga lindja e tij. Pablo Neruda. Njëherazi poeti më i kontestuar dhe më i lexuar i epokës. Shumë kritikë të sotëm madje Nerudën e kosniderojnë si Picasso të lirikës. Megjithëkëtë, edhe sot e kësaj dite, nuk është i paktë numri i atyre kritikëve e ekspertëve që kanë alergji ndaj kileanit ekstravagant «poetit që artin e vet e vuri në shërbim të marksizëm-stalinizmit dhe ia shtoi jetën edhe më shumë se sa duhej kësaj doktrine vrasëse», thonë ca ekspertë që kanë emër të njohur në shkencat e letërsisë.

Instrumentalizimi politik i lirikës nerudiane megjithatë burrimin kryesor e ka tek vetë autori, si në cilësinë e njeriut- qytetarit ashtu edhe në atë të poetit. Edhe sot e kësaj dite, në sfera të caktuara të etërit letrar, mbizotëron bindja se

Neruda është sinonimi më adekuat i poetit në shërbim të komunizmit global. Bindje, e cila nuk është edhe e padrejtë.

Latinoamerikani Neruda ka prodhuar edhe mjaftë vepra që blloku komunist i përdori për shpëlarje trushë. Libra eksperimental për të poetizuar «Manifestin komunist» të sivillezërve ideologjikë Marks-Engels. Eksperimente të dështuara, jo vetëm se dështoi ai sistem në praktikë, porse Neruda aty ka dështuar si poet. Në krahasim me poetët tjerë socrealistë të kohës ai nuk është as mesatar. Padrejtësia që bartë me vete ky opinion është rreziku i përgjithësimit dhe viktimëzimit të mbarë veprës lirike të poetit në emër të një fragmenti të jetës, në favor të një segmenti të caktuar, i cili edhe pse i rëndësishëm në biografinë e autorit, është vetëm njëri nga gjymtiritë e fizikut korpulent krijues (?) të tij. Veç postmortum – atëherë kur vepra e një autori mund të merret si e përfunduar – kritika pati mundësi të zbret nga tribuna e flaktë e paragjytimeve, spekulimeve dhe anësimeve në laboratorin e studimit objektiv dhe shkencor sa i përket stilit, kualitetit dhe origjinalitetit të lirikës së Pablo Nerudës.

Deri sa ishte gjallë autori opinioni rreth tij – ashtu siç u tha më lartë – ishte i ndarë njejtë si ai rreth blloqeve politike gjatë sundimit të Luftës së Ftohtë: në komunistë dhe antikomunistë (kapitalistë).

Pikërisht për shkak të namit si «lirik i komunizmit në Amerikën Latine» si dhe vajtjeve e ndjetjeve të herëpashërshme në vendet e bllokut komunist, u bënë të njohura ndërkombëtarisht vetëm librat me këngë e himne antikapitaliste dhe u përheshtën librat e parë që shënojnë zanafillën e suksesit dhe rëndësisë së tij si lirik.

## HARAÇET E POEZISË POLITIKE

Mirëpo çështja esenciale për t'u sqaruar në këtë kontekst është: sa objektive mund të jetë një teori a kritikë që fiksohet vetëm tek fragmenti e qëllimisht (apo diletantisht) në emër të tij përpiqet ta mohojë terrësinë e një bote krijuese aq gjigante, shumëdimensionale dhe epokale siç është vepra lirike e Pablo Nerudës. Poezia politike me temë e motiv marksist e Nerudës është madje pjesa më e vogël e krimitarisë së tij.

Kualifikimi i veprës së Nerudës në «poezi të keqe» dhe «poezi të mirë» edhe pse iriton absolutistët (rob të motos: „s'ka poezi të mirë e të keqe, por vetëm poezi”) dhe ithtarët e përbetuar të tij është definicioni më i drejtë që mund të thuhet për këtë poet, ashtu siç mund të thuhet për çdo poet tjetër, që i ka shërbyer ndonjë «dobësie morale» të kohës në të cilën ka jetuar.

Pablo Neruda, nga njëra anë urrehej nga antikomunistët (në gjithë botën) e nga ana tjetër keqpërdorej në vendet komuniste dhe nga qarqet kulturore të majta të perëndimit si «zëri i shpëtimit human nga fashizmi nëpërmjet idealit komunist».

Tendenca për të vënë veprën e Pablo Nerudës nën optikën e objektivitetit sa vjen e përforcohet. Përtej këtij keq(e pjesërisht drejt)kuptimi – ashtu siç na është servuar edhe regjimet e mëhershme ballkanase – gjatë studimit të veprës së tij përballemi me një poetike jashtëzakonisht komplekse, lirike që gjatë etapave të zhvillimit të saj (dhe të tij) na përball jo vetëm me stacionet e një poeti në kërkim të unit a origjinalitetit të vet, por edhe me zhvillimin e stileve të modernës e më tepër me aftësinë e harmonizimit të atyre drejtimeve në një majë të vetëm lapsi. Për ta kuptuar drejtë Nerudën, pa rënë prë e manipulimeve jashtëletrare së pari duhet njohur gjithë vepra e tij voluminoze.



E, Rrugëtimi nëpër veprën e tij është gjithçka tjetër se sa i lehtë, sepse nuk kemi të bëjmë me një poet, me një stil, por me shumë poetë, me shumë stile, me një botë plotë specifika të veçanta të kulturës së pasur latinoamerikane dhe me një «animal politique» të majtë që jorrallë e viktimëzon qëllimisht artin në favor të bindjeve ideologjike sikur të kishte të bëjë me një «zambak të sokulluar me një leckë të urinuar», siç e quan peozinë në njërin nga manifestet e tij.

Përveç «rëshqitjes së tij fatale mbi akullin stalinian» ç'ofron tjetër vepra e poetit Pablo Neruda, i cili qysh në moshën 20 vjeçare, si student bëri një libër me lirikë, që për vite me rradhe ishte bestseller në hapësirën latinoamerikane?

## SUKSESI I NJË PSEUDONIMI LATINOÇEK

Neftali Ricardo Reyes y Basualto lindi më 12 korrik të vitit 1904 në qytetin jugor të Kilit me emrin Parral. Disa muaj pas lindjes së tij i vdes e ëma, Rosa, nga tuberkulozi. I ati i tij, një puntor i hekurudhës nuk pret gjatë dhe martohet me një grua tjetër, të cilën – kështu biografët e Nerudës – Ricardo e konsideronte si «një të huaj të rastësishme në jetën e tij». Qysh në moshën dhjetëvjeçare, në «Liceo de Hombres de Temuco» fillon Ricardo të shkruaj poezi dhe artikuj për gazetatat lokale. Me të marrë vesh i ati i tij konservativ për vjershat «amorale» të të birit (kryesisht poezi dashurie) ia ndalon kërcënushëm publikimet e mëtejshme. Ricardo – përndryshe qysh si fëmijë me karakter rebeli – i nënshtrohet urdhërit të babait dhe gjatë dy vjetëve të ardhshme nuk do të botoj më gjë.

Në moshën dymbëdhjetëvjeçare, rastësisht, në një orë letrare Ricardo kërkon një autogram nga shkrimtarja (e cila

më vonë do marë çmimin nobel për letërsi) Gabriela Mistral. Ende pa përfunduar mbiemrin e Ricardos në faqen e librit të saj, Mistral çohet në këmbë dhe e përqafton poetin e ardhshëm duke e lutur që të «shkel urdhërin e babait» e të vazhdojë të shkruaj. Kështu edhe ndodhë. Një emër tjetër, por me të njejtin stil dhe elan, pas dy viteve shfaqet në gazetën kileane. Jo Ricardo R. Basulato, por Pablo Neruda. Një pseudonim latinoçek (mbiemrin Neruda Ricardo Basulato e merr në shenjë nderimi ndaj poetit social kombëtar çek Jan Nepomik Neruda 1834 – 1891) që njëzet vjet më vonë do të legalizohet edhe zyrtarisht si firmë e vërtetë e kileanit.

Duke filluar nga viti 1917 e deri në vitin 1920 Pablo Neruda i mbledh të gjitha shpërblimet më të rëndësishme të vendit dhe më gjërë për letërsi. Më 1921, për të «ndjekur gjurmët e nënës» regjistrohet në shkollën e lartë pedagogjike të vendit me pasionin për t'u bërë mësues. Po në këtë kohë, pra në moshën 19 vjeçare, ai boton përmbledhjen e tij të parë «Crepusculario», e cila arrin një sukses mesatar. Gjë që nuk thuhet dot për veprën e tij të dytë «Veinte poemas de amor y una canción desesperada» (Njëzet poezi dashurie dhe një këngë dëshpërimi), e cila emrin e Pablo Nerudës e bëri tepër të njohur jo vetëm në botën latinoamerikane por në mbarë botën.

## JETA OSE POETI SI «ANIMAL POLITIQUE»

Me përfundimin e studimeve për mësues të gjuhës frenge Neruda nuk hyjnë në profesionin e mësuesit, ashtu siç pritej, por në atë të diplomacisë. Më vitin 1927 emërohet si zv/konsul në Rangun të Birmanisë, për të vazhduar mëpastaj si konsul në Sri Lankë (ku funksionon edhe si këshilltar i Kongresit Panhindian), Xhakarta, Singapur etj.

Gjatë viteve të qëndrimit në këto vende, i dëshpëruar, i përçarë nga vizionet apokaliptike, dhe i vetmuar deri në depresion shkruan kryeveprën që konsiderohet si bestselleri i lirikës së të gjitha kohërave «Rezidimi në Tokë».

Vitet e mëvonta i kalon si konsul në vendet si Argjentina dhe Spanja ku edhe shkruan veprën tjetër të rëndësishme « España el corazón» (Spanja në zemër).

Viti 1945, pas kthimit nga Spanja, Pablo Neruda angazhohet aktivisht në skenën politike të vendit: më 18 tetor 1945 zgjidhet si senator i Partisë Komuniste të Kilit, post të cilin ai e humb me publikimin e shkrimit kundër presidentit Gabriel Videla (të cilin e ndihmon gjatë elektoratit) «Yo acuso» (Unë akuzoj) dhe kërkohet me fletarrest. Falë popullaritetit të madh të Nerudës regjimi nuk e zbulon dot vendqëndrimin e tij. Një vit më vonë detyrohet të emigrojë. Stacionet: Argjentinë dhe natyrisht Moskë, pastaj në Varshavë dhe Budapest, për të përfunduar pastaj në Mexiko Cyt.

Në vitin 1950 Pablo Neruda bashkë me poetin turk (poashtu emigrant) Nazim Hikmet fiton «çmimin ndërkombëtar për letërsi» të Bashkimit Sovjetik. Tre vite më vonë po nga i njejti vend shpërmbllimin «Stalin». Shpërblim të cilin ai e «kthen prapë» pas vdekjes së diaktorit rus më 1956, kur Nikita Hrushov zbulon krimet staliniane. Nga kjo pikë fillon Neruda të «rishikojë» bindjet e tija rreth komunizmit, gjë që vërehet qartë në veprat e botuara pas kësaj date. Në të njejtnë kohë vendos të kthehet në atdhe. Atje ai tashmë nuk arrestohet por zgjidhet si kryetar i «Lidhjes së Shkrimtarëve» të vendit.

13 vite më vonë, Partia Komuniste e Kilit fut Nerudën si kandidat për president të vendit, nga e cila kandidaturë tërhiqet në favor të mikut të tij të ngushtë, socialistit Salvador Allende, i cili pas zgjedhjes plotëson dëshirën e

Nerudës për ta dërguar si ambasador në Francë. Më 21 tetor të vitit 1971 Neruda merr çmimin Nobel për Letërsi.

Një vit më vonë, i sëmurë nga kanceri, tërhiqet nga posti i ambasadorit për të përgatitur veprat e mbetura në dorrëshkrim. Deri në grahmën e fundit Pablo Neruda nuk tërhiqet nga përzjerja në politikë.

Në vitin 1973 e publikon librin, shkatrrues për famën e tij, si poet me titullin «Nxitje për vrasje të Niksonit dhe lëvdata për revolucionin kilean».

Më 11 shtator të po të njejtin vit, në atdheun e tij jep shpirt demokracia, duke u zëvendësuar me juntën ushtarake të Pinoçetit. Një ditë më vonë demolohet shtëpia e tij në Santiago, ndërsa me 24 shtator vdes Pablo Neruda. Gjatë jetës së tij Pablo Neruda shkruajti më shumë se dyzet përmbledhje me poezi, përkthime dhe mijëra reportazhe e artikuj të ndryshëm. Pesë nga veprat e fundit të tij u botuan pas vdekjes së tij.

I rritur jetim. Në konflikt të përhershëm me njerikën; i formuar në kushte të mjerimit social e ekonomik dhe në një qytet ku mbizotëronin; varfria dhe epidemitë; i ati i tij konservativ përpiqet t'ia ndalojë dhuntinë dhe pasionin për të cilin ai jeton: Letërsinë; atdheu i tij vlon nga brigadat fashiste dhe naziste; si konsul përballet drejtëpërdrejtë me jetën nën kolonitë perëndimore – a nuk janë këto predispozitat më të përsosura për ta detyruar intelektualin e atëhershëm që të pranojë si fé doktrinën komuniste?

## VEPRA: POETIKA E KLAUSTROFOBISË

Poezitë e para, të botuara në formë vepre, të Pablo Nerudës janë në ndikim të pararendësve të *modernismo*-s latinoamerikane, atyre poetëve që njihen si përfaqësues të «poésie pure», tematika kryesore e të cilave përshkohet nga

reflektimi i fortë i botës së brendshme – pasqyrimi i pakompromis i gjendjes shpirtërore e frymore të intelegjencies së kohës. Në këtë frymë janë ngritur veprat: «Crepusculario» (e përkthyer në gjuhë të ndryshme si «Muzgu i mbrëmjes dhe agimi», Santiago 1923) dhe «Veinte poemas de amor y una canción desesperada» («Njëzet peozi dashurie dhe një këngë dëshpërimi», 1924).

Me veprën «Tentativa del hombre infinito» («Përpjekje e njeriut të pafundshëm», 1926) Neruda shihet se po braktis modernizmin latinoamerikan të «poezisë së pastër» dhe kërkon strehim në rrymat e avantgardës evropiane të kohës. Pjesa dërrmuese e veprës është ndikuar sidomos nga surrealistët francezë.

Edhe në veprat tjera pas këtyre vërrehen ndikimet e formave dhe rrymave të ndryshme në poezinë e Nerudës. Megjithëkëtë nuk mund të flitet për një poet të patalentuar që jeton nga kolazhi i formave dhe temave për të bërë artefaktin me firmë të veten. Vërtetësinë e kësaj teze e konfirmron kryevepra e Pablo Nerudës «Residencia en la tierra» («Rezidimi në Tokë» 1933). Arsenali simbolik e metaforik, që autori e përdor në poezinë e kësaj përmbledhjeje, nuk përngjason më me temat e «besuara» të puristëve, as me ato të surrealizmit francez e më hiç nuk u ngjan atyre të frymëzuesit të tij në kohën e pubërtetit, lirikut Carlos Sabat Ercaty nga Uruguai.

Me «Residencia en la tierra» Neruda vulos stilin e vetë poetik, por duke mbetur në kategorinë e autorëve të «poetikës së brendshmërisë»: imazhet gjuhësore; forma dhe mënyra e konstruimit të tonit brenda vargjeve; kontinuiteti formëmjaltë i skenës poetike; sidomos tematizimi i shpirtit të epokës dhe publikimi i tij në formë lirike, të përpjeshme nga të gjitha shtresat etj. bëjnë që poezia e Nerudës të shndërrohet në njërin nga «manifestet» më efektive në

Historinë e Letërsisë, sa i përket «infektimit» lirik të masave, dhe atë në plan global. Këtë vepër Neruda e shkruan në fazën më të keqe të jetës së tij, atëkohë kur jetën e tij e mbizotëronte vetmia e thellë, neveria ndaj një bote, së cilës kufomat i shërbenin si dekoracion urban dhe vdekjen e kishte të vetmen rit ceremonial e shkak festimesh.

Pa asnjë mundësi ikjeje ai ishte i detyruar ta përcjell me sy çdo ditë – përtej dritareve të rezidencës së tij në Azinë lindore ku shërbente si konsul – tërbimin e njerzve me veti kanibale. Edhe pse kjo vepër atij i solli njohjen ndërkombëtare, më vonë Neruda do të vë në dyshim aspektet estetike të saj, madje duke u përpjekur të distancohet nga pjesë të caktuara për shkak të brutalitetit që mbajnë në vete, gjë që nuk ka penguar aspak që në botën e Shkencave të Letërsisë «Residencia en la tierra» të mbetet e respektuar si njëra ndër kryeveprat e lirikës së përmasave universale.

Metamorphoza – braktisja definitive e «poetikës së brendshme» – ndodhë në Spanjë. Atje ku Neruda idolizohej si «mbret i lirikës» nga klubi i letrarëve që festonin 300 vjetorin e poetit të nënçmuar të barokut Luis de Góngora, ndër të cilët gjendeshin edhe F. Garcia Lorca, R. Alberti, V. Aleixandre etj. Në këtë kohë ai jo vetëm në poezitë që botoheshin në revista të ndryshme letrare parasinjalizonte ndarjen agresive nga e ashtuquajtura «poésie pure», por edhe teoretikisht u vu në luftë aktive kundër saj, duke e bërë manifestin e njohur poetik «Para una poesía sin pureza» (për një «poezi impure»). Apeli për një «poezi të papastër» do të definohet në mënyrën: «e shpërdorur nga puna e dorrës si nga të tharti, e përzier me djers, erë urine dhe aromë zambaku». Poezitë e atyketushme dhe manifestin do ta kompletoj në vitin 1937 me veprën «España en el corazón» (Spanja në zemër). Prej

këtu fillon Pablo Neruda, njeriu i angazhuar politik dhe poeti kritik, të marrë anën politike, duke u bërë njëherazi zë i të majtëve në Luftën Qytetare të Spanjës kundër Juntës fashiste të Frankos. Shumica e analistëve mendojnë se: Neruda hyjnë në komunizëm pikërisht në kohën kur jeton në Spanjë për shkak të miqësisë me Lorca-n. Kritikës pse Neruda nuk i mbetet besnik asaj që e njeh më së miri, natyrës, ai i përgjigjet me poezinë e njohur deklarative «Explico algunas cosas» («Sqarimi i ca gjërave»):

*«Ju pyetni pse Poetika e tij  
nuk rrëfen për Tokën, për gjethet  
për vulkanët e mëdhenj të atdheut të tij?  
Ejani, shihni gjakun rrugëve,  
ejani shihni  
gjakun nëpër rrugë,  
ejani shihni pra gjakun rrugëve*

.....

Me rënien në kontakt me ideologjinë e komunizmit natyrisht se nis edhe faza e afrimit thellë e më thellë me të të ashtuquajturën letërsi soçrealiste. Ithtarët e tij në Perëndim shndërrohen në kundërshtarët më të rreptë, injoruesit e deridjeshëm në vendet e bllokut komunist pas vitit 1949 fillojnë ta përkthejnë dhe mitizojnë. Përtej kësaj gare natyrisht se teorikë dhe shkenctarë të mirëfilltë amerikanë, gjermanë, etj. fillojnë të flasin për «poezinë e bukur apolitike» dhe «atë të keqe politike» të Pablo Nerudës. Kjo ndarje është e saktë në kontekst me cilësinë e lirikës. Jo për arsye se mund të jemi komunistë apo akomunistë, kapitalistë apo fashistë, porse vjershat e Nerudës të shkruara në këtë fazë, në funksion të agjitimit ideologjik s'janë gjë të tjetër veç se parulla të thata ku muzikaliteti, mjeshhtëria e plasimit të brendshmërisë

nëpërmjet imazheve gjuhësore e strukturore (skenike) humbin paritetin, domethënë humbet zërin ajo këngë aq e bukur latinoamerikane, ajo lirikë e natyrës nerudiane duke u shndërruar në paragrafe të rimëzuara e ritmëzuara me qëllim të poetizimit të «Manifestit Komunist».

Artistikisht: eksperiment kot!

Neruda – zarzavate për sendiç në luftën mes blloqeve të acarruara ideologjike.

Kulmi i paradës nerudiane në shërbim të partishmërisë, marksizëm-stalinizmit, shënohet me «Odëtë elementare» në tre libra e gjithsejt 500 faqe si dhe në veçanti me librin «Las uvas y el viento» («Pëllumbat dhe era», 1954). Kthimi i tij paralel tek rrënjët sa i përket krijimtarisë së tij nuk i ndihmojnë të ketë respektin e merituar. Krahas poezisë politike socrealiste ai, po në të njëjtën kohë boton «Canto General» («Kënga e Madhe», 1950), një ep poetik, homerik për historinë, kolonializimin dhe pavarësimin e popujve autoktonë të Amerikës Latine si dhe vepra «Los versos del capitán» («Vargjet e kapitenit» 1952), poezi kushtuar gruas së tij të tretë Matilde Urrutia ku Neruda bën përkryerjen e lirikës mbi dashurinë, të cilën e ka nisur në veprën «Njëzet poezi dashurie dhe një këngë dëshpërimi» të vitit 1924.

Kjo humbje e virgjërisë së neutralitetit dhe angazhimit jo vetëm intelektual por edhe militant politik i kushton Nerudës injorimin total të tij nga bota jokomuniste deri në vitin 1973, kur në atdheun e tij Kili ndodhë puçi ushtarak dhe në përfundim shpërthen një simpati për rezistencën e poetit, me ç'rast fillon edhe botimi i tij.

Edhe pse nuk duhet injoruar ky fakt: pas zbulimit të maskrave staliniane Neruda nis të shprehë dilemën, dyshimin dhe njëkohësisht zhgënjimin e tij të hapur karshi doktrinës dhe sistemit që për më shumë se 20 vjet aq shumë



e kishte hyjnizuar. Falë kësaj gjendjeje Neruda i kthehet vetes, pra atij poeti autokton që ishte para se të mbrrinte në Spanjë. Me librin «Estravagario» («Ekstravagancat», 1958) motivi dhe tema politike zëvendësohen elementet autobiografike, kujtesën dhe natyrën. Në «Estravagario» Neruda për subjekt të lirikës bën sërish veten. Deri në vitin 1961 pasojnë edhe katër përmbledhje të tjera poetike me tema nga më të ndryshmet që për bosht kryesisht kanë botën dhe kulturën latinoamerikane. Prapsepapë Neruda edhe pse braktis mënyrën socrealiste të krijimit si stil ai nuk i tradhton idelat e tij të majta dhe herë pas herë e nxjerr nga një libër «kundër imperializmit, krishterëve të rremë dhe fashistëve» në dritë, siç është rasti me librin e shkruar në formën e epit të vjetër spanik «Canción de gesta» («Epi i heronjve») kushtuar revolucionarëve përreth kubanezit Fidel Castro.

Njëra nga veprat kryesore të Pablo Nerudës në fazën e vontë të tij është «Memorial de Isla Negra» («Memoriali i Isla Negra-s) që është fillimi i «lirikës autobiografike» (1964) e që do të pasohet libra të shumtë që trajtojnë tema si: Dashuria («La baracola», 1967), Natyra dhe Materia («Arte de pajaros, 1969), Politika («Fin del Mundo», 1972) etj.

Në veprat e fundit, me gjithë pesimizmin, dëshpërimin dhe zhgënjimin ai krijon një si testament të shpresës duke u thirrur në forcën e intelegjencies politike që do të ngadhjnjëjë mbi sistemet brutale e tiranike. Një thirrje e vonuar? Jo, një apel i bërë në fillim të jetës së tij poetike e që e përsërit në fund të jetës së tij fizike.

## POETI SOCIAL I SHEKULLIT

Neruda vdes duke i mbetur besnik ideologjisë së tij, që e kishte përqafuar që në fëmijëri (kjo shihet nga artikujt e parë të tij). Jo aq ndaj doktrinës komuniste si të tillë, por besnik ndaj «misionit» të tij të përjetshëm për t'i mbrojtur shtresat më të dobta të humanitetit. Ato shtresa që atë e shoqërojnë tërë jetën; që nga lagjeja e vendlindjes së tij në Parral ku «fëmijët mbanin barkun me dorrë nga uria», e deri në vendet aziatike të kolonizuara ku po të njejtit «fizikusa të imët hyjnin ndër tavolinat e aristokratëve për të mbledhur grimcat e bukës që binin nga tavolina». Nuk do të thotë që ky justifikim e lanë nga mëkatet që ka bërë me himnizimin e një ideologjie që doli po aq e egër si të gjitha diktaturat brutale të historisë së njerëzimit, por ai nuk mund të jetë as shkak i injorimit të veprës së tij madhështore, lirikës së tij gjeniale, e cila po si në këtë qindvjetor të lindjes së tij do të mbijetojë duke u festuar edhe në shumë qindvjetorë tjerë që pasojnë.

Njëra nga aspektet që artin e bën të çuditshëm, psikologjisht misterioz dhe kryesisht të pakapshëm për logjikën e papërkryer njerzore është kontradikta që përmban në vete. Ajo kontradiktë dhe shumëvetësi që karakterizon edhe lirikun gjenial kilean Neftali Ricardo Reyes y Basualto alias Pablo Neruda. (2004)

## ECO, MANFREDI, BARICCO

### *Trashëgimtarët e Dantes*

Valerio M. Manfredi, Umberto Eco dhe Alessandro Baricco. Tre autorë me tri histori, tre romane që sjellin imazhin e tre epokave dhe kulturave të ndryshme dhe që vetëm dy gjëra i kanë të përbashkëta: atdheun e tyre, Italinë dhe famën e arrirë ndërkombëtarisht.

Olimpia përpiqet t'i ikë kafshimit të një gjarpëri, i cili vibrueshëm sillet rreth shtratit të saj. Britma e saj për ndihmë çan murret memece të ëndrrës dhe tërbon pallatin. Filipi s'gjendet askund. Artemisia vrapon me pelena në duar për të sokulluar foshnjën. Lind Aleksandri, i biri i Filipit. Nga koha aleksandrine në vitin 1154. Baudolino nga Aleksandria e Piemontit vjedh një tabak letre dhe një pergament nga kancelaria e peshkopit Otto – një ndërmarrje që mund t'i kushtojë me kokë – për të shkruar “Chronica” e tij mbi vrasjen misterioze të perandorit Fridrih Barbarosa.

Më se shtatë shekuj më vonë, në anijen luksoze oqeanike “Virginian” në një skaj të korridoreve të saja marinarët e gjejnë një fëmijë për të cilin mendojnë se është një qenie, si në legjenda, që ka udhëtuar nga një epokë tjetër

në vitin 1900, prandaj edhe e pagëzojnë me emrin Novecento, pra me vitin e gjetjes së tij.

Aleksandri, Baudolino dhe Novecento. Valerio Massimo Manfredi, Umberto Eco dhe Alessandro Baricco. Tre autorë italianë që tre viteve të fundit nuk zbresin nga maja e listës së romaneve bestselerë. Të tre në të njejtën kohë dhe me të njejtin intensitet, gjë që le përshtypjen sikur një depërtim i tillë të jetë i programuar dhe atë për t'i kthyer Italisë famën dhe primatin dantesk në gjyrimin e kulturës evropiane. Një spekulim – i përdorur nga ca kritikë anglezë e gjermanë – i kapur madje nga përtej zonës së qiellit.

### VALERIO MASSIMO MANFREDI

Ai u bë vetëm tridhjet e tre vjeçar dhe me famë të amshueshme: Aleksandri i Madh. Menjëherë pas vrasjes së të jatit të tij Filipit, në mëshon njëzetvjeçare princi i bukur, karizmatik dhe tepër i zgjuar merr fronin, detyron grekët të shuajnë kryengritjet për shpartallim të perandorisë së Maqedonisë dhe nis ekspeditat për “pushtimin” e botës. Trilogjia e Manfredit mbi Lekën e Madh (siç quhet shqip) “Aléxandros – Il Figlio Del Sogno” (“Aleksandri – i biri i ëndrrës” përkth. kalk) edhe pse është pasardhës i një tradite të pasur sa i përket “romanit aleksandrin” sjell me vete detaje të reja në lidhje me jetën e perandorit legjendë të ngritur deri në shkallën e perëndisë: Që nga stacionet e para si fëmijë në mesin e katër shokëve të tij të ngushtë; dashuria dhe orgjitë e para; mësimet tek Aristoteli; roli i ndërmjetësuesit ndërmjet Olimpisë dhe Filipit; tërbimi pas lindjes së gjysëmvëllaut të tij nga Euridike e deri tek marrja e pushtetit autori mbrininë të rrëfej historinë e mbretit të Azisë dhe sunduesin e gjithë botës me një gjuhë të pangarkuar shkencore, siç mund të pritej nga një arkeolog i

njohur si Valerio M. Manfredi (1943 – Emilia Romagna), që ligjëron univerziteteve të Romës, Parisit e Birminghamit.

Në krahasim me Eco, i cili me sukses përvetëson gjithçka nga epoka për të cilën shkruan, Manfredi për ta bërë më të “kuptueshme materien” përdor një gjuhë duke iu përshtatur standardeve moderne të saj (si lochos në batalion ose strategos në gjeneral e të ngjajshme). Shihet qartë se vepra e Manfredit është një mozaik i kombinuar dhe rafinuar mirë i fragmenteve të lëna nga Plutarku, Diodori, Rufuzi, Pliniusi, Arstitoteli etj. për të ardhur deri tek një rrëfim i unjësuar, respektivisht duke u ikur kontradiktave që rezultojnë nga versionet e shumta të sagave mbi Aleksandrin. Romani është botuar disa herë në gjuhët kryesore të Evropës perëndimore dhe vazhdon të shitet me një intenzitet të madh.

## UMBERTO ECO

Fshatari Baudolino nga Alesandria e Piemontit, ku më vonë do të lindë njëfarë Umberto Eco, i mbushur përplotë ide dhe kreativitet na sjell panoramën historike të një epoke e kulture me një shkathhtësi gjeniale rrëfimi: se si në moshën trembëdhjetvjeçare adoptohet nga perandori Friedrich Barbarosa dhe bashkë me të merr pjesë në pagëzimin e tij si perandor në Romë për të udhëtuar pastaj në Vendin e Shejntë bashkë me kryqëzatat.

Gjithë ato që i shkruan Baudolino në kronikën e tij i ka përjetuar. Mirëpo thelbi i rrëfimit të tij ka të bëjë me vrasjen misterioze të “prindit” të tij Barbarosa. Vrasjen e tij në një kështjellë të bukur mesjetare përderisa ai ka qenë duke fjetur. Një ndërmarrje tepër e rrezikshme në kohën kur edhe letra për të shkruar ka qenë e ndaluar.

Profesori i Semiotikës në Univerzitetin e Bolonjës Umberto Eco (1932) famën e tij në plan universal e arriti me romanin “Emri i trëndafilin” (1980). Që nga ajo kohë atij i përcillen të gjitha shkrimet dhe sidomos studimet si “Kërkime për një gjuhë të përkryer” etj. në shumicën e gjuhëve evropiane. Madje edhe artikuj gazetash si ato në “Katër shkrime morale” i mblidhen dhe i botohen në edicion të veçantë nga shtëpitë më prestigjioze evropiane. Eco, tashmë është bërë njëri nga intelektualët elitë në kontekst me strategjinë dhe ngritjen e mendimit për një kulturë të përbashkët kontinentale. Gjatë ekskurzionit nëpër botën shkencore për të zbuluar pikat e përbashkimit të çdo identiteti nacional në Evropë në një kulturë të vetme, shumëkush e festoi apo mallkoi ndarjen e tij nga letërsia, nga proza.

Njëzet vjet më vonë, pas botimit të “Emri i trëndafilin”, Eco doli me romanin e tij voluminoz “Baudolino”. Roman, i cili jo vetëm për shkak të famës së Ecos që dy vjet mban të pushtuara vitrinat kryesore të librit nëpër Evropë, por më shumë për shkak të stampimit edhe njëherë më shumë të vlerave të këtij rrëfyesi gjigant.

Edhe në këtë roman, si në atë të parin, Eco ndjek traditën e Sir Walter Scott (Waverly) dhe Alexander Dumas (Graf nga Monte Kristo). Ose; ai i mbetet besnik romanit historik që në vete vazhdimisht jo vetëm se paraqitet si një dokument i detajuar mbi kulturën e epokës në të cilën zhvillohet ngjarja por është edhe një kombinim i shumë tipeve të prozës në një: “Baudolino” në të njëjtën kohë është roman mbi një personazh real historik dhe roman që duket sikur është shkruar nga ndonjë Sherlock Holmes i mesjetës.

Autori futet aq thellë në ngjarjet e asaj kohe sa që djegia e Konstantinopojës, masakrat e zhvilluara nga kryqëzata e katërt e deri tek përpjekjet e Baudolinës për të denoncuar vrasësin e perandorit dalin si në një film, me fotografi fare të gjalla.

As kësaj here Eco nuk le anash pa involvuar teoritë e tij mbi kulturën evropiane, problemet e gjuhës dhe çështje të tjera që i japin prozës herë herë edhe karakterin e një eseu shkencor.

## ALESSANDRO BARICCO

Më kot kërkojnë marinarët prindët e foshnjës së gjetur në bordin e anijes “Virginian”. Askush nuk bë zë. Asnjërit prej tyre nuk ia merr mendja se fëmiu, i pagëzuar me emrin Novecento do të bëhet njëri nga pianistët më në zë të historisë së muzikës dhe se kurrë nuk do të shkel më tokën. Novecento bëhet legjende dhe pagëzohet; “Pianisti oqeanik”.

Ai jeton për muzikën e tij dhe me të ai ushtron mrrekulli tek të gjithë që i dëgjojnë të rënat e gishtave të tij në tastaturën e pianos. Novecento bëhet bëhet themelues i Jazz

–it.

Alessandro Baricco (1958), shkrimtari italian nga Turini, ku edhe jeton, me këtë roman u bë autor-kult me famë ndërkombëtare. “Legjenda e pianistit”, siç quhet në shumicën e gjuhëve të tjera (ndërsa në origjinal “Novecento”) edhe si film pati një jehonë të jashtëzakonshme. Film, i cili u bë nga bartësi i oskarit Guiseppe Tornatore u konsiderua si njëri nga filmat më poetik të dhjetë viteve të fundit.

Muzikologu dhe filozofi Baricco, i cili punon edhe si moderator televizioni dhe ka themeluar “shkollën për shkrim kreativ” ( e njohur poashtu edhe jashtë Italisë) edhe me romanet tjera si “Vendi prej qelqi” dhe “Mëndafshi” vazhdon të mbetet si njëri nga autorët më të lexuar. E veçantë tek ky autor është sidomos krijimi i romanit fare të shkurtë: Për shembull versioni gjermanisht i “Novecentos” i ka vetëm tetëdhjetë faqe dhe atë me shkronja të mëdha, një libër që sipas autorit, është bërë me qëllim për t’u vënë në skenë teatrale e që pastaj është riformuluar në formë romani.

Me një rrëfim poetik dhe një fantazi të merrekullueshme Baricco përbashkon muzikën, pasionin dhe miqësinë në një pikë, në atë të harmonisë ndërnjerëzore. Ndërkaq “Novecenton e paatdhe e lartëson në amblemë të epokës sonë” – shkruan një kritik gjerman në zë.

Tre autorë me tri histori, tre romane që sjellin imazhin e tre epokave dhe kulturave të ndryshme dhe që vetëm dy gjëra i kanë të përbashkëta: atdheun e tyre, Italinë dhe famën e arrirë ndërkombëtarisht si nga autorët më të lexuar. Kritikët në relacionin e gjuhëve italishte-gjermanisht-frengjisht -anglisht e spanisht i konsiderojnë si autorët “klasikë” të postmodernës. Me të drejtë! 2012



PALAMAS, KAVAFIS, RITSOS  
VASILIKOS DHE ELYTIS

*Odiseu nuk kthehet më!*

Greqia, respektivisht Letërsia greke, kur ishte e ftuara speciale e Panairit e librit në Frankfurt (2001), Shtëpitë Botuese perëndimore, si zakonisht, iu përveshen organizimit të (ri)prodhimit industrial të veprave të vendit të promovuar si mysafir të panairit. Aksioni i organizuar mirë për t'i krijuar pozitë t'u privilegjuar letrarëve grekë në atë universalen, megjithatë nuk ndezi.

As kontributi grek, në këtë drejtim, për të prezantuar letërsinë e vetë sa më dinjitetshëm, nuk mungonte. Siç u shpreh edhe vetë shkrimtari Vassilis Vassilikos (i cili mori famën me romanin dhe filmin e njohur “Z”), gjatë një konference shtypi, në njërin nga sallonet e Panairit; “Po duket se vendasit e mi më me kënaqësi sjellin në jetë libra se sa fëmijë”. Dhe ai ka të drejtë në këtë konstatim, kur kihet parasysh se në Greqi, vetëm brenda vitit të kaluar, u prodhuan më se 8 mijë libra, një tendencë kontinuitive që nuk është patjetër drejtpërdrejtë e lidhur me pjesëmarrjen

greke në panairin gjerman të letrave. Ka vite që në terrenin grek vërehet një “boom” në industrinë dhe tregun e librit.

Përkundër faktit se autorët grekë kanë arritur të aktivizojnë sensin, dëshirën dhe gatishmërinë e qytetarit të vetë për të lexuar, me një fjalë kanë gjetur metodën se si të ngacmojnë interesin e grekut të sotëm ndaj librit, ata nuk kanë arritur – përveç në planin turistik – të shpërthejnë muret e izolimit të letërsisë së tyre për të dalë jashtë stadiumit të tyre nacional. Pas romanit të heraklitasit Nikos Kazantzakis “Alexis Sorbas” që u bë i njohur falë Holliwoud-it dhe Antoni Quinn-it (1946) dhe çmimit Nobel që iu dha poetit Odysseas Elytis nuk ka pasur ndonjë “rast” tjetër që do të kishte shkaktuar interes jashtë vendit. Megjithëkëtë me pjesëmarrjen dhe prezantimin e letërsisë së tyre krijuesit grekë arritën që të mobilizojnë opinionin kritik mondan që ai të ballafaqohet me letërsinë e tyre aktuale, kështu duke nxitur një debat të ri në lidhje me identitetin, rolin dhe vlerat e letërsisë greke në gjirin e asaj botërores, gjë që në njëfarë mënyre, pjesërisht edhe ia arritën, nëse jo si letërsi e tërë, pra si kolektiv, atëherë nëpërmjet individëve – krijuesve të veçantë që sjellin vërtet një frymë të veçantë në letërsinë artistike, madje sipas një studiuesi të letërsisë greke; “kjo është mirë edhe për vetë letrarët grekë, është njëlloj peshimi vlerash, tash ata shohin se ku qëndrojnë”.

Tek dashnorët ose më saktë kritikët evropianë me një nostalgji të theksuar homerike debati po udhëhiqet nga një eufori referencash antike.

Një numër i konsiderueshëm kritikësh, që tubohen rreth disa medimeve prominente euro-amerikane, të cilët shoqëruan panairin me komente e refleksione pandërprerë,

që nga lajmi për pjesëmarrjen greke e deri në ditën e fundit, “harruan” të merren me letërsinë e sotme greke, ose iu qasën asaj vetëm në formë sipërfaqësore sa për të justifikuar paraqitjen, duke u zhytur sërish në stërinterpretimin e Mitologjisë Homerike, rëndësinë e antikës së lavdishme greke për majat e kulturës së sotme perëndimore e të ngjashme.

Në anën tjetër po aq e zjarrshme është edhe kritika që “ka alergji ndaj lavdisë greke”. Janë kritikët që zanafillat e lindjes së kreativitetit shpirtëror e mendor human nuk i shohin patjetër vetëm në epokën e Homerit, Eskilit, Euripidit, Sofokliut, por edhe në botën paraantike, orientale, duke u kapur për dokumenteve të para, shenjave të para të interesit human për artin. Ca ashpërsojnë polemikën e tyre duke ftuar në ndihmë faktet në lidhje me plagjiaturën që grekët kanë bërë në Antikë duke vjedhur mitet dhe legjendat e kulturave të përmbysura e të djegura nga vetë ata. Fakte kokëforta që injorohen nga “kori i elozhistëve, për të cilët bota nis dhe mbaron me Homerin”, siç shprehet një kritik amerikan.

Ndërsa, të rrallë janë ata që me një dozë të matur përfolën kontributin grek në zhvillimin e intelektit human – i cili assesi nuk duhet përjashtuar – dhe me një përqendrim profesional, kritik e shkencor përpiqen të përballojnë euforinë që shkakton Greqia me emrin e saj të lavdishëm historik, duke u përpjekur të japin një vlerësim korrekt në lidhje me letërsinë e sotme greke ose mbi letërsinë e re greke – nëse bazohemi në pretendimin grek!

Pa mohuar argumentacionin e që të tri fronteve të kritikës rreth rolit grek në zhvillimin human, pa u bërë varrës i njëjës apo tjetrës teori si dhe pa hulumtuar rrethanat dhe origjinën e vërtetë të një lulëzimi të tillë intelektual

grekët janë krijuesit e “Poetikës”, filozofisë, dhe shumë drejtimeve tjera të shkencave humane. Duke filluar që nga parasokratikët e deri në shkollat e fundit platonike nëpër trojet evropiane përulemi përballë faktit rreth kontributit të një populli në përhapjen e filozofisë për mendimin dhe shpirtin e lirë, i cili më vonë do të inspirojë të gjitha etapat e zhvillimit të mendjes humane nëpër shekuj.

Ekziston një vakum gati dymijë vjeçar në mes të letërsisë antike greke dhe rishfaqjes së saj në shekullin XIX. Letërsia e re greke, konkretisht, dokumentet e para postantike letrare – duke përjashtuar veprat e Andreas Kalvos Ioannidis, të shkruara në frëngjisht – datojnë me shkrimet e Dionysios Solomos, sidomos me veprën e tij “Kretasi” ku bëhet fjalë për ikjen e një ushtari grek nga thonjtë e soldnerëve të Ali Pashës.

Poeti dhe rrëfyesi historik Solomos përpiket që të shfrytëzojë “trashëgiminë” e poetëve të lashtë grekë, mirëpo i ndikuar tejmasë nga letërsia e filozofia anglo – saksonike, gjermanë e në veçanti nga Gëte, Kant dhe Hegel nuk ia del të dëshmojë për një stil tradicional grek që do të lidhej me klasikët e antikës.

Megjithatë Solomo është sinonimi i kthimit të letërsisë greke si dhe udhërrëfyesi i romantizmit grek, i cili, ashtu si tek popujt tjerë bëhet epoka e një shpërthimi shpirtëror. Me krijimin e shtetit të ri grek (1830), të frymëzuar nga Solomos (duke ndjekur stilin dhe formën e tij të krijimit) në skenë paraqitet një gardë krijuesish (Papadiamantis, Xanthopoulos, Martelaos, Danelakis, Gouzelis etj.), të cilët me të drejtë konsiderohen si prestarët e parë të Letërsisë Kombëtare greke. Një letërsi me barrën e pretendimit në shpinë për të konsistuar me historinë e Odiseut, pra për të

arritur statusin e trashëgimisë së Homerit në letërsi. Pa sukses.

## PALAMAS DHE KAVAFIS

Edhe pse Kostis Palamas me veprën e tij **“Këngët e atdheut tim”** bëri një jehonë të efektshme jo vetëm në Greqi nga pjesa dërrmuese e teoricienëve që merren me Letërsinë e Re greke nuk e konsiderojnë atë si krijuesin e lirikës moderne greke, por Konstatin Kavafisin e lindur katër vjet pas tij. Me plotë të drejtë. Palamas nuk arrin të çajë rrethin e krijuar stilistik, gjuhësor e përmbajtjesor të romantikut Solomos.

Ndërsa Konstantinos Kavafis (1863-1933) në poezinë e tij arrin në mënyrë mjeshtërore, me një finesë origjinale; t’i përshtatet ndërtimit modern të poezisë në aspektin stilistik; të shfrytëzojë (deri sot asnjë krijues grek nuk ik dot këtij segmenti) Mitologjinë greke aq të preferueshme nga mendësia evropiane me një perfiditet të lehtë; duke i dhënë letërsisë greke një ngjyrë krejt tjetër nga ajo antike, pra një pamje reale, domethënë një imazh bizantin e ortodoks. Kjo nuk do të thotë me çdo kusht që Kavafis nuk ka rënë (dhe atë në fillim e në fund të jetës së tij bindshëm) në grackë të lirikës historike e romantike, sidomos në përmbledhjen **“Gota e ngjyrosur”** vërehet një kurs labil në këtë kontekst, mirëpo ato poezi nuk i dhanë atij famën e një poeti të përmasave universale, por vjershat mbi dashurinë, vjershat homoerotike që hapën një horizont të ri në lirikën greke dhe i thanë fund sundimit të vetëm e absolut të tragjikes, dramatikes mbi jetën e një letërsie në krizë identiteti. Vizioni për t’iu afruar të së Bukurës pa i vënë asaj parakushte dramatike shpëtuan jo vetëm Kavafisin, por

edhe mbarë letërsinë që s'kapërcente dot kufijtë e një epoke mijëra vjet të perënduar e që s'imitohej dot.

## RITSOS DHE ODYSSEAS ELYTIS

Jani Ritsos (1909 – 1990), njëri nga poetët, të cilit, për dallim nga Kavafis, nuk mund t'i mëveshët asnjë grimë historiciteti, keqpërdorim të namit antik grek për të depërtuar në botën e letërsisë u bë viktimë e ideologjisë së tij. Ritsos në jetën politike, krahas asaj letrare, ishte një militant i majtë që në njërin blok ngrihej në kulm e në anën tjetër mallkohej si diletant. Një “diletant” letrar, poet e prozator, artit të të cilit nuk i ndalej dot fuqia ndikimit në gjeneratat e reja, segment që vërehet dukshëm tek krijuesit e rinj. Kundërshtarët e tij – në skenën letrare greke – nuk e mohojnë dot faktin se nga poetët e pasluftës Ritsos mbetet më i lexuari. Ritsos dallohet kryesisht për nga rebelizmi për një çlirim politik dhe të një krijimi, një gjuhe krejt apolitike. Paradoks që në krijimtarinë e Ritsos e humb domethënien themelore të kuptimit.

Odysseas Elytis (1911-1996) është bartësi i vetëm i çmimit prestigjioz Nobel për letërsi (1979). Elegjisti Elytis me veprën e tij “**Oxópetra – në perëndim të pikëllimit**”, poetikë që konsiderohet si “dialogu mistik me vdekjen”, është letrari i parë grek (deri më tani edhe i fundit) që u njoh se i takon gjenit homerik, përkundër përdorimit të terminologjisë mitologjike greke – tashmë të banalizuar – në një masë të tepëruar, ai dialogun e vetë e bën me kohën e tashme, ose më mirë thënë ai bashkëbisedimin e bën (me plotë dashuri) me vdekjen e pakohë.

## LETËRSIA E SOTME GREKE

Elytiss, në vitet e nëntëdhjeta, ende para vdekjes së tij nuk është më prezent në skenën letrare greke. Jo vetëm fizikisht, por edhe si ndikim. Në jetën letrare greke paraqitet faza e katërt (pas epokës së romantizmit, Kavafisit dhe Palamas ose letërsisë së viteve të tridhjeta dhe Ritsos e Elytisit të viteve të shtatëdhjeta), një fazë në kërkim të identitetit dhe që nuk i drejtohet më Homerit për ndihmë, nuk do që të identifikohet me vitet e humbura të Odiseut të Kalypsoja, nuk kërkon shpëtim nga mangësia e fjalorit në mitologjinë greke, por që i përshtatet dhe ec baras me kohën dhe problemet e saja. Thjeshtë një “dorëzim” demonstrativ nga pritja për kthimin e Odiseut në letërsinë greke. Autorë që edhe ishin prezantues të letërsisë së sotme greke, shkrimtarë deri ato ditë të panjohur por me perspektivë.

Jo vetëm në Evropë – në hapësirën gjermanofone, fraknfone, spanjolle, italiane – Shtëpitë Botuese më me renome u futën në një garë për të përkthyer si letërsinë e traditës ashtu edhe më se tridhjetë autorë të sotëm grekë, por edhe grekët vetë nuk qëndruan duarkryq; ata bënë antologji të përkthyer në gjuhët e sipërpërmendura dhe qysh para panairit ftuan gazetarët e redaktorët e medimeve në zë në Athinë për të lidhur kontaktet e duhura me qëllim që “ndërmarrja e prezantimit” të bëhej sa më dinjitoze. Suksesit nuk mungoi. Debati u zhvillua dhe po zhvillohet dhe librat e shkrimtarëve grekë janë në trend.

Po për çfarë letërsie bëhet fjalë? Njëri nga kritikët dhe gazetarët më prominentë të kulturës në Greqi, Vangelis

Chatsivassilou (Eleftherothypia) shprehet kështu; “Proza e sotme greke është një hartë tepër ekzakte politiko-gjeofizike e rajoneve greke”. Konstatim më të saktë nuk besoj se ka!

Igumenica, Heraklioni, fshati Kri-Kri me dhitë e tij në kodrat e gurta të Kretës, hujet e njerëzve të Peloponezit, hallet e njerëzve nëpër vendet më të thella të Greqisë së sotme dalin në shesh nëpërmjet letërsisë etj. – janë të përshkruar në formën më të përimitësuar që ekziston. Kjo është ajo forma e re e letërsisë greke, që për botën e huaj duke ekzotike e që ka zgjuar një interes të mjaftueshëm, nëse jo artistik, ani atëherë zbavitës. Element që u jep letrarëve grekë mundësinë e depërtimit dhe askush nuk mund të mohojë se nëpërmjet kësaj letërsie “zbavitëse” nuk depërtojnë edhe letrarët e njëmendtë si dramaturgu, romansieri dhe moderatori i ri kretas Petros Tatsopoulos (i cili tashmë është i kontraktuar me shtëpi botuese perëndimore e që deri tani nuk e ka pasur asnjë fjalë të përkthyer në gjuhë të huaj) ose autorja e romanit “Gratë e jetës së tyre” Lena Divani që poashtu ka zgjuar një interes të bujshëm.

Kështu Panairi i Frankfurtit, nga grekët u shfrytëzua si shans për të kërcyer muret e izolimit nacional në letërsi e art.

Aksion i menduar djallëzisht bukur!



RUDOLF BLÜMNER  
& XHINGIS AITMATOV

*Xhamilja ose puropoetika*

**Dashuria në letërsi – një megatemë komplekse apo aq e thjeshtë dhe e kapshme siç na e rrëfen shkrimtari kirgizian Xhingis Aitmatov me novelën e tij «Xhamilja»!**

«Betohem, është historia e dashurisë, më e bukura në botë». Kjo fjali e poetit francez Louis Aragon qëndron në kopertinën e çdo botimi të novelës «Xhamilja» të shkrimtarit kirgizian Xhingis Torekuloviç Aitmatov. Është vërtetë rrëfimi më i bukur i globit apo kemi të bëjmë – siç pandehte kritika e kohës – një aksion i mjerë i komunistit perëndimor (Aragon) për ta piedestalizuar me çdo kusht artin socrealist sovjetik (të cilës rrymë i përkiste edhe vetë) nëpërmjet yllit të saposhfaqur brenda Institutit Gorki (Aitmatov).

Vërtet si duken Xhamilja dhe Danijari nga katundit stepor Aul përballë megarrëfimeve, romancave si ai i Karitonit nga Afrodizia për Kairean dhe Kalliroen (shekulli i parë para erës sonë); si ai Akilit të Taitosit mbi Leukipen (shek. II); Longusit mbi Dafnën (shek. III); Maxhnunit mbi Lailan (shek. VII); si duket Xhamilja përballë Lotte-s së Goethes, Jane Eyre-s së Brontës, si duket Danijari përballë Adam Bede-s së Eliotit, Doktor Zhivagos së

Pasternakut e sidomos Werther-it dhe gjithë atyre figurave monumentale e të shumta të letërsisë universale?

Pikërisht ky ekskursion i imi, i cili u nxit automatikisht pas kërkesës së kryeredaktores së revistës «Saras» Alda Bardhyli për të shkruar mbi romancën më të pëlqyer, respektivisht dashurinë në letërsi është edhe defekti, gabimi që ne bëjmë saherë kur përballemi me dashurinë si megatemë të kështuqenies së humanitetit. Ne menjëherë i përvishemi rrugëtimit historisë së letërsisë, mitologjisë, doktrinave, psikologjisë, teologjisë, filozofisë, arteve e biologjisë duke kërkuar shembuj krahasues për ta shpjeguar një dashuri që ipso facto saora e humb autonominë, origjinalitetin dhe falsifikon perceptimin tonë ndaj saj, ngase e lexojmë me kode të huazuara historish, rrethanash e frymësh tjera dashurie.

Këtë gabim si duket nuk e ka bërë Aitmatov gjatë vendimit për ta shkruar «Xhamiljen» si temë diplome në Institutin Gorki. Nëse e ka bërë me program, atëherë e ka njohur poezinë manifest «Ango Laina» të gjermanit Rudolf Blümner (1921), nëse e ka shkruar drejt nga fryma, ndjenjat e në letër – dhe kështu duket – pa kërkuar imitate e referenca, atëherë ka kuptuar çelësin të cilin nuk e kapur autorë edhe shumë «më të mëdhenj» se ai të letërsisë universale.

## RRËFIMI

«He Danijar, thuaja këngës edhe ti njëherë! Je xhigit apo çka» [Fq. 50] e nguc Xhamilja e martuar me Sadikun, veteranin tashmë sakat e në front, pa e ditur se zëri i tij, kënga e Danijarit do ta tjetërsojë atë deri në qelizat më subkutane të frymës dhe shpirtit; pa e ditur se «vaji» i tij për dashurinë dhe atdheun do t'ia «çrregullojë» jetën, do ta

detyrojë të shtegtojë drejt zonave përtej stepave aq të dashura të saja.

Viti 1941 në fshatin Aul të Kirgisistanit. Shumica e meshkujve janë në luftë. Ashtu si burri i saj, Sadiku, i cili Xhamiljen e ka rrëmbyer në shenjë hakmarrjeje, pasi e fundit e turpëron (e fiton) në një garë vrapi me kuaj. Kështu e ka dashur tradita.

Osmoni, brigadieri sovjetik kërkon që Xhamilja, po si xhigitët (meshkuj të rinj, të aftësuar për të mbajtur familjet, zëvendës patriarkësh të „vërtetë“) të udhëheq një grup që me karroca bartin drithë për në stacionin më të afërt hekurudhor – furnizim për ushtarët në front. Në grupin e saj – sipas kërkesës së familjes – është edhe Saidi 15-vjeçar, i cili caktohet si «bodyguard» i nuses pa burrë. «Ti je përgjegjës për të» [Fq. 18] i thotë nëna, matriarkja e familjes së madhe, të riut.

Është po ky Saidi, nëpërmjet të cilit Aitmatov rrëfen storien e fshatit stepor ku jetojnë familje postnomadeve në kufi më Kazakistanin.

Dashuria ndërmjet Xhamiljes bëhet manifeste sapo Danijari ia kris këngës në të kthyer nga stacioni ku kanë shkarkuar drithin. Saidi që e ndjen këtë më shumë shpreson që t'i shohë të bashkuar se sa larg njëri tjetrit. Pse kështu? A nuk është kjo kundër përgjegjësisë së tij? Atij, Saidit i është fiksuar në shpirt e tru piktura. Ai donë me çdo kusht që t'i vizatojë të dytë bashkë, trupëlëshuar njërin mbi tjetrin, ashtu siç derdhën dy dashnorë në çastet e tyre më romantike. Dhe kjo ndodhë. Edhe më shumë: Saidi, Xhamilja dhe Danijari flejnë bashkë në një kasolle me kashtë, kështuqë një natë, kur jashtë natyra bën kërdrinë me shtrengata e rrëmujë ky dëgjon dialogun, nëpërmjet të cilit beson ta ketë kuptuar njëherë e përgjithmonë esencën e të

dashuruarit. Të nesërmen ai mezi gjen letrën dhe bën vizatimin e tij të parë, të cilin e fsheh menjëherë.

Në njërin nga mëngjeset e bukura të Aulit nënstepor Saidi sheh se si Xhamilja dhe Danijari me nga një trastë plaçkapakë largohen nga Aul-i. Ai u vrapon pas. Deri në lumin e afërt ku shtrihet përtokë duke qarë. Ato çaste kupton Saidi i mitur se edhe vetë është dashuruar në Xhamiljen aq jokonvencionale, kokëfortë, të bukur dhe plotë energji jete. Nuk i ndjek më tej. Kthehet në shtëpi. Sadiku tashmë i kthyer nga lufta mban vizatimin e tij në duar dhe i bërtet: «Kush është ky»? Danijari – ia kthen Saidi indiferent. «E ke ditur ti tërë kohën?», e pyet nëna. «Po», thotë Saidi dhe mbështetet për koftorit. Akuzave të nënës dhe Sadikut u jep fund me kërcënimin e vendosur: «Do t'i vizatojë përsëri!» [Fq. 79]

## RECEPCIONI

Menjëherë pas botimit të novelës në gazetën «Nowy Mir» (1958?) të Moskës Aitmatov pranohet në elitën e shkrimtarëve sovjetikë. Në Gjermaninë socialiste botohet libri iu urdhërohet shkollave si lekturë e obligueshme. Kështu ndodhë edhe në shtete tjera socialiste. Në vitin 1969 «Xhamilja» bëhet film në BS. Edhe përtej zonës së çekanit e draprit të kuq novela përkthehet në dhjetëra gjuhë. Po si Werther-it dikur që imitohej nga gjermanët ashtu edhe Xhamilja shndërrohet në ikonë të femrës drejt emancipimit. Ideologjikisht sovjetikët e përdornin Xhamiljen edhe për të ndikuar në etnitë e ndryshme për «t'i çliruar» ata nga religjionet, traditat dhe normat e tyre që i konsideronin refraktare, primitive dhe jokompatible me «Njeriun e Ri» të realizmit socialist. Edhe pse me të drejtë kritika si ajo perëndimore ashtu edhe ajo lindore e vulosën

si veprën më jo-ideologjike të mundshme: po të mos shfaqej dy tri herë Osmoni në novelë lexuesi as që e merr vesh se Krirgistani gjendet në zonën sovjetike. Aitmatov ka përjashtuar çdo gjë të mundshme ideologjike e referenciale për të mbrojtur pastërtinë, unikatësinë e rrëfimit të tij mbi dashurinë e dy dashnorëve të fshatit Aul dhe me këtë rikthehemi tek çështja se ç'ka të bëjë Aitmatov me aksionin poetologjik të shkrintarit gjerman Rudolf Blümner, respektivisht manifestin e tij «Ango Laina».

## PUROPOETIKA

«I éja / Alo /Myu [...] Schjatt / Ui ai laéla – oía ssísialu / [...] Iná/ Leíola/ Kbaó/ Sagór/ Kadó [...]», kështu duken vargjet e poezisë «Ango Laina» të Blümner-it. Ç' gjuhe qenka kjo? Nuk është gjuhë. Janë kombinime të rastësishme konsonantesh e vokalesh me synimin e qëllimshëm për të krijuar një atak antisemantik, për të çliruar aktin artistik nga referencat, asociacionet, për ta alarmuar recipientin që ta lexojë atë nga një gjendje karteziante (i çliruar nga çdo dije e përvojë dhe i përqendruar ekskluzivisht vetëm në atë që dëgjon, lexon në çastin konkret). Blümner donë art ku fryma e autorit nuk del si sumarium dromcash historike, të huaja, të lexuara; ai proteston kundër kolazheve dhe kompilimeve që kanë shndërruar artin vetvetiu në një zeje të kombinatorikës vetëriprodhuese. Për dallim nga shkencat arti, sipas kësaj teorie, duhet të mbetet zonë e paprekshme frymësh origjinale dhe të pafalsifikueshme.

Këtij parimi blümnerian i përmbahet Aitmatov në novelën Xhamilja. Ai rrëfen Xhamiljen në mënyrë të pakrahasueshme me Lotten e Gjermanisë apo me Kairean apo Dafnen e Antikës. Ai përshkruan Kirgizinë pa ia

ndërtuar ndonjë agorë apo arene fiktive që të na lidh si lexues nëpërmjet asaj që kemi të arkivuar në kujtesën tonë si kod identifikimi për të shpjeguar botën. Xhamilja është njëra nga rrëfimet (nuk e teprojmë si Aragoni) më të bukura të dashurisë ngase autorit të saj i ka interesuar të shpalojë vetëm ndjenjat e tij origjinale, të përshkruaj ashtu siç sheh e përjeton ai botën, vendin e tij, njerëzit e jo ashtu siç kanë parë e ndier idhujt e tij. Art pur pra!

10

LEROUX, KAY, WEBER, STILGOE,  
YESTON DHE FANTOMI I OPERAS

*Një histori e shëmtisë, artit dhe dashurisë*

I.

“Vetëm edhe koka ka mbetur zonjë. Shtypni, ndihmoni birin tuaj që ta shohë dritën e botës”, i bërtet mamia Madelaine-s. Dhe ja çasti i çlirimit: sytë e lindëses përballen me maminë e shndërruar në pikturën e famshme “Ulërima” të oslonezit Edvard Munch.

“Është i vdekur”?

Jo.

Edhe më keq.

“Zot ke mëshirë për ne”, pëshpëritin gati pa zë tri gratë e përballura me qenien më të shëmtuar që ua kanë zënë sytë ndonjëherë.

“Ta mbysim. Si ashtu është kufomë e gjallë. Vdekja vetë”, propozon nëna.

“Kisha e konsideron krim aktin qoftë edhe si ide”, i thotë prifti Mansart Madelaine-s së hutuar e kokëkthyer nga frika mos vjell sa ta shoh shëmtesën që sapo ka lindur.

Si ta quajmë – pyet prifti duke u vërdallë hutueshëm dhomës. “Si ju. Pagëzojeni Erik”.

Kështu “përshëndetet” ardhja e Erikut në këtë botë, respektivisht në fshatin Bosherville të Francës së vitit 1831. Bëhet fjalë për atë Erik që në moshën e tij madhore do të hyjë në historinë e personazheve më monumentale të letërsisë, muzikës, filmit dhe arkitekturës si Fantomi i Operës “Garnier” të Parisit.

## II.

Vërtet ka ndodhur gjithë kjo skenë tragjike apo s’është hiçgjë tjetër përpos sajësë e shkrimtares britanike, Susan Kay (Phantom: 1990)? Ka jetuar vërtet Fantomi i Operës apo është konstrukt imagjinar i babait, shpikësit të tij, shkrimtarit francez Gaston Leroux (Le fantôme de l’opéra: 1910)?

I fundit, romanin e tij e hap me fjalinë: “Fantomi i operës vërtet ka ekzistuar”. Susan Kay e letrarizon, monumentalizon shkëlqyeshëm personazhin, mirëpo nuk vë dot dorën në zjarr për të dëshmuar kundër apo pro ekzistencës së “përbindëshit që me varkë pati lundruar ujërave pesë kate nëndhé të operës parisienne”. Ndërkaq, historianët nuk i shkoqen rrëfimit të tyre: fantomi nuk ka ekzistuar fare, ai është pjellë e fantazisë së artistëve për t’i çshpjeguar, fshehur disi aksidentet e shumta që ndodhnin teatrit (një llambë vret njërin nga teknikët e të ngjashme).

Kur kihet parasysh fuqia e perceptimit, ndikimit dhe përmbajtjes së personazhit të fantomit, diskursi rreth (mos)qenies reale të tij duket fare sekondar: Që nga viti



1915 e deri më sot Fantomi vazhdon të jetë brumi i dhjetëra filmave, muzikaleve dhe zhanreve të tjera të arteve: Richard Stilgoe, Andrew Lloyd Weber, Mauri Yeston e shumë yje të tjerë të teatrit muzikal shpërthyen botës për shkak të maskës aq të njohur të lugatit të katakombeve të operës “Garnier”. Susan Kay salloneve mondane të letërsisë hyri jo me “Mbretëreshën” (2005) apo “Letrat për Sarën” (2003) por po ashtu me Erikun e shëmtuar. Nils Chrisander, Claude Rains, Robert Englund mbahen mend edhe sot ngase aktruan fantomin.

Ku qëndron çelësi i këtij sukcesi? Pse të jetë fantomi i shëmtuar nga Boshervilli – sikur pak t’i kishte proza, drama, tragjedia – aq tundues e tronditës saqë të ndikojë si personazhi më monumental nga shekulli 19 e deri sot?

### III.

Zëri i tij pushton. Ai zhdrynos eksplodueshëm edhe zonën më të hermetizuar të mendësisë melankolike të Bosherville-t. Sa herë kënga e tij shpërthen përtej dritareve të dhomëburgut çdo fshatar shndërrohet në transferues fushash të parëzistueshme akustike, secili subjekt ndihet të rrezitet ndër diellin e Apollonit, ngrohet me energjinë e atij Zoti të dritës, shërimit, pastërtisë, artit suprem. Ai zë që lëkund me forcë çdo atom del nga po ai konstrukt që askush nuk donë as ta parafytyrojë. As e ëma e tij.

“Mami”, lut Eriku të ëmën si në zor duke shtrirë duart mbi tavolinë, “Mami, për ditëlindje dua dy puthje!”

O tmerr! Madelaine ia plas vajit. Sillet si e përdhosur nëpër dhomë; i acarohet fytyra: “Kurrë, kurrë në jetë nuk duhet ta kërkosh një gjë të tillë. Kurrë më”

“Pse, pse qan”, pyet pesëvjeçari naiv. Po ai djalosh që tashmë ka një profesor privat arkitekture, është gjeni në

muzikë, magji, teologji dhe shkenca të tjera nuk e kupton një gjë aq të thjeshtë, nuk ia kap dot truri pse të jetë paputhshëm! I paprekshëm edhe për atë që e ka lindur.

Ik tërbueshëm. Mbyllet në dhomë. Jo gjatë. Pas disa minutave del në majë të shkallëve. Pa maskën që e bart që nga ditët e para të jetës së tij.

Madelaine: “Ik në dhomë”.

Eriku: “Nuk e vë më maskën, kam dhimbje në fytyrë”.

Madelaine: “Ikë në dhomë dhe mos dil kurrë më pa maskë jashtë. Kurrë”.

Eriku: “Pse?”

Ja pse. Për herë të parë Eriku sheh veten në pasqyrë, të cilën e bën copë përtokë.

Dikur natën, atëherë kur sundon errësira totale Eriku vjedhurazi i hyn në dhomë së ëmës: “Mami pse munden pasqyrat të bëjnë magji. Nga erdhi ai përbindëshi aty. Nuk fle dot se ai më del vazhdimisht parasysht. Kam frikë mami”.

Eriku ende nuk e kupton se në pasqyrë ishte vetë ai, fytyra e tij e shëmtuar.

#### IV.

Si ka mundësi që nga një shëmtirë e tillë të burojë ai zë, ajo muzikë gjeniale? Muzikologët dhe filozofët në refren do na thonë se “Tragjedia lind nga fryma e muzikës” (Nietzsche) ose se “Muzika është një fushë demoniake” siç na ligjëron gjatë gjithë lekturës “Doktor Fausti” i Thomas Mann-it të inspiruar nga purokrishteri Kierkegaard. Edhe gjenet mund të thirren në asistencë për ta dekoduar dramën: kompetencën muzikale Eriku e fiton qysh atje, në hapësirën paranatale. A nuk muzikonte tërë kohën Madelaine, ajo që me çdo kusht donte të bëhej Priamdonna e operës së Parisit? Qysh të re fare i ati i saj, arkitekti i madh

i Rouenit e trajtonte si princeshën e pakontestueshme të operave mondane. Arkitekti i madh i ati i Madelaine-s? Po. A nuk është Eriku gjeni edhe në arkitekturë saqë çmend edhe profesorët më me nam të Parisit? Po Vdekja, ajo të cilën Madelaine, prifti Mansart, Maria, mamia dhe gjithë të tjerët e shihnin në fytyrën e Erikut, nga erdhi ajo?

Edhe me të Eriku përballet qysh në sferën paranatale: Prindit e Madelaine vdesin nga kolera dhe burri i saj, Charles, po ashtu derisa kjo ishte shtatzënë. E dukshme kristalshëm linja rreth temave dhe kahut se drejt cilës finale ec rrëfimi, çelësin e të cilit do ta gjejmë në fund, atje në katakombet e mistershme të operës Garnier prej ku Fantomi do ta drejtojë botën e artit.

Natën Eriku azilon pyjeve të Borsheville-t. Pranë vetes gjithmonë ka Sally-n, qenin, specien e vetme që nuk e kthen kokën prapa kur ai heq maskën. Një grup fshatarësh të tërbuar e kërkojnë dhe gjejnë në pyll. Në zënkë, të egërsuarit primitivë të fshatit ia vrasin qenin.

Që kur prifti Mansart i thotë: “Sally nuk do të jetë në qiell ngase kafshët nuk kanë shpirt”, për Erikun vdes Zoti. I tërbuar nga ky “fakt” demolon çdo gjë dhe ikën nga shtëpia sapo merr vesh se dashnori i së ëmës do ta mbyllë në një internat. Rrugëve kapet nga një grup ciganësh, të cilët e mbyllin në kafaz dhe e ekspozojnë ngado si përbindësh. Spektatorët e gjuajnë me gurrë, gjësende, njësoj si abrahamitët gjatë përpjekjes për ta vvarë djallin. Edhe nga kafazi vazhdon të mësojë gjithçka të mundshme, çdo trik, hipnozën, magjinë. Po nga kafazi lind edhe vrasësi: Një natë kur shefi i bandës së ciganëve Javert do ta dhunojë seksualisht ky e mbyt, e vret, e vdes sa ora. Që këtej vrasjet do të shpeshohen. Nga njëra anë pasi çuditërisht e ndien veten sikur të mbushet me një jetë plus kur vret dhe nga ana

tjetër ngase shpesh kufomat do të jenë rruga e vetme e mbijetesës së tij.

Ikën nga ciganët dhe përfundon në Itali. Atje angazhohet nga gurëpunuesi (si Charles, i ati) Giovanni dhe pas një kohe të shkurtër shkëlqen si kryemjeshër i rajonit.

E s'ka si të jetë ndryshe: sa më shumë që rritet fantomi me maskë aq më tepër i afrohet dashurisë. Luciana, e bija e mjeshtrit Giovanni është marrëzisht e dashuruar në të, respektivisht në duart dhe zërin e tij. E lut ta heqë maskën. Tragjedia e paraprogramuar: kur ajo sheh fytyrën e Erikut bie nga ballkoni, vdes. Njësoj si nga Borsheville ikën Eriku, kësaj radhe drejt orientit: atje në Persi, angazhohet si magjistër dhe ekspozues në oborrin e perandorit, të cilit ia ndërton në fund një pallat me dyer të fshehta, dhoma torturimi dhe lloj-lloj hapësirash perverse. Është Daroga nga Manzenderan (një këshilltar i Shahut, më vonë brenda rrefimit i njohur si Persiani) që ia shpëton jetën, ky e njofton se Shahu është duke vrarë çdo njeri që ka punuar në ndërtimin e pallatit. Kthehet në Europë për ta shkatërruar shtëpinë e lindjes. Nuk e bën nga respekti ndaj së ëmës që ndërkohë, tri ditë para ardhjes së tij, paska vdekur.

Rastësisht zbulon një konkurs për ndërtimin e operës së Parisit. Vendos ta bëjë atë kushtuar së ëmës së tij.

## V.

Si të vepronte ndryshe një qenie përjetësisht e refuzuar? Kjo dilemë është vetë historia e etikës. Patjetër edhe estetikës: kush edukoi qenien humane t'i përcaktojë vetes parime, kritere se ç'duhet konsideruar të bukur, çka të shëmtuar, të pështirë, se cila fytyrë duhet të vuloset blasfemia vetë e cila

të dashurohet si ajo e engjëllit sykaltër siç e vizatonin italianët e renesancës së tyre? Si reagohet sot karshi fytyrëkufomave institucioneve për të handikapuar? Si reagohet sot ndaj gjithë atyre ndryshe, tjerëve që nuk duken patjetër si Rita Ora, Heidi Klum ose Yurena Rodrigez? Jo ndoshta me atë intensitet përjashtimi si në shekullin e 19, por ekskluzioni vazhdon dhe në esencë nuk dallon as në postmodernë. Këto tema e dilema të njëjta i nxit që nga vitet e njëzeta të shekullit të kaluar e deri sot sa herë që të dalë në skenë fantomi i operës.

Personazhi i “Fantomit të Operës” jeton zhurmshëm edhe sot e për mot, duke shkaktuar tërmete gjithandej kulturosferave, gjuhëve e shoqërive, për arsye se është përherë aktiv, prek nervin jo vetëm të arteve, por edhe të çdo sfare tjetër humane.

## VI.

Cili mund të ishte ilaçi për shërimin e një përbindëshi, vrasësi? Sipas versionit rrëfyes të Gaston Leroux – i cili për dallim nga Kay, rrëfen vetëm historinë e gjashtë muajve të fundit të fantomit – Eriku arrin të intrigojë me kërcënime mega-arkitektin Garnier që ai ta ndërtojë operën sipas udhëzimeve të tij. Ndërtohet opera, pjesa e dukshme e së cilës nuk do ta bëjë historinë, por katet e saja nëndhese, atje ku do të jetojë fantomi dhe prej ku do t'i dirigjojë drejtorët e shumtë, të cilët i instalon dhe heq sipas tekave të tij. Dhe një ditë, gjatë një shfaqjeje, nga lozha e rezervuar enkas për “vdekjen e kuqe“, fantomin, Eriku sheh se një 21-vjeçare e bukur kërcen aq lehtë, aq bukur mbi dysheme, ajo balerina Christine Daaé ia turbullon botën, ia fut frikën brenda vetes të jetë domiciluar ndonjë vullkan që mezi pret të plasë. Pasi

ikën e shtrihet në dhomën-katakomb të tij ndien një proces të trupit të tij që gjithë jetën e ka luftuar: njerëzimin, humanizmin, rrahjen e zemrës, dashurimin në dikë, diçka. Kërcen i tmerruar: Kurrë Luacianë më! Eh sikur të ishte vërtet aq i gjithëpushtetshëm siç besonte. Përballë dy monarkive, edhe në kulmin e tërbimit ai dështoi gjithmonë: karshi artit dhe dashurisë edhe fantomi i trajnuar me gjitha të këqijat edhe mjeshtëritë dorëzohej si një kalama që ia fut vajit. Si ta pushtojë Christinën se? Me zërin e tij natyrisht. Muzika, a nuk thanë se është ajo sfera demoniake që hipnotizon? Kështu edhe ndodh Christine Daaë çmendet pas vox mirabilisi që vjen nga nëntoka e operës. Ajo dikur edhe arrin të dashurohet në Erikun.

Romanca e tjetëron fantomin. Susan Kay e rrëfen njerëzimin e tij deri në finale; deri në vdekjen nga zemra e thyer, kur Christine megjithatë vendos të vazhdojë me të fejuarin e saj e jo me maskën e nëntokës së operës Garnier të Parisit.

## VII.

*Rekapitullim:* Eriku lind me një fytyrë të shëmtuar. Ai refuzohet, përjashtohet, paragjykohet, ndëshkohet për pamjen e tij. I ikën botës. Kriminalizohet deri në atë shkallë sa që vret duke ndier kënaqësi. Paralelisht ndërton si gjeni i arkitekturës pallate, pajiset me dije e njohje nga të gjitha shkencat e mundshme, vret me dashuri dhe vritet nga dashuria. I pastër, i fuqishëm dhe e vetmja urë që e mban gjallë me shpresën se megjithatë do ta gjejë një shpëtim në këtë botë është zëri i tij, tonarti, muzika, të cilën e ka të lindur, nëpërmjet së cilit detyron botën ta përjetojë tundueshëm edhe kur bota këmbë e kokë tenton ta shporë qenien e tij. Ky është çelësi që bën të amshueshëm

personazhin e fantomit të operës, Erikut: Arti nëpërmjet vetëm të të cilit mund të shkelet altarëve të dashurisë ndërhumane, tolerancës, respektimit të tjetrit pavarësisht ngjyrës, racës, kulturës që ai sjell me vete. Personazhi i fantomit të operës është fascinimi më i fortë i historisë së arteve për shkak se me një biografi të vetme rrëfen gjithë historinë kulturore, antropologjike, etike të humanitetit. Ai është akumulatori i rënieve dhe ngritjeve të kulturës së humanitetit. Është pasqyra e historisë së humanitetit; ajo pasqyrë ku politikat, shtetet, historitë përballen me fytyrën e tyre të shëmtuar, të bukur, gjeniale, kriminele ose triumfuese. Prandaj sa herë del ai në skenë nxit botën të ridiskutojë vlerat e saja.

Pjesa e dytë  
LIBRA



## IRVIN DAVID YALOM

*«When Nietzsche Wept»*

Vjeshhtë në Venedik. Një turmë pëllumbash merr hov tërbueshëm nga Palazzo Agnusdio o dei quattro Evangelisti drejt Canal Grande-s. Turistë vërdallen gjithandej hutueshëm, sikur të kërkojnë – po si ata perëndimorët lumenjve indianë të Amerikës së mëvonshme – ndonjë copë ar ose një hektar dhé për jetë e për varr. I pa përllarë nga magjia e relikteve etruske, bizantine e napoleonike të Venedikut, turisti austriak Josef Breuer, ri kokulur në tarracën e Café Sorrento-s dhe lexon për të satën herë një copë letër të çuditshme, që mban firmën e një gruaje të panjohur me emrin Lou-Andreas Salomé. Është ndoshta zëri kumbues i perfektit të Venedikut Dante Di Serego Alighieri, shkaku – i cili me pompozitet teatralik prezanton vaporët e parë të motorizuar – që zgjon austriakun për të çuar kokën, për të zgurdulluar sytë dhe për t'u përballur me bukurinë eksituese të një dame që i ri gatitu para tavolinës. Lou Andreas Salomé, i thotë ajo me zë triumfal, dhe i zgjat dorën. Josef Breuer humb fuqinë, ul kokën dhe stërlexon edhe njëherë letrën e saj: «Duhet të bisedojmë për një çështje shumë të rëndësishme. Ardhmëria e filozofisë gjermane gjendet në rrezik (...)». Sapo merr guximin ta çojë

kokën Josef Breuer, Lou ia shtrinë në tavolinë edhe një letër tjetër; atë të Richard Wagner-it drejtuar mikut të tij Friedrich Nietzsche.

## 1. PËRKTHIMET DHE KRITIKA

Emeritusi, shkrimtari dhe psikanalitik i njohur amerikan Irvin David Yalom është autori i romanit «When Nietzsche Wept» (Kur Nietzsche qau, në versionin gjermanisht është «Dhe Nietzsche qau»), roman i cili që nga dita e daljes e deri sot popullon vitrinat e librarive të perëndimit me të njëjtin intensitet shitjeje si ditëve të para të botimit. Libri tashmë është botuar në shumë gjuhë. Ai është përkthyer dhe botuar edhe në gjuhën shqipe nga Shtëpia Botuese «Morava» (Kur qau Niçja, 2008). Dhe si shumica e përkthimeve letrare në gjuhën shqipe edhe ky ta shpif leximin.

Po u bazuam në përhapjen dhe përshtypjen e lexuesve të tij dhe në arsyetimin e çmimit për novelën më të mirë nga Commonwealth California, Romani tashmë ka fituar statutin e romanit klasik të shekullit 20-të. Ndërsa kritikët janë më me rezervë në këtë drejtim. Los Angeles Times sikur me zor tha se «Yalom është një rrëfyes i talentuar (kupto: ka dhuntinë) historish». Kritika në hapësirën gjermanofone- si zakonisht – e lavdëroi me qëllimin për të thënë se megjithatë nuk kemi të bëjmë me ndonjë nobelist të ardhshëm. Frankofonët si ashtu-ashtu vuajnë nga klisheja se amerikanët s’dinë të bëjnë letërsi të njëmendte. Kritikët italianë u eksituan edhe më keq se Josef Breuer kur pa Lou Salomé-në, duke u përpjekur të potencojnë se gjithçka kulturore me përmasa universale nis nga Venediku apo Firenze. Ndërsa austriakët, respektivisht vjenezët e nderuar deri në palcë me librin e Yalomit (i cili i organizon

Nietzsches qëndrim në njërin nga sanatoriumet e qendrës austro-hungareze) shtypën 100 mijë kopje të romanit, i shpërndanë falas dhe ftuan Irvin D. Yalom në një turne leximi. Kritikët që konsiderohen (bashke me ata që shtyren si të tillë) si elita e gjykimit kompetent të letërsisë nuk shohin ndonjë arsye që t'i «bashkohen spektaklit», siç tha njëri nga gurutë e kritikës gjermanofone.

## Përshkrimi II.

Nga Venediku mediteranesk në Vjenën ku moderna bashkë me «klasën punëtore» përpiqen me lugëdruri t'i copëtojnë blloqet gjigante të akullit që i ka shkaktuar dimri i gjatë evropian. Mu atë moment kur përmes akullit depërton një rreze e ngrohtë, shfaqet pacienti më i çuditshëm i mjekut dhe psikologut të famshëm vjenez Dr. Josef Breuer. Friedrich Nietzsche mbërrin në Vjenë. Intriga e Lou Andreas Salomé-s arrin fazën e ekzekutimit konkret. «Prej këtij varret ekzistenca e filozofisë gjermane?», pyet veten sapo sheh mjeku Nietzsche-n t'ia shkel pragun. Me të drejtë. Më shumë se sa një filozof i së ardhmes Nietzsche le përshtypjen të jetë Enkidu, ajo qenia gjysmë shtazë e gjysmë njeri, të cilën arrin ta humanizojë Gilgameshi katër mijë vjet më parë. Breuer nuk është i sinqertë. Nuk e bën transparent faktin se në sirtar ka një libër të filozofit Nietzsche. E Nietzsche as që pret që një mjek vjenez që jeton në epokën dhe kohën e qëlluar, ta kuptojë botën e një filozofi të lindur në kohë të gabuar dhe që për fatum ka sakrifikimin, vuajtjen dhe privimin total nga çdo kënaqësi individuale. Mu për këtë dështon strategjia e mikut të ngushtë të mjekut të ri Sigmund Freud.

Kur Breuer kërkon nga filozofi, i cili herë pas herë nxjerr krehrin nga xhepi për të rregulluar mustaqet e çartura, se ç

'roli luan Dëshpërimi në gjendjen e tij shëndetësore, pra ai gjykimi pesimisti ndaj të qenurit (ekzistencës) të tij në një botë ku ai tepër herët, ndoshta aksidentalisht ka ateruar, ai, Nietzsche fikson sytë drejt stomakut të vet dhe i shpjegon mjekut punën e «Dëshpërimit me Qenien në një Botë që nuk e meriton atë».

«Dëshpërim? Jo. Ndoshta njëherë, ama jo më shumë. Sëmundja ime është pjesë e fizikut tim, mirëpo ajo nuk është Unë. Unë jam sëmundja ime, unë jam trupi im, mirëpo që të dyja këto nuk janë Unë. Që të dyja duhet kapërcyer, mbijetuar, nëse jo fizikisht, atëherë metafizikisht (...) dhe sa i përket kuptimit të të Qenurit këtu, ekzistencës sime, po unë e njohë psenë e Ekzistencës time (...).» (Fq. 122-123)

Nëse jo për më shumë, për dhjetë vjet Nietzsche ka arsye dhe motive të jetojë, të triumfojë mbi çdo barrikadë që ia përgatit trupi i tij. Ai duhet të shkruajë, të shkruajë libra, thotë duke rrahur me dorë mbi çantën e rrasur plotë libra e manuskripte, që i bartë me vete. «Aha, dhimbjet...», vazhdon ai «ato i përrjetoj si dhimbje shtatzënie...», për shkak të peshës së mendimeve të tij, truri duhet të vuajë, para se të lind ideja gjigante e radhës. Kështu e ka Mbinjeriu!

## 2. HISTORIA E PSIKANALIZËS

Irvin Yalom përpiqet që nëpërmjet ridhënies së teorive dhe korrespondencës filozofike Nietzsche-ane të skicojë sa më thjeshtë epiqendrën e botëkuptimit filozofik të tij: Vetinë kryesore të njeriut të nesërm, mbinjeriut, siç e shpreson Nietzsche. Yalom suksesshëm rivitrinizon nëpërmjet narratives tezën, e cila ngulë këmbë se pa nihilizmin (jo vetëm të asaj puro-nietzscheane) s'ka katarsis

final e pa këtë të fundit nuk synohet dot harmonia totale individuale e kolektive. Pra nuk ka shpresë për shërim nga defektet e shumta humane.

Skenat që i sajoi autori – dialogu Nietzsche-Breuer-Freud- janë kundërvëniet e hapur ndaj tezave historike, por edhe ndaj logjikës dhe sistemit shkencor terapik që sundon ordinancat dhe institutet e psikanalizës. Burimi i metodës, sipas Yalom, nuk janë Breuer dhe Freud (shërimet nëpërmjet dialogut - Redekur), por pikërisht nihilizmi nietzschean. Irvin Yalom futë në skenë një aftësi sukseshme metanojë, që përdor psikanaliza si kusht shërimi, pra atë procesin e pendimit dhe mohimit (etik) të veseve, të përjetimeve, dramave për të dalë përtej Unit të paraformuar. Shërimi nis me kërkimin e vlerave të reja (cilave?), dhe sikur bërtet; a nuk ishte Nietzsche ai që mbinjeriun (të shëndoshin në këtë kontekst) e shihte vetëm pas zhvlerësimit të të gjitha vlerave. Këtë formulë që Nietzsche e trajtoi si metodë për shërimin e humanitetit, Irvin Yalom e sheh edhe si metodë për shërimin e individualitetit.

Me këtë psikiatri famoz amerikan ia ngul thikën pas shpine atit të Psikanalizës Sigmund Freud. Ky jo njëherë, në shkrimet e tij, përpiqet të mohojë inspirimin nga Nietzsche:

«Schopenhauerin e kam lexuar shumë vonë. Nietzchen, atë filozofin tjetër, botëkuptimet e të cilit janë aq identike me rezultatet e mundimshme të Psikanalizës e kam anashkaluar qëllimisht, sepse për prioritet (gjatë hulumtimeve) kisha mosdikimin» (Freud në librin «Selbstdarstellung [Autoportret], 1925, XIV/86).

Studimet në këtë vijë thonë megjithatë diçka tjetër. Të njëjtën gjë e potencon edhe autori gjerman Klaus Lickint, i cili në librin «Arti nietzschean i psikanalizës» (Würzburg,

2000) mbështet Irvin Yalom-in, edhe pse po si Freud-i nuk bën transparent faktin se projektin e studimit e ka huazuar nga romani «When Nietzsche Wept» të psikiatrit amerikan. Pasojë historike e egocentrizmit të autorit.

### Përshkrimi III

Josef Breuer nuk ia del të bind Nietzschen që t'i nënshtrohet terapisë në njërin nga sanatoriumet e Vjenës. Koha e një filozofi që përlehet vazhdimisht me perënditë greke të kenë pjellë tragjedinë nga shpirti i muzikës nuk harxhohet dot për kontemplacione egoiste, ajo i është rezervuar misionit të madh, atij të shpëtimit të njerëzimit nga rruga e vetzhebërjes. Jo, Nietzsche çohet rrufeshëm nga kanapëja, falënderohet dhe braktis ordinancën e Breuerit trupshantur dhe të zhgënjyer. Zarathustra mezi pret dhe...

Ca ditë më vonë, në ora pesë të mëngjesit, kërcëllon dera e Breuer-it nga grushtet e njëfarë zotëriu me emrin Schlegel. Doktorin kur sheh kartëvizitën e profesor Nietzsches dhe emrin e vetë në pjesën e mbrapme nuk vonon dhe ngjitet në pajtonin e pronarit të bujtinës. Schlegel ia nis rrëfimit sikur të jetë duke lexuar ndonjë protokoll policor: pas disa ditëve, kur nuk dëgjon më rënkimet, ofshamat e mysafirit vendos ta hapë derën më dhunë dhe gjen Nietzsche –n të shtrirë mbi dyshekun e bërë lloç, gjysmë të vdekur, gjithandej të vjellura, gjak, pështyma. Breuer bëhet sikur dëgjon me vëmendjen më të madhe. Shtrëngon buzët. Fërkon duart. I thirr grahësit të pajtonit: jepi, jepi më shpejtë. Doktorin ka frikë. Pse? A nuk ia ofroi Breuer të gjitha. Pse të «kem frikë për jetën e tij» flet me veten Breuer. Nuk e din pse, ama Breuer ka frikë, djersitet, merr frymë thellë, sa që Schlegel fillon të besojë se është edhe më mjeshtrë rrëfimi se sa ata tregimtarët e

orientit që me ditë dërdëllisin episodet e njëmijë e një netëve të Sheherezadës.

Ja në një skaj të qelisë së errët, pranë një kove me ujë, me gojë të hapur dhe vetëm në nëntesha ri shtrirë «shpëtimtari i filozofisë gjermane», siç e kishte quajtur Lou Andreas Salomé Nietzsche-n në letrën e saj. Breuer lut Schlegel-in të mbledh lekat dhe të pastrojë. Para se të gjunjëzohet kërkon nga pronari bujtinës ta lë vetë me profesorin, pacientin e tij. Kujdesshëm ia fërkon ballin, kokën. I jep nitroglicerinë. Ngadalë hap njërin sy gjysmëkofoma. Flet diçka. Breuer nuk kupton. Ia ngjet veshin tek buzët. «Më ndihmo!». Breuer gati sa nuk alivanoset. Nuk iu beson veshëve. Edhe njëherë ia lëshon veshin pranë buzëve. E vërtetë. Nietzsche i lutet doktorit të tij për ndihmë. E pabesueshme!

### 3. FILMI

Këto skena i paraqet në mënyrë të mrekullueshme regjisori Pinchas Perry në filmin me të njëjtin titull si romani i Irvin Yalom (SHBA, 2007. I parë në versionin DVD). Aktorët Armand Assante (Nietzsche), Ben Cross (Josef Breuer) dhe Katheryn Winick (Lou Salomé) japin maksimalen dhe arrijnë të krijojnë sekuenca «autentike» të stories. Të tjerët mbeten në hije. Ashtu siç janë «hije» edhe personazhet tjerë në romanin e Yalom. Me gjithë mjeshtërinë e aktorëve filmi nuk arrin që nëpërmjet dialogëve të ekzekutojë atë që dëshiron Irvin Yalom dhe atë çka në të vërtetë përbën botën shumëdimensionale të filozofisë nietzsche-ane. Natyrisht që një përpjekje e tillë do të ishte e pamundur, mirëpo patjetër se nga një film 105 minutash mund të pritej edhe më shumë, sidomos duke reduktuar sekuencat tepër të gjata që përqendrohen madje

edhe në objekte statike e jo gjithaq relevante për rrëfimin si të tillë. Në vend të këtyre vakumeve, po të jepeshin dialogët e librit më komplet, ndoshta nuk do të dilnin disa nga pasazhet aq të pakuptimta, qoftë në aspektin kontekstual e qoftë në lidhje me idenë e romanit. Megjithatë filmi arrin të hap një dritare interesante në botën e një shekulli me aq figura dhe histori interesante.

#### Përshkrimi IV

Në kapitujt e fundit, pas kollabimit të Nietzsche-s në bujtinën me infrastrukturë burgu, rrota e rrëfimit ndërron drejtimin. Josef Breuer mendon ta ketë gjetur idenë se si do të shpëtojë pacientin e tij. Në takimin e radhës ai ndërron rolet dhe e lutë Nietzsche-n që ta shpëtojë atë nga Dëshpërimi i tij. Mjeku i famshëm Josef Breuer qëmoti nuk e sheh më diellin. Shikimin ia zënë dy gjinjtë majemprehura të pacientes së tij Anna O. (Bertha Pappenheim). Trupi i saj është gjithçka që mund të shohë, të ëndërroje, pa ftuar bukurinë e saj para syve ai nuk mund të préhet, të gjejë çastet e kënaqësisë. Po ky trup që Josef Breuer-in e ka bërë të mos e ndiejë veten mirë pranë gruas së tij Mathilde, pranë miqve të tij, pranë botës që e rrethon, është shkaku që Breuer ka filluar ta dëshirojë, ta lusë vdekjen që ta shpëtojë nga melankolia, nga monotonia e çdo mëngjesi, saherë që bindet se edhe atë ditë Anna O. Nuk do t'i shtrihet, ashtu gjysmë e zhveshur në kanapënë e tij të lëkurtë. Nietzsche pranon dhe fillojnë dialogët. Sa më thellë që zhytet Breuer në obsesionin e tij aq më shumë deblokohet shpirti i filozofit, i cili gjen paralele me obsesionin e vetë që ka ndaj Lou Andreas Salomé-së, e cila dy-tre herë refuzon të martohet me të. Pas disa ditësh në klinikën Lauzon, Nietzsche braktis dhomën numër 13 për ta bërë një shëtitje



me pacientin e tij Josef Breuer. Duke reflektuar mbi ngjyrën e gjetheve në shpërbërje e sipër mbërrinjë dy miqtë pranë varrit të nënës së Josefit. Nietzsche tmerrohet kur sheh se emri i së ëmës së tij ka emrin Bertha dhe gëzueshëm komunikon të ketë gjetur çelësin, të ketë gjetur zgjidhjen e problemit të obsesionit të tij ndaj pacientes Bertha Pappenheim (kujtoni Libidonë e famshme të Sigmund Freudit). Josef i irrituar nuk flenë dot, pas ndarjes nga Nietzsche-ja. Dhe atëherë kur e zë gjumi nuk e di se flenë. Ai vendos të ndahet nga e shoqja e tij Mathilde, të braktis fëmijët, famën, profesionin dhe ta nis një jetë tjetër. I hip trenit dhe shkon në klinikën ku gjendet dashnorja e tij Bertha. Para se të hyjë në korridorin e klinikës sheh se si një mjek i ri, më i bukur se Josef mbahet shtrëngueshëm për dore dhe përkëdhelet nga Bertha e tij. «Kishte Nietzsche të drejtë kur thoshte se ajo më ka shfrytëzuar për të mbijetuar paranojat e saja»? Atë moment zgjohet Josef Breuer dhe endet gjithandej për tu bindur se vetëm një ëndërr kishte qenë dhe asgjë tjetër. Vrapueshëm marrin te Nietzsche. «U shërova!» i lajmëron triumfueshëm. Tjetri nuk fesh habinë e madhe. Si doli kaq shpejtë ky nga zona e ashpër e vuajtjeve, e fiksimeve. Ende pa përgëzuar mikun, Josef-i ia përplas në ajër pyetjen djegëse: «Dhe ti Friedrich a ke harruar mete vërtete ndonjëherë Lou Salomé-në?» Kur Nietzsche pyet se si mendon ai me Lou-në, psikologu vjenez ia radhit gjitha ato që di në lidhje me «lidhjen e treshes» ku bën pjesë edhe ish miku i tij Paul Rée. Pas ca tiradave kundër qenies së femrës si subjekt labil, të padenjë për të qenë trashëguese e filozofit të madh, fillojnë burri t'i bien nga trupi mburojat e hekurta. Rrëfyeshëm fillon të zhduket agresiviteti nga zëri i tij. Heq syzet, mbulon fytyrën me duar dhe... Breuer nuk iu beson syve. Nietzsche qanë. Breuer i jep guxim «qaj miku im, qaj. Po të kishin gojë lotët

e tu çka do të më thonin ato», e pyet kujdesshëm miku Josef Breuer. Çka do të flitnin lotët? «Përfundimisht i lirë», thotë duke u përpjekur të fshijë lotët dhe «gjithë këto vite i burgosur në vete. Tash ndiej një fuqi aq të pushtetshme. Ç'çast i shenj të». Nietzsche vazhdon të qajë dhe të pastrojë shpirtin nga dhimbjet, nga plagët që e kanë bërë aq të mbyllur, aq ujk stepash, aq idiot e aq gjeni ndaj jetës dhe aq makiavelist ndaj ndjenjave të veta.

#### 4. REALITETI NË SHËRBIM TË PSEUDOFIKTIVES

Ngjarja kështu nuk ka ndodhur kurrë në realitet. Nietzsche nuk ka takuar kurrë Josef Breuer-in. E natyrshme do të thoshte lexuesi; roman është pra! Këtu qëndron edhe problemi. Se në roman gati vetëm ky relacion nuk është historikisht real. Përmbajtja e dialogëve janë filozofia e vërtetë e Nietzsches. Korrespondencat e tij gjithashtu. Roli historik i Josef Breuerit, Freudit dhe Nietzsches në inicimin e Psikanalizës janë poashtu objekt e shkencës historike mbi filozofinë dhe psikanalizën. Nietzsche vërtet ka qenë marrëzisht i dashuruar në shkrimtaren dhe Psikanalizën e vonshme Lou Andreas Salomé dhe i ka bërë ofertën e martesës, gjatë përpjekjes së këtyre dyve bashkë me Paul Rée-në të krijojnë një banesë të përbashkët ku do të filozofonin dhe jetonin që të tre bashkë. Një ide e Lou Andreas Salomé-së për të kopjuar sallonet ruse, italiane e franceze. Bertha Pappenheim, në të cilën Breuer për herë të parë e përdor teknikën e «Redekur» (shërimit të histerisë nëpërmjet bashkëbisedës»), ka qenë vërtetë pacientja e tij, mbi të cilin rast Freud dhe Breuer publikojnë bashkë një studim.

Lexuesi më kot do t'i kërkojë «pëllumbat, reliktet etruske, zërin kumbues të Alighierit me vaporët e tij të motorizuar, turistët ekspandues, Enkidunë bashkë me Gilgameshin, akullin e Vjenës, Nietzschen në pozën e ujkut të stepave» dhe shumë imazhe që përbëjnë këtë ese. Ato janë mvëshje të autorit të kësaj eseje. Prozës i mungojnë kriteret e saja themelore; rrëfimi nuk është estetik, por protokollar, mungojnë perspektivat interpersonale (ndërmjet personazheve), intime. Romani nuk plotëson as kushtet minimale të atij Setting-ut (përshkrimi subjektiv i vendit, kohës, rrethanave sociale) të nevojshëm artistik. Prandaj Irvin D. Yalom do të kishte bërë punë tejet korrekte nëse pasthënien në fund të librit (sqarimin se çka është reale e çka fiktive) do ta botonte si parathënie.

## 5. KRITIKA

Evidente është se në shumicën e veprës letrare të Yalom-it vërehet tendenca e reduksionit maksimal të estetikës. Shumë pak duhet hequr nga romani për ta kategorizuar atë si libër faktik, si doracak hyrës në historinë e lindjes së Psikanalizës dhe Jetës e Veprës së Friedrich Nietzsche-s. Pse e bën Irvin Yalom këtë?

Po spekulojmë. Krijohet përshtypja sikur Irvin Yalom bën letërsi për shkaqe të ekonomisë së kohës dhe intelektit të tij. Domethënë atë që e sheh se është shumë komplekse dhe kërkon më shumë se sa një jetë studimi përpiqet ta përmbledh lirshëm brenda kapakëve të një «romani». Dhe logjike që me gjithë përpjekjen e madhe të autorit që t'i japë vendin e meritueshëm fiksionit, faktet historike me lapidaritet kanë primatin.

Megjithëkëto libri ia vlen të lexohet. Siç është thënë libri i ofron lexuesit një hyrje fare të lehtë në filozofinë e

rëndë Nietzsche-ane, i jep njohuri mbi kushtet relacionale ndërmjet disa personave historibërës e epokalë. Dhe parasëgjithash lexuesi mëson për debatin rreth zanafillës së Psikanalizës si teori e më vonë si disipline shkencore. Pikërisht këtu duhet kërkuar edhe suksesin komercial të shumë romaneve historikë të dekadave të fundit.

Gjermanët këtë lloj letërsie e quajnë shumë bukur «Unterhaltungsliteratur» (literaturë e shkruar për konsum të shpejtë). (2012)

#### *\*Biografia*

*Irvin David Yalom është i lindur më 1931 në Washington DC. Është profesor i emeritus për Psikiatri në Universitetin e Standfordit. Yalom konsiderohet si përfaqësuesi (i gjallë) kryesor i psikoterapisë ekzistenciale. Në vitin 2009 fitoi çmimin ndërkombëtar «Sigmund Freud» për psikoterapi. Më shumë se për veprat e tij letrare ai është si autor i studimeve të ndryshme mbi psikanalizën.*

#### *Shënim*

*\*Për këtë ese është përdorur versioni gjermanisht: Yalom, D. Irvin: Und Nietzsche weinte, Random House, München 2009, ai shqip nga Shtëpia Botuese Morava «Kur qau Niçja» 2008 dhe ai anglisht: «When Nietzsche Wept», BasicBooks, New York, 1992 si dhe filmi «When Nietzsche Wept», versioni DVD, IMDB.*

## PETER ACROYD\*.

*Testamenti i fundit i Oscar Wilde, 1983*

Ditari (fiktiv) që tronditi skenën letrare angleze ose shkrimtari që edhe mbi një shekull pas vdekjes nuk e le të qetë ndërgjegjen angleze.

Për shkrimtarin, frika ndaj vdekjes është shumë më e vogël se sa frika e ndarjes nga bota pa thënë gjithçka që qarkullon në shpirtin e tij të paqetë. Një frikë absurde kur kihet parasyshë se shkrimtari kurrë nuk ndalet së torrturuari shpirtin dhe mendjen e kohëve, madje as pas vdekjes së tij.

Ai ngjallet sërish në trupin e dikujt tjetër për të vazhduar shkrimin e tij të pafundtë për universin e artit. Një dëshmi për këtë teori është “Testamenti i fundit i Oscar Wilde” që i literatit dhe kritikut letrar Peter Acroyd.

## HIOBI I LETËRSISË

Paris 9 gusht 1900. I kërrusur mbi një tavolinë antike që mezi po e mbajnë këmbët, në njërën nga dhomat më të lira të hotelit d’Alasce fillon Oscar Wilde ditarin e tij. “Unë nuk kam të kaluar. Triumfet e mia të dikurshme nuk kanë asnjë rëndësi. Vepra ime është e harruar...Unë jam Salomoni dhe Hiobi, më fatlumi në mesin e të vdekshmive

të pafatë”. Njeriu që deri paradokohësh ecte si një dandi nëpër salonet e prominencës londineze dhe mendonte se me veprat e tij do të pushtojë botën, do të ndryshojë kahjen e mendimit mondan dhe do të bëhet ikona e përjetshme e teatrit botëror tashmë është një njeri i thyer, larg atdheut, hiçgjë më shumë se sa një poet i djegur dhe i harruar. Dhe ky njeri nuk është askush tjetër përveçse se autori i “*The picture of Dorian Gray*” (Piktura e Dorian Greit), i “Tragjedisë florentinase”, i “Vera ose nihilistët”, “Salomé”-së e të ngjajshme. Pra Oscar Wilde i njohur sa për famën e tij si poet, prozator, eseist e dramtaurg aq famoz edhe për jetën e tij të çuditshme dhe jashtë konditave etike të kohës në të cilën jetonte (1864 – 1900).

## DITËT E FUNDIT TË JETËS

Në kulmin e famës së tij Wilde dënohet me burg për shkak të homoseksualizmit të tij, respektivisht lidhjes intime me një djalosh me merin Bosie, siç e quan ai në letrën e dërguar nga burgu (H.M.Prison) që mban titullin “De profundis” dhe që kosniderohet si njëra nga esete më të bukura biografike të letërsisë angleze. Që nga ai moment të gjitha teatrot e Londrës heqin nga skena veprat e tij, librarët i fshehin veprat e tij për të mos u komprometuar para klientëve, ndërkaq kolegët e tij festojnë nëpër salone për eliminimin e dandit, manifestim që më shumë ka demonstruar lehtësimin e tyre nga asgjësimi i një konkurrence, së cilës nuk i dilej përpara, se sa diçka tjetër. Dhe vërtet atmosfera e asaj kohe ka qenë e tillë, saqë bashkëkohanikët e tij kanë menduar se Oscar Wilde njëherë e përgjithmonë shporet nga kronikat e të gjitha kohëve. I nënçmuar, përbuzur e i harruar për gjithmonë, i dënuar për të mos shkruar më kurrë ai lëshon Anglinë dhe

pas burgut emigron në Paris, drejt në dhomën e hotelit d'Alasce për të kaluar ditët e fundit të jetës së tij.

## RINGJALLJA

99 vjet pas vdekjes së tij botohet ditari “The last Testament of Oscar Wilde”. Riaktualizohet rëndësia dhe roli i gjenit Wilde në botën e artit letrar e skenik, i cili bashkë me Bernad Shaw (që del si i inspiruari i parë nga Wilde 1864-1950) thejnë monotoninë e krijimit sipas rregullave të kodit të salloneve angleze, kod, të cilit madje edhe vetë Shekspiri i është përlur padenjësisht (historia e veprës mbi Johanën nga Orleansi). Jo, ditari i Wilde nuk ka qenë dokument i fshehur që 99 vjetë më vonë është zbuluar nga studiusit e tij, ai nuk është as një dokument fatkeq e i drynosur në kacafortat e Scotland Yardit për shkak të thënieve fyese të irlandezit Wild ndaj Anglizë dinjitoze, por vërtet është “shkruar nga Wilde i inkarnuar” që sot në botën letrare mban emrin Peter Acroyd\*.

Çdokush që njeh veprën e Oscar Wilde, që njeh gjuhën, stilin, ironinë, shpotinë dhe jetën e tij gjatë leximit të ditarit të shkruar nga Acroyd ndeshet me Wilden e ringjallur.

Acroyd duket se e ka shkruar atë që Wilde ka menduar ta thotë para se të vdes: jetën e tij me gjithë ngritjet dhe përplasjet, si shkrimtar me famë dhe si një qenie e përndjekur madje edhe rrugëve të Parisit nga kolegët e tij.

Acroyd ia plotëson një dëshirë Wilde-t që e ka shprehur në telegramin e dërguar me 18. tetor 1900, dyzet e dy ditë para se të vdesë; “Qe disa ditë nuk kam shkruar më asgjë. Nuk mundëm më as të flej e as të mendoj. Thuhet që brenda katër ditëve duhet të operohem. E kam një abces në vesh, i cili është tepër i rrezikshëm për trurin tim. Për këtë e kam njoftuar Robbie nëpërmjet një telegrami. Jam shumë

i frikësuar. Dua të jetoj. Kam ende shumë për të thënë. Maurice do të ma sjell supën, shpresoj që mos ta ketë zier vetë...”

Wilde ka pasur frikë të vdes sepse ka pasur ende të thotë diçka, atë që Acroyd e thotë në veprën *“Testamenti i fundit i Oscar Wilde”* në emër të tij. Me sukses! (2012)

#### Bioinfo\*

*Peter Acroyd* ka lindur më 1949. Londinezi është specialist i shkencave të letërsisë. Për vite me radhë ishte redaktor i "Spectator" dhe kritik letrar në "Times". Për studimet, monografitë dhe biografitë e tij është shpërblyer disa herë me çmime prestigjioze.



## ROLAND BARTHES

*Vita Nova ose ligjërata e fundit*

«Vita Nova». Kështu quhej romani, të cilin donte ta shkruaj Roland Barthes.

Një roman nga kritiku më i rreptë letrar i shekullit 20, i cili në esenë e tij «vdekja e autorit» kishte shpallur autorin si instancë parazitare, të vdekur dhe pa rëndësi për veprën letrare? Paradoks?

Projekti «Vita Nova», i cili që nga prilli i vitit 1978 e deri me shuarjen e autorit të tij mbizotëronte bisedat e salloneve dhe mediave letrare, nuk u realizua. Barthes nuk arriti ta bëjë romanin e tij sepse u shkel nga një kamion i ngarkuar me qumësht .

Për dallim nga dorëshkrimi i Albert Camus –së, i cili i dekodua nga një staf redaktorësh dhe e veja e tij Francine Camus, kështu duke «përfunduar» dhe botuar romanin e tij të fundit «Njeriu i parë», në studion e Roland Barthes u gjetën vetëm disa lista lemash. Një *mind map* , nga e cila nuk mund të mësohej asgjë konkrete se si do të mund të dukej romani i «rrezikshëm» i njërit nga etërit më dominant të semiologjisë postrukturaliste. Në vend të romanit u gjetën tre seri ligjëratash me temën «Përgatitja e romanit», të cilat Roland Barthes i kishte mbajtur para studentëve të *Collège de France* gjatë

semestrave të viteve 78 – 80. Ligjëratat u botuan fillimisht në frëngjisht e këtyre ditëve edhe gjermanisht.

Botimi i këtyre ligjëratave domosdo risjell dilemën rreth konceptit teorik të Barthes-it: Demonton ai teorinë e vetë, të hedhur në esenë «Vdekja e autorit», me analizat mbi Marcel Proust-in, Franz Kafka-n, Leo N. Tolstoi-n e të tjerët?

Me riaktualizimin e diskursit mbi Roland Barthes parasëgjithash ama duhej të aktivizohej shpërthimi i një bombë tjetër, shpërthim që kushtimisht e përllanë edhe një figurë tjetër të rëndësishme: është vërtet Jacques Derrida themeluesi i Dekonstruktivizmit?

## VETËDEMOLIMI?

Në librin «Përgatitja e romanit» Barthes demolon jo vetëm tekstet e autorëve të sipërpërmendur, por edhe biografitë, fotografitë dhe çdo material tjetër që ka mbetur trashëgimi nga ekzistenca e tyre. Ai i analizon ato duke demonstruar procesin e shkrirjes së curriculumit nganjëherë banal të autorit në veprën e tij artistike dhe anasjelltas. I shpërndanë përvojat reale të autorëve në elemente të veçanta dhe i barazon ato me skena fiktive nga veprat e tyre. Nëpërmjet fotografive dhe dokumenteve tjera reale e ndërton një psikogram të njeriut Marcel Proust. Psikogram, të cilin pastaj e shtron mbi tavolinë krahas psikanalizës së bërë mbi njërën prej figurave fiktive të Proustit dhe konstaton se jo vetëm në vija të përgjithshme figura fiktive i përngjan autorit, por edhe më shumë ata janë të ngjashëm në detaje. Me një fjalë: ata kanë kryesisht shpirt të njëjtë, personazhi fiktiv dhe autori. Këto eksperimente Roland Barthes i bën – siç shihet – duke marrë në ndihmë instrumentet e psikanalizës.

Ajo që nuk përkon ndërmjet autorit dhe botës brenda veprës së tij është ajo që i takon artit dhe vizioneve të tij mbi universin. Personazhet mund të jenë të vrazhdë, kriminelë, stوريا mund të jetë një horror i vërtetë, siç mund të jetë vetë autori dhe jeta e tij, mirëpo nëse autori ka arritur që storien ta rrëfejë gjuhësisht bukur me imazhe aq tërheqëse – si Flauberti – sa që lexuesi vërtet të besojë se një botë e tillë ekziston, atëherë lind romani i përkryer.

Në këtë mënyrë, pra duke kërkuar kauzalitetin që sipas tij shpjegon arsyet se pse figurat e Kafkës janë kryesisht vrasës apo gjykatës apo pse figurat e Leo Tolstoit janë aristokratë, besimtarë dhe njerëz mondan që flasin frëngjisht, Barthes dekonstruktiv autorët nëpërmjet teksteve të tyre dhe shpesh klith triumfueshëm: «një fuqi e mrekullueshme transformimi», siç bën gjatë analizës për Proustin.

Është pikërisht kjo «metamorfozë e mrekullueshme», të cilën ai e identifikon tek Proust dhe Kafka, mirëpo që më së shumti e përjeton, respektivisht praktikon vetë. Tezat, me të cilat Barthes dikur i kishte tmerruar sallonet akademike e që flitnin për «vdekjen e autorit» transformohen në ligjëratat e tij të mëvonshme në konstatime rreth «amshueshmërisë» së autorit. Autori, pra, si instancë jo vetëm përbërëse, por edhe që me vetëdije apo nënvetëdije ndikon në krijimin e veprës letrare.

## PËRGATITJA E ROMANIT

Në ligjëratën e parë Barthes flet për origjinën dhe shpërthimin e inspirimit. Nga vjen ideja që e frymëzon një njeri të zakonshëm t'i përveshet procesit të mundimshëm të krijimit të një veprë letrare? Ideja dhe inspirimi për Barthes-in janë dy situata frymore e shpirtërore që nxisin

një autor ta nis një projekt letrar, pra romanin, por ato nuk mjaftojnë për t'i krijuar skenat, imazhet dhe gjithë elementet tjera që kërkon një prozë e mirëfilltë nëse ai, pra autori, nuk e ka distancën e mjaftueshme ndaj asaj që ka përjetuar më parë. Autori – në këtë analizë – del pra si një regjistruar estetik i proceseve frymore e shpirtërore të epokës, funksion të cilin e arrin me sukses ta bëjë veç pas tjetërsimit të tij, konkretisht pas transformimit të tij në një genie jashtë kohës dhe mendësisë në të cilën jeton fizikisht. Vetëm në këtë mënyrë ai disponuaka me mjeshtërinë e rikonstruktimit apo dekonstruktimit të realiteteve shumëvariantëshe.

Ligjërata e dytë dhe ajo e treta trajtojnë fuqinë, metodën dhe aftësitë narrative që duhet t'i ketë një autor për ta krijuar romanin ose artefaktin në përgjithësi. Në këtë kontekst ai merr si shembull poezinë trevargjësh humoristike japoneze. Për Barthes *haikut* janë interesante, sepse poetët japonezë si Sumi Taigi kanë ditur qysh në shekullin 18- të ta bëjnë atë *imagination* aq mjeshtërore që përjetësisht e kërkon shkenca e letërsisë perëndimore.

Bashkë me *imagination*, por kësaj radhe nëpërmjet shkronjave – shenjave e jo sekuencave të dritës, krijohet një fotografi më e përkryer e frymës dhe shpirtit të epokës se sa ajo që njohim ne. Barthes thotë «më e përkryer», sepse mbetet në pozitat e tij fillestare teorike: autori shfrytëzon realitetin dhe përvojat e tij, mirëpo gjatë procesit të krijimit dekonstrukturon ato për të rikonstruktuar një realitet tjetër, një botë tjetër, të cilën autori as ka jetuar e as e ka parë.

Gjatë këtij procesi de- dhe rikonstruktimi autori kalon nëpër stacione herë të tmerrshme e herë të këndshme si: dështimi, snobizmi, frika, mania, tjetërsimi nga njëra anë dhe imagjinata e fuqishme, lehtësi pas realizimit të një fjalie

të përkryer, ndjenja e superioritetit karshi të zakonshmëve dhe të vdekshmëve nga ana tjetër etj.

## KRITIKA DHE TEORITË

Disa kritikë gjermanë, anglofonë e francezë i konsiderojnë këto «lëvizje» të Barthes si shenja të një «skizofrenie teorike» (ithtarët e teorisë anglosaksone të duos Welles und Warren). Ata madje justifikuan edhe njëherë qëndrimin e tyre se kjo «na qenka arsyeja se pse shumica e veprave të Barthes janë të panjohura dhe se ai asnjëherë nuk u pranua si serioz nga akademitë shkencore». Sipas këtyre kritikëve kemi të bëjmë me një revolucionar eksziv të Semiologjisë, ama pa ndonjë relevancë të madhe për shkencën e letërsisë si tërësi. Se këto teza nuk mund të qëndrojnë këtë e kanë dëshmuar studimet e shumta postmortum mbi Roland Barthes-in, të cilat kanë vulosur peshën e këtij mendimtari në kuadër të Semiotikës strukturaliste. Ajo që irriton edhe më shumë në këtë drejtim janë tentativat e disa teorikëve e kritikëve për të deklaruar teorinë e hershme barthiane mbi «vdekjen a autorit» si një episod adoleshent të diskursit shkencor letrar, pra si ekskursion joserioz i njërit dhe vetëm njërit nga kritikët dhe filozofët më të rëndësishëm të shekullit që shkojë (kritikja gjermane *Ina Hartwig*).

Problemi banalizohet dhe kritikata zbehen rëndë sapo të shtrojmë para vetes historinë e tezës së «vdekjes së autorit». Barthes është njëri nga ata shkencëtarë e filozofë që kanë reflektuar mbi këtë lloj roli të autorit në raport me veprën e tij letrare. Michel Foucaults në veprën e tij «Çka është një autor» (1969) flet për të njëjtën gjë. Ky kërkon zgjimin e kritikës para se letërsia dhe artet të katapultojnë në një

«Histori biografish njerëzish të mëdhenj». «New Criticism»-i anglosanksonik ndërtohet po mbi këtë botëkuptim, i cili vetëm me «vdekjen e autorit» e sheh «lindjen e lexuesit». Dijetari nga Piemonti Umberto Eco në veprën e tij *Opera aperta* (1962) madje është njëri ndër të parët që hedh konturet e një filozofie të tillë interpretimi.

Teorinë e «Scriptor» -it Barthes e formulon në esetë e tij mbi Honore de Balzacs (novela «*Sarrasine*») dhe gjatë interpretimeve të teksteve të Proust – it, Valéry- së dhe Mallarmés gjatë viteve 1968 – 1969, që do të thotë gjashtë e shtatë vjet pas publikimit të librit të Umberto Eco-s. Në këtë kontekst kronologjia është e qartë dhe ecë në këtë linjë: Eco – Barthes – Foucault, për të vazhduar më pastaj si «doktrinë» e teorive dhe shkollave të shumta letrare deri në të ditët e sotme.

Nëse teoria në fjalë vërtet është një eksperiment i dështuar, atëherë Barthes qenka i pari – në krahasim me të tjerët që ende nuk rishqyrtojnë tezat e tyre (Eco) – që e modifikon veten dhe kthen autorin ndër të gjallët, paralelisht duken ngritur një teori tjetër të rëndësishme: atë se si përgatitet romani.

## „RIVARRIMI“ I AUTORIT

Në këto ligjërata Roland Barthes s’ka dyshim se e «ringjallë» autorin. Ai nuk është më kategorik në lidhje me rolin statik të autorit gjatë krijimit të veprës artistike. Mirëpo as në këto reflektime ai nuk i ndan atij ndonjë rol superlativ. I mbetet deri në fund besnik frymëzuesit të tij Friedrich Nietzsche dhe filozofisë së tij, e cila priret nga formulat si: «Arti është shpikur për të na lehtësuar peshën e rëndë të realitetit». Që konkretisht do të thotë: nëpërmjet

artit ne dekonstruktivitetin e realitetit për ta bërë atë të durueshëm. E, autori në këtë kuptim është Dekonstruktori. Ai që di se si deformohet realiteti dhe si ndërtohet romani.

Është kjo arsyeja, pra braktisja e teorisë rreth «vdekjes së autorit» se pse Barthes donte ta shkruaj një roman dhe ta pagëzojë atë «Vita Nova» – duke asociuar me Danten? Kritika dhe akademitë vazhdojnë që Roland Barthes-in ta reduktojnë në autor të vetëm të një eseje, asaj «vdekja e autorit». Kështu është më lehtë. Më lehtë është pra të fiksohesh në një tekst të shkurtër të një autori se sa të bësh punën e mundimshme e ta studiosh veprën voluminoze (e cila ende vazhdon të botohet) të tij, e cili nuk gjendet vetëm brenda ca kopertinave librash, por është e shkapërderdhur gjithandej: revista, gazeta, dorëshkrime, ligjërata e libra. Barthes-it mund t'i vidhet ca kohë deri tek njohja e merituar nga «zyrat» akademike dhe kritikët «seriozë», humbës ama sigurisht se nuk do të jetë ai, por ata që vazhdojnë të bartin titujt e kritikëve dhe shkencëtarëve letrarë pa njohur si duhet njërin nga gjenitë e kritikës së shekullit 20-të.

## UMBERTO ECO

«*Flaka misterioze e mbretëreshës Loana*», 2004

Umberto Eco me romanin e fundit ka bërë autobiografinë e ilistruar të postmodernës evropiane. A mund ta finalizonte dikush tjetër një projekt të tillë më mirë se i urti gjenial nga Piemonti?

Mbreti i citateve, detektivi i epokave dhe kirurgu i shenjave e gjuhës Umberto Eco në romanin e tij më të ri «*Flaka misterioze e mbretëreshës Loana*» nuk na merr me vete për të zbuluar ndonjë murg vrasës brenda murreve të kishave mesjetare e as nuk na detyron të deshifrojmë pergamenët e pluhurosur bashkë me Baudolinon për të identifikuar vrasësin e perandorit Friedrich Barbarosa, kësaj rradhe ai na fton t'i bëjmë një eskurzion gjeografisë së Unit të tij. Atij Uni nëpërmjet të cilit mund të mësojmë jo vetëm intimitete biografike të autorit, por edhe të të ashtuquajturës postmodernë vetë. Nëse si lexues kemi dilema me atë se çka në roman është reale e çka joreale, atëherë mund të shërbehemi me ilustrimet që shoqërojnë tekstin – kështu oferta e autorit.

Tashmë siç është bërë zakon, nuk shkoi as një muaj pas botimit të originalit në italishte «*La misteriosa fiamma*



della regina Loana», romani u botua edhe në shumicën e gjuhëve të tjera perëndimore. Falë kolonisë jo të vogël të lexuesve të Ecos, në çdo vend, kulturë e gjuhë botuesit janë të sigurtë se firma e këtij autori është profitabile dhe nuk çajne kokën më gjithaq me shushuritjet e lektorëve dhe kritikës. Përderisa kritika karshi romaneve të tij si «Emri i trëndafilut», «Baudolino» etj, ishte e ndarë në dy pole agresive (njëra palë asgjësuese e tjetra të bën të vjellësh nga përlulja e tepruar para këpucëve të lustruara të shkrimtarit italian) kësaj here vërehet një ballafaqim më syçelë, më i argumtuar dhe më i angazhuar në deshifrimin e botës së komplikuar të autorit bestseler. Në romanin e parafundit (dhe të tjerët) ishin të rralla skenat dhe imazhet nëpërmjet të cilave mund të hyjmë në sferën intime të krijuesit, botën e tij, madje edhe kur mendonim të kemi triumfuar e kemi dekoduar ngjashmërinë e tipareve të Baudolinës me Econ pas pakë duhej të dorrëzoheshim para maskimit mjeshhtëror që pasonte në skenën e rradhës. Për këtë romani i fundit «Flaka misterioze...» është një roman tepër i rëndësishëm për ekspertët, paraprakisht të fenomenit Umberto Eco e pastaj edhe të temave tjera që vepra sjell me vete.

## BODONI, ECO DHE NE

Storia: Antikuari milanez Giambattista Bodoni zgjohet nga koma. Ai nuk i njeh njerëzit që i qëndrojnë pranë shtratit. As gruan e tij të bukur Paola. Libri fillon me pyetjen: si e keni emrin? Pacienti nuk e di atë. Shtrngon ballin dhe provon emra nga më të ndryshmit. Ia qëllova? Jo. Ai vërtet e ka humbur kujtesën. Ai nuk di se ku ka lindur, prej nga vjen dhe kush është. Yambo, e thërret gruaja që i qëndron pranë dhe ia shtrngon dorën. Kot. Zotëri Bodoni,

i cili pas një infarkti më 25 prill 1991 ka rënë në koma, është shndërruar në një qenie pa identitet. Më vonë bëhet e qartë se Yambo nuk ka humbur tërë kujtesën, por vetëm atë të personit të vetë (fenomen ekzistent në medicinë, për të cilin Eco si duket i ka konsultuar mirë neurologët), sepse ai me saktësi e di kush është Pitagora, Shën Augustini, Abrahami, ai e di shumë për Aleksandrin e Madh, por jo për nipin e tij Alessandro. Giambattista Bodoni nuk njeh vetëm antikuitetet dhe librat me të cilat është marrë si tregtar, por edhe historinë tyre, një personazh më i ditur se sa të gjitha enciklopeditë e Bertelsmannit, Brockhausit dhe Larousse-s bashkë.

Bodoni nuk pranon që jetën e tij t'ia rrëfejnë të tjerët. Rast i shkëlqyeshëm për Econ, i cili merr atë dhe ne për dore dhe – këtu nis ai investigimi i fashëm i Umbertos- dhe nisemi për të kërkuar gjurmët e identitetit të humbur të kryepersonazhit. Stacioni i parë: fshati Solara, në rrafshnaltën e Po-së, në Piemont, atje ku ka lindur Yambo. Në tavanin e shtëpisë së pararendësve të tij shfaqen shenjat e para të rinjohjes, të kthimit të kujtesës. Peisazhet e natyrës i njeh, por nuk e di prej ku (!). Mjegulla ende është shumë e dendur sa për të parë qartshëm.

Duke bastisur kutitë dhe librat e gjen një leksikon të vitit 1905, pastaj një radio që s'funksionon, mirëpo që atij ia ngjall iluzionin sikur të dëgjoj muzikë klasike, operë, Chopin-in natyrisht dhe shumë këngë popullore të asaj epoke. I ngul sytë në inicialet RL të shënuara mbi rregullatorin e kanaleve të radios dhe bën «aha», «Radio London», pra. Gjyshi i tij paska dëgjuar radion e armikut me qëllim që informacionet pastaj t'i krahasojë me ato të regjimit për të zbuluar të vërtetën (vlerësimi dhe krahasimi i tekstit).

Dikur lodhet Bodoni me Homerin, Manzonin dhe Flaubertin, madje edhe një botim origjinal të Sheksipirit që mban datën e vitit 1623 dhe i përveshet literaturës me nivel «më të ulët» si ajo e Emilio Salgarit (Karl May italian). Pikërisht me fletoret komike, në reklamat e atëhershme si Micky dhe Donald, Vespa, Espresso, me figurat si Mussolini, Hitleri partizanët, fashistët dhe komunistët nis rikonstruimi i historisë. Pllakatet dhe sojet e kutive të cigareve Eco i boton krahas rrëfimit. Kur Bodoni hyjnë në fazën e pubërtetit shfaqet figura e dashnores së tij të paharueshme Lilës – po si ajo Luara e Petrarkës dhe Beatricja e Dantes – e cila tragjikisht shpejt vdes në Brazil larg syve të kryepersonazhit. E kështu me rradhë pastaj Yambo duke hulmtuar vetveten na rrëfen historinë kulturore të epokës duke filluar nga vitet e para të vitit 1900 e deri kur ai bie në koma më 1991, në vitin e bomardimeve të Bagdadit nga amerikanët.

## ANALIZË E IDENTITETIT KONTINENTAL

Rrëfimi për antikuarin që humbjen e kujtesës e shfrytëzon për të gjetur një identitet të ri është vetë biografia e Umberto Ecos. Dhe më shumë: si në asnjë vepër tjetër më parë – qoftë ajo shkencore apo artistike – profesori dhe intelektual i famshëm italian përpiket që ta njoftojë kohën me rëndësinë e prezencës së tij në kulturën postmoderne.

Giambattista Bodoni lind një vit para Umberto Eco, ku tjetër veçse atje prej nga vjen autori, si fëmijë i ka po të njëjtat lodra, në rini edhe ky ka simpati për fashistët e pastaj bëhet antifashist dhe gazetar e më vonë intelektual i pakrahasueshëm dhe enciklopedi e gjallë.

Yambo na shpalon dialogjet që e kanë shpëtuar nga religjioni, na reciton poezi dhe anekdota që Eco i ka botuar më herët në përmbledhje eseshë.

Jashtë asaj personales, biografikes e pse mos të themi edhe narcisoides, Umberto Eco përnjëmendt ka bërë autobiografinë e ilustruar të postmodernës në formë romani. Mbitëgjitha romani është analizë e kërkimit të identitetit që ka dhe po zhvillon kultura kontinentale. E kush mund ta bënte një projekt të tillë më mirë se i urti gjenial nga Piemonti?

## CITATE DERI NË ALIVANOSJE

Eco ka bërë një punë të mirë që kësaj rradhe në fund të librit ka botuar një glosar që sqaron terminologjinë e përdorur në libër, se për ndryshe lexuesin e tij mund ta përemendonim duke lexuar në tren me një valixhe të mbushur përplotë libra enciklopedikë dhe fjalorë të shumë gjuhëve. Ndoshta po për këtë arsye kapituj të tërë e bëjnë Yambon të përgjumshëm, të përsëritshëm dhe të mërzitshëm.

Edhe në «Flaka misterioze e mbretërshës Loana» citatet ta plasim trurin, duke filluar me Poen, Stevensonin dhe Mellvilin, pastaj vijnë Manzoni, Çehovi, Baudelaire, Augustini e natyrisht pse të mungojnë edhe Montaleja, Lili Marleni, Shekspiri, Danteja, Floberit dhe pa e lënë anash patjetër Umberto Econ dorën vetë. Kollazhet, që burrimin e kanë nga biblioteka e madhe e autorit, nganjëherë ta krijojnë përshtypjen sikur duan t'ia marrin frymën prozës, ta zhveshin atë nga arti i bukur dhe ta degradojnë në shenja dhe fotografi si në ato librat e historisë për gjimnazistët.

Lexuesit që duan ta dijnë arsyen se pse Eco romanin e ka titulluar «Flaka misterioze e mbretëreshës Loana» duhet të kenë durrim dhe të presin deri në faqen 249 (të botimit origjinal, italian). Aty do të mësojnë shpejtë e sipërfaqësisht se bëhet fjalë për figurën kryesore të një «Cartooni» që zhvillohet në Orient, që Yambo e ka lexuar si fëmijë.

## MILAN KUNDERA

*Injoranca ose legjenda e kasapit islandez*

Në romanin më të ri të tij “Injoranca” Kundera edhe njëherë më shumë, kësaj rradhe në mënyrë më të koncentruar, i qaset emigrantit, si qenie me identitet të humbur.

Emigrantja çeke Irena është lodhur nga pyetja e çdoditshme e Parisit; “pse je ende këtu?” dhe pas njëzet vjetëve i del përballë sërish Pragës – vendlindjes së saj. Pyetja ndrron formën dhe bëhet edhe më e padurrueshme: “Kush je ti. Çka bën këtu”? Parisi nuk e durron më e Praga s’ka nevojë për shpirtërat e shpërngulur që kanë humbur drejtimin dekada më parë. Pa atdhe. Në udhëkryqin e fatit të saj ajo përpiqet të gjej identitetin e humbur gjatë pranverës së famshme çeke të vitit 1968. Përderisa Irena kërkon kuptimin e mosdurrimit të Parisit ndaj saj Milan Kundera shkëput rrëfimin mbi këtë grua pa identitet dhe fillon të bëjë zbërthimin etimologjik të fjalëve greke “nostos” e “algos” ose të fjalës spanjolle “anoranza”, asaj portugeze “soudade” e kështu me rradhë duke shëtitur gjuhëve të Evropës me qëllim për të treguar se si popuj të ndryshëm e quajnë mallin për atdheun, nostalgjinë për të.

Dhe ja “finalja”: rirrëfimi i stërpërsëritur i historisë së luftës së Odiesut për t’u kthyer në Itakën e tij.

## “ARTI I ROMANIT” TË KUNDERËS

Në romanin më të fundit të tij “Injoranca” (të botuar në gjermanishte nga Carl Hanser Verlag, 2001, München) Kundera edhe njëherë më shumë, kësaj rradhe në mënyrë më të koncentruar i qaset emigrantit, si qenie me identitet të humbur.

Ata që e njohin stilin e këtij autori e dijnë që çdo libër i tij – sidomos nga “Lehtësia e padurrueshme e qenies” (1984) e këndej – është roman dhe ese shkencore përnjëherë. Edhe “Injoranca” duket si botim i dy veprave në një, vepra, të cilave aksidentalisht u janë përzier kapitujt. Për shembull: në të njejtën kohë kur ai rrëfen për emigranten Irena dhe burrin e saj flet për Revolucionin francez dhe Komunizmin ose vërtetësinë shkencore mbi sagën e Odiesut e të ngjajshme.

Ashtu si librat e Kunderës edhe versionet e kritikës i përngjajnë kësaj natyre kombinimi të domosdoshëm: njëra anë thirret në mungesën tempos te Kundera për ta rrëfyer një histori deri në fund artistikisht, pa thirrur në ndihmë teori intelektuale e filozofike mbi temën, ndërsa ana tjetër e konsideron këtë si një formë të re të romanit, e cila nuk bën asgjë më shumë se sa i përshtatet nivelit intelektual të lexuesit të shekullit njëzet e një dhe që është krijuar nga një autor me përmasa paraprirëse në këtë drejtim. Natyrisht se në këtë kontekst aludohet në teorinë e Kunderës të proklamuar nëpërmjet eseut “Arti i romanit” (Paris, 1986).

## DYJ -P. SARTER – NJË MILAN KUNDERA

Ekziston versioni teorik që suksesin e Kunderës e lidhë me traditën e romanit për të integruar sa më gjallë refleksionin filozofik dhe atë duke filluar që nga Cervantesi , Musil, Broch e kështu me rradhë. Me këtë justifikohet edhe “sakrfikimi” i artit të rrëfimit, pra aty ku teksti më nuk i përngjan prozës, domethënë në emër të “hulimtitit filozofik të ekzistencës” autorit i lejohet që nganjëherë edhe të rrëshqasë duke ngatrruar gjinitë letrare me qëllim të shkrimit të një polihistorie – një për lexuesin e zakonshëm, një për intelektualin, një për marinarin etj. Aksion që nuk është negativ sidomos në përpjekjen për të gjetur lexuesin të sa më shumë shtresa që është e mundur.

Në gjithë këtë debat, absurdi bëhet edhe më i padurrueshëm, sepse i iket faktit kryesor se çdo vepër arti përmban në vete një refleksion filozofik dhe se në rastin e Kunderës fjala është për të gjetur kufirin në mes tekstit letrar artsitik dhe tekstit kryekëput shkencor filozofik e jo se deri në cilën masë i lejohet një artisti që të jetë filozof. E, stili i Kunderës, pra metoda e tij për të krijuar romanin nuk ka të bëjë fare me atë të Cervantesit, as Musilit e as Brochut, por më shumë me shkrimin e dy sartërve në një; pra me përbashkimin e dhunshëm të sartrit filozof me atë të sartrit shkrimtar në Kunderën vetëm shkrimtar! Gjë për të cilën ca thonë se nuk shkon fare e ca thonë se është mjeshtri.

Megjithkëto Kundera mbetet pjesmarrës i listës së autorëve më të lexuar evropianë.



## TEMATIKA

Jo vetëm në “Injoranca” Kundera e trajton “ekzistencën” e njeriut pa atdhe. Kjo temë autorin e preokupon që nga vepra “Valsi i ndarjes” (1976) e që intensifikohet në veprat e mëvonshme, prej kur i merret shtetësia nga atdheu i tij (1979). Pa përjashtuar historinë e bukur të muzikantit Arnold Schönberg, që është është dromcë e bukur e instaluar në “Injoranca” për të përshkruar jetën e emigrantit, ajo që më së miri e vulos teorinë e Kundërës në këtë libër, sa i përket fatit të njeriut paatdhe mbetet rirrefimi i historisë së poetit romantik islandez Jonas Hallgrimsson, i cili ka jetuar dhe shkruar në Kopenhagë, përderisa atdheu i tij ka qenë koloni e Danimarkës.

Patrioti dhe alkooliku Hallgrimsson vdes gjatë vitit 1845 pa pasur fatin të përjetoj pavarrësimin e vendit të tij, gjë që ka qenë edhe e pamundur, kur kihet parasyshtë fakti se një gjë e tillë ndodhë tek në vitin 1944.

Dy vjet më vonë një industrialist i njohur islandez sheh ëndërr poetin dhe merr kërkesën e tij për t’ia kthyer eshtrat nga Kopenhaga në atdhe, në një rrafshnaltë ku ka qenë i lindur poeti. Kapitalisti islandez i del zot këtij premtimi dhe arrinë të kthejë skeletin e poetit në atdhe, mirëpo pa suksesin për ta varrosur në vendlindjen e poetit, kjo për arsye se Parlamenti i Islandës ia ka grabitur skeletin nga duart për ta varrosur në varrezat e njerzve të mëdhenj të Islandës, në panteonin pranë parlamentit ku prehej vetëm një poet tjetër i madh deri atëherë. E gjithë kjo histori e kthimit të eshtrave të Hallgrmissonit e ka një anë tjetër të medaljes. Në varrezat ku ka qenë i varrosur poeti nuk ka ekzistuar asnjë pllakë mbishkrimi që

do të identifikonte kufomën e poetit, kështu që kapitalisti zgjedh ato që i janë dukur më të “forta” duke mbajtur fshehur faktin se ai nuk e ka ditur në ato eshtra janë të poetit apo jo.

Një vit më vonë merret vesh se eshtrat nuk janë të poetit, por të një kasapi islandez që atë kohë ka jetuar në Kopenhagë.

(Këtë fragment Kundera e ka huazuar nga një roman i nobelistit Halldor Laxness (1902) i cili u bë botërisht i njohur me romanet e tij “Koncerti i peshqve” dhe “Stacioni atomik”)

Ky është opinioni i Kunderës që e pëcjell nëpërmjet romanit “Injoranca” mbi njeriun e paatdhe: Ai as si kufomë më nuk e ka të sigurtë kthimin e ndonjëhershëm në vendin e tij!

Të gjitha historitë, fragmentet, shëtitjet e Kunderës për të shkruar “Injorancën” janë të njohura. Ashtu edhe stili i tij i kontestuar. Ajo që mbetet e panjohur, pothuaj anonime është Irena, të cilën Kundera e shpall si kryepersonazh e rrëfim kryesor, mirëpo e cila përballë Odiseut, Schönbergut, Hallgrimssonit duket si një personazh e papeshe që aksidentalisht gjendet në lojë.

## DANIEL QUINN

*Ismael, 1992*

Shkrimtari amerikan Daniel Quinn i flet njerëzimit nëpërmjet gorillës me emrin Ismael. Me sukses. Përveç një shpërblimi prej gjysmë milioni dollarësh ai tashmë është përkthyer në 21 gjuhë të botës.

Daniel Quinn nuk sjell asgjë të re. Teoritë rreth potencialit të njeriut për të shkatërruar veten dhe gjithçka që e rrethon atë ekzistojnë që me dokumentet e para të qytetërimit human. Dhjetëra shkrimtarë të suksesshëm e me famë botërore qëmoti e kanë kapërcyer kufirin e kopesë humane dhe në shenjë revolte kundër natyrës eksploatuese të *homo sapiensit* kanë zgjedhur macet, luanët, lopët dhe majmunët si bashkëbisedues seriozë mbi botën, jetën dhe Zotin.

Çka atëherë i bën veprat „Ishmael“, „The Story of B“ dhe „My Ishmael“ të shkrimtarit nga Teksasi aq të shitura. Për veprën e tij të parë «Ismael» Quinn fitoi shpërblimin më të lartë amerikan «Turner Tomorrow Fellowship Award» prej 500 mijë dollarësh. Në hapësirën anglofone ato vazhdojnë të mbeten në majën e listave të librave bestsellerë. Sidomos vepra e tij e tretë «Ismaeli im» është përkthyer deri më tani në 21 gjuhë.

Hiti i kinemasë «Instinct» ku rolet kryesore i luajnë Anthony Hopkins dhe Cuba Gooding Jr. është skenarizuar duke pasur për bazë po këtë libër.

## RRËFIMI

Walter Sokolow, një hebre i moshuar merr vesh se e gjithë familja e tij është asgjësuar në një kamp nazist. I zhytur në depresione, i kërcënuar nga rreziku i vetëvrasjes ec pakrye përreth kafazeve të një cirkusi. Papritmas ndalet pas një grupi fëmijësh të grupuar para një gorille, i cili me indiferencë bluan me dhëmbë një degëz dhe herë pas here çon sytë kah turma. «Ti nuk je Goliati», i drejtohet Sokolow me nervozë majmunit të pafajshëm. Gorilla çohet në këmbë dhe ndjek me sy plakun që ia kthen shpinën. Pas disa ditëve Sokolow kthehet dhe ua blen cirkusantëve Gorillën.

«Ti nuk je Goliati, por Ismaeli», i thotë hebreu Gorillës, të cilin e ka vendosur në një pjesë të shtëpisë, të ndarë me xhama. Për çdo ditë, me orë të tëra bisedon Sokolow me të. Jo pa sistem. Sokolow do që Ismaeli të mësoj gjuhën e dykëmbësorëve.

Ismaeli jo vetëm që mëson gjuhën, por muton në një filozof të vërtetë. Ai arrin që për një kohë të shkurtër të lexoj veprat kryesore të kulturologjisë njerëzore. Shkollohet në bazat e fizikës, kimisë, teknikës dhe shkencave tjera natyrore. Përgatitet aq, sa që pas vdekjes së «mbajtësit» të ti, ia zgjedh vetes një profesion. Atë të mësuesit.

Alan Lomex – figura e dytë qendrore e romaneve të Quinnit – një ish revolucionar i Lëvizjeve Kulturore të 68-ës që ka humbur shpresat dhe i deziluzionuar vërdallet rrugëve të qytetit. Nga ëndrrat e dikurshme për të shpëtuar botën s’ka mbetur hiçgjë më shumë se sa një tundje koke dhe një buzëqeshje e thyer dhe cinike. Kur Lomex lexon në gazetë: *«mësuesi kërkon nxënës që kanë pasonin serioz për ta*

*shpëtuar botën. I dëshiruar është kandidimi personal», gati sa tërbohohet. Nga shtytja, jo për të shpëtuar botën, por për të parë se ç'qenie e krisur qenka ajo që mendon se e njeh formulën nëpërmjet së cilës u shpëtua bota, nisjet për në adresën e dhënë përfundi anonsës. Shoku është i paraprogramuar. Lomex e ndjen veten si një liliput para një gorille gjigante që bluan me dhëmbë degëza drunjsh. Hamendet: të ikë apo t'i bëjë ballë situatës. Tmerrimi bëhet edhe më i padurueshëm kur Ismaeli fillon të flasë. Fillon ligjerata e Ismaelit mbi biografinë e çuditshme të tij. Lomex poashtu rrëfen herë pas herë nga një fragment nga deziluzionet e tija. Fillon debati mbi jetën, botën, speciet, religjionet dhe çdo segment tjetër filozofik, të cilat Daniel Quinn do t'i ketë trajtuar sa ka qenë murg i «Urdhrit të Trapistëve » katolikë.*

Një ditë zhduket Ismaeli pa gjurmë. Për tu shfaqur pastaj në librin e radhës së Daniel Quinnt, «Fshehtësia e Ismaelit», ku stória nuk vazhdon, por është një rrëfim paralel me të parin. Përveç Lomexit Ismaeli ka pasur edhe një nxënëse tjetër, një vajzë me emrin Julie.

## FILOZOFIA OSE TEMATIKA

Rrëfimi nis qysh me Revolucionin Agrar, gjashtë mijë vjet para Krishtit. Fillimin e këtij revolucioni Ismaeli, respektivisht Daniel Quinn e paraqet si zanafillën e «përzënies së Adamit nga parajsja». Nga këtu nis ndarja e botës në «Marrës» dhe «Lënës». Marrës – që për Quinn do të thotë eksploator – janë njerëzit, të cilët jetojnë vetëm për të marrë gjithçka nga natyra, pavarësisht pasojave dhe Lënës janë të gjitha speciet tjera, të cilat jetojnë sipas ligjeve dhe rregullit të universit, pra sidomos kafshët. Në debatin ndërmjet Lomex-it dhe Ismaelit Quinn vë në

pikëpyetje gjithçka që bota humane e konsideron si zhvillim pozitiv. Ai vështron temën nga të dyja perspektivat – nga ajo e njeriut egocentrik dhe atij objektiv – e kap atë dhe i denoncon kontradiktat brenda saj, e rikonstrukton dhe e le ashtu pa rezultat.

Duke filluar që nga teoria e krijimit të botës nga një bri i Adamit e deri në ndikimin e padiskutueshëm të filozofisë antike dhe «kopjeve të saja të mëvonshme» Quinn i llogarit si shtylla të një Miti që duhet vënë vazhdimisht në pikëpyetje, sepse ky Mit që është baras me «Nënë Kulturë» është shkaktari që njeriu sot është i këtillë siç është: eksploator dhe vetshkatërrues! Është e qartë: Quinn nuk i vë Lomexit përballë njeriun, por kafshën: «se vetëm kjo specie është e çliruar nga çdo lloj ideologjie e teorie mbi «Nënë Kulturë» dhe mund të flasë nga një kënd jashtëhuman?», shkruan kritiku gjerman Winfried Berner, i cili romanin «Ismael» e konsideron si kryevepër. Dakord, mirëpo pse i duhej atëherë Ismaelit shkollimi kulturologjik human, pse nuk i mjaftoi gjuha për ta transmetuar të vërtetën universale që «mbizotëron» tek speciet tjera si realitet? Çështja komplikohet vazhdimisht e sa më shumë kur Quinn, Lomex dhe Ismaeli tentojnë të gjejnë përgjigje se ç'thotë natyra, pra universi vetë. Asnjëri prej këtyre nuk ka për këtë një burim bindës që mund t'ia ofronin recipientit si fakt.

Teori filozofike këto, që patjetër shpjegojnë arsyen përse librat e Daniel Quinn që nga dalja e tyre përbëjnë «Biblën» e të gjelbërve, antiatomikëve, pacifistëve dhe humanistëve në mbarë botën.

Teoritë e Daniel Quinn në romanin «Ismael» – dhe të tjerët – mund të diskutohen, të pranohen ose të refuzohen. Asaj që recipienti nuk mund t'i shmanget gjatë leximit të

romanit është detyrimi për të menduar rreth problemeve që shtron autori. Këtë qëllim Quinn e arrin me shumë sukses.

## KRITIKA

Rrëfimi i Quinn ndërtohet kryesisht mbi bazat e një dialogu. Introperspektiva e Lomexit është gjithmonë në shërbim të personazhit kryesor, pra një empati e «çliruar» nga çdo motiv egoizmi (cili është qëllimi i Alan Lomexit ta shoh botën vetëm si Ismaeli?).

Teksti është i shkruar për çdokë, pra jo vetëm për intelektualët e këtij lloj debati. Quinn shkruan thjeshtë, shpesh gati në atë gjuhën e protokolleve juridike. Lexuesit e mësuar me romanin klasik, ku përshkrimi i bukur i elementeve të stories është alfa dhe omega e rrëfimit, del i zhgënjyer. Quinn madje as personazhët nuk i përshkruan mjaftueshëm tek romani «Ismael». Veç në romanin pasues «Fshehtësitë e Ismaelit» arrin ta realizojë figurën e Juli-t, e cila madje nga kritika u shpall si figura më e bukur feminare pas figurës Huckleberry Finn të Mark Twain -it .

## SUKSESI

Niveli artsitik i veprave të Daniel Quinn nuk janë shkaktari i lexueshmërisë së lartë të romanit të tij «Ismael». Tema e bën atë njërin nga shkrimtarët më të lexueshëm të ditëve të sotme. Ish studenti i Universitetit të St. Luisit dhe Vjenës ka gjetur mënyrën e përkryer se ç' pyetjesh të parashtrijë për ta prek në nerv vetëdijen e kohës. Një kohe me ndërgjegje të vvarë për dëmet klimatike, atomike dhe një gjenerate humane që vazhdon hutuar ta kërkojë një lloj të vërtete universale. Të cilën Quinn as që e ofron e as që e kërkon, por apelon: hiqni duart nga Mitet e historisë së

vetëkonstruktuar të «nënës Kulturë» dhe jetoni si Ismaeli, në harmoni me natyrën dhe i kënaqur me rolin e tij prej gorille.



PAOLO COELHO  
*Shamani i «pabesisë», 2015*

Rrëfimi është banal. Figurat – si në shumicën e romaneve të Coelho – janë pa gjak, statikë. Rrëfimi i përngjan një procesverbali ku Linda jo patjetër tregon për përditshmërinë e saj por operon me stereotipe aq të përhapura mbi gratë e paemancipuara.

«Shkoj atje ku ujërat janë më së thelli». Me këtë citat të Lukës (Bibla, 5.4), Paulo Coelho hap romanin e tij të fundit «Adultério» (Shqip: Pabesia). Shkrimtari brazilian, rezident në Gjenevën zvicerane, i cili tashmë është përkthyer në 80 gjuhë, që në hapje të prozës premton, garanton thellim. Kemi të bëjmë me një prozë që nuk i përngjan më stilit të zakonshëm të tij; atij aq të thjeshtë deri e në djegie. Është «Pabesia» një rrëfim ndryshe, i tillë që djersit duke detyruar lexuesit të ecin sferave më subkutane të jetës, dashurisë, besimeve, kulturës, apo do të rezultojë në fund vetëm sa një premtim bosh e hiçgjë më shumë. Ta lëmë që fillimin ta thotë vetë:

«Ka mundësi të ju prezantohem? Quhem Linda, 31 vjeçe, 1 m. e 75 e gjatë, me peshë prej 68 kilogramësh dhe falë zemërgjerësisë së burrit tim mund të vishem me teshat më të bukura dhe më të shtrenjta. Meshkujt më lakmojnë e gratë lakmojnë jetën time. Jam duke jetuar në një botë, të cilën shumica e njerëzve vetëm ëndërr mund ta shohin (...).».

Kështu, në këtë stil nis rrëfimin Coelho. I gjithë romani është shkruar kësisoj. As pyetja «qe kjo e gjitha?» e jetës, nuk shkakton ndonjë spirale, nuk shpërthen asnjë atom dramatik, nuk është porta drejt mistereve të jetës, fatumit dhe shpengimit. Me gjitha sforcimet proleptike, psikonarrative, proza duket e kafazuar brenda isokronisë horizontale të saj (Lindës kudo i ndodh e njëjta).

## PABESIA

Me njohjen, me përshkrimin e situatave komplekse, gjojatragjike të njeriut Coelho mëton të merret në çdo roman të tij: në njërin libër kërkon nga qenia humane t'u mbetet besnik ëndrrave («Alef»), në tjetrin përpiqet të nxisë frymën e letargjizuar, joprezente në tashmëri, që nëpërmjet dashurisë ta ndryshojë botën («Engjulli mbrojtës»); në të tretin sugjeron dedikimin absolut për të siguruar shpengimin («Triumfuesi mbetet gjithmonë vetëm»). Analizuar veprën e Coelho në këtë linjë libri «Pabesia» duket si një kurorë e këtij rrugëtimi në kërkim të çelësit për çlirimin e njeriut pasmodern nga të gjitha pengesat që ia imponojnë modat e mondanitetit. Qenka pabesia, thyerja e kurorës, çelësi që shpëtuaka gazetaren Linda nga robotizimi i saj social?

Kjo varet nga çasti fokalizues i autorit, pra se me cilin kanal përvojeje e dijeje autori e pasuron trurin, respektivisht retorikën e personazhit të tij. Dhe Linda herë flet e reflekton si një shkollare e ditëve të para në manastirin jezuit San Ignacio të Rio de Janeiro-s, herë si një hipi nën ndikim të drogës që s'ia var jetës, konditave, ligjeve e moraleve, herë si një shamane që kërkon shpërthimin nga një seancë në trans dhe ekstazë për të përjetuar magjinë – sidomos atë të zezën. Këto «mësime» të shpartalluara, e që

burojnë nga jeta private e Paulo Coelho mirëpo nuk e realizojnë veten, nuk janë efektive, në asnjë skenë apo sekuencë të prozës në romanin „Pabesia“. Ato dalin e zhduken si filluska që recipienti sigurisht i pandeh si anomali ajrore jashtëlibrore. Ajo që vërtet përjetohet thellë, ndihet e parafytyrohet nga lexuesi janë aktet që pasojnë nga aty kur Linda vendos të tradhtojë, të kapërcej përtej telave të «normalitetit», kështu ngase shkrimtari e bind kjo të jetë rruga e vetme nëpërmjet së cilës ajo do ta gjej lirinë dhe përfundimisht do ta vrasë monotoninë.

## ORGJITË

Pas 200 faqeve ndodh mrekullia. Linda «rastësisht» takon shokun e saj të rinisë, biznesmenin Jacob König. Që në takimin e parë: pantallonat poshtë dhe Blowjob. Në takimin e dytë maçoja që apriori skllavëron çdo femër e përdhunon atë analisht. Dhimbje, epsh, qeshje të çoroditura dhe nga orgjia në orgji. Pas këtyre akteve të vetësakrifikimit vullnetar (sepse Linda ti thotë ashtu e jo se i ka përjetuar si çlirimi- këtu del edhe paradoksi) gjen protagonistja aftësinë të rimendojë. Ose më saktë ajo fillon ta kuptojë botën ndryshe. E nga dita kur në një kafene të qytetit takon shamanin kubanes, i cili e bind se «vetëm dashuria mund t’ia tregojë rrugën e një jete të lumtur» zbulon tempullin nga ku do të marrë energjinë t’i kthehet sërish po atyre konditave monotone nga të cilat me aq «sakrifica» iku.

A ha tregu edhe më banalishte se kjo? Po. Sipas gjitha prognozove edhe ky libër i maskuar si roman e që në të vërtetë «është një doracak banal ezoterik do të bëhet bestseller» (TAZ dhe dhe media tjera të hapësirës gjermanofone) do të përlajë top listat e bestsellerëve. Është

stupiditeti çelësi i suksesit apo Coelho ka ndonjë recetë tjetër?

Që nga romani «Alkimisti», «Veronika...», «Mali i Pestë» Coelho ka krijuar jo vetëm komunitetin e tij të lexuesve në mbarë globin, por pothuaj në çdo gjuhë kryesore disponon me shtëpi botuese, të cilat bashkë përbëjnë një industri globale marketingu. Ai mban ligjëratat, po në atë nivel të thjeshtë, këshillëdhënës mbi dashurinë, shpengimin dhe ikjen nga konvencionet «qytetare» drejt rebelimit dhe përdhosjes. Ka sukses. Nuk ka letërsi kualitative, art, por kjo nuk ka rëndësi edhe pse pjesa dërmuese e kritikës mendon që kësaj radhe autori e ka tepruar më shumë se duhet ngase fyen inteligjencën edhe të atyre që preferojnë literaturë të tillë, libra që nuk parakushtëzojnë as nivelin themeltar të arsimimit.

## ANTIFEMËR

E thënë: Rrëfimi është banal. Figurat – si në shumicën e romaneve të Coelho – janë pa gjak, statikë. Rrëfimi i përngjan një procesverbali ku Linda jo patjetër tregon për përditshmërinë e saj por operon me stereotipe aq të përhapura mbi gratë e paemancipuar që s'kanë detyrë tjetër frymore, intelektuale. Të atij soji që ndiqen shtrigërisht nga fantazitë e tyre pornografike, sadomazohiste, të sojit që veç një gjë i shpëton; seks në të gjitha pozitat më brutale të mundshme.

Coelho e rrëfen këtë gjendje maniakesh seksuale si stad të natyrshëm të femrës «me gjitha të mirat» e civilitetit, qenka status universal, i dëshmuar, absolut: femra nis të mendojë vetëm kur të realizohet shoqërisht / materialisht dhe atë përherë në drejtim të asketoseksualizmit brutal. E fundit pastaj shfaqet si purgator të domosdoshëm për çdo

genie të përhumbar që donë ta kap psyché tou pantós -in ose „anima mundin“. Atë Shpirtin Universal të Dashurisë, të cilin e kap sidomos pas këshillave (që nuk i jep kurrë se si janë) që i merr nga ndonjë shaman ezoterik kubanes, qoftë edhe në Zvicër, vendin ku sipas Coelhos edhe lopët bartin armë, frynë mistrali e ka plotë djathë që prodhohet gjithandej mirëpo jo aty ku thotë autori brazilian. Pasaktësi të pafundme që edhe fiktives ia shpifin jetën.

Libri është i lehtë për lexim. Rrëfimin kështu siç është mund ta gjesh në çdo magazinë erotike apo pornografike dhe atë nga vitet e 60-ta e deri sot. «Pabesia» e Paulo Coelhos hynë në historinë e librave të gurve që ligjërojnë receta për jetën, dashurinë, në bazë të një miksture doktrinash që përmenden vetëm sipërfaqësisht. Libri nuk është prozë kualitative, pra letërsi, art nuk mund të jetë kurrë. Megjithatë si mall do të shitet sepse ka tregun.

*(Për këtë recension është lexuar versioni gjermanisht i romanit: «Untreue», Diogenes, Zürich 2014).*

## MICHEL HOUELLEBECQ

*Profet apo maniak?, 2015*

Autori në modë Michel Houellebecq e ka një program se si ta shpëtojë Europën: me vrasjen e gjithë intelektualëve të majtë, Marksit, Freudit, Nietzshes, mediave dhe me përmbysjen e islamit nëpërmjet krishterimit dhe judaizmit! Seriozisht. Lexoni fjalimin e tij gjatë shpërblimit nga gazeta gjermane FAZ.

Ai e ka një mision: ta shpëtojë Europën nga vetëvrasja! Fazat kryesore të këtij programi autori i rishpaloj së fundi gjatë fjalimit të mbajtur më 26 shtator, në pallatin e gazetës gjermane «Frankfurter Allgemeine Zeitung», ku morri çmimin «Frank Schirrmacher», i cili iu ndahet «personaliteteve me kontribut të jashtëzakonshëm në zbërthimin e ndodhive të epokës». Programi i autorit të romanit të famshëm «Pjesëzat elementare» (1998) është ky: Pas Marksit dhe Freudit synon ta vrasë përfundimisht edhe Nietzsche-n. Të mbyll gjitha mediat franceze, të cilat pas atyre suedezeve të vetmet financohen nga shteti dhe që «ndjekjen e shtrigave» e quajnë debat publik. Të ekzekutojë edhe intelektualin e fundit të majtë në Evropë. Të detyrojë mendësinë e kohës që të pranojë vetëm të vërtetat e trios profetike franceze si: sionistin e vetëdeklaruar Maurice Dantec, ekzorcistin

spiritual Philippe Muray dhe atë personalisht, Michel Houellebecq-un.

Të parandalojë shtetin në dënimin e shfrytëzuesve të prostitucionit, ngase vetëm kështu shpëtohet bashkëshortësia. Të pranohet nëse jo komplet si gjysmë profeti ngase parashikoi sulmet islamike në Francë.

Europeanët – e vërtetë – të nisin që sot me shtatëzënie masive të grave të tyre për të shpëtuar botën nga invadimi islam. Nga nata e fjalimit e tutje të shpallen të vdekur «lopët e shenjta», intelektualët, të mos dëgjohet më ajo kastë e «cofur» që nga Sartri e Levy, por vetëm shkrimtarët.

Ky është programi i Houellebecq me ultimatumin e huazuar nga miku i tij Maurice Dantec që iu bë kryeskandaloni nga mediat shtriga franceze e që përmbledhet këtu, citat: «Vetëm krishterimi dhe judaizmi janë të vetmet fuqi spirituale që mund ta përmbysin pushtetin e fuqisë tjetër spirituale -islamin» Këto përmbledhtazi janë paragrafët kryesore të programit Houellebecq. Nëse dikush mendon se kjo pasqyrë është e hiperbolizuar mund ta lexojë fjalimin komplet në faz.net, dhe do të vërejë është se vetëm minimumi i programit.

## II.

Për ta kuptuar një autor përtej asaj që e stampon me «vetërehabilitimin» pas ballinës së librit «Rrëfimi s'ka të bëjë asgjë me persona dhe ndodhi reale. Ai është produkt imagjinar i autorit», duhet t'ia lexosh biografinë. Kush është Michel Houellebecq? Ai lind në ishullin e kolonizuar nga Franca «Reunion» të oqeanit indian. Prindit nuk kujdesen fare për të. Si pasojë e kësaj ai detyrohet pesë vitet e para të fëmijërisë t'i kalojë në Algjeri tek njëra nga gjyshet. I ati

alpinist gjithë kohën endet maleve. E ëma infermiere mbetet shtatzënë nga njëri prej dashnorëve të shumtë të saj. Prindit ndahen. Si 6 vjeçar Michel-i përfundon tek gjyshja tjetër; një komuniste e ashpër dhe e përbetuar, mbiemrin e së cilës e përdor edhe sot autori, si pseudonim.

Gjersa e ëma e tij Janine Ceccaldi, thotë Michel të jetë lindur më 1956, autori rinon vetën për dy vjet dhe thotë të jetë lindur më 1958. E ëma përbetohet i biri i saj të jetë skizofrenik, gënjeshtar dhe të bëjë jetë në një botë ireale, prandaj ka qenë e detyruar që si fëmijë ta dorëzojë në një internat, nga ku Michel-i mbërrin deri të regjistrohet në Institutin Nacional të Agronomisë. Si agronom me profesion themelon revistën letrare «Karamazov», ku boton kryesisht vjershat e veta. Qysh si student martohet. I lindë një fëmijë. Bie në depresione të thella. Ndahet nga e shoqja. Përfundon në një klinike psikiatrike. Pas rehabilitimit gjen punë në Ministrinë e Bujqësisë. Boton romanin e parë të pasuksesshëm «Zgjerimi i zonës luftarake». Martohet sërish. Boton romanin e dytë të njohur «Pjesëzat elementare». Kritika franceze e përtokë për dy arsye: E para: autori e quan religjionin islam si më idiotin nga fetë monoteiste dhe e dyta: shpëtimin e njeriut evropian e sugjeron nëpërmjet gjenoteknikës, prodhimin e robotëve, më mirë të fundit se njerëz me besim islam. Jo me shtatzënie masive si së fundi. Ikë në Irlandë. Ikë edhe nga gruaja e tij e dytë. Ikë sërish në Spanjë, në Almeria. Në vitin 2013 kthehet sërish në Paris. Izolohet. Rikthehet me romanin «Nënshtrimi». Sërish kritika të ashpra që për titullin e romanit të njëjtë me atë të filmit të regjisorit holandez Theo van Gogh, i cili u ekzekutua nga terroristët islamik. Romani vizionarizon Francën nën sundimin islam – «si pasojë krejt normale pas një epoke miterraneske, të



majtë». Seksi dhe Islami janë temat boshte të romanit. Vetë FAZ, që e honoroi me shpërblimin, për romanin «Nënshtrimi», më 6 janar të vitit 2015 shkruante: «Ai luan me zjarrin, ai alimenton (financon imaterialisht) teoritë më abstruze (të maskuara) të ideologjive ekstreme të djathta».

Dhe pikërisht këtij autori FAZ ia ndanë shpërblimin për të njëjtin roman?

### III.

Po të ishte prostitucioni i lejuar në Algjerinë e viteve të 60-ta a do të kishte marrë rrjedhën e këtillë jeta dramatike e Michelit të rritur gjysheve e internateve? Ndoshta as ndarjet e shumta nga gratë nuk do t'i kishin ndodhur saherë të hynte-dilte pufëve parisiane, ngase edhe vetë shprehet t'i ketë pasur dashuri të njëmendta, prandaj edhe përfundoi në klinika psikiatrike. E të jesh pacient i këtyre «burgjeve më shkatërruese» siç i kulaifikonte Foucault dhe ta lexosh me objektivitete Freud-in do të ishte paradoksale. Po Marks, pse urrejtja ndaj tij? Ai është babai i gjithë intelektualëve francezë, atyre që sot bashkë me mediat sabotojnë, parandalojnë dy luftërat që duhet bërë patjetër: atë frontalen me krishterim dhe judaizëm siç kërkonte miku i tij të Maurice Dantec për ta përmbysur islamit dhe atë që kërkon Houellebecq, qenien robotike gjenoteknike për ta populluar Europën, të cilët së paku nuk do të çmendeshin nga emocionet – jo lindjet masive? – do të ishin të paraprogramueshëm dhe do të përbënin pseudohumanitetin e ri. Nietzsche duhet të vdes që të jetoj zoti, ai i krishterë me bazë judaike, se pa të nuk ka luftë ndërmjet feve.

Defekti i kësaj mendësie është fakti se fetë e kërkua nga Houellebecq poashtu ndalojnë prostitucionin. Apo

autori gjitha i donë pas shuarjes së tij që sipas tij mezi ia pret gazeta «Le Monde»? Atëherë kur robotët e formuar nga pjesëzat elementare gjenetike mund të programohen të funksionojnë pa seks. E pse të lejohet prostitucioni atëherë? Në këtë drejtim mund të bëjmë shaka në mënyrë enciklopedike me autorin e «Nënshttrimit». Ai del si një kloun i narkotizuar deliriumshëm përballë edhe intelektualit më të lodhur marksist dhe humb lojën. I lejohet se është artist. Ai nuk mund të humb seriozitetin se nuk e ka pasur asnjëherë. Seriozitetin e humbi «Frankfurter Allgemeine Zeitung», ngase realiteti serioz, ekzistent, terrorizmi islam nuk luftohet me esktremizma tjerë, me religjione luftarake (siç i koncepton Houellebecq ndryshe nga miku i tij Dantec që paqen e krishtere të Krishtit e kishte parim final) dhe me «Frontin National» të Le Pen-it, me gjitha këto bashkë që përbëjnë subjektin aktual Houellebecq, por me ato mjete që sugjerojnë intelektualët e gjithë taborëve: me njohjen reciproke, harmonizimin e botëve pa humbur identitetet dhe kulturat në favor të një ekspansioni siç kërkojnë të gjitha religjionet e sidomos këto të Abrahamit, Ibrahimit.

Hë për hë me sekularizmin, këtë gjetje intelektuale në gjendje të kthjellur, e cila është e vetmja mundësi që garanton koekzistencën saherë çmenden fetë, ideologjitë dhe shkrimtarët si ky që e trajtuam këtu, mund të shpresohet në ndonjë frymë triumfuese.

Është Micheli profet apo maniak? Profet nuk është ngase letrarizon me dramatikë skenat e veprës «The Clash of Civilizations» të Samuel Huntington-it mbi një rrezik të dalë më shumë nga vepra në fjalë se sa nga librat e shenjtë. E maniak? Jo. Nuk është intelektual, por shkrimtar që ka të drejtë t'i shpalojë instinktët e tij, e ato i thonë se duhet të

ketë frikë nga epidemia e terrorizmit islamik. Me kaq paranojë? Si duket Europa politike e mediale sot në këtë drejtim? Lexo FAZ-in dhe kupto shpërblimet e saja! (2016)

Pjesa e tretë  
DISKURSE

## BERNARD-HENRI LEVY

*«Kush e vrau Daniel Pearl», 2003*

Shkrimtari dhe filozofi i njohur francez Bernard-Henri Levy në romanin e tij të fundit «Kush e vrau Daniel Pearl»-in ka bërë rikonstruimin e vrasjes së gazetarit të «Wall Street Journal» në Karaçi. Përveç kësaj ai pretendon të ketë zhvilluar teorinë mbi «dimensionin antikuloror të xhihadizmit».

«Kush e vrau Daniel Pearl?» («Qui a tué Daniel Pearl» Grasset, Paris 2003) quhet romani hulumtues i filozofit dhe shkrimtarit francez me famë ndërkombëtare Bernard-Henri Levy. Libër, i cili si shumica e veprave pararendëse të këtij autori paralelisht u përkthye dhe botua edhe në shumë gjuhë të tjera perëndimore.

Daniel Pearl, korrespondenti i gazetës «Wall Street Journal» për Azinë Juglindore, ekzekutohet në mënyrë brutale me 23 janar të vitit 2002 nga rrëmbyesit e tij: terroristë të organizatës Al – Qaida! Dhe atë para kamerave.

Video që tronditën botën dhe arrin efektin që donin vrasësit: futjen e frikës tek «armiqtë e Allahut»! Frikë që nuk funksionoi tek Levy, i cili hiç më vonë se pas një muaji braktis Parisin në drejtim të Pakistanit për të hulumtuar rastin në vendin e ngjarjes (ku qëndron një vit), pothuaj me të njejtin tip vendimi kokëfortë siç kishte vendosur ta bëjë monografinë monumentale për Sartrin («Shekulli i Sartrit», Grasset 2000 Paris): «Do të ecë pas gjurmëve të njeriut që naivisht u zhyt në errësirë, do të ecë nga Islamabadi deri në Karaçi, do t'i bëj hapat e njejtë si ai, do të vëzhgojë si ai, mundësisht do të mendoj dhe ndjejë si ai – deri në fundin e hidhur, deri në çastin e vdekjes». Këtë vendim nuk ia luhat as arrestimi i Omar Sheikh, organizatorit të rrëmbimit të gazetarit amerikan Daniel Pearl, ky i fundit kishte udhëtuar atje për të hulumtuar origjinën e njeriut të pagëzuar nga mesmediat perëndimore si «këpucëbomba» e si duket kishte depërtuar në qarqet e rrezikshme të Al- Qaidës.

Levy mbrrin në Kandahar. Prej këtu nis rikonstruimi i stories. Kandahari ka qenë stacioni i parë e Daniel Pearl prej ku ka nisur lëvizjet e tij hulumtuese. Si e bën Levy këtë?

## MUXHAHEDINËT SI «GOLDEN BOYS»

Rrugëve të qyteteve pakistaneze, lagjeve plotë pluhur dhe baltë Levy kërkon njerëzit që kanë pasur kontakte me gazetarin Pearl: policë lokalë, informantë që çdo fjali e lënë përgjysmë duke mbajtur dorën zgjatur, ushtarakë të lartë, agjentë të policisë sekrete, avokatë dhe pjestarë të organizatave të ndryshme islamike. Takimet me ta shndërrohen në skena ekzotike, të frikshme, imazhe të një kohe që me qindra vjet s'leviz fare.

Bernard- Henri Levy merr një dhomë pikërisht në hotelin ku ka filluar e gjithë tragjedia – hotel i cili në librin «Kush e vrau Daniel Pearl?» del si një qendër e komandosëve të organizatave islame. Ne jemi pranë tij kur ai fillon t’i ndajë me kujdes një nga një fijet e marrimangës: ta shkapërderdh mitin e rrezikshëm të terrorizmit islam. Pikërisht në këtë «çerdhe» autori përpilon teorinë mbi «golden boys» e xihadit dhe izmës së tij.

Levy është mjeshtër i orientimit në xhungël: maqinaria vrasëse e xihadizmit nuk është vetëm një «bindje totale», përkulshmëri fanatike ndaj besimit, fésë, porse ajo është edhe një industri, një biznes me profite miliardëshe në xhepin e sheikëve dhe shërbimeve të ndryshme sekrete – kështu njëri nga konstatimet e Levyt. Ky paska qenë edhe shkaku i ekzekutimit ritual të Daniel Pearl. Ai ka depërtuar më shumë se sa duhet në aparatën e Al-Qaedës dhe është ballafaquar me ato fakte që s’duhej: bashkëpunimin dhe mbështetjen e Pakistanit zyrtar që gëzojnë organizatat e ndryshme fanatike e terroriste islame.

Pakistani?

Njëri nga aleatët besnikë të SHBA-ve në këtë luftë kaotike qenka njëri nga kandidatët më potentë të atij «boshtit të së keqes» që presidenti amerikan nuk e heq nga goja? Ky është apeli qëndror – shikuar nga aspekti politik – që Levy e bën nëpërmjet librit «Kush e vrau Daniel Pearl?»

Levy faktet për këtë i gjen në arkivat e pluhurosura të shërbimit sekret ind.

## AUTORI NË KONKURRENCË ME FIGURAT

Rrëfimi sipërfaqësisht rikonstruohet në bazë të dy biografive themelore: në atë të gazetarit «martir» Daniel

Pearl – i cili duke kërkuar origjinën dhe bazën e njeriut të mbiquajtur «këpucëbomba» zhytet në strukturat «mafioze» të Al – Qaeda-s dhe vritet para videokamerës – dhe vrasësit të tij Omar Sheikh, të dënuar me vdekje si organizator i vrasjes të të parit. Një terroristi që dikur ka pasur namin e kosmpolitit dhe absolventit brilant të School of Economics të Londrës e i cili pas kthimit në Kashmir dhe udhëtimit për në Bosnjë, Afganistan, Pakistan (dimensioni ndërkombëtar i xhihadizmit) shndrohet në një njeri brutal, në konto të cilit shkojnë dhjetra vrasje dhe rrëmbime. «Edhe ky armik i perëndimit është shkolluar në perëndim», thotë Levy plot mlllef.

Ndërsa biografia themelore që mban litarët në dorë, ngritet vetvetiu mbi dy të parat duke rrëfyer e përplotësuar historinë me hipoteza dhe konstatime të letrarizuara e sidomos duke ecur nëpër kujtimet personale është ajo e vetë autorit Bernard-Henri Levy. Pra përtej të së mirës (Pearl) dhe të keqes (Sheikh) ekziston një zonë që qëndron mbi ta, ajo zonë e Unit suprem të Autorit Levy. Ai rrëfen për veten më me përkushtim, për odisejadat e tij në Pakistan 1971: si perkrahës i flaktë i Z.A. Bhuttos, i cili bënte luftë për të marrë pushtetin.

Bangladesh 1973: si luftëtar i një njësie rezistence të një fisi në afërsi të Afganistanit. Bosnjë 1992-93: si judë perkrah muslimanëve të Sarajevës që përpiqen t'i rezistojnë okupimit serb (pikërisht në kohën kur mendohet që edhe Omar Sheikh të ketë qenë atje), pastaj pasojnë Ankara dhe Dubai (1994) e më në fund Israeli (2002).

Në këtë mënyrë shkrimtari, që në vitin 1970 debutoi me librin e tij të suksesshëm «Indes Rouge», nuk i del zot asaj që premtonte në fillim të librit, pra nuk sjell një rrëfim empatik («do të vëzhgojë si ai... do të mendojë dhe ndjejë si



ai...») por një «roman» që duket më shumë autobiografik për nga aspekti letrar e përmbajtësor i tij e që dy biografite tjera (po të spekulojmë) i përdor si ilustrim për ngritjen e një botëkuptimi filozofik personal mbi «dimensionin gjeografik e filozofik të xhihadizmit». Bota dhe gjithë tragjedia që plasohet në vepër nuk shihet me sytë e Daniel Pearl, por me sytë e Bernard-Henri Levyt.

Pra, përpjekja për të ndërtuar rrëfimin nisur nga duktusi multiperspektivësh kolidon me kryepesonazhin «hijerënde»: vetë autorin!

## KRITIKA

Në Amerikë romani nuk u përfill fare. Në botën gjermanofone u kritikua ashpër. Në Francë u ngrit në pedestal. Edhe rreth përcaktimit të zhanrit ka mospajtime: është roman, libër publicistik e gazetaresk apo një pamflet propolitic i ngjajshëm me ato librat e gjermanit Handke? Libri është një formë e përzier rrëfimi që në Francë ka arritur sukses: një lloj kollazhi letraro-gazetaresk që ndez sidomos në fushën e thrillerëve, romaneve historiko-dokumentarë dhe krimiromaneve. Një lloj «romani» që jashtë Francës ende nuk gjen përkrahës në fushën e shkencave të letërsisë. «Kush e vrau Daniel Pearl» është një kollazh i tillë: përderisa në njërin kapitull flitet me gjuhën e ftohtë të fakteve dhe gazetarisë hulumtuese në tjetrin kapitull del në pah mjeshtëria letrare, artistike e Levyt kur përshkruan, rrëfen, mediton për çështje të komplikuar filozofike si natyra e krimit, gjendja e njeriut rrugës për «në amshim» etj.

Lexuesi me lehtësi ndjek hapat e autorit rrugicave labirinth të Madrassa-s (atij qyteti në qytet ku është e

ndaluar hyrja e të huajve), sikur të ishte vetë aty. Çdo detaj, qoftë edhe ai më i parëndësishmi, në gjuhën e Levyt, shndërrohet në një element peisazhi që ngulitet e mbetet në memorien e lexuesit si stampë. Natyra e rrëfimit *a la* Sherlock Holmes tërheq, intensifikon kureshtjen e recipientit dhe ia merr atij të drejtën e kalkulimit, baraspeshimit apo formimit të një pikëpamjeje personale mbi definimet që shtron Levy në libër. Autori di si ta «burgos» lexuesin (sidomos atë naiv, të padjallëzuar) brenda murreve të rrëfimit të tij deri në atë masë sa që ky i fundit që në faqet e para e humb aftësinë e dallimit në mes fiksionit dhe realitetit. Ajo që pakashumë degradon nivelin artsitik të veprës është fjalori i rëndë që Levy kultivon në libër: Bastardët, barbarët, errësira islame, demonët të ngjajshme dhe atë jo vetëm kur bëhet fjalë për terroristët, por ato shpërthejnë në shumë situata e çaste ku s' duhej të ishin.

### TERRORI I MËVONË SI PËRGJIGJES FINALE

Levy di t'iu përgjigjet shumë pyetjeve në kontekstin islam-perëndim. Është një analizë e kompletuar letraro-politike me një strukturë dhe apel të qartë në aspekte të shumta morale, kulturore e filozofike. Kuptohet nga prizmi i «kufizuar» i autorit. Mirëpo është e qartë se: «Kush e vrau Daniel Pearl» është një libër që më shumë se çdo kanal tjetër, i mundshëm, të lehtëson udhëtimin në zemrën e organizatës aq të përfolur terroriste Al-Qaeda dhe jo vetëm kaq e mbitëgjitha: ai është një homazh për një gazetar që mizorisht u ekzekutua para kamerave vetëm pse donte të zbulojë një të vërtetë, pikërisht atë të vërtetë që s' duhej ta shpalonte dhe bëri që të merret vendimi për likuidimin e tij – nëse e kuptojmë drejt nëntekstin e Levyt – dhe atë jo vetëm nga Al-Qaeda. Për këtë arsye, përkundër dënimit me

vdekje të Omar Sheikh-ut, Levy edhe më tej pyetet: kush e vrau Daniel Pearl-in? (2003)

## HABERMAS, BENDIT, KONRAD, MAK

*Ave Europa? Eurodebati në krizë.*

Evropa në krizë? Në debatin aktual duket të jetë kështu. Intelektualët si Habermas, Cohn-Bendit, Konrad, Mak thonë se nacionalizmi, shpërndarja e keqe e kapitalit dhe religjionet bllokojnë emancipimin e mëtejme të kontinentit. Tezat dhe antitezat!

Politfilozofi, studenti me nam i Louis Althusser-it dhe romansieri Régis Debray së fundi në numrin e fundit të revistës europiane për kulturë «*Lettre International*» parashtrori pyetjen tashmë refren «a i erdhi fundi primatit të oskidentit mbi botën», çka automatikisht implikon moton «e pati Europa dhe SHBA-të»? Të «ngacmuar» nga ky diskurs intelektual dhe nga krizat e njëpasnjëshme që kohëve të fundit kanë përparë Europën edhe këtë vit debati ndërmjet studiuesve dhe intelektualëve kyç të kontinentit vazhdon me të njejtin intensitet.

Në librin e tij «Nën presionin e teknokratisë» (2013) filozofi i shkollës së Frankfurtit **Jürgen Habermas** mendon që Bashkësisë Evropiane i mungon vullneti politik dhe ai i solidaritetit të nevojshëm me anëtarët e saja që i ka kapluar kriza (Portugalia, Greqia dhe pothuaj shumica e vendeve të jugut). Nga kjo analizë doajeni i europianizmit kërkon nga

burokracia e Brukselit që të krijojë një çelës të ri të ndarjes së kapitalit brenda bashkësisë. Kjo perspektivë brenda diskursit mirëpo ka mobilizuar intelektualët konservativë dhe atyre ekstramarksistë që kërkojnë «braktisjen sa më të shpejtë të BE-së».

**Daniel Cohn-Bendit**, njëri nga kryeprotagonistët e protestave franceze e gjermane të vitit 1968, sot shef i fraksionit të të Gjelbërve në Parlamentin europian në librin e tij «Për Europën» (2013) bllokadën kryesore e sheh tek nacionalizmat e vendeve të Europës, të cilat jo se nuk janë zbutur pas rikonstituimit të Evropës por janë egërsuar edhe më shumë. Në «Manifestin» e tij ai i drejtohet çdo qytetari të kontinentit që ta luftojë «këtë të zezë të shekullit 19» që ende vazhdon të kërcënojë barazinë dhe demokracinë evropiane.

Në të njëjtën linjë argumenton edhe eseisti dhe shkrimtari i njohur ungarez **György Konrád** me librin e tij «Europa dhe kombet» (2013), vetëm se në formë më profunde dhe më qartë se Cohn – Bendit. Konrad sheh poashtu nacionalizmin si njërin nga problemet kyçe, mirëpo apelon për një mospërzierje të nacionalizimit dhe të drejtën e njerëzve në identitet, kulturë dhe etni, sepse këto sipas tij, janë poashtu të drejta supreme dhe themelore që njerëzit kanë drejtë ti kultivojnë. Intelektuali hungarez – ndër të vetmit – përfol edhe segmentin religjioz në këtë debat. Në eseun «E njëjtë Lenini apo Kurani – terrori është një biznes i keq» autori kërkon nga religjionet të jenë më aktivë dhe mos të luajnë lojën e dyfishtë, sepse më së shumti do të jenë ato vetë humbëse.

Publicisti holandez me renome ndërkombëtare, sidomos pas librit të tij «Në Europë» (2007)**Geert**

**Mak** qorton neoramonatikët dhe turboeuropianët (Habermasin me Co.) të kapen vetëm për fragmenteve të veçanta të problemit që kërcënon idenë evropiane. Sipas tij përqëndrimi vetëm tek format dhe variantet e racionalizimit të kapitalit është ikje nga problemet e vërteta të Europës, sepse ajo lëngon sidomos në aspektet më të rëndësishme të saja siç janë identiteti, politika, demokracia dhe barazia – kështu shkruan Geert Mak në librin e tij më të ri «Çka nëse dështon Europa» (2012), esetë e të cilit libër ribotohen brenda debatit aktual.

Edhe më kompletuar në këtë diskurs argumenton Profesori i i historisë në Augsburg dhe Fribourg **Martin Kaufhold** me studimin e tij «Vlerat Europiane» (2013), i cili konkludon se pikërisht «histerikët» më të mëdhenj në debat që kërkojnë ruajtjen dhe shpëtimin e Evropës nuk kanë dëshirë të flasin mbi vlerat evropiane që ecin në relacionin antikë – mesjetë – iluminizëm dhe sekularizëm. Sipas akademikut Kaufhold kjo intransparencë rezulton nga frika e filozofëve që mos ta krijojnë përshtypjen se Europa është produkt oksidental e jo i të gjithëve që sot jetojnë në të, çka për Kaufhold është një mashtrim i dyfishtë i vetëvetes dhe atyre që mendojnë ta tjetërsojnë realitetin.

*Faciti* - Debati është fundamental dhe konform problemeve që ka Europa. Kontinenti ngec në shumë drejtime dhe kriza e fundit e tronditë atë rëndë, megjithatë në krahasim me tjerët ai është me demokratiku dhe më dinamiku në kërkimin e formave të konsolidimit të mëtejme të lirive, demokracisë dhe barazisë ndër kombet. Se nacionalizmi është një problem nuk ka dilemë; se lobet dhe klubet e pangopura të kapitalit duhet disi të zmbarsen poashtu nuk ka dilemë. Dhe ndoshta Daniel Cohn Bendit

ka të drejtë; «Në momentin kur qytetari evropian ( të gjithë jo vetëm ata të BE-së) do të kuptojë se Europa është shtëpia e tij dhe do të veproj e ndiejë si i tillë do të fillojë faza konkrete e emancipimit të Europës». (2013)

DAWKINS, HITCHENS, HARRIS  
KUNDËR COLLINS, McGRATH DHE  
SPAEMANN

*Parada e neoateistëve*

Polemika mes feve, nihilizmit, humanizmit dhe ateizmit është ndezur sërish. Neoateistët e kanë fjalën. Shqiptarët vazhdojnë të mbeten indiferentë. Ateistët janë të ashpër. Religjiozët sillen të butë. Bariu i mirë kundër posthumanistit të përdhosur e therës. Kështu duket, shikuar sipërfaqësisht, debati më i ri mes neoateizmit dhe religjioneve, i cili që disa muaj ka përfshirë mediat e elitave intelektuale në Evropë dhe SHBA. Diskursi transkontinental rreth çështjes kyçe «ka apo nuk ka zot?» e djersit edhe në këtë epokë sërish trurin njerëzor.

Ndërkohë që ideologët dhe moralistët e feve të krishtera dhe ata të neoateizmit debatojnë mbi diferencat e tyre, «ajatollahët» islamikë as që përzihen në këtë diskurs. Këtë nuk e bëjnë ata jo për arsye se nuk kanë guxim, siç u shpreh një Islamolog iranian, por ngase klubi i të thinjurve nga Orienti është edhe më përjashtues ndaj të tjerëve, të cilët si ashtu e paskan vendin në atë rrethin e fundit të komedisë aligjeriane, prandaj s'ka as çfarë të bisedohet me «viktima» të tilla. Kështu thotë mesazhi nga Teherani.



Në këtë debat nuk marrin pjesë mirëpo as edhe ca fe të tjera madhore të planetit. Budistët dhe Hindutë gjithashtu heshtin. Përzierja e të parëve, pra budistëve, do ta bënte edhe më interesant debatin. Dalai Lama gëzon një autoritet të fuqishëm në qarqet intelektuale të botës perëndimore dhe do të ndikonte shumë për opsionin që përfaqëson ai. Po përse nuk përzihet Dalai Lama në këtë diskurs? Për arsye se ai nuk bën pjesë në llogoren e religjioneve abrahamite? Apo ka ndonjë arsye tjetër?

Para së gjithash ç'kërkojnë sot, në shekullin 21, fetë nga njerëzimi dhe përse ky debat sa herë që shfaqet i trondit gjitha cepat e kontinentet?

### *Ekskurs I: Debati aktual ndër shqiptarë*

Në letrat shqipe ende nuk ka arritur ky debat. Domethënë ai ende nuk ka mbërritur në këtë formë siç zhvillohet në pjesët e tjera të kontinentit. Në mediat shqiptare një debat i tillë u zhvillua më herët rreth lejimit apo moslejimit të përdorimit të simboleve polit-islamike nëpër vende publike.

Gjatë atij debati u bë fjalë më shumë se si duhet të sillen shqiptarët ndaj religjioneve të importuara, ndërsa në këtë debat bëhet fjalë edhe për një alternativë të tretë; ateizmin, të cilën shqiptarët e njohin si «specialitet të vetin» (Shqipëria komuniste dhe pjesa dërmuese e letërsisë së tyre kombëtare) dhe – në përparësi nga të tjerët – e njohin edhe si eksperiment të përjetuar.

Tjetër polemikë, që pati po ashtu karakterin e kësaj teme ishte ai rreth shpalljes së Kosovës si shtet laik. Pati zëra që akuzuan elitën politike kosovare të ketë vepruar pa kokë, kështu duke iu nënshtruar trysnisë së institucioneve supranacionale dhe vendosëse pa marrë parasysh elementet

kombëtare që duhej të përmbante identiteti i ri kosovar. Këto dy polemika dhe disa edhe më «intensive», të zhvilluara kohë më parë në media të ndryshme shqiptare, dëshmojnë se edhe ndër shqiptarët dominon dilema dhe preokupimi se si duhet reaguar ndaj njërit apo tjetrit religjion dhe se cili është roli i feve përbrenda identiteteve shqiptare?

## 1. MULTIPLIKIMI I NJË «PARANOJE» SHEKULLORE?

Kësaj radhe nuk janë humanistët erazmikë, as marksistët apo niçeanët e zgjuar keq ata që u bëjnë telashe kryeshtabeve të féve, kësaj radhe fjalën e kanë të të ashtuquajturit neoateistë. Ata janë të organizuar, dinë se si shfrytëzojnë mediat për të shpërndarë idetë e tyre, prijnë në treg dhe janë intelektualisht të përgatitur.

Richard Dawkins, Christopher Hitschens dhe Sam Harris janë tre përfaqësuesit e të ashtuquajturit «Ateizmi i Ri». Tre librat e tyre «The God Delusion», «The end of fait» dhe «God is not great – How Religion poisons Everything» vazhdojnë të mbajnë vendet e para në listat e bestsellerëve. I pari, libri i Dawkins, «Paranoja e Zotit», madje konsiderohet si megaseller. Që të tre kanë mesazhet e tyre konkrete: Duart larg nga Religjionet! Ato «helmojnë shoqëritë», bllokojnë çdo përparim paqësor të njerëzimit dhe «besimi s'është asgjë tjetër përveçse shprehje e prapambetjes», pra «në thelb një e metë psikike» që duhet shëruar.

Këtyre tre guruve të suksesshëm të «Ateizmit të Ri» u kanë dalë përballë tre shkencëtarë e filozofë gjithashtu me reputacion mondan si Asi i shkencave të natyrës dhe gjenetiku Francis Collins, filozofi Robert Spaeman dhe

mikrobiologu Alister McGrath. Veprat e këtyre – të cilat janë rezultat i këtij debati – si «Dawkins Delusion», «The Language of God» dhe «Das unsterbliche Gerücht» edhe pse shënuan sukses nuk arritën atë efekt siç bënë ato të ateistëve. Deri tani – kështu pohon analiza e shumicës së mediave – mbështetur në intensitetin e përhapjes së veprave dhe frekuentimit të kongreseve të tyre nga masat, debati zhvillohet në favor të ateistëve të rinj.

Ateizmi i ri për religjionet është «më i rrezikshmi nga gjithë të tjerët», shkruan kontrahenti i Dawkins, Alister McGrath, «sepse atë e përkrahin mediat». Këtu qëndron edhe problemi kapital: ndërkohë që në epokat e shkuara debati, me këtë edhe përhapja e tij, ishte i lokalizuar në sallonet dhe akademitë e kulturave të veçanta, sot ai arriti të mbulojë, për një kohë fare të shkurtër, më shumë se gjysmën e kontinenteve.

Shenjë që njeriu i shekullit 21 dëshiron të heqë dorë nga etika triadike jetë-vdekje-amshim? Apo ka të drejtë Dawkins kur thotë: «njerëzimi nuk është më aq injorant saqë të ketë frikë nga kërcënimet e ulëta të féve me djallin e ferrin»?

## 2. GJENEZA E DEBATIT

Debati është po aq i vjetër sa edhe vetë Fetë. Mendime e Teori që kundërshtojnë ekzistencën e hyjnive, zotërave dhe fenomeneve tjera transcendentale mund të gjejmë qysh në shkrimet e para të njerëzimit. Triumfi i religjioneve, pra institucionalizimi i tyre si udhëheqëse të pakontestueshme morale të kolektivit, ndryshoi gjendjen në këtë drejtim. Opinione e tilla, sidomos ato që tentonin të shndërroheshin në teori të përgjithshme, ndëshkoheshin

nga kisha me shuarje të pakompromistë. Edhe pse qysh dy shekuj më parë Dideroja kishte përpiluar librin e të vërtetave të tjera dhe teoria e specieve e Çarls Darvinit kishte filluar t'i gërryëjë në themel teoritë e sakralizuara mbi Gjenezën e Universit, Religjionet do ta mbajnë këtë monopol lidhur me çështje të moralit e formimit të njeriut deri në fillim të shekullit 20, influencë, e cila pastaj në postmodernizëm e deri sot funksionon sipas dinamikës së valëve – herë merr hov dhe ndikon dukshëm në rikonstruktimin e opinionit të masës e herë «denoncohet» si doktrinë negative që ka për synim çrregullimin e demokracive apo pushteteve ku ajo shfaqet.

Debati do të ndizet për të mos u shuar deri në ditët e sotme nga dy filozofët gjermanë Karl Marks dhe Friedrich Nietzsche. Teza e të parit «Feja është opium për masat» dhe ajo e të dytit «Zoti ka vdekur» (Gott ist tot) do të shndërrohen në maksima të të gjithë ateizmave që do të pasojnë.

Po në cilën linjë, në ç' traditë argumentojnë ateistët e sotëm; duke u bazuar në teorinë evolucioniste të Darvinit, duke u mbështetur në doktrinën marksiste, respektivisht komuniste që synonte të zhdukë një moral për ta zëvendësuar atë me një tjetër, apo reflekton Dawkins me kolegët e tij duke u mbështetur në nihilizmin zarathustrian të Nietzsches?

### 3. TEZAT E NEOATEISTËVE

Pikërisht këtu qëndron specifika që i dallon ateistët e rinj nga pararendësit e tyre. Dawkins, Hitchens, Harris dhe kompani për metodë kanë në radhë të parë përgënjeshttrimin e drejtpërdrejtë të mësimave të Biblës dhe Kuranit në bazë të «një logjike të kapshme dhe arsyeje të

shëndoshë». Ata nuk mbështeten në një ideologji të veçantë ose mbi një skemë të caktuar etike, por – siç pohojnë ata – bazohen në matematikën elementare të trurit dhe frymës. Reflektimet filozofike e empirike (kryesisht nga gjenetika, biologjia dhe filozofia) janë shkrirë në formë të tërthortë dhe evokuese përbrenda një teksti gati narrativ, qoftë në librat e shkrimtarëve Harris dhe Hitchens ku një formë e tillë e të shkruarit do të ishte e natyrshme e qoftë në ato të zoologut dhe biologut Dawkins.

RICHARD DAWKINS. Sipas tij Bibla (dhe Kurani si kopje e deformuar e së parës) është burimi i çdo regresi. Që njeriu i përngjanë një bombe vetëvrasëse dhe në mbarë historinë e tij nuk mundet të shporet nga vetëdija e urrejtjes, luftës dhe pushtetit mbi tjetrin qenka meritë e këtyre besimeve, të cilat ekzistencën e tyre e mbakan të gjallë vetëm duke përforcuar frikën, panikun dhe idiotizmin tek njerëzit. Për ta ilustruar këtë tezë të tij Dawkins në ligjëratat dhe paraqitjet e tij publike bën një krahasim që për shumikë është maja e agresivitetit neoateist: ai krahason presidentin Bush me Bin Ladenin si dy produkte të besimeve, të cilat dërmuan dhe zhgjakësuan humanitetin gjatë luftës së tyre për ta ngrënë njëra tjetrën: «Bush dhe Ladeni janë vërtetë në të njëjtën anë: në anën e Besimit dhe Dhunës kundër anës së Arsyes dhe Diskutimit. Që të dy kanë besimin kategorik, të kenë të drejtë dhe se tjetri është ai që duhet shfarosur». E kjo – për Dawkins – është skena aktuale që përshkruan fare saktë se ç'bëjnë fétë me humanitetin.

Çdo njeri normal, i pahelmuar me gënjeshtren historike mbi ekzistencën e një Zoti, sidomos sot në shekullin 21, u dashka ta ketë të qartë se «çdo besim që kërkon të ndjehemi të kënaqur me faktin se nuk mund ta kuptojmë botën, është qëllimkeq dhe ka për synim debilizimin e qenies humane».

CHRISTOPHER HITCHENS, publicist dhe kritik letrar, në librin e tij « Zoti nuk është i madhërishtëm – si religjioni helmon gjithçka» është edhe më asgjësues me antitezat e tij: Martin Luteri s'ishte asgjë më shumë se sa një tradhtarë bigot, poashtu Nënë Tereza dhe Martin Luther Kingu. «Feja», nëpërmjet këtyre misionarëve bigotë «mban të gjallë mizantropinë ndërmjet njerëzve». Religjioni mbjellka racizmin se gjithë ata që nuk besuakan kështu apo ashtu qenkan më me pak vlerë, qenkan për tu përjashtuar, për tu asimiluar, tjetërsuar apo asgjësuar. E kjo sipas Christopher Eric Hitchens është racizëm pur, më primitiv se çdo formë tjetër racizmi politik e kulturor. Ajo që poashtu tmerron Hitchens është: «pse të kërkojë një besimtar më shumë respekt për budallallëkun e tij se sa një maoist, një astrolog apo një racist». Edhe të tjerët që besojnë fanatikisht në besimet e tyre « duhet të kenë të njëjtën pozitë respekti apo përjashtimi siç kanë fundamentalistët e krishterë dhe muxhahedinët islamikë», kërkon Hitchens.

SAM HARRIS, për dallim nga dy kolegët e tij fokuson ofensivën e tij kryesisht kundër Islamit. Ky religjion aktualisht – dhe për kohën e mbetur të humanizmit, duke u bazuar në “Crash of Civilisations” të Huningtonit – qenka rreziku me të cilin bota do të përballet keqas deri në eliminimin e njerit apo tjetrit. Për shkak të «political Correctnes», elitat perëndimore nuk paskan të drejtë të sillen aq neglizhentë ndaj një rreziku kaq të madh siç është islamizmi, për këtë arsye Harris i bën thirrje elitës jashtislame që të flasë preras, qartë dhe mbi të gjitha realisht për katastrofën që mund t'ia sjellin qytetërimin terroristët mjekroshë nga Orienti.

Në librin e tij «The end of fait» shkrimtari britanik në esencë apelon tek njeriu i postmodernës që spiritualitetin dhe moralin e tij ta kërkoj në librin e njohur të filozofit Bertrand Russell «Pse unë nuk jam i krishterë» (1927), i cili religjionet i konsideron si «sëmundje të dala nga frika e njeriut» të paforcë përballë fenomeneve të universit dhe si një «përdhunim i natyrës njerëzore». Russell parashikon një rrezik permanent nga religjionet, të cilat pengojnë prosperitetin e botës humane, madje edhe duke e kthyer atë shumë shpesh në epokat më të errëta të tij – duke aluduar në këtë kontekst në fushatat e kryqëzatave, ndjekjen e shtrigave dhe shfarosjet epokale osmane.

Harris i ndërton tezat e tij pikërisht mbi këtë teori të Russellit.

Gjatë një krahasimi të tezave e trios neoateiste me ato të Bertrand Russell-it në librin “Pse nuk jam i krishterë” lehtë konstatojmë se bëhet fjalë për një teori të njëjtë, e cila tek neoateistët pasurohet nëpërmjet një *Updat* - i të kodeve dhe fenomeneve të kohës aktuale.

#### 4. TEZAT E APOLOGJETIKËVE OSE ADVOCATI EX DEI GRATIA

Tezat e mbrojtësve të Religjioneve nuk konstruktohen mbi bazën e ndonjë teorie të re, siç bëjnë ateistët duke manovruar me teori e statistika tashmë të dëshmuara nga fusha të ndryshme të shkencave natyrore. Ato në thelb nuk dallojnë nga Apologjetika tradicionale. Argumenti i tyre kapital edhe më tej vazhdon të jetë «mrekullia», ajo që njeriu është i pazot ta kapë dhe ta shpjegojë dhe që burimin mund ta ketë te një fuqi mbinatyrore siç është Perëndia.

Madje edhe shkencëtarët si Collins, të cilët gëzojnë një autoritet të pakontestueshëm edhe në qarqet jashtëkrishtere

nuk thirren gjithaq në fakte «të reja» dhe konkrete se pse mesazhet biblike qenkan e vërteta përfundimtare mbi universin dhe jetën në të. E re në diskursin e mbrojtësve të së vërtetës religjioze është mënyra se si ata polemizojnë. Intelktualët anti-ateistë, Collins dhe McGrath (duke përjashtuar në këtë kontekst anëtarin e tretë të këtij grupi Robert Spaeman), nuk mohojnë rolin e shkencës në arritjet e saja, pra nuk e shohin atë si diçka «djallëzore» dhe fajtores për dështimin moral të humanitetit, por e trajtojnë shkencën si diçka që Zoti e ka shpikur për t'i shërbyer njeriut në rrugën e emancipimit frymor e shpirtëror të tij. Gjë që për kundërshtarët s'është hiçgjë më shumë se sa edhe një potez i dobët i predikuesve religjiozë për të shpëtuar moralin «e prapambetur» fetar. Përderisa neoateistët janë të ashpër, janë agresiv në, evangjelistët shfaqen më të matur në gjykimin dhe kualifikimin e kundërshtarëve.

FRANCIS COLLINS i quan neoateistët «ekstremistë , ushtria e të cilëve përbëhet prej kukullave të barit». Sipas shkencëtarit të profiluar të Gjenetikës (Udhëheqës i projektit të suksesshëm amerikan «Human Genome Project», i cili ia doli që të deshifrojë një DNA -sekuencë të plotë njerëzore) shkenca nuk qenka në asnjë segment të saj në kundërshtim me të «vërtetat» që përfaqëson Bibla. Përkundrazi, thotë Collins, ato përplotësojnë njëra tjetrën. Në librin e tij «The Language of God», Collins radhit fenomene të ndryshme të pashpjegueshme nga Kosmologjia, Fizika, Biologjia e sidomos nga Gjenetika, të cilat dukuri, sipas tij nuk mund t'i krijojë asgjë dhe askush tjetër përveç Zotit. «Kodet e jetës», thotë ai «kanë një sistem aq të përkryer, saqë është e pamundur të mendosh se janë krijuar rastësisht dhe pa plan». Collins, i cili pohon që edhe vetë të ketë qenë ateist, para se të fliste me Zotin, mendon



se njeriu postmodern është ateist për arsye komoditeti; «jeta është shumë më e lehtë kur mendon se nuk ke përgjegjësi për të tjerët, por vetëm për veten. E vetes mund t'i përgjigjesh si të kesh dëshirë». Collins këtu reflekton sigurisht duke pasur parasysh alarmin e neoateistëve, të cilët apelojnë tek humaniteti të ruajë frymën e tij nga subverzorët e ndryshëm. Subverzorë, që mund të depërtojnë në trajtën e një ideologjie apo ideje dezorientuese, siç është besimi në Zot. Tezë, e cila për besimtarin kategorik Collins është rezultat i një lloj «verbërie e vetëdijshme kundër argumenteve, të cilat flasin në favor të besimit ». Ky është thelbi i komentit të Francis Collins se pse ka njerëz që me qejf donë të jenë ateistë.

Për recipientin e pasionuar që në librin «Gjuha e Zotit» kërkon argumente «të kapshme» e të forta në favor të religjioneve kundër neoateistëve ky shpjegim i shkencëtarit Collins ka gjasa që të mos mjaftojë. Ashtu siç nuk mjafton stória e tij rreth transformimit nga ateisti në besimtar. Storie, e cila edhe pse e bukur i mungon substanca për të bindur humanistin e sotëm që jeton në një ambient të hiperdigjitalizuar se megjithatë ka zot, sepse ajo bazohet po në atë mrekullinë subjektive e metafizike si shumica e «realiteteve» tjera religjioze.

Kështu e përshkruan Collins «rilindjen» e tij: «Gjatë një pasdite një paciente më pyeti: «Në çka besoni ju». Mu bë e qartë se nuk dija asnjë përgjigje. Kjo pyetje më shtyri ta studioj Biblën. Për çdo ditë më rritej bindja se ekzistenca e Zotit ishte shumë më logjike se sa mosekzistenca e tij. Ama ende nuk mundesha të vendosë. Një ditë duke udhëtuar për në Veriperëndim, duke ecur nëpër Cascade Mountans pash një ujëvarë njëqindmetërshe, të ngrirë. Një skenar gjigant, një bukuri e paparë. Dhe aty më foli Zoti «mos e shtyj më

tej». Të nesërmen rashë në gjuhë në një livadh të lagët të Uashingtonit dhe ia dorëzova jetën time Jezu Krishtit».

Irlandezi ALISTER McGRATH thotë gjithashtu të ketë qenë ateist. Fuqinë e argumentit biblik ai pohon ta ketë ndier gjatë studimit të Matematikës, Fizikës dhe Kimisë në Belfast, kur vendos që paralelisht me shkencat natyrore të studiojë edhe Teologjinë, ku edhe doktoron.

Sot ai, si Collins, konsiderohet si njëri nga evangjelistët më aktiv në mbrojtje të së “vërtetës biblike”. Në librin e tij “Paranoja e ateizmit – një përgjigje Richard Dawkins dhe fundamentalizmit ateist” McGrath sulmon neoateistët për shpifje dhe shtrembërim të qëllimshëm të fakteve për të diskredituar besimin. “Në krahasim me librat e mëparshëm të Dawkinsit “Paranoja e Zotit” është më i keqi, më joseriozi. Ai përsërit aty teza, tashmë të njohura qindra vjeç kundër besimit dhe krishterimit në përgjithësi. Më vjen keq që një shkencëtar aq i aftë të merret me sende të tilla”, shkruan McGrath, i cili poashtu si Dawkins ligjëron në universitetin e famshëm Oxford.

Religjioziteti i McGrath, edhe pse sipërfaqësisht duket i kulturuar dhe objektiv, sidomos në gjetjen e kompromiseve dhe krijimin e biotopeve ndërmjet dy armiqve tradicionalë religjion – shkencë, kur bie fjala për “krimet” historike që kanë prodhuar sistemet politike ateiste si Stalinizmi e të ngjashëm ai humbë baraspeshën dhe matematizmin duke u bërë tejmase i njëanshëm. Përpjekja, duke paraqitur vetëm stalinizmin si krimin më kapital të historisë, për të minimalizuar, dividuar dramat dhe krimet e shkaktuara nga fundamentalistët e krishterë (kryqëzatat, ndjekja e shtrigave – vetëm sa për të përmendur disa procese historike) e radhit atë, siç thotë Dawkins në taborin e atyre “apologjetëve të pashkollë” që gjithçka

përpiqen ta sqarojnë “me teorinë abstrakte dhe të pavërtetë të mrekullisë”. Stalinizmi është poashtu një etapë ku krimi ka mbizotëruar, ama i nuk ka qenë – sipas neoateistëve i bazuar në ndonjë filozofi ateiste, por për bazë ka pasur poashtu një religjiozitetin: Komunizmin. Konkretisht: Ouleanizmin (Dramë e Karl Marksit) marksist, e cila në vend të Zotit biblik preferon djallin që është poashtu produkt i religjioneve për të frikësuar njeriun.

McGrath njëjtë si koleget e tij proreligjiozë, edhe pse thirret në shkencë, tezat e ngritura kundër sulmeve ateiste i formulon mbi simbolikën biblike dhe transcendentalen.

Komunizmi dhe ateizmi nuk qenkan hiçgjë tjetër përveçse një religjion plus që ka për synim etablimin e vetë si besim universal dhe përmbysjen e konkurrencës, kështu përmbledhurazi teoria e filozofit të krishterë gjerman ROBERT SPAEMANN në librin “Shushuritja e amshueshme” sa i përket ateizmit dhe qëllimeve të tij.

«Krekosjes» së neoateistëve se vetëm ky «koncept frymor» - për dallim nga terrori islamik dhe ai i krishterë – nuk paska nxitur krime masive me përmasa apokaliptike, Spaemani përgjigjet me revolucionin ruso - komunist të Stalinit, i cili shfarosi miliona njerëz.

Spaemann, i cili thotë se edhe vetë ka qenë edhe ateist dhe komunist, respektivisht marksist, dallon nga dy apologjetët McGrath dhe Collin sa u përket bindjeve rreth raportit “harmonik” ndërmjet religjioneve dhe shkencës: «Është një mashtrim modern që të mendosh se ligjet e natyrës na sqaruakan neve botën, kur dihet se vetë ligjet e natyrës kanë nevojë për tu sqaruar». Sipas Spaeman shkenca pra ende nuk ka arritur të sqarojë veten, pse atëherë ajo merr guximin të sugjerojë sikur ta ketë gjetur të vërtetën që paska

apo nuk paska Zot. Gjithçka që mbetet pas këtij realiteti Robert Spaeman thotë «që të gjitha s'janë hiç më shumë se perspektiva subjektive: njëri i shikon gjërat kështu e tjetri ashtu». Çështje perspektive qenka se çka beson njeriu. Perspektiva e filozofit gjerman Spaeman është e qartë: Ka Zot. Ai është Krishti. Të tjerët ende nuk e kanë gjetur të vërtetën absolute.

## 5. INDIFERENCA E AKTORËVE PËRTEJ OKSIDENTIT DHE ORIENTIT

Përveç se gjatë të të ashtuquajturit «Revolucion Kulturor» – sipas disa historianëve prominentë – asnjëherë tjetër mësimet budiste nuk kanë hyrë në ndonjë konkurrencë garuese me religjionet tjera. Shumica e «prijësve» të revoltave panevropiane të 68-ës merrnin si model filozofimi mbi botën dhe jetën «Sinddhartën» e Herman Hesses. Ekzistencialistët e prirë nga Hipikët besonin se nëpërmjet kontemplacionit budist janë shumë më afër realitetit se sa nëpërmjet pikëpamjeve tjera konservative, që sipas tyre, deri atëherë e kishin bllokuar jetën në vendnumërim.

As në këtë etapë pra, kur mund të flitet për një shans ekspansioni, nuk ka qenë Dalai Lama ai që ka projektuar një nismë të tillë, por vetë evropianët që kanë qenë të inspiruar nga Hesse dhe vepra e tij probudiste.

Një tentativë e tillë budiste do të ishte krejtësisht kundër esencës së këtij religjioni, sepse Buddha nuk e ka konsideruar veten si Perëndi e as si sjellës i mesazheve të tij në Tokë. Në krahasim me Mosheun apo Musën dhe gjithë profetët tjerë abrahamitë, ky bën të qartë se Dharma e tij s'është asfare hyjnore, por vetëm një Kontemplacion (përjetimit meditativ), nëpërmjet të cilit njeriu arrin ta

«kuptojë natyrën e frymës së vet dhe të të gjitha sendeve që e rrethojnë». Një religjion (me rreth 500 milion ithtarë) që beson në Vetpërgjegjësinë e njeriut dhe që parandalon çdo lloj dogme.

Padyshim se këtu qëndron shkaku se pse Dalai Lama nuk shfaqet në polemikën e shpërthyer rreth të vërtetave të shumta «religjioze» mbi ekzistencën apo mosekzistencën e Zotit.

Ndërkaq vetë natyra e Hinduizmit dhe Vedave të saja parandalon çdo lloj synimi për ekspansion global. Kjo fe nuk njih «udhëheqës» tokësorë. Çdo njeri ka parafytyrimin personal për Zotin. Dhe sido që të vdes ai do të reinkarnohet në frymën e Brahman-it – frymës më të larte kozmike.

Nëse kemi parasysh këto rezonime e qëndrime filozofike të budizmit e Hinduizmit, atëherë mund të kuptojmë qartë se pse Dalai Lama luftën për dominancë të religjioneve abrahamite dhe atë të ateistëve i konsideron si një vërtetje infantile humane në rreth, e cila bën luftë banale duke injoruar ligjet e «rikthimit të përjetshëm» të qenieve dhe proceseve natyrore.

## PYETJA KAPITALE – PA PËRGGJIGJE!

Njërës nga pyetjet fundamentale të neoateizmit i ikin sheshazi avokatët e Jahwes ose Allahut. Pyetjes: a është Zoti racist? Pse ai ka zgjedhur judët apo arabët si popuj hyjnor e jo të tjerët, që shumë shekuj para tyre kanë disponuar me kultura e qytetërime të larta? Pse ai përjashton gjithë të tjerët duke i kualifikuar ata si të «padenjë» sie «të pavlerë» për të dhe «urdhëron» të **zgjedhurit** e tij që t'i emancipojnë ata? Këto pyetje neoateiste kanë një logjikë të qartë: ajo sugjeron akuzën se e vërteta e religjioneve në thelb qenka

raciste, sepse ajo përjashtoka të gjitha identitetet dhe kulturat tjera si idiote. Kultura e popuj, që nuk ia vlekën të kenë kontakt me Zotin.

Kësaj pyetjeje neoateiste është rëndë që t'i jepet një përgjigje konkrete dhe pa thirrë në ndihmë «mrekullitë». Sepse matematika e frymës humane çon vetëm në një rezultat: patjetër që Zoti ose të jetë racist ose ata dy popujt të gënjejnë. Po thonë neoateistët, ata gënjejnë, dhe atë me një qëllim historik: ata me shekuj përpiqen të bëjnë ekspansion frymor. E gjithë bota duhet të frymojë si njëra apo tjetra se përndryshe, sipas mendimit të tyre, Zoti do ta zhduk botën. «Kjo s'është asgjë tjetër përveç se një përdhunim i lirisë së kulturave dhe identiteteve tjera humane», bërtet Dawkins.

## NEOATEISTËT SI RELIGJIONET: EKSKLUZIONISTË!

Po, neoateistët a bien edhe ata në grackën e racizmit?

Nëse pranojmë teorinë mbi racizmin kulturor të John Solomos-it dhe Les Back-ut (*Forma të caktuara jetese, besime, tradita dhe norma të një bashkësie të caktuar njerëzish absolutizohen, paushalizohen dhe neutralizohen*), atëherë edhe neoateistët e bëjnë të njëjtin gabim si Religjionet në fjalë. Ata kualifikojnë si debilë dhe idiotë gjithë ata njerëz që kanë lejuar të bien pré e religjioneve «nacional – shoviniste» nga Arabia dhe Izraeli, pra gjithë atë pjesë bote që tashmë beson në hyjnitë nga Jerusalemi dhe Meka e Medina. Kjo madje është më shumë se racizëm kulturor, sepse nuk përjashton vetëm një kulturë e vetëm një identitet, por qindra prej tyre, pra më shumë se gjysmën e njerëzimit.

Rreth dilemës se sa racist është Zoti, respektivisht se sa raciste dhe çfarë racistesh janë Religjionet dhe Ateizmi mund të debatohet deri në pafundësi. E qartë është se religjionet kanë një Curriculum dhe të tashme ekspansioniste. Ashtu edhe neoateistët. Pyetja se a ka Zot apo gjithçka është shpikje e kulturave të caktuara do të vazhdojë edhe për shumë kohë të çajë trutë e njerëzimit. Ky është një mallkim apo fat që ndoshta do ta ndjek humanitetin deri në vdekjen e tij.

### *Ekskurs II: Indiferenca shqiptare*

Religjionet kanë luajtur gjithmonë një rol markant gjatë krijimit të identitetit shqiptar. Ato kanë qenë herë pjesa substanciale dhe e hapur e herë prapavija e pushtimeve të ndryshme. Asnjëherë në historinë e tyre shqiptarët nuk janë përpjekur të krijojnë doktrina të përmasave universale, pra të atilla me synimin për ta pushtuar mendjen njerëzore. Pra religjionet tek shqiptarët s'kanë qenë kurrë «të shtëpisë».

E gjithë kultura e dokumentuar shqiptare si letërsia, folklori, historia, gazetaria dhe sfera tjera kulturologjike dëshmojnë për një indiferencë të skajshme të shqiptarëve ndaj religjioneve. Shqiptari është qenia më «légère» dhe ma indiferente ndaj religjioneve që ekziston.

Pse dhe a është mirë kështu?

Shqiptari çdo ideologji të ardhur prej diku e ka njohur dhe konsideruar si një «ofertë» që duhet respektuar, por jo patjetër e ka marrë atë si alfa dhe omega që duhet kopjuar për të ekzistuar. Kështu ai është sjellë ndaj që të dy religjioneve abrahamite (Krishterimin dhe Myslimanizmin), kështu ai është sjellë ndaj ateizmit dhe ouleanizmit marksist.

A është i shëndetshëm ky qëndrim? Patjetër.

Kurani është antidemokratik, diskriminon femrën, është intolerant ndaj mendimit tjetër (kërkon ndjekjen dhe zhdukjen e tij) dhe përjashton të gjitha alternativat e mundshme të lirisë dhe vullentit njerëzor përveç atij që presupozon ta ofrojë vetë.

Bibla – Dhiata e Vjetër – është Nëna e Kuranit. Nga aty është vjedhë gjithçka dhe si e tillë nuk vlen hiç më shumë se Kurani si produkt plagjiat i të parit. A nuk duket sheshazi plagjiatura: qindra vjet më parë në tekstin e dhiatës së vjetër Ibrahimimi mban emrin Abraham, «hazreti» Jusufi Jozef, Musa Moshe e të ngjashme. Dhe shumë sende tjera që madje dhe fëmija i identifikon ende pa mësuar sa duhet alfabetin?

Dhiata e re: aty mbizotëron toleranca, por edhe ajo përjashton çdo alternativë tjetër. Që të dyja kanë burimin në orient. Çështja është se kemi të bëjmë me historinë e dy popujve të Lindjes së Afërt, të cilët dikur dhe sot pretendonin ta pushtojnë botën me modelin e tyre etik e frymor dhe që sot janë burimet (pra historitë e tyre) e një konflikti nervgërryes dhe shpeshherë dramatik.

Ideologji të tilla as që duhet marrë seriozisht.

Këtu ndoshta edhe qëndron baza e tolerancës shqiptare. Përpyekjet e ca qarqeve për të detyruar qeverinë kosovare apo atë shqiptarë të funksionojë sipas këtij apo atij modeli vetvetiu – nga natyra e debatit që u zhvillua – përfunduan si humbjekohe dhe pa ndonjë rëndësi relevante. Kjo është arsyeja themelore se pse shqiptarët nuk kyçen me aq energji në debatin aktual dhe intensiv ndërmjet religjioneve dhe neoateizmit sot.



## E DREJTA SUPREME E INDIVIDIT

Kapitale në këtë kontekst është çështja se religjionet abrahamite dhe neoateizmi shkelin mbi parimet themelore të të ashtuquajturit «civilizim postmodern».

Religjionet – ose filozofie e tyre – kolidojnë me pluralizmin, demokracinë dhe standardet tjera që garantojnë liritë e të drejtat njerëzore. Me këmbënguljen – secila për vete – që të kenë monopolin mbi të «vërtetën» hyjnore dhe se vetëm njëra apo tjera gjenden në rrugën e drejtë ato ofendojnë dhe diskriminojnë gjithë ata që nuk gjenden në taboret e tyre si «qenie të humbura» të planetit. Si njerëz të pa dinjitet. E kjo bie ndesh edhe me Kartën e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe gjithë konventat tjera ekzistuese që megjithatë janë nënshkruar nga shumica e kulturave dhe shteteve.

Është e drejtë e çdo njeriu të besoj dhe ushtrojë praktika që atij i duken se ia lehtësojnë «peshën e rëndë» të jetës, pa u kualifikuar si i padenjë, i pavlerë, idiot, i pafé (në kontekstin e vlerësimit) ose djall. Gjitha këto kualifikime që janë substanca e religjioneve dhe doktrina në fjalë janë produkt i një racizmi kulturor që duhet izoluar dhe refuzuar. Sidomos nuk duhet lejuar ata që të kenë sërish shansin për të diktuar funksionimin e një shoqërie, respektivisht të një shteti. Madje ato nuk duhet që të kenë as ndikimin më të vogël.

Liria e individit dhe frymës së tij duhet të vazhdojë ta mbajë primatin. Të drejtat e njeriut dhe pluralizmi politik e kulturor deri më sot kanë dëshmuar se janë të vetmet forma që parandalojnë kulturat e identitetet e priira nga fé e nacionalizma që t'ia hanë kokën njëri tjetrit, prandaj edhe mbeten të vetmet forma funksionale që duhet përkrahur e

vënë mbi çdo religjion a doktrinë që pas vetes ka një histori përplotë krime e që në thelb propagandon një superracë, pra një «pjesë njerëzimi» që e paska zgjedhur Zoti, ose një pjesë mase që paska kuptuar se sa debilë qenkan besimtarët.

Besimet s'duhet të kalojnë pragun e shtëpive private, sepse vetëm atje e kanë vendit. (2009)

## BERNARD-HENRI LÉVY

«Shekulli i Sartr-it», 2000

*Ekzistenca dhe esenca e shekullit që shkoi?*

Jean-Paul Sartre është mendimtari kryesor i shekullit 20, kështu pretendon ish studenti i tij. Filozofi i njohur francez Bernard-Henri Lévy ka shkruar biografinë e krijuesit të teorisë së ekzistencializmit – ai i ka bërë Sartrit monografi monumentale. Libri i tij «Shekulli i Sartr-it», konsiderohet si biografia më e suksesshme dhe më objektive që është shkruar ndonjëherë.

«Biografia e Bernard-Henri Lévy e bën Sartrin përsëri të gjallë», thotë kritiku i njohur gjerman Wolf Lepenis. Edhe më shumë se kaq. Biografia e Lévy-t na jep për herë të parë mundësinë që ta kuptojmë «fenomenin Sartre» më mirë se sa në kohën kur ai edhe fizikisht – mbështetur për dashnores së tij Simone de Beauvoir – endej rrugëve të Parisit.

«Shekulli i Sartrit» (Le siècle de Sartre) quhet libri voluminoz i H – B Lévy-t, i cili me të drejtë nga kritika konsiderohet si kryevepra e biografive. «Lévy ka shkruar një libër që si të tillë deri tani askush s'ka mundur ta shkruajë: një gurthemel në fushën e intelektualizmit», shprehet i fascinuar komentuesi i njohur gjerman i biografive Georges Neuvecelle.

Për filozofin ekzistencialist Jean-Paul Sartre deri më tani janë shkruar qindra biografi, portrete, ese e shumëçka tjetër, përse Lévy doli më i suksesshmi, ngadhënjeu mbi gjithë të tjerët duke bërë biografinë kapitale (deri më tani) mbi intelektualin, filozofin, shkrimtarin dhe njeriun më paradoksal të epokës sonë? Për arsye se ka qenë nxënësi i tij apo sepse më vonë u shndërrua në njërin nga kundërshtarët më të rreptë të filozofisë së tij?

«Isha tridhjetëvjeçar dhe para meje gjendej një kohë e pafundmë plotë iluzione, zhgënjime. E dija – dhe shpresoja – qysh atëherë se do të më mbetet kohë e mjaftueshme, se do të vijë një ditë kur do t'i hyjë në rrënjë historisë së komplikuar, paradoksale dhe të errët që mban emrin Sartre». Kjo është njëra ndër arsyet përse biografia e tij është kaq e suksesshme: Ai jo vetëm se ka jetuar në të njëjtën kohë me Sartre, ka mësuar te ai, porse edhe i vë vetes si detyrë jetësore zbërthimin, shpjegimin e filozofisë së tij. Një vendim që mund të merret vetëm një herë në jetë, posaçërisht kur ke të bësh me një gjigant si Jean – Paul Sartre.

## SARTRE DHE BEAUVOIR

Lévy librin e tij e hap me përshkrimin e ditës së varrimit të Sartrit. Atë ditë prilli kur para banesës së filozofit në bulevardin Edgar Quinet grupe njerëzish qëndronin gati për të nisur marshin për në varrezat e Parisit. Vetë struktura e pjesëmarrësve në varrim, e cila është përbërë prej pakistanezëve, disidentëve sovjetikë, sindikalistëve të majtë, grupacioneve të djathta, përfaqësuesve të postës, afrikanëve dhe aziatëve demonstroi faktin se fjala e Sartrit kishte prekur e bërë për vete jo vetëm të gjitha shtresat shoqërore

të jetës franceze, por edhe se «fjalët» e tij kishin arrirë në çdo kontinent dhe tek çdo popull i globit.

Në parathënien e Lévy-t, natyrisht paragrafi më prekës është imazhi i asaj gruas që rri ulur në krye të varrit të hapur, ashtu e përhumbur dhe pa asnjë lot në fytyrë. Gruaja që për shkak të dashurisë ndaj Sartr-it sakrifikoi veten me statusin e të qenurit hije: Simone de Beauvoir. Ajo që edhe sot e kësaj dite vazhdon të paguajë «llogaritë e hapura morale» për shkak të jetës së saj konkubine me mendimtarin kryesor të shekullit. Është kjo ajo gjysma e rëndësishme e Sartr -it (sidomos pas verbërimit të pjesërishëm të Sartrit viteve të fundit të jetës së tij) aq kapitale me të cilën Lévy e shkruan kapitullin e parë të librit të tij: Sartër dhe gratë! Ose më konkretisht: Jean-Paul Sartre dhe Simone de Beauvoir. Analiza e autorit mbi këtë lidhje, mbi këtë dashuri sjell një pasqyrë reale që përmbys të gjitha spekulimet e deritanishme – e veçanërisht ato që dolën pas publikimit të letrave të zonjës Beauvoir – për «Le Grande Sartreuse» (sartresha e madhe – poashtu emër i një likerit, pijeje alkoolike), siç thirret me shpoti Beauvoir. Sipas Lévy kjo lidhje parasëgjithash ka qenë një përbashkim i dy intelektualëve të barabartë dhe më shumë ka qenë një dashuri filozofike se sa diç tjetër. Faktin se ka qenë kështu autori e ilustron me krijimtarinë e Simone de Beauvoir në kohën postsartrine, me shkrimet që nuk mund të jenë tablo mendimesh të filozofit, madje pjesërisht kapërcejnë në drejtim të kundërt botëkuptimet e tij.

## «EKZISTENCA I PARAPRINË ESENCËS»

Sartre dhe Stendali, Spinoza, Hegeli, Nietzsche, Gide, Bergsoni e deri te Martin Heideggeri. Autori i biografisë zbërthen ekskursionet e mendimtarit si dhe shpjegon përse

ai nuk gjente tek asnjëra nga filozofit ekzistuese stacionin ku mund të pushonte duke pranuar si të vlefshëm kuptimin e tyre. Pse Sartre mendonte se teoritë e bëra mbi ekzistencializmin (Jaspers dhe Gabriel Marsel) s'vlenin fare.

As teoria e «idolit» të tij Heidegger “Qenia dhe koha” nuk ishte ajo që ai kërkonte. Sartre nuk pranonte mendimin jaspersian se qenia është e kushtëzuar nga besimi, religjioni e as atë të Heidegger-it se identiteti racor, nacional e etnik qenka përcaktuesi i rolit të qenies në kohë. Ky mendon se njeriu ekziston para se të jetë, pra «ekzistenca paraprinë esencën». Së pari duhet të jesh e pastaj mund të zgjedhësh se nga çka do ta bësh të varur kuptimin e qenies sate. Lévy, që edhe vetë është një filozof me famë botërore dhe njihet si kundërshtar i teorisë sartriane, lavdëron këtë përkufizim të mësuesit të tij të dikurshëm si tejet logjik e praktik, sidomos në epokën moderne ku liritë njerëzore luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e shoqërive.

### «SHTETI MOBIL»

Lévy në kapituj të tërë përqendrohet në zbërthimin e atyre paradokseve të shumta të këtij filozofi, të cilat për shumkë janë kokëçarëse, të pakuptueshme, të papërcaktueshme. Ishte Sartri një skizofren që brenda një ditë barte me vete disa personalitete: herë komunist, herë përkrahës i diktaturave të dhathta e kështu me radhë.

«Si mundej një filozof radikal e i majtë siç ishte Sartri të gjej frymëzim tek teoritë e dyshimta të Martin Heidegger-it? Si mundej Sartri i Revoltës, i cili me përkushtim kishte përkrahur nacionalistët algjerianë në luftën e tyre për pavarësi, të bëhet një zëdhënës po aq fanatik i Fidel Castros? Si kishte mundësi t'i quajë hungarezët “popull i papjekur” kur ata, gjatë vitit 1956, u çuan kundër

diktaturës? Pse e akuzonte Hrushovin të ketë bërë një gabim të madh, në kohën kur ky përpiqej të demaskojë krimet staliniste? Për çfarë arsye e quajti Solzhencinin “element të dëmshëm”», pyetet me të drejtë Bernard- Henri Lévy duke konstatuar se kanë ekzistuar dy J.P Sartre, dy fryma me një kokë, përafërsisht si ai përbindëshi tek Moby Dick, i cili poashtu si shkrimtari dhe filozofi kishte sy të shpërndarë larg njëri tjetrit – një lloj çiklopi. Kritika e Lévy në këtë drejtim është e ashpër dhe therëse, mirëpo ajo shpreh edhe një segment tjetër. Sartre ka qenë një si «shtet mobil»: Kur Franca ka marrë ndonjë qëndrim tjetërfare – nga ai siç ka menduar Sartri – ndaj ndonjë shteti, ai, menjëherë ka shkuar atje dhe duke u ulur pranë shefave të atyre shteteve, ka folur në emër të një France tjetër, ndryshe, pra si një lloj instituti për balancim, paraqitje, e cila shpesh, ka qenë më e rëndësishme se sa vetë politika zyrtare franceze.

## GËNJESHTRAT NË KURRIZ TË LETËRSISË

Mbi të gjitha apeli i Lévy është fare i qartë: «çka sot mbetet janë veprat e tij. E pikërisht kjo është më e rëndësishmja». Nga ky konkluzion nis edhe analiza mbi Sartre letrar. Veprimtaria e Sartrit është po aq voluminoze sa edhe teoria e tij filozofike. Lévy, biografisë «Fjalët» të Sartrit e kualifikon si një «gënjeshërë në kurriz të letërsisë; ku autori është aq i dashuruar në fjalë, saqë me plot mjeshtri artistike i vret ato». Nga ky botëkuptim mbi letërsinë ai mohon çmimin Nobel, kështu duke vënë në dyshim kompetencën e këtij instituti për të vlerësuar letërsinë. Letërsinë e tij. Shkencëtarët që kanë vlerësuar veprat – sipas tij – nuk janë ende në gjendje t’i kuptojnë ato, nuk e dinë se për çfarë bëhet fjalë aty, prandaj çmimi i tyre është i

pavlefshëm. Gjithçka në funksion të karakterit kontradiktor të Sartre. Mirëpo gjithë kjo – sipas Lévy – është material që i hyjnë në punë një biografie, por jo edhe nivelit parnasian të letërsisë së këtij shkrimtari që aq shumë ndikoi në formimin e vetëdijes së shekullit të fundit. Ai për Lévy-n mbetet intelektual absolut i shekullit. Libri i Bernard – Henri Lévy përmbillet në të njëjtën mënyrë siç hapet: në ceremoninë e varrimit të Sartrit. «Sot ka vdekur një djalë i ri», thotë një këngëtare plakë, të cilës Sartri ia ka shkruar tekstet e këngëve, ndërsa Parisi mblidhet i tëri përreth një varri duke pëshpëritur: «Ky plak ishte i riu jonë».



## EAGELTON, RIFKIN, JUDT, HAN

Eagelton: «Pse Marksii kishte të drejtë»

*Postmoderna si epokë e CashKulturës*

Debat i ashpër zhvillohet ndërmjet neomarksistëve dhe neoliberalëve. Së fundi Terry Eagelton ndezi atë edhe më shumë kur botoi librin «Pse Marksii kishte të drejtë». Neutralët ende nuk kanë përfunduar diagnozën e së tashmes për të thënë se ç'kërkon e nesërmja. Që të gjitha palët e kanë problem pushtetin vendosës që kanë koncernet globale mbi ekzistencën apo mosekzistencën e shoqërive, shteteve, ideologjive.

Si një bombë u prit libri më i ri i profesorit të Letërsisë Angleze dhe filozofit **Terry Eagelton**. Vetëm titulli shpjegon shumëçka: «Pse Marksii kishte të drejtë» (Ullstein, Berlin, 2012 [2011]), kështu titulli i librit! Kjo i bie njëjtte sikur ndonjë filozof shqiptar të shkruante «Pse Enver Hoxha kishte të drejtë?». Përdorim këtë krahasim jo për të paralelizuar peshën intelektuale të këtyre dyve, por për të përshkruar se ç'infarkti mendor shkakton një titull i tillë tek neoliberali i sotëm evropian, për të cilin Marksii është sinonim i diktaturës, komunizmit, dështimit, çnjerëzores, ashtu siç është edhe opinioni i shumicës së shqiptarëve për

diktatorin «e shtëpisë», pra jo racional, por më shumë subjektiv.

Në dhjetë kapituj Egelton merr mundin t'iu kundërvihet tezave kryesore të antimarksistëve, të cilët sidomos dhjetë viteve të fundit kanë fituar terren në diskutet publike.

Akademiku i University of Manchester dhe «katoliku marksist» - siç e quan T.E. veten – hedh benzinë dhe përdhos zjarrin edhe më shumë kur përsërit tezën e famshme të duos Marks – Engels në «Manifestin» e tyre «Komunist», e cila thotë: «armët me të cilat aristokracia rrëzoi për toke feudalizmin, janë drejtuar tani drejt saj». Egelton e formulon në mënyrë pak më moderne: «Pyetja se kush do ta rrëzoi kapitalizmin është e panevojshme. Kapitalizmi është vetë në gjendje që nëpërmjet kontradiktave që përmban ta shkatërrojë veten».

Sikur të ishte çuar vetë Marksi prej varri!

Këtu nisin kritikën, atakun mediat kryesore evropiane kundër Terry Egelton dhe e denoncojnë si «apologjet të padhëmbë të Marksizmit» (FAZ, 11.03.2012). Madje edhe më keq gazeta franceze «Liberation» zbuloi se Terry Egelton duke u përpjekur ta përshkruaj marksizmin sa më njerëzor i vizatoi Marksit një portret si ai i Barbie-t që di vetëm të përkëdhel. Një figuracion që implikon banalizimin e mëtejshëm të doktrinës marksiste.

Më shumë se sa recensione therrëse kundër një autori të caktuar, trajtesat e tilla janë pjesë e një debati të rindezur ndërmjet neomarksistëve dhe neoliberalëve.

## VETANATEMIMI I JOMARKSISTËVE

Kur doli nga shtypi libri «Reappraisals. Reflections on the Forgotten 20th Century» (Penguin Press, 2008) i

profesorit dhe historianit tashmë të ndjerë britanik **Tony Judt** mediat kryesore amerikane, gjermane, angleze e franceze bënë festë. «Më në fund një “histori” ndryshe, një diskurs që na pushon sytë dhe mendjen nga ato historitë e mërzitshme të intelektualëve të majtë (mendoj se është një aludim në «Epoka e ekstremist» të Eric Hobsbawm, 1994), kështu njëri nga recensentët në «New York Times». Të njëjtin opinion e gjejmë në «Neue Zürcher Zeitung», në «Times» apo në «Libération». Entuziazmi kishte këtë arsye: Tony Judt në librin e tij «Shekulli i harruar 20» portretizon intelektualët si Arthur Köstler, Albert Camus, Edward Said, Primo Levi, Henry Kissinger, Hannah Arendt, Raymond Aron dhe korrigjon biografitë e Louis Althusser, Eric Hobsbawm etj. Siç mund të vërehet që nga emrat kemi të bëjmë me dy klube të ndryshme intelektualësh, të cilët Judt i rreshton ballë për ballë për të konstatuar se; intelektualët marksistë kanë sunduar diskurset e shekullit njëzet çka edhe ka rezultuar në një anatëzim të padrejtë të (neo) liberalëve si Camu, Köstler, Aron, Jaspers, Maritain e të ngjashëm!

Entuziazmi i mediave e ka një defekt teknik kur ngul këmbë se libri me ese i Tony Judt-it botuar në vitin 2008 i thirri edhe njëherë mendësisë intelektuale se ekziston edhe një orientim tjetër më serioz, përveç atij marksist. Defekti është një çkalkulim për tre vjet. Tony Judt, tre vjet më herët, në librin e tij kryesor «Historia e Evropës – nga viti 1945 e deri sot», njërin nga kapitujt (VII) ia kushton pikërisht kësaj lufte kulturore dhe atë shumë më qartë dhe më në formë më argumentuese se sa në esetë që me vonësë i zbulojnë mediat e mëdha (libri i fundit i Judt konsumohet shumë lehtë se sa ai 1100 faqesh mbi historinë e Evropës).

Këtë korrigjim të domosdoshëm e saboton tash Terry Eagleton me librin e tij poashtu bestseller «Pse Marksi kishte të drejtë» dhe bën nervoz mediat që shpresuan të kenë shpëtuar nga mallkimi i dominancës së diskursit të majtë, ose asaj mendësie që i kërkonte intelektualit «t'i bashkohet asaj organizate e cila ka shkruar në flamurin e saj luftën kundër neoliberalizmit» (Foucault, Michel. Veprat kryesore, Suhrkamp, Frankfurt, 2008)

## SHKOLLAT MARKSISTE

Rusët më kot krekoseshin me programin e Zhdanovit në dorë (teoria e dy blloqeve intelektuale) të jenë konkurrenca e fortë e elitës intelektuale «kapitaliste». Jo pse ajo i kyçte edhe muzhikët e stepave në bllokun e vetë (Nikolai Alexandrowitsch Berdjajew) menjëherë sa të rekrutoheshin në ndonjë organizëm të aparatit shoqëror, porse epiqendra e inteligjencies gjendej mu në kapilarët kryesore të shoqërive kapitaliste. Jo Moska drejtonte timonin e refleksionit dhe kritikës ndaj sistemeve dhe proceseve sociale e ekonomike, por shkolla e Frankfurtit me Adorno-n, Horkheimer, Marcuse, Pollock-un, Benjamin-in e të ngjashëm në krye.

Tonelata më rëndë peshonte një fjalë e Sartrit nga Parisi se sa e gjithë zhurma dekadëshë e gjithë «miletit» të bllokut real-socialist (me satelitët bashkë). Një efekt që u pa me lëvizjet e 68-ës në mbarë globin, kur militantët, figurat kryesore të këtyre lëvizjeve endeshin me librat e Sartrit dhe me botimet e Horkheimer dhe Adorno-s .

Tony Judt ka të drejtë kur vajton për mungesën e autoritetit dhe me këtë edhe të respektit ndaj elitës intelektuale jomarksiste. Judt, mirëpo, në esetë e tij sugjeron përshtypjen sikur «bota e Zoti» t'i kenë pasur fajet

për këtë padrejtësi. Ai nuk lokalizon e identifikon konkretisht fajtorin që ka bllokuar përhapjen e ideve jomarksiste të autorëve që lakmon. Në një mënyrë fajin e adreson tek mungesa e mobilizimit konkret e organizative të elitave jo të majta. Gjë që nuk qëndron.

## KULTURA E KONGRESEVE DHE ZYRAVE TË CIA-S

Po si Moska që përpiquej të përvetësoje fabrikat intelektuale të perëndimit e me këtë edhe opinionin dominues kulturor edhe Washingtoni bënte çmos që të jap alternativat dhe direktivat e veta.

Nga frika që marksistët të mos ndezin revolucione kulturore brenda shoqërive demokratike (kapitaliste) CIA dhe qeveria amerikane krijuan në vitet e 50-ta Kongresin për Liri Kulturore (CFF). Në kryesi të saj u ulën; Bertrand Russell, Karl Jaspers, John Dewey, Benedetto Croce dhe filozofi katolik Jacques Maritain. Kryesisë së gjerë i përkonin edhe ish marksistët si; Albert Camus, Arthur Köstler, Raymond Aron, Ignazio Silone, Sideney Hook e të tjerë. Ky kongres (CCF) hapi zyra në 35 vende të botës. Revistat shkencore e elitare si «Encounter» (Angli), «Preuves» (Francë), «Tempo Presente» (Itali) dhe «Der Monat» (Gjermani) kishin për detyrë të mobilizojnë intelektualët në luftë kundër komunizmit (Judt, Historia e Evropës, Kapitulli VII, Pengiun 2005).

E gjithë kjo Industri nuk ndihmojë fare që në fund të viteve të 60-ta inspirues të lëvizjeve dhe thyerjeve të mëdha kulturore të jenë marksistët. As sot veprat e Russell-it, Jaspers-it, Aron-it, Köstler-it nuk hyn dot në konkurrencë me dominancën që mbajnë teoritë e Adorno-s, Horkheimer-it e sidomos Sartrit dhe pasardhësve të këtyre

siç është Egelton me kompani. Natyrisht që është obligim i specialistëve të shpjegojnë këtë fenomen, mirëpo edhe ne me kapitalin tonë modest intelektual po shohim se masat më shumë identifikojnë veten me literaturën e Slavoj Žižek (Së fundi; Shpirtat e këqij të zonës qiellore – Lufta e majtë për shekullin 21, Fisher, Frankfurt, 2011) që po si Egelton (kanë të njëjtën Apologji, veçse i pari teoretizon deri në dhimbje) apelojnë për një atentat ndaj kapitalizmit «para se ai të na mbysë» (TE) të gjithëve.

## EAGELTON DHE NEOMARKSISZMI

Që me veprën e tij «Ideologjia – një hyrje» (1991) dukej sheshazi se kah drejtohet akrepi intelektual i Terry Egelton. Po në këtë libër ai taborizon në një anë Lukasin, Gramscin, Marks-in, Engels-in, Adorno-n dhe Althauserin e në anën tjetër Schopenhauer-in, Nietzsche-n dhe Freud-in për të definuar në mënyrë sa më koncize bashkëveprimin e Filozofisë, Marksizmit dhe Psikanalizës. Një aksion që nuk u pranua, jo pse erdhi nga shkencëtari i letërsisë Egelton, por sepse eksperimenti nuk qe i suksesshëm. Megjithëkëto se Terry Egelton nuk mund të burgoset në kornizat e «marksistit» e di çdo recensent që së paku ka dëgjuar apo sipërfaqësisht lexuar dy veprat tjera të Terry Egelton-it. «Ideja e Kulturës» (Gjermanisht përkthyer si: Çka është Kultura, Oxford, 2000) e tij është një ndër teoritë më të mira mbi kulturën. Veprat si «E keqja» (Yale University, 2010), «Hyrje në shkencat e letërsisë» (1988) dhe «Kuptimi i Jetës» (2008) tashmë nuk kanë marrë statusin e veprave standarde nëpër seminarët e akademive përkatëse.

Pikërisht këtu mund ndoshta edhe të dekodejmë formulën e suksesit epokal të intelektualëve të majtë. Ata

rallë bëhen vox prima me programet e tyre ideologjike. Kryesisht ata krijojnë autoritetin dhe seriozitetin duke qenë autorë projektesh historike në fusha të ndryshme shkencore. Gjë që nuk mund të pohohet për konkurrencën aktuale të Eagelton-it, ose për atë brigadën që e numëron Tony Judt, të cilët ai postum i shpall neoliberalë.

Problemi tjetër që «u le terrenin për vete» neomarksistëve është mungesa e një programi konkret neoliberalë. Pas vdekjes së Adam Smith-it (teoria e të cilit po si ajo e Marksit nuk iu përshtaten më rrethanave të shekullit 21) nuk ka më ndonjë elitë intelektuale që do të jepte përgjigje – siç japin Eagelton, Hobsbawm dhe Žižek udhëzime për shekullin 21 – probleme konkrete për zhvillimin intelektual të kapitalizmit.

Debati i nxehtë (më shumë me libra se me paraqitje klasike nëpër gazeta) që po zhvillohet ndërmjet ithtarëve të dy blloqeve të trashëguara intelektuale për dominancë, siç shihet ka natyrën e luftës për mbijetesë, për kontinuitet e më pak për të rimanipluar botën se «komunizmi ka qenë aksident kolateral i socializmit», siç pretendon të bind Eagelton. Përderisa neoliberalët ende nuk e kanë gjetur derën se si të ikin nga Historia e të bëjnë aktualë – sidomos kur kemi parasysh krizën aktuale ekonomike – neomarksistët janë shndërruar në kapitalistë nga shitja e librave.

Është kjo anatomia e debatit evropian mbi ideologjitë?

Jo. Një përgjigje ka, mirëpo ajo operon jashtë kufijve të dy blloqeve dhe mendësive në fjalë. Më tepër teoria e «neutralëve» ka karakter neutral, diagnostik e kryesisht konfuz.

## FUNDI I IDEOLOGJIVE DHE FILLIMI I CASHKULTURËS?

Përtej këtij debati një elitë tjetër e përbërë nga filozofët dhe intelektualët Jeremy Rifkin («Civilizimi empatik», New York, 2009), Peter Sloterdijk («Në brendinë e botës së kapitalit», Frankfurt 2005), Tomáš Sedláček («Ekonomia e së Mirës dhe së Keqes», Oxford, New York, 2011), Byung-Chul Han («Aroma e Kohës», Bielefeld 2009) etj. janë të çliruar fare nga trashëgimia e blloqeve dhe përpiqen duke përshkruar të kuptojnë kohën, pa tentuar që paraprakisht t'ia servojnë asaj programin se si duhet të funksionojë.

Filozofi gjermano-korean Han shpalon arsyen se pse ideologjitë e lartëtrajtuara i sheh si irelevante për diagnostikimin e postmodernës. Sipas tij (Përtej shoqërive të disiplinës) shoqëritë kanë arritur shkallën absolute të mendësisë së rendimentit (ku çdo gjë matet nga kapaciteti prodhues). Edhe për Sloterdijk ka përcaktuar koha kur njeriu parimisht perceptohej si qenie humane që ka nevojë për liri dhe ekzistencë të virtytshme, sot, ajo, qenia matet sipas konditave krejtësisht tjera si rrjetëzimi kompatibël social (net kultura), forca e tij e konsumimit, rentabilitetit dhe niveli i komfortabilitetit. Për këtë edhe përpjekja e Sedláček për të «humanizuar» Wall Street-in dhe apeli i Jeremy Rifkin-it për ta përvetësuar «qytetërimin empatik si vetëdije globale».

Sipas kësaj diagnoze del se njerëzimi është zhveshur nga çdo lloj idealizmi, utopie dhe shprese dhe ka hyrë në stadin pragmatik të komoditetit, i cili kushtimisht arrihet vetëm në sajë të pasurisë (kreditkartës). Kjo ka sjellë shoqëritë që



të mos kenë mundësi vetkontrollimi. Çdo gjë komandohet (pa kontroll) nga valuta.

Kjo teori diagnostike që u përngjan atyre filozofive të lashta filozofike e religjioze (mallkimi i parasë, pangopësisë, mos solidaritetit) nuk premtion ndonjë potencial për të zëvendësuar as marksizmin praktik e utopik e as neoliberalizmin mbijetues e brutal, por vetëm e bën të qartë se kulaçin e dominimit do të vazhdojnë ta ndajnë edhe për shumë gjatë ideologjitë në fjalë me religjionet e shumta. (2012)

24

## TOMÁŠ SEDLÁČEK

«Ekonomia e së Mirës dhe së Keqes»

*Moralet dhe biznesi deri sot*

Profesori çek Tomáš Sedláček botoi librin «Ekonomia e së Mirës dhe së Keqes». Mediat evropiane e festojnë si intelektualin par exellance të kohës. Bestselleri që u proklamua në spikamë të ketë vënë kapitalistët, del si pledoaje, si mbrojtje të një morali historik ekonomik që nuk e gjejmë dot.

Václav Havel e solli nga perëndimi në Çeki dhe e bëri këshilltarin kryesor për ekonomi. Që atëherë (2001) Tomáš Sedláček është komentatori më i kërkuar dhe autori më i përkthyer i vendit. Me librin e tij të fundit «Ekonomie dobra a zla» (Ekonomia e së keqes dhe së mirës, 2009) Sedláček hyri ceremonialisht në klubin e zgjedhur të elitës evropiane. Libri u përkthye gati paralelisht me origjinalin në anglisht e gjermanisht.

Përtej suksesit personal libri i tij hapi, respektivisht rikonfiguroi debatin e nisur evropian mbi pushtetin e materialitetit (kapitalit) në vlerësimin apo çvlerësimin e identiteteve dhe kulturave të caktuara. Pikërisht në ato momente kur debatet kishin filluar të marrin konotacione

asgjësuese për «mentalitetin e çoroditur grek» që sjell në greminë gjithë ekonominë kontinentale shfaqet Sedláček me pledoajenë e tij për «homo economicus»- in e gabueshëm dhe të falshëm.

Sipërfaqësisht duket sikur autori sugjeron që fajin ta postojmë atje ku e kërkon moda: tek menaxherët e paskrupullt që kanë harruar etikën, atë moral tradicional që e propozojnë të gjitha konceptet kulturore humane që nga Gilgameshi e deri sot. Në lexim e sipër të veprës mirëpo na imponohet paradigma ( e re dhe e vjetër) se jo matematikat e sistemet ekonomike nuk janë të menduara suksesshëm e deri në fund, por njeriu, veçanërisht morali i tij i gjuetarit, grykësit dhe ekspansionistit të papërmirësueshëm krijon krizat si kjo që na ka përllarë kohëve të fundit.

## LIBRI

Profesori i të famshmit Universitet «Karl» të Pragës viziton epoka e kultura për të bërë të qartë se «këmbimi me mallra», ekonomia, qoftë edhe në këtë formë të egër të spekulimit siç është sot, nuk është gjetje e menaxherit postmodern, porse rrënjët i ka që në Enkidunë e pacivilizuar të Gilgameshit. Kapitulli i parë i librit trajton pikërisht këtë botë para katër mijë vjetësh. Nga këtu nis Tomáš Sedláček të na sjell idenë e tregtisë ndër njerëz si diçka krejt të natyrshme. Nëpërmjet të një interpretimi të pazakontë deri tani Gilgameshi dhe gjysmëkafsha Enkidu na dalin si qenie të një procesi krejt identik me atë të një bankieri që përpiqet me çdo kusht të shes hipoteka apo aksione në Wall Street. Nga anatomia e kësaj bote Sedláček kalon në ligjet e dhiatës së vjetër, duke krijuar kështu jo vetëm një kontinuitet tematik (lufta për kapital dhe sigurim të tij) por duke na sqaruar edhe një «huazim permanent e

historik» nga kultura në kulturë dhe atë nëpërmjet arkës së Noa-s, i cili kujdeset që malli, speciet dhe metodat të mbesin gjallë edhe atëherë kur planetit i kanoset rreziku i zhbërjes. Antika greke paraqitet si zonë akumulative e këtyre kulturave për të ndërtuar bazën deri tek pankrishterimi justinianik i Evropës. Fiziologjia mekanike (makinerike) e Descartes-it dhe teoria e bletëve të Bernard Mandevilles nuk kanë ndonjë vlerë më shumë si tendenca për ta sjellë diskursin deri tek farkëtari i ekonomisë moderne, pra tek kryeliberali historik Adam Smith.

Veç në kapitullin 8 e deri 10 Sedláček na njofton për qëllimin e tij kapital, pra demonstrimin e të së «vërtetës se ekonomia bëhet nga njerëz. Se në ekonomi bëhet fjalë për të Mirën dhe të Keqen. Bëhet fjalë për njerëz që rrëfejnë historira për njerëz tjerë... Gjithçka është një parabolë, një storie, nëpërmjet së cilës ne përpiqemi ta kuptojmë botën përreth».

## KRITIKA

«Libri është shkruar për mrekulli», shkruan Samuel Brittan i «Financial Times», i cili pranon se gjatë lekturës së librit nuk ka mundur më të lexojë diçka tjetër. «Der Spiegel» si zakonisht më kthjellët kap domenin qendror të autorit kur thotë se Sedláček përpiqet ta çlirojë moralin e bërë gërmadhë të ekonomistëve që kanë humbur çdo sens për realitetin nga shifrat e tyre të përdhosura». I pazakontë është rasti për letrat intelektuale evropere ndimore se për librin «Ekonomia e së Mirës dhe së Keqes» nuk gjejmë pothuaj as një recension të thelluar, të mirëfilltë, që do të ndihmonte recipientin të ecë anatomisë së librit edhe atëherë kur ndeshet me saga kulturologjike të panjohura si

ekonomia e sabbatit (?) apo katrahura e miteve të shumta që përлахen e groposen për qindarka të pavlershme.

Samuel Brittan ka të drejtë: libri është shkruar me një gjuhë dhe ritëm havelian. Si një prozë me një kapital të rëndë intelektual që kërkon përgjigjen në pyetjen se «sa moral lejon ekonomia?»

## DEFEKTET

Pikërisht kësaj pyetjeje nuk i përgjigjet Tomáš Sedláček. Ai i bën analizë historisë së moralit human, mirëpo duket sikur me çdokusht kursen aktualitetin. «Ai nuk flet për grumbullimin dhe monopolizimin e kapitalit nga një grusht grykësish që kanë buxhetin dhjetë herë më të madh se ekonomitë e dhjetëra shteteve bashkë», na thotë në një email marksisti dhe filozofi i papërmirësueshëm slloven Slavoj Žižek për Kohën Ditore. E kjo është e vërtetë sepse në veprën 500 faqesh të tij Sedláček na dhuron një ekskursion të bukur historisë së njerëzimit në lidhje me sjelljen e humanitetit ndaj kapitalit, mirëpo nuk na ofron edhe analizën e tij rreth «egërsisë tonë» (kapitulli i fundit) aktuale që nëpërmjet kapitalit ta ndajmë botën në të mjerë dhe në të privilegjuar.

## SYNIMI

Ndoshta nëpërmjet nëntekstit Tomáš Sedláček përpigjet të na e lansojë apelin se qëllimi (si telos) nuk është i moralshëm, s'ka qenë kurrë i moralshëm kur ka qenë në pyetje kapitali. Mirëpo ai apel, nëse ka qenë i planifikuar, nuk duket konkretisht askund. Ky ndoshta edhe nuk ka qenë synimi i autorit çek, që aq me pompozitet festohet nga

mediat evropiane, por siç shkuan Patrick Bernau i Frankfurter Allgemeine Sonntagszeitung (19.02.12); «Tomáš Sedláček na ofron një udhëtim të mrekullueshëm nëpër historinë e qytetërimit dhe mendimit human». Këtë autori çek e ka bërë vërtet për mrekulli. Poashtu meritë e tij është që në mediat kryesore evropiane ka muaj që debatohet ashpër për etikën në ekonomi dhe për rebalancimin e kapitalit në aspektin global.

## PETER SLOTERDIJK

(Fjalim falenderimi për çmimin Ludwig-Börne, 2013)

*Filozofia e imagjinimit kundër realitetit*

«Europa është një klub zbavitës që nuk zgjedh dot probleme serioze. SHBA – të e pas 11 shtatorit janë bërë skllavë të luftës së tyre imagjinare. Që të dyja format kanë një cak: atë të vetëshkatërrimit!», kështu diagnoza e kryefilozofit të popullarizuar Peter Sloterdijk. Ka vendosur edhe ky, përndryshe i pavarur, të bëhet neomarksist si Habermass & Co.?

Me librin e sapobotuar të tij „Reflektimet e njërit jo më apolitik“ (*Fjalim falenderimi gjatë marrjes së çmimit Ludwig-Börne, 2013*) filozofi gjerman Peter Sloterdijk si përherë, tronditi opinionin perëndimor me tezat e tij. Për BE-në tha se drejtohet nga entertainer-ë, e për SHBA-të mendon të jenë futur në një luftë të imagjinuar kundër islamit për t’iu ikur problemeve madhore të cilat veçse nuk eksplodojnë globin si: tëhollimi ekstrem i ozonit, kollapsi gjigant i sistemit të kapitalit, mungesa e resurseve energjetike dhe plotë të tjera si këto.

Sloterdijk, faktikisht, nuk thotë asgjë të re, pasi këto akuza ditinatë recitueshëm, zgjuar e gjumshëm, vend e pavend dhe papagajshëm i përsërisin intelektualët e

proveniencës neomarksiste dhe militantët e vonëzgjuar çegevaristë.

Pse atëherë kaq tërmet në mediat amerikane e europiane?

Arsyeja e reagimit qëndron tek komunikatori: Ai nuk i takon asnjë ideologjie, besohet të jetë vox liber-i i frymës pasmoderne dhe konsiderohet i pakorruptueshëm nga sistemet dhe doktrinën historike.

## BIOINFO

Lindja e tij ishte një krizë në vetë. Për shkak të një rhesus-inkompatibiliteti (mospërshtatshmëria e grupeve të gjakut ndërmjet nënës dhe foshnjës) mjekët gabimisht i dhanë foshnjës vetëm disa ditë afat për tu rikthyer në mosqenie. Nuk ndodhi. Përkundrazi. Qenia Peter Sloterdijk, e lindur në vitin 1947, në Karlsruhe të Gjermanisë edhe pas 66 viteve nxeh gjakra sa herë që shkruan dhe reflekton.

Popullaritetin akademike dhe mediave Peter Sloterdijk e fitoi me studimin e tij „Kritika e arsyes cinike“ (1983 – si aludim në antagoni ndaj „kritikës së arsyes së pastër“ të Kantit). Me veprat e mëvonshme; „Imperativi estetik“, „Derrida një egjiptas“, „Millefi dhe kapitali“, „Në zonën e brendshme të kapitalit“ (ku trajton dhe enverizmin) dhe „Ti duhet patjetër ta ndryshosh veten“ dhe mbi dyzet tjera të llojit preku dhe u ul në Olimpën e mendimit filozofik. Disa e konsiderojnë llafollog të pashtershëm, tjerët në të shohin filozofin, pas Nietzsches, me gjuhën më të thellë të mundshme. Për dhjetë vite (2002-2012) bashkë me kolegun e tij poashtu famëmadh Rüdiger Safranski drejtuan emisionin „Das Philosophische Quartett“. Aktualisht udhëton gjithandej kontinenteve duke ligjëruar për jetën,



botën, religjionet, ekzistosferat dhe subsferat e qenies, me një fjalë për çdogjë.

## ANTI SHBA

Në librin e radhës (titull identik me atë të Thomas Mannit: Vëzhgimet e një apolitiku) Sloterdijk pandeh që laboret e Pentagonit as vetë mos të jenë të vetëdijshme se çka i shkaktojnë humanitetit me formulën „war on terror“, e cila si një virus ka demoluar jo vetëm habitusin si ashtu ekcesiv amerikan, por edhe atë të europianit përndryshe racional e kantik, republikëhapur. Bakteria madje, sipas filozofit, përdoret edhe nga ata që në fakt do të duhej t'i dobësonte, siç është rasti me kryeministrin fundamentalist turk Erdogan, i cili protestat paqësore të Gazi-Parkut i sulmoi me po të njëjtën retorikë pentagoniane të „war on terror“-it. SHBA-të sot në botë u perceptokan më shumë si një Wanted – Company, e cila luftoka të keqen në adresë të gabuar, sepse, kështu Sloterdijk, 99%e terrorit vazhdon të jetë prodhim i shteteve, pra terror i organizuar dhe legal.

Që të majtët, këtë kritikë të ashpër të tij ndaj SHBA-ve, mos nguten ta llogarisin pro së vërtetës së tyre, aty ku kanë konzervuar edhe tezat e Habermas-it dhe Naom Chomsky-it, Sloterdijk ua riatakoi idhullin, konkurrentin kryesor të tij duke ironizuar: „po ta kishin konsultuar Habermasin pas sulmeve të 11 shtatorit do të thoshte të mos jetë kompetent, sepse qenka i specializuar vetëm për relacione simetrike ndërmjet subjekteve të parasortuara racionale“, kjo konkretisht implikon që Habermas flet vetëm atëherë kur akuzohen SHBA-të përndryshe nëse faktet janë në anën e tyre shpall veten inkompetent ose në pushime.

## ANTI BE

Shumëkush mendon por Sloterdijk e thotë: BE të jetë klub i paaftë për të zgjedhur ndonjë problem madhor të kohës përtej kufinjve nacionalë të anëtarëve të sajë të ngushtë.

Sloterdijk aludon sidomos në menaxhmentin e këtij suprainstitucioni në kohë krizash si lufta në Siri, kriza financiare, problemet në Ballkan, por edhe në ato të brendshmet si përballja me problemin e islamit politik, ekstremizmin e djathtë dhe të majtë e të ngjashme. Indirekt atakon edhe sjelljet iracionale të masave eurperendimore të „bëjnë referendume fantome për çështje që nuk kanë të bëjnë me realitetin konkret“ (kritikë ndaj iniciativave zvicerane, franceze... kundër ndërtimit të minareve dhe bartjes së shamive). Sloterdijk e përshkruan BE-në dhe vendet në të (jo vetëm anëtare) si kokëtundës kronikë të vendimeve amerikane që nuk dinë të mendojnë vetë.

## KRITIKA

Megjithatë, edhe pse nuk e pranon, me këtë ese Sloterdijk duket të ketë rrëshqitur hundëpërtoke në mendësinë e konspiracioneve antiamerikane. Nëse jo për diçka tjetër atëherë për shkak të njëanshmërisë.

Mirë kanë hetuar gazetat si FAZ dhe TA se Sloterdijk edhe pse përpiqet të duket sikur „padit“ gjithë botën, ai e bën atë vetëm ndaj një sfoere të caktuar të saj – perëndimit! Filozofi i cinizmit asketik dhe imperativit estetik nuk thotë gjësend për rolin e Kinës, Indisë dhe Rusisë në shkaktimin apo obligimin e tyre në zgjidhjen e problemeve.

Nga njëra anë ai akuzon SHBA të sillen si „boss-a revolverashë të globit“ e në anën tjetër terrë përgjegjësine për procesin vetëshkatërrues të planetit e kërkon prej tyre, çka del si antagoni tipike neomarksiste. Logjikë që në përkthim do t'i shkonte ai proverbi i njohur „ngjitu se të vrava, zbrit se të mbyta“. Konstatimi pra del i pakalkuluar mirë ngase rezulton thirrjen e maskuar ndaj SHBA-ve në realcion me „99% e terrorit është shtetëror“ e cila sikur dekodohet në imperativin: „mos i luftoni 1% terroristët islamikë, por ato shtete që bëjnë 99% të terrorit legal, shtetëror“!

Në kritikën e tij ndaj BE-së autori është më argumentues. Ndoshta për shkak se aty e ka banesën e rregullt. Brukseli vërtet deri tani u tregua impotent për të zgjedhur ndonjë krizë. Së fundi BE shëtiti ndërmjet Washington-it, Moska-s dhe Peking-ut sikur ta ketë humbur adresën. Demokracitë nacionale nuk ia varrin asnjë qëndrimi që del nga burokracia e qendrës në Belgjikë ose e zgjasin çdo vendim deri sa ai të çaktualizohet. Sa herë që skuqet qielli janë sërish SHBA-të që duhet të vënë veton për të debllokuar situatën. Ndryshe nuk eci gjë.

Kritika e Sloterdijk drejtuar Francës, Zvicrës, etj të votojnë për probleme imagjinare duket vërtet e huazuar nga divizioni i trurit të majtë e që nuk i rrin pragmatikut Sloterdijk: Votimet në Zvicër e gjetiu kundër minareve, shamive dhe burkave nuk dolën si ide të shpikura nga kuzhinat ksenofobe, por ato – duke bastisur argumentet e realpolitikës ekzistente – erdhën si reaksion ndaj kërkesave të zëshme të komunitetit islam në vendet përkatëse.

Sloterdijk me eseun e radhës rihapi debatin rreth rikonfigurimit të sferave të ndikimit global. Kjo është me

rëndësi. Ndoshta kësaj radhe – herat tjera dështuan – taboret majtas, djathtas, të mesit e neutralët u përfaqësojnë problemeve konkrete dhe japin ide të vështjeme në vend të teorive kot, respektivisht akuzave reciproke. (2013)

## SLAVOJ ŽIŽEK

«Lufta e re e klasave – arsyet e vërteta të ikjes dhe terrorit»,

*Religjioni megjithatë opium?*

Në librin: «Lufta e re e klasave – arsyet e vërteta të ikjes dhe terrorit», filozofi sloven i përmasave botërore Slavoj Žižek kërkon militarizimin e botës kundër kapitalizmit global dhe «monstrës islamike».

Revista tashmë 100 vjeçare amerikane «New Republic» e konsideron «filozofin më të rrezikshëm të perëndimit». Vitin që shkoi katokomunisti dhe filozofi me ndikim relevant Terry Eagleton (së fundi: *Vdekja e Zotit dhe kriza e kulturës*: 2015) kërkoj nga «sundimtarët e botës» ta lexojnë autorin e kryeveprës «*Më shumë se asgjë – Hegeli dhe hija e materializmit dialektik*» nëse duan vërtet ta shpëtojnë botën nga mizëria ku është zhyt (*The Guardian*). E pakontestueshme është se saherë që shkruan e flet Slavoj Žižek trondit, trand e tremb të gjithë bashkë: liberalistë, konservatorë, socialdemokratë, komunistë e religjione.

Veçanërisht dy librat e fundit: «*Mendime blasfemike – Islami dhe moderna*» (2015) dhe «*Lufta e re e klasave – arsyet e vërteta të ikjes dhe terrorit*» (2015-2016) kanë memecëruar shumicën e filozofëve lartë-poshtë oksidentit. Ka arritur psikanalisti lacanian, filozofi dhe teoriku nga Lubjana t'i argumentojë tezat e tij në mënyrë aq absolute saqë tjerët s'kanë më çka thonë? Kështu del pas përfoljes së librit të tij të fundit në mediat kryesore të Evropës dhe SHBA-ve.

Askush nuk guxon të përballet me të? Çka përmban broshura «Lufta e re e klasave – arsytet e vërteta të ikjes dhe terrorit» që u shpall si «manifesti» më i ri «i luftës së klasave» (ARD)?

### «KËRCËNIMI I DYFISHTË»

Librin, Žižek e hap duke huazuar teorinë pesëfazëshe të psikiatres zvicerano-amerikane Elisabeth Ross, me të cilin model donë të diagnostikojë gjendjen e evropianëve përballë krizave aktuale, sidomos këtë të refugjatëve. Modeli është ky: 1. Mospranimi i realitetit dhe izolimi 2. Mllef 3. Përpjekja për ta shtyrë zgjidhjen e problemit apo për ta zbutur atë 4. Depresion dh 5. Pranimi i realitetit siç është [F. 7]. Reagoi dhe veproi vërtet kështu Europa në këtë krizë? – më vonë tek analiza e tezave.

Realitetin, respektivisht burimin e të «gjitha të këqijave» Slavoj Žižek nis ta vizatojë poashtu me teorinë e një kolegu tjetër, i cili për dallim nga psikiatreja Ross është i një kategorie madje edhe më të rëndë se vetë Žižek: Peter Sloterdijk në veprën e tij «*Në brendabotën e kapitalit*» (2005: 26) koncernalizimin e resurseve dhe kapitalit global brenda olimpeve të spekulimit si *Wall Street* e të llojit e krahason me metaforën e Dostojevskit për «*Pallatin e kristaltë*» të Londrës (1864), kështu duke sugjeruar se resurset madje nuk janë në duar të shoqërive të pasura perëndimore, porse: «*Brendabota (e kapitalit) nuk është agorë apo ekspozitë shitëse nën qiellin e hapur, por një agregat i mbyllur që absorbon gjithçka nga jashtë për brenda (...)*» [27].

Okupimin, hapjen dhe rrënimin e këtyre fortesave të kapitalit kërkon Žižek. Aksion të cilin e ai pagëzon si «luftë të re klasash». Problemin kryesor për pamundësinë e realizimi të një veprimi të këtillë, të domosdoshëm kundër

«kapitalizmit global» Slavoj Žižek e sheh në mungesën e proletariatit që rezulton si pasojë e mungesës së elitave të sinqerta dhe të përgatitura komuniste. Kanë vdekur intelektualët e majtë europianë? Jo, por Žižek sugjeron të jenë kot fare, ngase kanë tradhtuar parimet bazë të marksizmit. Ilustrimin e kësaj teze ai e bënë me sjelljen e të majtëve ndaj Islamit politik dhe refugjatëve.

### «TË THYEJMË TABUTË E TË MAJTËVE»

E paaftë për tu përballur si me «neoliberalizimin anglosaksonik» ashtu edhe me «kapitalizmin autoritar të vlerave aziatike» dhe me BE-në jodemokratike [13] e majta nuk i shkoqet mantras së saj infantile që e manifeston si kritikë kundër eurocentrizmit [16]. Ajo ka: «bërë një “kompromis strategjik” në emër të anti-imperializmit pro doktrinave që ushtrojnë nateditë femicid serial, vrasin në turmë homoseksualë, hedhin bomba në koncertet e rokmuzikës, poshtërojnë femrën si genie (...)» [11]. Sjellje që komunistët e shek.21 detyrueshëm i bën avokatë të lodhur të «Boko Haram-it, Mugabes, Putinit» [10] dhe të regjimeve që i sponsorizojnë këtë doktrina e që njëkohësisht janë më fashistet e kapitalizmit global si «Emiratet e Bashkuara, Arabia Saudite, Katari, Turqia» e të llojit [45]. Sipas autorit vendet e «kapitalizmit të vlerave aziatike» janë shumë më të pasura se këto perëndimore dhe pranë vendeve nga vijnë refugjatët, «pse atëherë ato as nga dhjetë refugjatë nuk kanë strehuar? Sipas tij është e palejueshme të koketohet me vende që zyrtarisht luftojnë IS, mirëpo bombardojnë kurdët që de fakto dhe në terren luftojnë ISIS-in» [44].

Ato sillen dhe bëjnë ashtu, vendet arabe dhe Turqia, ngase kanë të bëjnë me një Europë që ka frikë të mbrojtë

vlerat e saja, pse jo edhe «eurocentrizmin». Žižek pyet nëse të majtët e dinë se Marksia ka qenë i tillë, eurocentrist [17] dhe se marksizmi nuk mund të jetë kompatibel me doktrina si ajo që ligjëron jo vetëm islami politik, por edhe ai kuranor?

Të majtët, sipas kryefilozofit të tyre, qëllimisht parashtrajnë çështjet gabimisht kur diskutojnë mbi të drejtat e njerëzve të besimit islam në Evropë ngase nuk pyesin: «çka bëjmë nëse në kantine ku fëmijëve myslimanë nuk u servohet mish i dërrit protestohet pse tjerët e hanë atë para tyre mish dërr? Si të veprojmë kur vajzave me shami u pengon se shoqet e tyre të klasës vijnë gjysmë të zhveshura? Si të veprojmë kur për shkak një, dy njerëzve që janë fantikë kërkohet detyrimi i shumicës të sillen konform tyre? [17]». Kjo përballje sipas autorit, kjo tolerancë e shumicës që nxit intolerancën e shtresës që kërkon privilegje për shkak të religjionit të saj saboton në mënyrën më brutale vlerat e egalitare, të drejtat bazë, shtetin social ... [17+52-55]». Të majtët besuakan të ringjallin revolucione duke keqpërdorur turmat fanatike dhe të rrezikshme më bazat themelore të lirive.

## ÇKA DUHET BËRË?

Kështu titulli i kapitullit të fundit në librin e fundit «*Lufta e re e klasave – arsytet e vërteta të ikjes dhe terrorit*» të njërit nga gurutë më të botuar aktual të mendimit universal. Kërkesat janë ndër më radikale dhe që me siguri i rrëqethin 27 filozofët më në zë të oksidentit e të ftuar në janar të këtij viti në revistën gjermano-frenceze «*Philosophie*» për të ofruar mundësitë e zgjidhjes së problemit të refugjatëve dhe të cilët operonin pikërisht me kodet e demantuara nga Žižek si të keqpërdorura siç janë:



borxhi dhe detyrimi (Aleida Assman), solidariteti i pakushtëzuar (Reinhard Merkel), pranimi i sa më shumëve (Peter Singer) e të ngjashëm.

Žižek kërkon një lloj «militarizimi» të shoqërive për çpushtetëzimin e këtyre qendrave globale të kapitalit. Ai kërkon militarizimin e çështjes së refugjatëve, duke angazhuar ushtritë supranacionale dhe nacionale (për shkak se kanë infrastrukturën dhe organizimin e nevojshëm) që të kujdesen për refugjatët në vendet menjëherë pranë të tyreve, pra organizatat si OKB-të, BE e të tjerat të detyrojnë vendet e pasura arabe – që edhe janë burimi i drejtpërdrejte i së keqes – që të pranojnë numrin më të madh të refugjatëve. [76-77]». Autori kërkon poashtu që Europa e sidomos e majta të mos u bëhet krah – duke tradhtuar parimet bazë të marksizmit – atyre që ushtrojnë «femicid serial», «vrasin rrugëve homoseksualë», «presin gjymtyrë kah mbërrijnë» dhe dhunojnë si pakistanezët në Rotherdam 1400 fëmijët (1997-2013) duke besuar se ushtrojnë ritet e tyre islame. Ai qorton të majtët, kolegët e tij antagonistë, jo të sinqertë të jenë e keqja e diskursit, ngase me «inJORANCËN e tyre» jo vetëm islamit fanatik por i shërbejnë edhe kapitalizmit të pamëshirshëm global që përpijnë gjithçka e sidomos njerëz.

## ANALIZA

Hordhitë spekulante të kapitalit global nuk janë klasë në kuptimin klasik të fjalës dhe ashtu siç e definonte Marksi, prandaj Žižek as që mund të argumentoj konkretisht se për cilat klasa e ka fjalën. Duke lokalizuar «pallatet e kristalta» të kapitalizmit global anglosaksonik dhe atë të vlerave

aziatike autori më shumë na përballë me qendra totalisht joideologjike, respektivisht të atilla që bëjnë biznes sa në New York aq edhe – siç shkruan ai vetë – në Kongo ku brenda 10 viteve të fundit janë vrarë rreth katër milion njerëz në luftën e warlord-ëve që luftojnë për minierat e diamantit, arit dhe kobaltit, pa të cilin, kobaltit nuk bën dot Iphon-ët dhe Samsung-ët. Pra këtu nuk kemi të bëjmë me komunizmin, konzervatizmin, liberalizmin, por me një rrjet spekulantësh vrasës që kanë monopolizuar kapitalin e globit në kurriz të popujve që u janë nënshtruar shitësve kriminelë. Ndoshta edhe për këtë arsye Žižek kërkon militarizimin. Kjo mizëri, mirëpo mund të ndalohet dhe zgjidhet vetëm me një mobilizim të shteteve të forta (për këtë apelonte Terry Eagleton që qeveritë ta mësojnë përmendsh Žižekun) demokratike, ato pra me vlerat «eurocentriste» e assesi nga Kina apo Koreja vetëm se janë më afër Marksit.

Defekti tjetër në manifestin e radhës të filozofit sloven është qasja se si ai e trajton eurocentrizmin. Vlerat që ai i radhit si eurocentrizmin, nuk kanë aspak të bëjnë me të fundit. Eurocentrizmi, nuk janë «egalitarizmi, shteti social...», por supermacia e kontinentalëve ndaj kulturozonave tjera. Eurocentrizëm është poashtu të mos pranosh fajin se deri me bombardimin e Irakut dhe shkatërrimin e Libisë së Gadafit Oksidenti perëndimi bartë një faj tepër të madh se pse sot gjithë këto miliona refugjatësh (të përgatitur dhe orkestruar siç thotë Žižek me të drejtë) duan me çdo kusht ta arrijnë Gjermaninë, Norvegjinë kryesisht për çështje ekonomike e shumë më pak për të shpëtuar jetën (ndryshe nuk do të donin patjetër të mbërrijnë tek më të pasurit).

Në lidhje me «monstrën islamike», siç e quan Žižek ka të drejtë, ashtu si në veprën paraprake, se sistemi i vlerave

të aritura në Evropë duhet të mbrohen e jo të falen në favor të ndonjë ideologjie aq retarde sa edhe antihumane.

Përkundër defekteve të shumta, antagonike në veprën e tij, Slavoj Žižek është intelektual i parë oksidental që flet gjërat në emër dhe pa dorëza. Tezat e tij tashmë diskutohen laboratorëve të perëndimorëve si pjesë e analizës që ka për temë titullin e kapitullit të fundit në librin që trajtojmë: çka duhet bërë?. Kriza as e refugjatëve e as kolapsit të mundshëm të sistemit financiar global nuk zgjidhet me në këtë mënyrë si sot. Kjo është e qartë. Mirëpo as problemi nuk sqarohet e zgjidhet me ato pesë fazat e zonjës Ross siç bën Žižek. Duhet më shumë – çështjet janë shumë më të komplikuar se sa duken! Ajo që qëndron si lapidar dhe bosht është e vërtetë: secili keqpërdor secilin (homo homini lupus) për të kap ndonjë copë nga kulaçi para se të mbarojë në «pallatin e kristaltë» dhe asgjë tjetër. Të majtët ndërsa s’qenkan as për ideal e as për kulaç, pasi njërin nuk e kanë e tjetrën s’dinë ta hanë – kështu sintheza e Slavoj Žižek.

## HANNAH ARENDT

*ose enigma e një kampanje*

Lajmi u shpërnda si rrufe: Hannah Arendt paska shkruar edhe një ese. Një që deri dje bota nuk e kishte parë. Trajtesa pa titull e datë hulumton lirinë. Saora u bë libër dhe u shpërnda në plotë gjuhë të botës. E famshmja «Der Spiegel» e shpalli bestseller. Një program i ri për lirinë? Jo. Për çka atëherë? E lexuam dhe u shokuam. Jo me autoren por me aktualizatorët e saj.

«Liria, për të qenë i lirë», «The Freedom to Be Free», kështu quhet esea e porsazbuluar e filozofes Hannah Arendt, e cila bashkë me Simone de Beauvoir përbëjnë dyshen femërore, më të spikatur të shekullit njëzet. Vetëm ca ditë pas daljes në treg, revista «Spiegel» e shpalli librin bestseller. Veçanërisht mediat gjermane fill e paralelisht e shndërruan botimin në spektakël, skandal dhe sensacion. Profesori dhe filozofi i Universitetit «Ludwig-Maximilian» të München-it, Thomas Meyer, në pasthënien e tij, rëndësinë e zbulimit e lidh me aktualitetin e përjetshëm që ka tema e «lirisë» në jetën e njeriut. Me theks të veçantë potencon ai degradimin që ky pasion human (liria) ka pësuar nisur nga agorat antike e deri sot. Është Arendt – sipas akademikut – e vetmja që këmbëngul në këtë fakt prapa-ecës historik. Domethënë kjo: sa më shumë zhvillim e iluminim aq më pak liri!

Për ç'arsye zbulimin mund ta kritikojmë edhe si sensacion, spektakël dhe skandal, me një fjalë si një formë jo aq e denjë për të aktualizuar dy singularët tashmë historik si «liria» dhe Hannah Arendt?

Kopertina e librit të botuar në gjermanishte.

## ORIGJINA E ESEUT DHE KRITIKA

Jerome Kohn nga «New York Institute of the Humanities», përndryshe ish komiliton dhe pastaj asistent i përjetësisht «Visiting Professor»-es Arendt zbuloi esenë e përmendur në «Library of Congress» të Washington-it. Teksti origjinal, të cilin ai prezantoi para mediave nuk mbante titull e as datë. Do ta ketë shkruar në vitin 1967? Kështu e situon zbuluesi datëlindjen e trajtesës. E nga erdhi titulli «The Freedom to Be Free»? Meyer ka të drejtë: titulli është citat i huazuar nga vepra e shkrimtarit dhe filozofit amerikan Henry David Thoreau.

Trajtesa 60 faqëshe mirëpo, as përafërsisht nuk manifeston atë kompletësi njohurish, atë integritet e koherencë, që e hasim në studimet e bëra më herët – nëse pranojmë moshën e tekstit sipas zbuluesit. Integritet, unikalitet dhe origjinalitet arëndtian rreth lirisë, të cilin e recipojmë jo ne esenë e fundit, por në plotë tekste të mëhershme, të shkruara dekada më parë, siç është për shembull ai «Liria dhe politika» që fillimisht ligjërohet në vitin 1958 në kuadër të ciklit «Edukimi me lirinë» në «Institutin për Hulumentimin e Botës së Jashtme» në Zürich e që pastaj, i njëjti tekst, një vit më vonë botohet edhe në «Chicago Review» [Freedom and Politics: A Lecture, në: CHR 14, Fletorja 1, Spring 1960, F. 28-46]. Për këtë arsye nuk mund të qëndrojë hipoteza e dy aktualizatorëve të filozofes dhe esesë «Liria, për të qenë i lirë», shkrimi të jetë përplotësues i mendimeve të saja mbi lirinë që ajo i zhvillon ndërmjet veprave «On Revolution» [New York: 1963] dhe përmbledhjes së botuar postum «The Life of the Mind» [New York: 1978]. Jo pra sepse tezat i hasim qartë të formuluar qysh në veprat më të hershme mbi totalitarizmin, në «Vita activa», në «The human Condition» [1951-1960] dhe tjera. Teksti i fundit me sugjerimin e botuesve për tu perceptuar si

sintezë apo përplotësues i teorisë së Arendt-it mbi Lirinë është eklatant. Ai devalvon konceptin en total të filozofes mbi lirinë. Eseja duket të jetë i një faze shumë më të hershme të autores, ndoshta e moshës 20-25 vjeçare, atëherë kur ajo reflekton mbi diktusin e Rousseau-së «njeriu të jetë gjithandej i pranguar»; asokohe kur ajo hulumton «skllavin dhe zotërinë» e Hegelit apo paradigmën e reja që sollën Heidegger, Jaspers. Linja e aporive që ajo tenton t'i hekuros në atë ese madje udhëtojnë që nga «Esenca e lirisë» së Schelling-ut të shekullit të 19, nëpërmjet zonave mentale të Augustinit mbi termin e dashurisë [Interpretimi i parë filozofik i Arendt: 1929] e deri në ditët e Sokratit platonik.

Ekspertët e Hannah Arendt-it e vërejnë pra shpejtë se libri «Liria, për të qenë i lirë», do të duhej të ekspozohet ndryshe nga seç e kanë bërë planin dy akademikët përndryshe meritueshëm të respektuar brenda diskursit publik perëndimor. Rikualizimi i temës së «lirisë» me metoda të konsumerizimit agresiv është paradoks në vete. Apo ishte kjo pikërisht strategjia, plani i biznesit i menaxherëve këndeje e përtej oqeanit; që nëpërmjet një aksioni banal e tejet enigmatik të rizgjojnë kureshtjen e mentaliteteve për temën e «lirisë». E tema në vete është e amshueshme, ashtu siç shkruante edhe Arendt vetë se «ajo nuk njuh të kaluar, tashmëri dhe ardhmëri».

## KONCEPTI I LIRISË TEK ARENDT

«Kuptimi i politikës është liria» shkruan Arendt. Ajo ishte e bindur se pikërisht këtë maksimë të saj nuk do ta kuptojnë asnjëherë masat, të cilat veprojnë sipas një dinamike që ua ka implantuar përvoja konkrete e ushqyer nga parimi krejtësisht ndryshe kuazi-aksiomatik që formulohet në «Liria fillon pikërisht nga aty ku përfundon politika». Këtë mendësi e kritikon Arendt si produkt të utopive që kanë prodhuar filozofitë oksidentale dhe religjionet abrahamite. Këto botëkuptime – thotë ajo – e kanë trajnuar Subjektin për shekuj politikën ta

kuptojë ekskluzivisht si «liberum arbitrium», si aftësi për zgjedhur në bazë të vullnetit të lirë, si mundësi për të dashur, dëshiruar, synuar (mentalisht), si mundësi për të zgjedhur ndërmjet të së Keqes dhe së Mirës. Por kjo nuk është aspak politika. Ndodhë e kundërta: ky qëndrim përjashton apriori Subjektin nga politika dhe detyron atë në jetë pasive, vegjetuese dhe afaktorizuese. «Parimi i shpresës» (siç sugjeronin marksistët e tipit Ernst Bloch që duke fjetur të ëndërrohet shoqëria parajsore e komunizmit) është për Arendt burgosja e njeriut në modusin jo-aktiv të vërdalljes maleve të kotësisë duke pëshpëritur «Unë besoj, unë dua». Jo «unë dua», por «unë mundem» atrakton njeriun të veprojë në favor të lirisë së tij. Natyrisht se pa dashur e vullnetëzuar diçka nuk vepron dot, por ku e marrim vesh se çka donë njeriu i shkyçur nga mundësia e shprehjes si në agorat antike të Polis-it ku agonaliteti (konkurrenca dhe gara në mendime publike) i jepte mundësi çdo qytetari të propozojë sipas vullnetit të tij, si në res publica-t romake dhe format tjera të participimit total që në komunizëm dhe neoliberalizëm u bënë të pamundshme nëpërmjet fintës, blofit të përfaqësimit parlamentaresk që të lejon vetëm të thuash «unë dua» të jetë ky apo përfaqësuesi im dhe këtu përfundon gjithçka.

Për Hannah Arendt – akumulueshëm thënë – liri nuk është mundësia për të zgjedhur, votuar ndërmjet disa opsioneve të paradhëna, por për të vepruar e krijuar vetë si subjekt!

Ku të veprojë subjekti nëse ai është peng i lirisë negative, konkretisht; nëse atij nuk i jepet liria për të vepruar për diçka, brenda një strukture, shoqërie, organizimi?

## DEFEKTET E KONCEPTIT ARENDTIAN

Sipas kësaj diagnoze dhe konceptimi të lirisë nga Arendt del sikur politika të jetë e vetmja rrugë nëpërmjet së cilës njeriu mund ta fitojë lirinë e tij – kjo sipas saj do të jetë gjithmonë kështu deri sa njeriu të jetojë në bashkësi. Kjo është e qartë edhe para regjistrimit filozofik që i bën dukurisë filozofja Arendt. Ajo që mbetet për tu pasqaruar është Si-ja? Duke vepruar! – thotë asketja e vita activa-s? Ky është imperativi i Hannah Arendt. Hyrja në aksion, nisja e luftës individuale për të siguruar sa më shumë liri.

E pikërisht në këtë gozhdë sharrës së humanitetit i thyhen kronikisht dhëmbët: para se njeriu të jetë aktiv politik; para se ai të futet në veprë, ai duhet të dijë çka donë. Në shoqëritë pa traditë agorash, pluralizmi, res public-ash, ku numri i atyre që lirinë nuk e konsiderojnë si përgjegjësi që duhet deleguar sa më shpejtë tek ndonjë përfaqësues është më pak se minimal. Vetëm Subjekti i shkolluar, ai që dinë të dallojë brenda vullnetit të vetë se çka është nevojë dhe dëshirë e tij e çka injeksion për ndonjë ideologji është i aftë të tejkalojë rubikonin e «unë dua» drejt veprimit konkret. Pastaj këtij veprimi i del edhe një murr shumë më i pakapërcyeshëm se gjitha tjerat që përmendëm: sigurimi i lirisë negative! Si të veprojë individi ta zëmë, të cilit nuk i jepet liria për të vepruar për diçka, brenda një strukture, shoqërie, organizimi?

«Liria, për të qenë i lirë» -folur me Isaiah Berlinin – është në praktikë si në sferën e demokracive të konsoliduara ashtu edhe në ato të tranzicionit e mos flasim për diktaturat ende në stadin paranegativ të saj. Lirinë për të qenë i lirë sipas vullnetit total personal e merr vetëm subjekti, ai që donë të dalë në xhungël ku s'ka ligje e norma, përndryshe liria e tij është përherë e instruktuar, e deleguar, e mundësuar apo ngushtuar nga shtetet, sundimet, ideologjitë në sajë të të cilave funksionojnë shtete.



Vetëm imperativi «vepro, bëhu aktiv brenda politikës», nuk mjafton. Ose mjafton aq sa për t'u bërë bazë për të ndërtuar doktrina retrorevolucionare si ato të Pierre Félix Bourdieu-s, Hardt & Negri apo të shërbejë si motivim për ndonjë kampanjë sensibilizuese si ajo e veteranit francez Stéphane Hessel me titullin bombastik «Indignez-vous!». «Indinjohuni» pra sa të doni, por edhe kjo është «gjendje pasive frymore» si ajo «unë dua», pasi vetëm urdhri nuk mjafton për të vënë në lëvizje mentalitetet e kulturat drejt lirisë – se cilës është histori madje edhe shumë më e komplikuar.

Arendt nuk mësoi nga Kant që imperativin e saj lirisë ta shoqëroj me një program konkret. Një program që sot do t'ia vlente shumë të aktualizohet nëse u jepte përgjigje atyre utopive postmoderne që i shfaqti së pari Joe Bailey (Pesimism. 1988: 573-576) dhe që kanë të bëjnë me çlirimin e njeriut të sotëm jo nga papjekuria e vetëshkaktuar kantike, pro nga vetëskllavërimi «vullnetar» i Subjektit të sotëm nga psikopolitka gllabëruese neoliberalë e konsumomanisë, vetoptimimit brutal në favor të renditës materiale, karrierës dhe dukurive tjera. Arendt përveç se nuk ka koncept të lirisë fare, ajo as me teoritë tjera të mrekullueshme rreth anatomisë së totalitarizmave nuk ndihmon sot dot, ngase këto, «diktaturat» e reja janë perfide dhe poashtu kanë mësuar nga homologet e tyre historike se si të veprojnë pa u perceptuar si të tilla nga shumica absolute e viktimave të tyre.

## ENIGMA E NJË KAMPANJE

Hannah Arendt është një filozofe që ka depërtuar si rrallëkush në anatinë e totalitarizmave që eskaluan në luftën e dytë botërore. Plus edhe duke qenë hebreje vetë i dha botës një shembull se si shkencëtari qoftë edhe vetë viktimë e holokaustit ka fuqinë t'i mbetet besnik objektivitetit. Me të drejtë ajo është lekturë akademike filozofike. Tendencë mirëpo për ta riaktualizuar atë me çdo kusht, nëpërmjet një eseje nga faza e

adoleshencës intelektuale të saj mbi temën e lirisë – më shumë e dëmton se sa që nxit ndonjë debat apo rritje të simpatisë për ta studiuar edhe më shumë se ç'është bërë deri tani. Në fund enigma mbetet: ç'deshën në të vërtetë të shkaktojnë dy akademikët që ndezën mediat botërore me esenë pa titull e pa datë të Hannah Arendt mbi lirinë?

Si do që të të jetë, edhe një herë bëhet e qartë se: Liria është temë përteper kompleksë dhe është absurd të tentosh ta mbyllësh atë brenda një imperativi pa përmbajtje.

*Ese mbi Epistemicidin*

Përveç luftërave tjera ku ndeshen për ta vrarë njëri tjetrin popujt, shtetet e kulturat, ekziston edhe lufta historike e gjenit kundër despotit dhe anashjelltas. I pari dijet dhe njohjet e fituara mbi botën, lirinë, njeriun dhe natyrën e tij i përhap formëfryme kohës e kujtesës. I dyti, tirani, që poashtu përdor përherë një doktrinë, filozofi, fé si mjet manipulimi për të mbajtur njeriun në psikokafaz, të pranguar këmbëduar brenda sistemit të tij, ka qenë historikisht, tash e tri mijë vjet të regjistruara nga kujtesa njerëzore, armiku i përbetuar i të parit. Gjersa gjeniu, i cili që nga iluminizmi e deri në postmodernë perceptohet si triumfatori, demiurgu i frymës së lirë, tirani është demoni, ati i së keqes absolute. Se pse është kështu e jo ndryshe – natyrisht me përjashtime – përpiqet të argumentohet në këtë ese. Dhe jo vetëm kaq. Në këtë tekst flitet nga një perspektivë aq e munguar në letrarinë globale – atë të epistemicidi![\*] Studimet e deritanishme në këtë drejtim përfolin e janë të përqendruara më shumë tek dëmet ndaj materialiave pa treguar kujdesin as minimal për njerëzit, bartësit e frymëve gjeniale që sot e në të ardhmen frekuentojnë si vektorë mentalitetesh, shkollash, filozofishë, kulturash, popujsh e paradigماش. Kjo lloj lufte ndërmjet frymës së lirë dhe atyre që duan të instrumentalizojnë për pushtet ose zhbëjnë vazhdon edhe sot – në forma tjera plus në modusin e saj klasik, si gjithmonë.

## I.

Gjatë vapës provinca hinde Karnataka nuk dallon nga shkretëtira subtropike namibiane Kalahari. E vetmja simfoni që herë pas here shpon murin hermetik të megasaunës përvëluese është ajo e mizave në kor me mushkonjat, të cilat edhe pse pas veti lënë dissonanta veshacaruese, dëshmojnë megjithatë endejetën fshatrave të braktisura të subkontinentit aziatik. Më 30 gusht të vitit 2015, kjo «harmoni» monotone gati e përhershme, u çrregullua nga një motoçikletë që zhurmshëm çante mëngjesin e Dharwad-it, qendrës kulturore të provincës. Dy të rinj, të veshur në të zeza, parkojnë motoçikletën para shtëpisë së poetit, akademikut dhe kritikut 77 vjeçar M.M. Kalburgi. Njëri prej tyre i bie ziles. Uma Devi, e shoqja e poetit hapë portën. I riu thotë të jetë studenti i profesorit dhe se dëshiron të flas me të. Uma Devi instruon të riun kah duhet të ecë për në studion e poetit dhe niset kuzhinës për t'ia bërë çajin mysafirit. Dy krisma. Umas i përplasen enët në dysheme. Vrapthi e në histeri, sa mbërrin në dhomën e ndejës, gjunjëkëputur bie mbi gjakun ende të ngrohtë që shpërndahet parketit si harta e një miti të ri. Aty, ajo gjen të shoqin e saj përdhë, të ekzekutuar, me dy plumba; njëri në ballë, tjetri në gjoks.

Zhurma e motoçikletës e suspendon nga ferri zonjën në moshë për ca sekonda, nga dritarja sheh të largohen dy të rinjtë me shpejtësi e zhurmë ashtu siç u shfaqën minuta më parë. Ata u larguan në drejtim të adresës, atje ku do të merrnin pastaj lëvdatat dhe paratë për krimin e kryer.

Ende pa mbërritur organet e rendit në shtëpinë e intelektualit kritik, partia e kryeministrit aktual Narendra Modi, «Bharatiya Janata Party» (BJP) e lëshon një komunikatë ku thuhet se «njëri nga intelektualët më me ndikim të vendit u vra për shkak të një grindjeje familjare». Bëhet fjalë për atë parti dhe për atë Narendra Modi për të cilin dihet se ishte arkitekti,

menaxheri dhe ekzekutori i krimit masiv të vitit 2002 në Gujarat, atij konflikti ku u vranë 254 hindusë, 790 myslimanë dhe edhe sot e kësaj dite dëbohen johindutë drejtimeve të panjohura të kësaj e asaj bote. «Vrasja», thotë shkrimtari ende i mbetur gjallë Uday Prakash «ishte ekzekutimi për shkak të kritikave që Kalburg-i ushtronte tash e sa vite me vepra e artikuj kundër hindu-nacionalizmit tashmë aq fashist e të padurueshëm». Ishte pra një exemplum facere, statuim i një shembulli që duhej të paralajmëronte ata me privilegun ende të jenë gjallë? Si dy ekzekutimet paraprake, të kryera poashtu nga dy të rinj, të veshur njëjtë në të zeza dhe po me një motoçikletë që u bënë ndaj dy poetëve tjerë Narendra Dabholkar (i vranë dy vite më parë poashtu në Gusht) dhe Govind Pansare (i vranë pesë muaj para të fundit).[1] Në të njëjtën formë dikur dhe nga e njëjta rrymë u ekzekutua edhe asketi, pacifisti, i shumë famshmi Mahatma Gandi.

## II.

Historia e humanitetit paralelisht është edhe faktografi e terrorit kundër dijes, dóxa-pluralitetit, vizioneve, librit dhe çdo mediumi a subjekti tjetër, i cili nxiste të vërteta ndryshe nga master-narrativa e despotit në sundim e sipër. Çdo despoti e deritanishme shumimin e bedelëve, abandonëve – të quajtur sot modernisht partiakë – e siguronte në sajë të libidos së imitimit, klounimit dhe multiplikimit të vetes. Dhe pasi as edhe perandori më agresiv e më i inteligjent i historise nuk ia doli të krijonte ndonjëherë monarkinë e tij absolute, njëdimensionale, hermetikisht imune karshi viruseve të konkurrencës që poashtu bënin luftë për pushtet, çdoherë, çdo tiran vritej, helmohej nëse jo nga fëmijët, nga gruaja atëherë nga kundërshtarët e tij. Andaj çdo epokë nga njëra anë ka kalorësit apokaliptikë, cezarët, stalinët e hitlerët e saj e nga ana tjetër kontrahentët e tyre, të cilët

si rëndom janë të së njëjtës kategori – tiranët e ardhshëm në luftë me tiranët e aktual.

Matanë këtij mulliri specie- e planetshkatërrues, ishte vetëm kategoria e liberove\*\*, që paguante haraçin pa marrë pjesë fare në arenën e ngushtë brenda paralelogramit vetëdegjenerues të kandidatëve të sëmurë për pushtet! Këta ishin, poetët, artistët, intelektualët – gjenitë, të cilët u vranë përherë kryesisht ngase frymonin, mendonin dhe besonin ndryshe se ç ‘donin despotët me «popujt» e tyre. Luftë paranojake njëshash të përllarë nga demonët e pushtetit kjo, atyre kundër dijes së personifikuar në subjektin e tjetrit. Kjo garë e përjetshme ndërmjet së Mirës dhe së Keqes, nuk shpjegohet pa e rrëfyer paralelisht edhe historinë e despotit, ideologjisë dhe atyre demonëve që mobilizonin aq shpejtë gjithë akterët malinjë për të zbrazur e akumuluar tërë arsenalin timotik të masave në formën e zjarrit, plumbit apo në trajtën e litarit siç preferonin dikur ata që në fytyrë mbanin «maskën e mortit të kuq» të Edgar Allan Poe-s. Vetëkuptohet se për despotët kjo kategori ishte ajo më fragjilja, më e lëndueshmja se sa që mund të ishte çdo armik tjetër politik apo militarist. Nga ana tjetër mirëpo, pikërisht ishte kjo përparësia e liberove përballë edhe diktaturës sa do të egër. Me armiqtë bën luftë me shpata, topa e raketa, ndërkaq në betejë me gjenitë nuk të vyejnë ato fare. Nuk janë ushtri së cilës mund t’ia dërgosh gjeneralët apokaliptikë që t’i asgjësojnë në fushëbetejë, por individë të veçantë me fuqinë karizmatike që jo me plumba e bomba por me fjalë e shkronja hapnin vrima të mëdha edhe në murrin më të trashë, plot e beton e çelik të çdo diktature të mundshme. Për këtë arsye çdo vrasje gjeniu konsiderohet edhe si luftë interpersonale ndërmjet diktatorit dhe gjenit, edhe pse kjo përplasje shekujsh prodhoi singularin tashmë aq në numër sa një subkontinent në vete: atë të martirëve të dijes, arteve, atë të lirisë. Martirë që në asnjë mënyrë nuk mund ta kenë babë Adamin, as Polikarpin nga Smyrna, madje as Sokratin e dënuar me

vetëhelmim e as ndonjë epigon të Konfucios, pasi paraardhësi i gjithë martirëve është ai i panjohuri i parë që u vra sapo zbuloi teknikën e fiksimit të epistemave në gur, dru, lëkurë, letër apo duke i vizatuar ato si figura, shenja mureve të shpellave e zgafelleve kontinenteve në formim e sipër.

Para se të mëtojme ta përshkruajmë sa më gjallë botën e despotive kundër dijes, frikën e tyre nga shpirti i lirë, aparatën e tyre ndëshkues dhe vrasës, arsyet, paranojat le të lëmë historinë që ajo të rrëfejë me gjuhën e saj konfliktin e përjetshëm ndërmjet liridhunuesve, vrasësve dhe botëpohuesve, libertinëve.

### III. NGA PARANTIKA DERI NË MESJETË

23 shekuj para «revolucionit kulturor» të Maos njëri nga urgjshërit e tij është i pari që hapi kapitullin e errët të historisë së Epistemocidit. Perandori kinez Qin Shi Huang Di[2]\*\*\*, i mbiquajtur «i pari zot madhështor», themeluesi i dinastisë Qin [221-207] dhe ushtrisë nga balta, sapo pushtoi disa vende rreth Kinës urdhëroi kancelarin e tij Li Si [213] të organizojë mbylljen e të gjitha shkollave filozofike dhe djegien e çdo libri. Arsyetimi nis kështu: «Të urtit nuk ligjërojnë për tashmërinë, por për të kaluarën. Ata kritikojnë kohën tonë dhe u ngatërrojnë mendjen flokëzinjve. Kur ata dëgjojnë urdhrin e perandorit debatojnë secili sipas opinionit që ka. Kur vijnë në oborin e perandorit lëndojnë zemrën e tij me kritika e sa dalin jashtë flasin se ç'i thanë perandorit-zot. Pasi duke kritikuar perandorin fitojnë famë. Kështu ata nxisin edhe nxënësit e tyre të difamojnë perandorin. Nëse gjitha këto nuk ndalohen do të dobësohet pushteti i perandorit dhe do të formohen parti. Për këtë arsye ju lutem që të digjen gjitha shkrimet, reliktet dhe shenjat historike që nuk i përkojnë epokës së perandorit tonë dhe akademisë së oborrit [...]»[2]. 460 filozofët e 100 shkollave protestuan jo vetëm pa sukses por edhe më keq. Të gjithë u ekzekutuan. U dogj një

sistem shkollash filozofike të hapura rreth 3 shekuj para akademisë së Platonit dhe Liceut peripatetik të Arsitotelit. Digjen ato shkolla të Dao, Konfucios, Ging-ut, përballë mësimeve të të cilave fragmentet e parasokratikëve, postsokratikëve, atomistëve, pitagorenjëve dhe gjithë substitutëve tyre e deri tek Aristoteli duken si ato përrallat e bukura të 1001 netëve.

#### IV.

Një vit pas vdekjes së perandorit August, pasardhësi i tij Tiberiues modifikoi të ashtuquajturin «lex maistetatis» për ta bërë atë instrument legal jo vetëm kundër atyre që bënë tradhti të lartë kundër Republikës, por veçanërisht për të përndjekur ata që sillnin ide të reja, shkrime ose përhapnin deklarime të dyshimta apo fyese kundër perandorit dhe pushtetit të tij. Ky ligj i mundësoi Tiberius-it që përveç «policisë» së rregullt ta formojë një aparat prej mijëra delatores-ësh (denoncues privatë), curiosish (informantët) dhe frumentarii-shë (sigurues indiciesh) – sistem ky i aq identik me aparatën e censurave të mëvonshme e deri sot.

Shumica e teatrove u mbyll me dhunë; për çdo ditë në shesh organizoheshin ceremoni të djegies së manuskripteve dhe papiruseve me drama, tragjedi, fragmente filozofike dhe formula magjish sybilike; autorët kritikë u kryqëzuan periferisë së qyteteve, ndërkaq atyre të tipit të historianit Titus Labenius, që njiheshin në gjithë perandorinë, pas djegies së librave u lejohej e drejta për ta vvarë veten. Përmasën e krimeve dhe orgjitë piromane të Tiberiusit për të shkrumbuar gjithçka të regjistruar nga epokat para se të merrte pushtetin ai, e dokumenton Tacitusi[3] kur për imtueshëm përshkruan procesin kundër historianit tjetër Cremutius Cordus [Viti 25], në padinë e të cilit krimi ishte se «ka lavdëruar Brutusin dhe Cassiusin, të cilët nuk



i preferon Tiberius». Dënimi djegia e autorit dhe librave. Fjalja e fundit e Cordusit: «E nesërmja do t'ia jap nderin çdonjërit aq sa e meriton». Zgërdhirja e Tiberiusit të sigurte të ketë djegur dhe zhdukur gjithçka që do të mbetej shenjë e gjenit i shkoi huq. E bija e Cordusit kishte prodhuar kopjueshëm të gjitha veprat e të atit, të cilat i botoi vite më vonë gjatë periudhës së Caligula-s.

Njëra nga reformat ndër kryesoret të perandorit romak [284 deri 305] me origjine iliro-dalmate Dioklecian ishte asgjësimi i sekteve religjioze, nga të cilët druante se ato synojnë teokratizimin e aparatit të perandorisë. Krishterimin, Diokleciani e konsideronte si fënë më të rrezikshme në këtë drejtim. Kjo ndoshta edhe për shkak të gjendjes në shtëpinë e tij: gruaja e tij Aleksandra dhe e bija Valeria ishin të krishtera. Për arsye se kisha katolike më vonë institucionalizoi «martirët e librave të shenjtë të Abitinës në Numidia» u zbuluan me këtë edhe përmasat e pogromit dioklecian jo vetëm ndaj librave por edhe ndaj njerëzve që i pandehte të jenë në shërbim të fesë në fjalë. Frika e Dioklecianit nuk doli aspak irracionale. Pas rënies së tetrarkisë së ngritur nga Diokleciani dhe ardhjes së Konstatinit [306 bis 337] nga Naissus-i Dardanisë, religjioni i krishterë u shpall zyrtari i imperium romanum-it. Për periudhën e Konstantinëve nuk ka të dhëna përndjekjesh të religjioneve tjera dhe shkollave filozofike, përveç vrasjeve spektakolare të të birit Crispus dhe gruas së tij Fausta nga vetë dora e tij. Se kjo ndryshon pas vdekjes së tij dëshmojnë kronikat e viteve 364-378, gjatë sundimit të perandorit Valens. Ky urdhëron të digjen gjitha librat, papiruset e pergamenat që kishin të bëjnë me «artes liberales», të së drejtës dhe magjisë. Dy tri vite më vonë, më 380-390 në Romë nuk ekzistonte më asnjëra nga 29 bibliotekat dhe asnjë shkollë e vetme. Urdhrin për shkretëtimin dhe «dezinfektimin» e Romës nga dija, librat, piktorët, skulptorët e jep Ipeshkvi famëkeq Theophilos nga Aleksandria. Përkundër teorive aspak të besueshme që pandehin se arabët në vitin 642 dogjën Muzeionin\*\*\*\* famoz të Aleksandrisë, të

ndërtuar nga Leka i Madh, biblioteka me 400 mijë manuskripte dhe 90 mijë tuba e mijëra pergamenë, digjet në të njëjtën kohë me tempujt Serapis në vitin 416 dhe atë nga një grup fanatikësh të krishterë, të cilët gjatë djegies së bibliotekave ekzekutuan edhe filozofen dhe shkencëtaren Hypatia.

Kontinuiteti i kësaj përndjekjeje, djegie, gjenicidi dëshmohet aq bindshëm edhe në periudhën e Justinianit [527-565], i cili mbyll edhe akademitë e fundit dhe vret e djeg çdo shkronjë që nuk përkon me të vërtetat biblike. Herezia si «*corpora delicti adversus deus*» legalizohet në kohën e trakasit me origjinë nga prefektura pretoriane e Ilirisë, nga fshati Taor i komunës së sotme maqedonase Zelenikovë. Nga kampanjat e Justinianit kryq e tërthorë perandorisë së tij më së tepërmi e pësojnë perënditë, statujat, tempujt paganë që lidhnin rajonin me epokat mionikomikene.

Që nga kjo kohë e deri në shekullin XX Kisha Katolike dhe ajo Lindore bëjnë luftë të pandërprerë jo vetëm kundër çdo dijeje profane por ndërkohë nisin të djegin masivisht edhe Talmudin bashkë me hebrenjtë. Ndërmjet viteve 1207 deri në vitin 1256 janë të dokumentuara qindra ekzekutime të ashtuquajtura «*in maxima multitudine*», ku librat radhiteshin në gërmadha dhe digjeshin krahas autorit në flakë dhe atë në Paris, Londër, Zürich, Berlin, Romë e gjetiu.

## V.

Pandemia e shuarjes së materialiave orale e dokumentare nuk ishte e kufizuar vetëm në pjesën të nofkuar si oksidentale të globit. Sa më shumë dëshmi të fiksuara në gur a lëkurë që kishte brenda një gjuhosphere aq më shumë persekutime ndodhnin. Me tu ngjitur në pushtet Kalifi i tretë islam Uthmān ibn ‘Affān i mbiquajtur Osman e Usman [644–656] urdhëroi mbledhjen e të gjitha haditeve të fiksuara bashkë me «hafizët» dhe mistikët që i

ligjëronin ato përmendsh dhe dogji çdogjë dhe çdokë që mbante mend qoftë edhe një vers të vetëm. Atë që ekspertët e doktrinës parafilozofike islame sot nuk e përmendin me qëllim është se në këtë ofensivë disavjeçare libra – e njerëzdhjegëse më shumë se «hafizët» postmuhamedanë e pësuan shkollat, filozofitë, kulturat e identitetet jo-islame si ato perse, mesapotamike, babilonase, ato të Damaskut, Armenisë, Egjiptit, Kaukazit, Basras e gjithandej ku ky perandor depërtoi me devet e tij. Në të gjitha këto rajone të vëna nën kontroll prej tij, duke filluar nga viti 649, dënohej me vdekje pa asnjë lloj gjyqi përdorimi i çdo përmbajtjeje tjetër përveç «Kuranit të standardizuar» nga Uthmani.[4] Kjo politikë e djegies dhe vrasjes – me përjashtim të antikalfateve të ngritura nga Umayyadët e Cordoba-s dhe Almohadëve [912-1236], të cilët pranoheshin vetëm nga al- Andalus dhe pjesë të Maghrebit – u ndoq edhe nga abasidët, fatimidët dhe në fund osmanët. Në pushtim e sipër të Indisë më vitin 1193, afgani trukmeno-bengalez Muhammad bin Bakhtiyar Khilji (paraardhësi i turqve të mëvonshëm) shkatërron Universitetin budist Nalanda, më të madhin e kohës, duke masakruar mijëra mësues, studentë dhe murgj me një spektakël morbid mortal: studentët i bënë spektatorë të nisjes së zjarrit ku digjen mësuesit e tyre, ndërsa popullatën spektatore të një megafushe studentësh pa koka. Djegia e librave të universitetit, për shkak të volumit të madh të tyre shkruhet të ketë zgjatur disa javë. Të njëjtën dramë e pëson edhe Biblioteka e madhe e Assasinëve në Alamut nga mbreti mongol Khan Hylegy, i cili më 20 dhjetor të vitit 1256 djeg gjitha veprat shkencore, letrare, përveç disa kopjeve të Kuranit. Se qasja e tillë kriminele ndaj dijes ishte «mjet tradicional pushteti» dëshmohej edhe në fazat kur bota islame bie komplet në duar të osmanëve, më vonë turkmenëve. Në vitin 1485 Sulltan Bajaziti II ndaloi shkrimin e çdo gjëje jokuranore me dorë dhe shtypin e kuranit me makina (në Europë përhapje shtypi mekanik i librave). Shkelja e këtij ligji sanksionohet me vdekje. Të njëjtin ligj e zgjeron edhe me masa më drastike – përfshirja

edhe e familjes në dënim – i biri i tij në vitin 1515. Ligji mbeti në fuqi deri në shekullin XVIII.

## VI.

Nga shekulli XVI, në mënyrë intensive dhe nisur me rastin e Girodano Bruno – s si exempli causā, dy kishat europiane si ajo katolikja ashtu edhe ajo protestantja, do ta bëjnë «rend dite» djegien e bibliotekave, gjenive, intelektualëve, ikonave, pikturave dhe çdogjëje që kishte të bëjë me artet e lira dhe shkencën. Veçanërisht gjatë shekullit XVII, gjatë fazës së ashtuquajtur «kthesë kopernikane», d.m.th. kalimit nga botëkuptimi gjeocentrik në atë heliocentrik, kishat e asistuar me monarkët që gjendeshin nën «bekimin» e tyre masakruan një numër të madh bibliotekash dhe dënuan me vdekje ose ua dogjën veprat, dëbuan e burgosën mijëra reformatoreve (shkencorë jo brendareligjioz) lart e poshtë Europës dhe duke filluar nga shekulli XIX në mënyrë masive edhe në Amerikë. Sa për të ilustruar përmasat e krimit ndaj librit dhe arteve mjafton të përmendet vetëm rasti i priftit jezuit sllovak Antonín Koniáš [1691–1760], në gjashtë veprat e të cilit numëron hiç më pak se djegien e 60 mijë titujve me përmbajtje «heretike».[5] Në këtë e sipër natyrisht nuk duhet lënë anash krimin përmbyllës bashkë me mesjetën e errët nga ana e jakobinëve gjatë revolucionit francez: bashkë me bibliotekat religjioze Robespierre urdhëroi të digjet edhe çdo fletë, libër apo dokument që përmendte, lavdëronte monarkët e mëhershëm francez ose që kishin sunduar mbi këtë rajon.

Ishin gjithë këta lartë kontributorët e asaj që sot nga shkenca konsiderohet si «epokë e mesjetës së errët» për shkak të mungesës së faktografisë e relikteve për ta përshkruar kohën qoftë edhe nëpërmjet stacioneve minimale antropokulturore të saj.

## VII. NGA SHEKULLI XX E KËTEJ

Sa më tepër që shtrihej ideja iluministe hartës së Evropës aq më shumë pakësoheshin djegiet e bibliotekave dhe gjenive qyteteve perëndimore. «Index Librorum Prohibitorum» i Kishës katolike tkurrej vazhdimisht dhe nuk bindte më asnjë monarki a republikë që ta ekzekutojë atë seriozisht. Censorët dhe inkuizitorët e lënë pa «profesion» mirëpo, patjetër se të kërkonin arsye e shkaqe tjera për ta vazhduar zejen e tyre. Pandemia e inkuizicionare kësaj radhe u spostua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1873 Anthony Comstock [1844–1915] themeloi shoqërinë «New York Society for the Suppression of Vice» (Shoqëria për luftimin e veseve), e cila organizonte konfiskimin e librave, të cilat pasi vuloseshin me logon e organizatës (një libër duke u djegur) digjeshin në turma me një ceremoni të veçantë si në kohën e heretikëve dhe shtrigave. Ngase Comstock ishte njëkohësisht edhe Shefi i «United States Postal Inspection Service» nuk ndodhte që kësaj organizate t'i ikë nga zhbërja asnjë libër që shkelte parimet e puritanëve. Çdo libër, revistë a gazetë që ndonjë postieri apo puritani nën komandën e kësaj organizate t'i dukej jomorale, erotike, blasfemike, darviniste i jepej saora zjarrit. Sipas sociologut të Northwestern University Nicola Beisel[6] Comstock dhe organizata e tij deri në vitet e 50-ta të shekullit XX dogjën 15 tona libra, shkatërruan 150 pllaka shtypshkronjash dhe rreth 4 milionë fotografi e piktura. Në të njëjtën kohë edhe një krim i përmasave «aleksandrine» do të ndodhë në Europë, konkretisht në Löwen të Belgjikës: Në ditët e para të Luftës së Parë Botërore, më 25 gusht të vitit 1914 trupat perandorake gjermane tmerruan botën duke bërë hi e pluhur Bibliotekën e Universitetit Löwen, ndër dhjetëra mijë librat gjendeshin edhe mijëra dorëshkrime origjinale nga Mesjeta e Vonshme, të cilat u zhdukën përgjithmonë..

## VII. KOMUNIZMI DHE NAZIZMI

Duke filluar nga nisja, përfundimi e pas LPB-së akterët e luftës kundër dijes dhe arteve nuk do të jenë më vetëm religjionet, kishat, ummat, ordot, papatët, perandorët, monarkët e kalifët por nazistët, fashistët dhe komunistët dhe listuar me emra të veçantë ishin; stalinët, hitlerët, mussolinët, franco-t dhe epigonët e tyre që gjallojnë edhe sot e kësaj dite cepave e qendrave, të cilat sa për t'ia siguruar kontinuitetin kësaj drame humane shërbejnë si centrifuga mentalitetesh të çorientuara nga e gjithë bota, drejt krimeve të reja.

Nazizmi, fashizmi dhe komunizmi po aq brutalisht si perandorët e shekujve ante et post christum natum besonin se mund ta riprogamojnë njeriun (duke eksperimentuar me kafshët sipas kondicionimit klasik të Pawlowit) në atë mënyrë që ai mund t'i vesh vetes një habitus novum sipas ofertave, urdhëresave dhe ndalesave të doktrinës së diktatorit. Diktaturat moderne besonin të jenë më të zgjuara se paraardhëset e tyre dhe Njeriun e tyre të Ri nuk donin patjetër ta ndërtojnë mbi kadavrat dhe hirin e të vjetërve për t'i krijuar feniksët e tyre, por ishin aq mendjemadhe saqë besonin në kondicionimin, modifikimin, tjetërsimin absolut të tij në zombi, në epigon të përkryer të Njëshit qoftë ai Führer-i, Sekretari i Parë i Partisë, Presidenti apo lideri (i sotëm) pa e ekzekutuar fare.

## VIII. STALINI

Masakra e parë e kësaj «epoke të re» ndaj autorëve, bibliotekave dhe autorëve do të zhvillohet nga bolshevikët gjatë luftës qytetare ruse, viteve 1918 -1922. Lidhja e Shkrimtarëve Proletarë përpilonte lista të zeza shkrimtarësh e poetësh në «Krasnaja nov»

[1921] dhe «Novi mir» [1925], kështu duke bërë paralinçimin e atyre që nesër do vdisnin gulagjeve. Nëpërmjet «studimeve» si «Psikologjia, refleksologjia dhe marksizmi», të cilat botoheshin nga Instituti «Profesorët e Kuq» shpalleshin katalogët me kritere për krijimin e «inteligjencies së re komuniste», të cilën më vonë detajisht dhe në formë ligji e shpalli Stalini në Kongresin e Rinisë Komuniste (Komsomol) në maj të vitit 1928. Që nga ai Kongres rinis edhe njëherë në formën më kriminele vrasja e gjithë shkencëtareve dhe intelektualëve që i bënin bisht ideologjisë së re. Në vitin 1937 u ekzekutuan publikisht 9 gjenetikët kryesor të vendit. Wawilov, ai që bënte listat denoncuese paraprakisht gjeti katër vite më vonë të njëjtin fat nën akuzën të jetë «spiun anglez». Sidomos historia e shkrimtari të romanit të njohur «Nëna», Maksim Gorkij tregon më së miri se ç'nënkuptonte në praktikë, në përditshmëri, kriteret e Stalinit për «intelektualin e ri». Pas hapjes së arkivave të KGB u zbulua se shërbimet sekrete bolshevike ruse kishin vrarë të birin e tij më 1934 me qëllimin për ta thyer psikikisht të atin. Ndër autorët që dy revistat e lartpërmendura kritikonin, ndër qindra të tjerë, ishin edhe Ossip Mandelstam, Boris Pasternak, Wlladimir Majakovski, Isaac Babel e plotë të tjerë. Mandelstam burgoset dy herë në vitin 1934 dhe 1938. Gjatë arrestimit të dytë kishte në vizitë shkrimtaren e njohur Anna Achmatowa që kishte ardhur nga Leningradi. Gjatë gjykimit të parë në dosje i shkruante: «poeti duhet izoluar e keqtrajtuar por jo vrarë». Në gjykimin e dytë ndryshon përcaktimi i shtetit ndaj tij: «duhet izoluar dhe s'duhet patjetër mbajtur gjallë». Për 26 dhjetorin e vitit 1939, ditës së vdekjes së poetit, qëndron ky shënim në aktet e KGB-së: «Për këmbës së kufomës ia lidhëm një pllakë druri me emrin dhe mbiemrin, e hudhëm mbi kufomat tjera në kerrin që e sollti në varrin masiv pranë logorit»[7]. E shoqja e tij Nadeschda mëson për vdekjen e të shoqit veç disa muaj më vonë dhe atë rastësisht, pasi i kthehet një letër me shënimin: adresati i vdekur! E njëjta i ndodhë Isaac Babel-it dhe autorëve të formatit si filozofi Jan Sten – që kishte

pas nxënës vetë Stalinin – Boris, Guber, Iwan Katajew dhe 1600 shkrimtarëve tjerë tashmë të identifikuar e mijëra e mijëra tjerëve, të cilët ngase jo të njohur gjithaq atëkohë as që u dihet emri[8].

## IX. HILTLERI

Paralajmërimin e spastrimit në Gjermaninë e Hitlerit e bëri ministri i tij Goebels më 15 mars të vitit 1933, kur botoi një listë me mijëra emra aktorësh, piktorësh, filozofësh, poetësh e intelektualësh, veprat e të cilëve kërkonte që të ndalohen për hir të luftimit të «shpirtit të keq jogjerman». Fatkeqësisht elitat gjermane nuk kishin gravuar në kujtesë alarmin e Heinrich Heines në tragjedinë e tij «Almanson» [1823] kur shkruante: «Ajo ishte vetëm paraloja, atje ku digjen librat, digjen në fund edhe njerëzit», qysh me nisjen publike të djegies në tonelata të librave, shesheve të qyteteve nga NSDAP. Menjëherë pas nisjes së këtyre autodafeve publike, Gestapo shpërndau në të gjitha pikat kufitare një libër të trashë me fotografi të atyre që po u panë të arrestohen dhe ekzekutohen menjëherë. Listës i printe fotografia e Albert Einstein-it me një shënim ndër portret ku qëndronte rreshti: «Ende i pa varur»![9] Sidomos pas djegies publike të 1052 librave të Emil Nolde-s – këtëj ithtari të tërbuar të nazistëve – rra kambana e fundit se së shpejti do të nis përndjekja dhe vrasja e shumicës së inteligjencies së atëhershme. Freud, Paul Klee, Feininger, Beckman, Lieberman, Adorno, Horkheimer, Arendt, Brecht dhe qindra të tjerë u shpëtuan dhomave të gazit pasi ikën në kohën e duhur Amerikës, Skandinavisë, Anglisë, Francës e ku jo. Shumë të tjerë mirëpo vranë veten siç bëri Walter Benjamin, i cili nga frika se spanjollët e pikës kufitare Portbou do t'ia dorëzojnë Gestapos vrau veten. Vetëvrasje bënë edhe qindra të tjerë që ishin tashmë larg Gjermanisë por që nuk duronin më tmerrin si Stefan Zweig në Petropolisin brazilian. Ata që megjithatë ktheheshin e



pësonin si poeti, teologu dhe antinazisti Dietrich Bonhoefer, ekzekutimin e të cilit Hitleri e urdhëroi nga bunkeri ku kaloi ditët e fundit të tij.[10]

Krahas holokausti ndaj hebrenjve qëndron teza se ndodhi edhe holokausti që nazistët ushtruan ndaj gjenive, dijes, pikturave, muzeve, skulpturave, kulturave dhe jo vetëm në Gjermani por gjetiu ku shkelën me çizmet e tyre. Se rënia e sistemit nuk donte të thotë se së paku kësaj lloj epidemie i shpëtoi bota. Në Spanjën e Francos, pushteti i të cilit vazhdoi deri më 1975, që nga dekreti i parë i tij në vitin 1936 e deri në rënien e pushtetit përveç 600 mijë njerëzve të vrarë, 400 mijë të ikurve ekzekutimin e mijëra intelektualëve u zhdukën – dhe nuk gjenden më – edhe 2663 tituj veprash që nga ekspertë konsiderohen të rëndësishme për historinë dhe kulturën latino-amerikane.[11]

## EKSKURS: NË SFERËN SHQIPTARE

Është i vetmi krim i përmasave universale epsitemocidi ku nuk mungojnë edhe shqiptarët, të cilët përndryshe pogromeve tjera të llojit i ka kursyer fati. Shikuar pra historinë globale dhe atë rajonale nga ky kontekst edhe shqiptarët kanë pjesën e vetë në këtë histori të epistemocidit dhe gjenicidit. Gjatë diktaturës moniste të Enver Hoxhës deri më tash janë dokumentuar 199 shkrimtarë të ekzekutuar apo të katapultuar përjetësisht llogoreve vdekjeprurëse. 50 të pushkatuar, të varur, të vdekur në tortura. Visar Zhiti[12] – njëri nga vetë viktimat sollti një libër dokumentar për përmasat e krimit shqiptar në këtë luftë të despotit kundër poetëve, shkrimtarëve, dijes ndryshe nga doktrina e tij. Edhe pse libri trajton vetëm martirët e kolonisë aq modeste letrare për nga numri e jo të gjithë viktimave të mundshme edhe të fushave tjera të shkencave e arteve, ajo është një sintezë e tmerrshme e pjesëmarrjes shqiptare në krimin kundër arteve, lirisë së fjalës dhe progresit shkencor të

kulturosferës shqiptare. Ky kapitull i historisë shqiptare ende nuk është trajtuar aq sa duhet e më thellë për të kuptuar në total përmasën e krimit të diktaturës shqiptare prandaj edhe nuk na lejohet më shumë se të hedhim edhe njëherë në eter pyetjen: a ishte kuksiani Havzi Nelaj [1988] vërtetë poeti i fundit, i varuri i fundit në kulturosferën shqiptare? Apo në forma tjera ai vazhdon të rivaret e rivritet edhe më tej?

## X. SOT

Më rënien e bllokut socrealist dhe regjimeve fashiste në Amerikën latine u besua të zhduken sistemet e fundit të mëdha e të përmasave globale ku ndodhte epistemocidi, liria e fjalës dhe ku ende ekzekutoheshin e vareshin autorë shesheve publike. Festë e parakohshme. Statistikat më të reja që na vijnë nga vende të ndryshme e të mëdha flasin një gjuhë krejtësisht ndryshe. Ashtu siç nuk kuptuan gjermanët, rusët dhe tjerët me kohë alarmin kur po si në kohën e inkuizicionit rinisën djegiet masive të bibliotekave, librave dhe njerëzve edhe njeriu i kësaj të ashtuquajture postmodernë nuk lexoi me vëmendje sinjalet e reja të rikthimit të epistemocidit, vrasjes së kujtesës dhe djegies së shenjave kulturologjike humane.

Me gjysmëzë u protestua kur talibanët në Afganistan rrënuan statujat mijëvjeçare budiste; kur dogjën dhe shkatërruan muzeun e fondacionit Nasir-i-Kushra në Kabul, i cili në vete konservonte libra shumëshekujsh në arabishte, poashtu dhe anglishte, botime origjinale nga Firdausi Shahname, kompletin e veprave ismailite të Hasan Sabbah-ut dhe papirusë të Aga Khan-it. Poaq me indiferencë u përcoll edhe djegia e Institutit Oriental të Sarajevës me një fond arkivor prej 250 mijë metrash. Aty u zhdukën edhe dokumentet origjinale të kompletit «manuscripta turcika» (7156 dokumente që dëshmonin periudhën osmane në Ballkan), arkivin e Vilajetit (220 mijë dokumente të shek.XIX), kompletin

e sixhileve (shek.XVII-XIX) tapi të shumta dhe 5236 kodeke (manuskripte origjinale). Materialet e Institutit ishin të një rëndësie kolosale për të gjitha viset që kishin qenë nën sundimin osman, ngase dokumentohej sjellja e popujve, strukturat demografike dhe intensiteti i rezistencave dhe pakteve gjatë periudhës osmane, të cilat materialia ish RSFJ i tubonte atje. Tash dihet se Instituti u dogj me urdhër direkt nga postpashalluku i Beogradit.

Se kjo traditë epistemocidi, sidomos e intensifikuar në periudhën e mbiquajtur postfaktike, vazhdon në forma tjera por gjithmonë aktive, dëshmon edhe kjo kronikë e kondensuar këtu: Në janar të vitit 2001 Ministria egjiptiane e Kulturës, duke iu nënshtruar presionit të fundamentalistëve dogji në stilin e paramesjetës 6000 kopje të përmbledhjes poetike homo-erotike të poetit Abu Nuwas. Në mars të po të njëjtit vit prifti amerikan Georg Bender i kishës «Harvest Assembly of God» me «delet e tij» të Pittsburg-ut bëri një mal me romanet e serisë Harry Potter dhe romanet e J.K.Rowlings dhe u vuri zjarrin i ndjekur nga mediat kryesore të SHBA-ve. Më 30 mars të vitit 2005 deputeti provincial turk Mustafa Altinpinar urdhëroi mbledhjen e gjitha librave të Orhan Pamukut për t'i djegur në sheshe të krahinës Isparta, në shenjë proteste kundër kritikave të tij rreth mospranimit të gjenocidit ndaj armenëve dhe politikës antiturke. Në vitin 2006 politikanë italianë si Ceccano dhe Gizzi pas një mbledhjeje disaditëshe të romaneve të Dan Brown-it i dogjën ato duke mbajtur pankartën lartë «ne mbrojmë Jezusin». Në maj të vitit 2008 në qytezën izraelite Or Yehuda u mblodhën qindra kopje të Dhiatës së Re dhe u dogjën publikisht nga nxënës të një shkollë ekstra-ortodokse judaike me pretekstin të jenë blasfemike pasi propagojnë Jezu Krishtin të ishte mesia i pritur. Në 9-vejetorin e sulmit të 9. Shtatorit 2001 predikuesi evangjelist amerikan Terry Jones në Florida bëri apel për djegien masive të Kuranit, gjë që u parandalua për shkak të protestës së madhe

ndërkombëtare. Që nga dekreti i presidentit turk dhe ministrive të tij religjioze për të dëbuar gjitha teoritë shkencore të bazuara në darvinizëm, jashtë syve të opinionit, për çdo ditë digjen tonelata me libra shkencorë që nuk përkojnë me mësimet e islamit. Pjesa dërmuese e intelektualëve kritikë gjendet burgjeve dhe i vetmi nobelist i gjallë ecë nga gjykimi në gjykim, i paditur nga fundamentalistët si antiturk. Për likuidimet si në Indi as që dimë gjë, ngase askush nuk mund t'i përgjigjet pyetjes kush vërtet është ende në burg e kush nuk është më fare hiç. Sipas PEN-it Ndërkombëtar, raportit të tij për 2017[13] ishin 700 raste që i regjistroi gjatë vitit: 28 shkrimtarë e poetë të ekzekutuar, 33 të dënuar me vdekje, 202 të dënuar me burgje të rënda në kushte paravdekëse, 148 gjenden në procese gjyqësore. Prijnë vendet nga Azia, Afrika si dhe Turqia e Kina. Dhe për optimistët dhe tifozët e hiperdigjitalitetit që këmbëngulin se zhdukja e shenjave, gjurmëve është e pamundur për shkak të fiksimit elektronik të dijes le t'iu shërbejë ky rast: Nën kontrollin e presidentit amerikan Donald Trump u zhdukën fare dhe pakthyesëm të gjitha informacionet e mbledhura me dekada nga portali e Shtëpisë së Bardhë dhe Departmanetit Environmental Protection Agency (EPA) që kishin të bëjnë me problemet klimatike dhe mbrojtjen ekologjike të planetit.

## XII. KONKLUSIONE DHE PËRFUNDIM

Nga kjo ekspozë mësojmë se diktatorët epistemocidalë nuk kanë lënë asnjë doktrinë, asnjë ideologji, filozofi e religjion pa e përdorur për ta imponuar atë si «anima mundin» personal – patjetër jo për hir të njerëzve e doktrinave, por për tu bërë zoti panoptik i masave nën sundim. Faktet për vazhdimin e këtij epistemocidi vazhdojnë edhe sot të jenë kokëforta ngado që lexohen e lokalizohen. Llogaritur përtej fatkeqësive individuale dihet e shihet se kush në plan afatgjatë fitoi luftën: Gjenitë! Po, megjithatë si është e mundur që kjo ushtri e pafuqi dhe e

paarmatosur gjenish të triumfojë mbi gjitha ato perandori që me armë, flakë e terror domin e duan t'i shuajnë të pashenjë nga kujtesa humane? A ka fakt më të madh se ky për të dëshmuar se nuk shuhet fryma?

Diktaturat i vrasin gjenitë fizikisht. Frymën e tyre mirëpo nuk e zhbëjnë dot. Është ky fakt i padiskutueshëm edhe për këtë epokën tonë? Jemi pesimist sa i përket kësaj teze. Jo se jemi të bindur se asnjëherë nuk do të pushojë tentimi i shumicës së partive, liderëve dhe ideologjive që të kushtëzojnë eksternalizimin e subjektit sipas modelit të tyre, të kërkojnë militimin ekskluzivisht në favor të idëbotës që përfaqësojnë, kështu duke vazhduar të prodhojnë shumica që aq shpejtë shndërrohen në flashmob-e të pakontrollueshme; jo se edhe mëtej do lindin liderë të tipit që do të kërkojnë nga ithtari i tij t'i multiplikojë antivlerat për pushtetin e tij, të jetë pra ai «dinamiti» që ua eksplodon ndrysheqenien tjerëve, siç thoshte Nietzsche për veten; një tjetër problem, i sjelle nga postmoderna dhe i paralajmëruar Hannah Arendt e sidomos nga Adorno e Marcuse, e diagnostikuar nga shumica e analistëve elitare të «postmodernës» si Sloterdijk, Hahn, Zhizhek, Agamben, Gray, Beck, Bolz, Nancy e dhjetëra të tjerë është burimi i pesimizmit tonë se ky epistemocid një ditë të mundet përfundimisht.

Adorno kishte vërtet të drejtë me prognozën e tij kundër industrializimit të kulturës dhe frymës nga kapitalizmi i çdo lloji. Ky sendëzim i frymës dhe çdo vlere del të jetë arma shumë më perfide, më e sofistikuar dhe efektive se sa gjitha idetë tjera gijotinske të dijeve dhe arteve, armë që mund të definohet troç kështu: imunizimi i masave me të keqen dhe banalizimi i dijeve! Duke e shndërruar edhe frymën në mall për treg, kapitalizmi i tipit neoliberal ia del të parashuajë en mase çdo gjeni që në embrion. Prandaj trendi sot është kryeprapë: jo më si më parë kur masat duhej të mësonin nga gjenitë, në këtë shekull të fundit

prodhojnë vetëm atë që konsumojnë masat për të mbijetuar materialisht. Gjithçka matet e vlerësohet sipas peshores utilitariste të kapitalit, monedhës. Gjersa në shtetet me mirëqenie të lartë poeti, shkrimtari i frymës «së rëndë» përqeshet dhe konsiderohet si një relikv kohësh të shkuara, në vendet e pazhvilluara ai vritet, përheshtet, asocializohet po në ato forma klasike si në kohën e perandorit kinez Qin dhe askush nuk bënë zë. Receta e epistemocidit postmodern neoliberal pra është jo martirizimi i gjenit por banalizimi dhe injorimi i tij deri sa ta vrasë veten ose të vdes i pavërejtur e në anonimitet. Më e çuditshmja e kësaj lufte metodash ndryshe është se duket sikur edhe gjenitë t'i jenë dorëzuar këtij fati, gjithandej në lindje, perëndim, veri, në të gjitha kulturosferat pa dallim. Intelektualët janë dorëzuar përballë fuqisë e magjisë së komfortit aq rëndë sa që nuk manifestojnë më ideale dhe ky zhvillim s'ka se si mos të përfundojë me pyetjen se cili ishte kuptimi i luftës dhe shuarjes me koshiencë i gjithë atyre martirëve të historisë së dijes? Simbioza e intelektualit me injorancën në favor të pushtetit të tiranëve dhe minidespotëve të kohës sonë?

*(Kjo histori e shkurtër mbi epistemocidin dhe gjenitë e martirizuar i kushtohet poetit martir kuksian Havzi Nela, i varur nga regjimi komunist shqiptar më 10 gusht të vitit 1988)*

### **Burime dhe sqarime**

*[\*] Epistemë donë të thotë, njohje, dije. Epistemocid është fjalëformim i autorit nga dy fjalët Epistemë dhe Gjenocid dhe që nënkuptohet: si vrasje kronike apo masive (të përnjëhershme apo si proces) me paramendim e dijes, njohjeve që mundësojnë sa më shumë liri për njerëzit, masat dhe shoqëritë, respektivisht si tendencë masive për banalizimin apo zhdukjen e bartësve të saj si shkencëtarët, poetët, intelektualët, artistët, shkrimtarët, nga një grup, shtet, sistem politik apo forma tjera turmo-afine. Shpesh në tekst si asistent i këtij termi*

*përdoret edhe Gjenicidi!*

*\*\* Këtë term përdorim për t'i ikur reduktimit zhanëror të gjeniut*

*\*\*\* Bëhet fjalë për ndërtuesin e ushtrisë 7 mijëstatujëshe nga balta (= terrakota) gjatë të cilit aksion u viktimizuan rreth 700 mijë skllavë përgjatë 36 viteve. Qm besonte se pas vdekjes së tij do të jenë ata ushtarë që do ta mbrojnë Kinën e sapo bashkuar dhe atë nga armiqtë.*

*\*\*\*\* Këtë fake-teori Arabët të kenë djegur bibliotekën e Aleksandrisë e formulon historiani Abdulfarrad i shek. XIII pas konvertimit të tij në të krishterë. Sipas legendës së tij Emiri Umar ibn al-Chattâb jep urdhrin që librat të përdoren për nxehjen e rreth 4000 pishinave publike të Aleksandrisë.*

[1] Dominik Müller: *Schriftsteller im Zeitalter des Hindunationalismus*. DR. 2016.

[2] Peter-Matthias Gaede: *Das große Buch der Archäologie: Expeditionen in mythische Welten*. Hamburg 2003; F. 123

[3] P. Cornelius Tacitus: *Annales*, 4. 34f.

[4] Claude Cahen: *Der Islam – vom Ursprung bis zu dem Anfängen des Osmanischen Reiches*, në: *Fischer Weltgeschichte*. Völl. 14.

Frankfurt am Main 1968 & Wilferd Madelung: *The succession to Muhammad. A study of the early caliphate*. Cambridge University Press, Cambridge 1996: F. 78–140 & Ulrich Haarmann (Ed.): *Geschichte der arabischen Welt*: 2001.

[5] Werner Fuld. *Das Buch der verbotenen Bücher – Universalgeschichte des Verfolgten und Verfemten von der Antike bis heute*. Berlin, 2012: F.67

[6] Nicola Beisel: *Imperiled Innocents Anthony Comstock and Family Reproduction in Victorian America*. Princeton University Press, 1997.

[7] Peter Watson. *Das Lächeln der Medusa -: Die Geschichte des modernen Wissens*, 2003: F. 509 versioni iBook.

[8] Robert Gallately. *Lenin, Stalin, and Hitler: The Age of Social Catastrophe*, Londër, 2007.

[9] Peter Watson. *Das Lächeln der Medusa...F. 475.*

[10] Werner Maser. *Adolf Hitler – Legende, Mythos, Realität*. B. 13. München 1993

[11] Robert O. Paxton. *The Anatomy of Fascism*. New York: 2004.

[12] Visar Zhiti. *Panteoni i nëndheshëm ose letërsia e dënuar*. Tiranë: 2011.

[13] <http://www.pen-international.org/.../The-PEN-Report-Creativit...>